

## SUKSESE TË MËDHA

DR. CIRIL PISTOLI  
MINISTER I SHËNDETËSISË

U bënë 20 vjetë që kur atdheu i ynë u çlirua, mbas një luftë të ash-për me pushtuesit nazi-fashistë italianë dhe gjermanë si dhe me reaksionin e brëndëshëm. Revolucioni ynë triumfoi dhe u vendos Pushteti Popullor. Gjatë 20 vjetëve populli ynë luftoi kundër provokacioneve të armiqve jashtëm, kundër blokadave të imperialistëve dhe revizionistëve modernë, nuk u përkul përparrë asnjë vështirësie dhe duke pasur në një dorë kazmën dhe në tjetër pushkën iu vu punës pér ndërtimin e shqëritës së re, pa shfrytëzues dhe të shfrytëzuar. Dhe në tërë këtë rrugë, gjatë luftës pér çlirimin dhe pér ndërtimin e socializmit në vëndin tonë, organizatorë dhe drejtuese ishte Partia e janë heroike, me në krye shokun Enver Hoxha.

Ndryshime të mëdha janë kryer gjatë kësaj kohe në jetën e vëndit tonë, të mahnitëshme mund të themi. Po kështu edhe në shëndetësi janë arritur suksese të mëdha që as mund të krahasohen me paraçlirimin.

Para çlirimit shëndetësia ishte një sektor pothuajse i braktisur. Vjetjan e shëndetit të popullit dhe fonde shumë më të mëdha caktohenë pér mbajtjen e oborrit mbretëror. Me ato mjete financiare shumë të varfëra, kuptohet se nuk mund të ngrihej dhe të mbahej veçse një rrjetët — ose 8 shtretë pér 10.000 banorë, 40 ambulanca, nga të cilat 14 në fshatra, si dhe ndonjë institucion tjetër ambulator. Atëherë punonin vjetëm 102 miekë — ose një mjeq pér 10.000 banorë, 32 mami dhe disa kuadro preqatishënh jashtë shtetit.

Populli i shtypur dhe i shfrytëzuar me një shërbim shëndetësor shumë të kufizuar, vuante nga sëmundje shoqërore dhe epidemike. Kështu p.sh. në vitin 1938, vdisnin 17.8 veta pér çdo 1000 frymë dhe zgjatja mesatare e jetës ishte vetëm 38.8 vjetë.

Ky ishte, me fjalë të pakta, kuadri i përgjithshëm i shëndetësisë para çlirimit në regjimet antipopulllore.

Me vëndosjen e Pushtetit Popullor ky kuadër ndryshoi rrënjesisht. Filloi një punë e madhe, epike, pér ngritjen e shoqërisë së re socialiste, pér përmirësimin e vazdueshëm të mirëqënies të popullit. Një kujdes i madh iu kushtua mbrojtjes së shëndetit.

«Mirëqënia e popullit, nuk mund të kuptohet pa mbrojtjen e shëndetit të tij» (Enver Hoxha). Mbi këtë koncept është bazuar politika shëndetësore e Partisë dhe e Qeverisë, gjatë këtyre 20 vjetëve. Kjo politikë është e shprehur në ligjin që i siguron popullit të drejtën e ndihmës mjekësore pa pagesë, në planet pesëvjeçare që janë konkretizuar në institucionet e shumta shëndetësore të ndërtuara, dhe në preqatitjen e një ar-

Shëndetësia e jonë u ndërtua mbi parimet e shëndetësisë socialiste: karakter shtetëror i shëndetësisë, ndihmë mjekësore pa pagesë për popullin, zhvillimi me plan; drejtim profilaktik; pjesëmarje e vetë masave punonjëse në mbrojtjen e shëndetit të tyre.

E mbështetur mbi këto parime dhe mbi potencialin ekonomik gjithnjë në ritje të vendit tonë, (për mbrojtjen e shëndetit shpenzohen më shumë se 5% e buxhetit të shtetit) shëndetësia e jonë pati një zhvillim të madh, megjithëse nga e kaluara trashëgoi tepër pak.

Sado mjete të shumta financiare që Pushteti Popullor të ndante për mbrojtjen e shëndetit të popullit, detyrat e mëdha që i dilnin përparrë shëndetësisë sonë, nuk mund të zgjidheshin pa siguruar kuadrot e nevojshme mjekësore. Politika largpamëse e Partisë për preqatitjen e kuadrove në përgjithësi, në rastin tonë e kuadrove mjekësore, ishte kygi që do të zgjidhë me sukses problemin e shëndetësisë në vëndin tonë. Për këtë arësyё në fillim u ngritën kurse e shkolla për preqatitjen e kuadrove të ulëta mjekësore (infirmiere etj.) dhe më vonë, në vitin 1949 u ngrit Politeknikumi Mjekësor, i cili preqatit kuadro të mesme, të profileve të ndryshme. Në vitin 1952, me vendim të Komitetit Qëndror të Partisë dhe të Qeverisë, u ngrit edhe Institutu i Lartë i Mjekësisë sot Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Kështu sot në vënd preqatiten të gjitha kuadrot e mjekësisë duke përfshirë mjekët, stomatologët dhe farmacistët. Kjo është një fitore e madhe. Kështu, nga një repart i vogël punonjësish të mjekësisë para çlirimt, sot në të gjitha anët e atdheut punon një numur i madh kuadrosht mjekësore të shkallëve të ndryshme që as mund të krahasohet me paraluftën. Kundrejt 428 kuadrove të 1938-tës, sot punojnë 6667 kuadro mjekësore dhe kemi një mjek për çdo 2300 banorë.

Pushteti Popullor cakttoi mjete financiare kolosale për ngritjen e institucioneve shëndetësore, që sot janë shpërndarë në të gjithë anët e Republikës tonë. Institucione profilaktike, institucione për ndihmë mjekësore ambulatore, institucione me shtretër, institucione të specializuara që nuk njiheshin para çlirimt sot janë ngritur në vendin tonë në numër të madh dhe i sigurojnë popullsisë ndihmë mjekësore të specializuar dhe të kualifikuar. Ne sot kemi 57 shtretër për 10.000 banorë.

Profilaksia është drejtimi i shëndetësisë sonë. Për mbrojtjen e shëndetit të popullit, merren masa të gjëra shtetërore. Industrializimi socialist, kolektivizimi i bujqësisë në baza socialiste, ndërtimi të mëdha të banesave dhe të objekteve të tjera komunale, revolucioni kultural që u bë në vëndin tonë, të gjitha këto kanë për qëllim përmirësimin e vazdueshëm të konditave të jetesës, rritjen e mirëqënies së popullit, forcimin e shëndetit të tij. Krahas këtyre masave, janë marrë të he masa profilaktike ngushtësishët mjekësore. Për këtë qëllim janë ngritur institucione mjekësore profilaktike si qëndra sanitare epidemiologjike (që tanë funksionojnë në përbërjen e drejtorive të shërbimit shëndetësor, D.SH.SH. në rrethe) konsultore për gra e fëmijë, dispanceri, preventorième etj. Qëllimi i këtyre institucioneve është parandalimi i sëmundjeve, nëpërmjet masave preventive mjekësore, nëpërmjet të ngritjes së nivelit të kulturës sanitare të masave punonjëse.

Për vetë karakterin e Pushtetit tonë popullor, për arësyё të gjëndjes së trashëguar nga e kaluara, nuk mund të mos përballoheshe problemi i sëmundjeve shoqërore dhe i sëmundjeve epidemike-masive, organizimi i luftës kundër tyre. Në saje të masave të gjëra që janë marrë në këtë fushë, janë arritur rezultate të shkëlqyera. Në vëndin tonë nuk vërtetohen

më forma të fshehta sifilizi. Tuberkulozi po shkon duke u pakësuar çdo vit, në mënyrë të vendosur dhe vdekjet nga të gjitha format e tuberkulozit në vitin 1963 ishin 1.3 për 10.000 banorë. Malaria, kjo sëmundje shëkullore në vëndin tonë, që dërmonte shëndetin e popullit, praktikisht është çrenjosur dhe po i kalon historisë. Poliomieliti është sëmundje te-për e rrallë dhe jemi në prak të zhdukjes së tij krejtësisht. Po pakësohet shumë difteria, po zhvillohet me sukses lufta kundër sëmundjeve të tjera.

Kujdes i veçantë i kushtohet mbrojtjes së shëndetit të nënës e fëmijës. Përveç të drejtave të mëdha shoqërore që gjëzojnë tek ne gratë gjatë shtatëzansë dhe pas lindjes, për mbrojtjen e shëndelit të tyre është ngritur një rrjetë institucionesh shëndetësore të posaçme. Në të gjitha qytetet janë të ngritura konsultoret për gra shtatëzane dhe fëmijë të moshave deri në 3 vjeç, në fshat numëri i tyre po shkon duke u shtuar më shpejtësi në këto vitet e fundit. Veprimtaria e këtyre institucioneve shkon nga viti në vit duke u zgjeruar. Çdo vit shtohet numëri i shtretërve për lindje në institucionet tona shëndetësore, ne kemi sot 1296 shtretër të tillë. Numëri i grave që lindin në shtëpitë e Lindjeve shkon duke u shtuar dhe në vitin 1963, afro gjysma e grave kanë lindur në shtëpitë e lindjes, të cilat para qëllimit nuk ekzistonin.

Për fëmijët e moshës deri në 3 vjeç sot kemi 9652 vënde në çerdhet. Për to janë organizuar edhe çerdhe speciale. Për mbrojtjen e tyre nga sëmundjet ngjitetë bëhen vaksinime në masë. Për mjekimin e fëmijëve, në spitalet tona ka më shumë se 1000 shtretër. Për fëmijët e moshës deri një vit barnat jepen pa pagesë edhe kur ata mjekohen në shtëpi.

Në sajë të masave të gjëra që janë marrë për mbrojtjen e shëndetit të tyre, vdekjet e fëmijëve të moshës së gjirit janë ulur. Nuk shihet më influenza e stinës së verës në vdekjet e fëmijëve. Në vitin 1939, vdekjet e fëmijëve gjatë muajve të stinës së nxehitë (qershori-korrik-gusht) përbënin 38.9% të vdekjeve të vitit në fëmijët, kurse në vitin 1963 — 26.4% që është një përqindje thaujse e barabartë me atë të tremujorëve të tjerë. Barku i fëmijëve nuk zë më vëndin e parë në shkaqet e vdekjeve në fëmijët e moshës së gjirit. Kjo ka ardhur si pasojë e përmirësimit të ndihmës mjekësore, të higjenës, të rritjes së nivelit të kulturës sanitare të nënave.

Fshatarësia e merr ndihmën mjekësore në institucione shëndetësore të fshatrave, por edhe në ato të qyteteve. Për çdo 3-4 fshatra ka një ambulancë, ka gjithashtu edhe spitale, shtëpi lindje. Por plenumi i Qershorisë 1963 i K.Q. të P.P.SH. konstatoi se ndihma mjekësore në fshat ka mbetur prapa asaj të qytetit dhe vuri si detyrë të ngushtojmë dalngadalë, por në mënyrë të vendosur, ndryshimin që ekziston në shkallën e shërbimit mjekësor midis qytetit dhe fshatit. Kështu u muarën masa dhe u organizua ndihma mjekësore në bazë lokaliteti dhe po fuqizohen institucionet e shëndetësisë në fshatrat me kuadro të mesme dhe të larta. Sot në fshat punojnë 1270 kuadro mjekësore, ndërmjet të cilave 86 mjekë, 392 mami etj. Deri në 1966 çdo lokalitet fshatar do të ketë së paku një mjek, çdo 3-4 fshatra 1 mami etj.

Rezultatet e mëdha që janë arritur gjatë 20 vjetëve në fushën e ekonomisë dhe të kulturës, puna e madhe që është bërë për mbrojtjen e shëndetit të popullit, pasqyrohen më së miri në treguesit demografikë. Në vitin 1963 rritja natyrale e popullsisë ishte 29‰, në krahasim me 16.9‰ në vitin 1938; vdekjet e përgjithësime 10‰, në krahasim me 17.8‰ në 1938,

zgjatja mesatare e jetës afro 64 vjet në krahasim me 38,8 në 1938. Këto shifra flasin shumë qartë për ndryshimet e mëdha që janë kryer në jetën e vëndit tonë gjatë viteve të Pushtetit Popullor nën udhëheqjen e urtë marksiste leniniste të Partisë, të Komitetit të saj Qëndror, me në krye shokun Enver Hoxha.

Megjithëse mjekësia e jonë është e re dhe shumica dërmuese e kuadrove janë të reja dhe të ngarkuara me detyra të shumta në shërbim të mbrojtjes të shëndetit të popullit, ata nuk e kanë lënë mbas dore punën shkencore dhe për këtë ata kanë patur vazhdimi iktuar min e Partisë dhe të Qeverisë. Puna shkencore është zhvilluar në bazë të planit tëaprovuar nga Qeveria me problematikë të caktuar, sidhe jashtë tij. Sidomos kuadrot e fakultetit të mjekësisë i kanë kushtuar kujdes këtij problemi. Puna e bërë për realizimin e këtij plani, disertacionet e mbrojtura përtë fituar titullin e kandidatit të shkencave mjekësore, sesionet e ndryshme shkencore të organizuara deri tanë nga fakulteti i mjekësisë dhe temat e referuara në to, flasin për interesin e kuadrove mjekësore për shkencën mjekësore, për seriozitetin gjithënjë e më të madh që po i kushtohet këtij problemi shumë të rëndësishëm. Me konditat gjithënjë e më të mira që ù krijohen, me një bazë më të gjërë eksperimentale, laboratorike dhe me një punë më sistematike, kuadrot tonë, sidomos ato të fakultetit të mjekësisë do të kenë mundësi të hyjnë më thellë problemeve dhe do ta shpien kështu përpara edhe shkencën tonë të mjekësisë.

Kuadrot e mjekësisë sonë i kanë kryer me ndërgjegje detyrat e mëdha që u ka ngarkuar Partia për mbrojtjen e shëndetit të popullit. Ata do ti shtojnë edhe më shumë përpjekjet e tyre dhe do ti kenë parasysh vendimet e Pleniumit të korrikut 1964 të Partisë.

Punonjësit e mjekësisë sonë nuk do të kursejnë asgjë, dhe me shpirt sakifice, veti e luftëtarëve kundër vdekjes, do të punojnë përtë ngritur në një shkallë më të lartë mjekësinë tonë, ashtu siç porosit Partia, në interes të popullit.

## **MBI MORTALITETIN NGA TUBERKULOZI NË SHQIPËRI** (Mortaliteti nga T.B.C. në disa qytete)

**Doc. SHEFQET NDROQI**  
**Katedra e Terapisë Fakultetit**  
**(shef. Doc. JOSIF ADHAMU)**

Gjendja epidemiologjike e tuberkulozit në një vënd të caktuem, sot vlerësohet në bazë të disa treguësve të veçantë si ai i infeksionit, i morbiditetit, i endemicitetit, i mortalitetit dhe i letalitetit.

Por në praktikë, për t'i caktue të gjithë ato treguesa nuk është një punë e lehtë, bile e pamundur. Vetëm ai i mortalitetit është më pak i vështirë pse vdekjet tashma rregjistrohen rregullisht kudo. Sa për saktësinë e shkakut të vdekjes (d.m.th. të diagnozës së vdekjes) kjo është një tjetër punë. Këtu fillojnë e dalin vështirësítë.

Autorët e ndryshëm epidemiologë, deri vonë për të studjuen gjendjen e T.B.C. dhe për të dhanë një ide mbi të, kanë pasë si ndihmë kryesore të dhanat e mortalitetit. Nga këto të dhana kanë ba krahasime dhe kanë nxjerrë konkluzione të vlefshme mbi gjendjen e t.b.c., zhvillimin e përhapjen e tij, si dhe masat që duhen marrë për luftimin e kësaj sëmundjeje.

Regjistrimet e vdekjeve dhe statistikat mbi mortalitetin nga t.b.c. kanë fillue në Europë në gjysmën e dytë të shekullit XIX-të megjithëse për disa qytete gjenden elementa statistikore edhe ma të vjetra.

Pikërisht po në këtë periudhë edhe t.b.c. ka fillue të përhapet ma tepër në këtë pjesë të botës.

Në bazë të atyne të dhanave, autorë të ndryshëm si Gottstein, Hafbauer, Flatzek etj. (7) kanë nxjerrë konkluzionin se tuberkulozi, sikur edhe sëmundjet e tjera infektive, ka një dekurs me fazat e tij të zhvillimit. Fillon, zhvilohet, përhapet tue mrrjtë një kulm, pastaj zbret.

Këto periudha në tuberkuloz janë shumë të gjata dhe nga një herë është vështirë me i caktue. Siç do ta shohim jo shumë rrallë, ato paraqisin zik-zake.

Dekursi gjatë viteve të kësaj sëmundje influencoitet nga një seri faktorësh me karakter ekonomiko-social dhe me nivelin higjeno-sanitar të popullit. Krahas me këta faktorë, ka autorë (si Given Peurl etj. (7) të cilët mendojnë se faktorë me randësi në uljen dhe pakësimin e t.b.c. është seleksionimi natyral që bahet gjatë viteve, kështu që me kohë ato që e kalojnë sëmundjen fitojnë një lloj rezistence ose imunitet relativ që e trashigojnë.

Pra, simbas shumicës së autorëve në përhapjen ose pakësimin e t.b.c. kemi dy seri faktorësh:

Faktorët ambiental ose ekzogjen dhe faktorët konstitucional ose endogenjë: i pari me karakter social dhe i dyti me karakter biologjik.

Shumica e autorëve pranon se në tuberkuloz randësinë ma të madhe e kanë faktorët ambientalë ekonomiko-socialë.

Asht nji fakt i provuem se ushqimi i keq, lodhjet, vuejtjet, konditat e këqija të banimit e të punës, mungesa e edukatës higjeno-sanitare etj. favorizojnë zhvillimin dhe përhapjen e t.b.c.

Në periudhën e luftës ku lodhjet, vuajtjet, mizeria, mungesa e ushqimit, shpërnguljet etj. janë ma të theksueme, edhe plaga e tuberkulozit në popull randohet.

Me gjithë këtë edhe influenca e faktorit endogen konstitucional e biologjik nuk mund të përjashtohet.

Zhvillimi i indekseve epidemiologjike e sidomos i mortalitetit flet në këtë drejtim.

Prof. L'Ettore (9) në konferencën e XIV t'Unionit Internacional kundra tuberkulozit (New Deli), tue u bazue me të dhanat statistikore botnore ekzistuese dhe në disa konsideracione biologjike e shoqërore, përcaktoi në relacionin e tij, se fenomeni tuberkular zhvillohet në bazë të tre ligjeve epidemiologjike:

1) I pari ligj, asht ai i *evolucionit* në kohë, që tregon ekzistencën e nji dinamizmi evolutiv të tuberkulozit, me tri fazat e zhvillimit: faza epidemike, e tranzisionit dhe endemike.

2) I dyti asht ai i *ambientit* që tregon bashkëekzistencën e faktorëve biologjike e sociale në fenomenin tuberkular.

3) I treti asht ai i *përhapjes* ose i zhvillimit në hapësirë, ai tregon shpërndarjen gjeografike të mortalitetit t.b.c. në botë në lidhje me konditati demografike, sanitare e sociale të grupimeve (popullatave) njërezoze.

Sigurisht ky ligj (spacial) nuk mund të jetë fiks dhe mund të "ndryshojë me ndryshimin e konditave që e krijojnë. Gjithashtu dhe ligji i parë, ai i kohës me tri fazat e tij (epidemike, e tranzisionit dhe endemike) mund të ndryshojë fazat e tij, të paraqiten ma të shkurtina ose ma të gjata, të përzihen po në një shtet prej një vëndi te nji tjetër, simbas zhvillimit të tij dhe simbas luftës që i bahet tuberkulozit.

Përparimet që ka ba shkenca si në fushën e terapisë (me zbulimin e antibakterialeve), ashtu dhe të profilaksisë (me hovin që ka marrë bioprofilaksia (B.C.G.) e kimio-profilaksia) dhe masa se deri ku do të aplikohen në praktikë në vëndet e ndryshme, mund të bajë që këto ligje të ndryshohen shumë. Këto ndryshime do të mvaren shumë dhe me ndryshimet e sistemeve shoqërore që do të vendosen në vendet e ndryshme.

Kështu p.sh. vendosja e nji sistemi socialist në nji vënd të caktuam do të krijojë kondita të reja sanitare e sociale dhe do të lejojë të merren masa të tilla në luftën kundra t.b.c. që do të pengojë zhvillimin ritmik të fazave, (epidemike, e tranzisionit dhe endemike), që përmend prof. L'Ettore, dhe të kapérxehen këto faza; gjithashtu aplikimi në masë i kemio-antibioterapisë do të ndryshojë karakteret e këtyre ligjeve dhe kuptimin e tyre, p.sh. ulja e mortalitetit jo paralel me indekset e tjera epidemiologjike.

Konkrektisht për vëndin tonë:

Na tue njohtë mirë ligjet epidemiologjike të t.b.c. tue studjue mirë gjendjen epidemiologjike të tuberkulozit në Shqipni do të shohim se ku gjendemi dhe do të dimë ma mirë me marrë masat përkatëse.

Nga disa të dhana statistikore paraprake që disponojnë, dhe nga disa sondazhe që janë ba (Dr. Kalmari, Dr. Ndraqi, Dr. Lito) del se në Shqipni ka zona ku t.b.c. është në fazën epidemike, ka të tjera që kanë hy në fazën e tranzisionit, ka dhe lokalitete ose fshatra ku t.b.c. nuk është përhapë dhe mund të thuhet se janë virgin nga kjo sëmundje.

Simbas rastit, na mund ti drejtojmë forcat tona dhe ta ndalojmë zhvilimin e fenomenit tuberkular të zakonshëm.

Një nga indekset me randësi të epidemiologjisë së t.b.c. siç e theksuam qysh në fillim, ashtë ky i mortalitetit.

Kemi kërkue me gjetë të dhana sa më të vjetra në këtë drejtim, porse para çlirimt nuk kemi gjetë gja.

Anuari statistikor i botuam nga Drejtoria e Shëndetësisë e asaj kohe prej vitit 1927-1932 dhe prej 1933 deri në 1940, jep vetëm vdekjet e përgjithëshme si numur por jo me shkak vdekjeje.

Studimi i Dr. Kërcikut «Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shekullit XVIII ( )» nga faqia 168-176 tue folë mbi tuberkulozin në Shkodër gjatë kësaj periudhe paraqet disa të dhana statistikore mjaft interesante të nxjeruna nga regjistrat e kishës mbi të vdekunit katolikë në qytetin e Shkodrës.

Citimet e ndonji autori të huaj si A. Degrand, Santucci etj. (<sup>1</sup>) qि kan vizitue e ka shkruejtë mbi Shqipnën përsa i përket t.b.c. dhe vdekjeve nga kjo sëmundje, nuk kanë asnjë vlefte shkencore pse bazohen vetëm në thanie e në përshtypje.

Studimi i mortalitetit në Shqipni nga ana e jonë ashtë ba kryesisht nga skedat qि ka disponue Drejtoria Statistikore dhe asht përqëndrue në radhë të parë në skedat e qytetarëve që në shumicën dërmuese të rasteve ishin me raport mjeku dhe jo në fshatarë ku zakonisht ka mungue mjeku.

Kemi zgjedhë dhe klasifikue skedat jo simbas vendit ku ka ndodhë vdekja por simbas vënd rregjistrimit në gjendjen civile, kjo për të evitue që shifrat dhe indekset e mortalitetit të mos fryhen ndër ata qytete ku gjinden Institutet anti t.b.c. siç janë senatoriumet dhe stacionarët e dispanserive.

Prandaj, në llogaritjen e indekseve të mortalitetit nga T.B.C. ne kemi parasysh në fillim popullsinë simbas regjistrave të gjendjes civile, pastaj kur ligji i pashaportizimit ka hytë fuqi dhe ka eliminuar deridiku diskordancat në mes vënd banimit të zakonshëm dhe vënd regjistrimit, atëherë ne kemi marrë parasysh popullatën simbas vënd-banimit ose të pashaportizimit, kjo d.m.th. nga viti 1959.

Kështu dëshitet e vdekjes janë punue simbas vënd-regjistrimit në gjendjen civile për vitet e para deri në vitin 1958 dhe pastaj nga viti 1959 simbas vënd-banimit të zakonshëm d.m.th. i ati qि praktikisht asht po ai i pashaportizimit.

Tue dashtë me qenë sa më ekzakt kemi kërkue dhe kemi gjetë nga Drejtoria e Statistikës popullsinë e qyteteve në studim për çdo vit dëshsimas seksit kurse simbas moshës kjo nuk ishte e mundur me u gjetë veçse në vitet kur asht ba regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë d.m.th. 1950, 1955 e në 1960. Kështu ne muanë koeficientin mezatar ose  $\frac{1}{10}$  e popullsisë të vitit 1955 për çdo grup moshe p.sh. 12% e popullsisë i përket grup moshës 1-4 vjeç etj. dhe me këtë koeficient llogaritëm popullsin në gjith grup-moshat për çdo vit dëshsim.

Megjithëse regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë paraqet popullsinë prezente sa për llogaritjen e grup moshave për indeksin e mortalitetit simbas grup moshës na menduam, tue mos pasë si me ba ndryshe, se do të jetë e mjaftueshme.

1) Degrand A. Souvenir de la Haute-Albanie — f. 26; Santucci St., Un viaggio nell'Albania Settentrionale, 1916, f. 8-63.

Nga sa u tha deri këtu shifet se q'veshëtirësi kemi gjetë me llogaritë indekset e ndryshme të mortalitetit në bazë të popullsisë.

Tash mbas këtyre konsideracioneve të përgjithëshme statistikore le të diskutojmë materialin tonë.

## I. MBI DISA TË DHANA TË MORTALITETIT T.B.C. PARA VITIT 1950

Na kemi shfletue skedat e vdekjes që dispononte Drejtoria e statistikës qysh prej vitit 1947.

Këto, në fillim nuk ishin të plota jo vetëm në drejtim të diagnozës por duket se mungojnë dhe mjaft skeda.

Megjithëkëtë, na i përpunuem dhe nxorëm disa pasqyra simbas sekisit, grup-moshës, profesioneve dhe të ndarë në qytetarë e fshatarë. Nga këto rezulton se numuri total absolut i vdekjes nga t.b.c. në tre vjetet e para 1947-1948-1949 nuk del i naltë, por kjo nuk i përgjigjet së vërtetës për arsyet që thamë dhe kryesisht se shumë skeda ishin pa diagnozë. Me gjithë këtë, kjo punë për këto tre vite nuk ishte e koton pse na vlen për të pa për atë sasi të studjueme, ndarjen e tyne simbas sekisit, grupmoshës dhe profesioneve.

Ktu na nuk mund të nxjerrim indekse në bazë të popullsisë por vetëm ndarjen në shifra absolute.

Nga këto del se në vitin 1947 në disa rrëthe kemi 235 vdekje t.b.c. të denonsueme me diagnozë mijeku nga këto 127 meshkuj ose 54%, dhe 98 femna ose 46% me peshë specifikë afro 18% (vdekje nga t.b.c. në krahasim me vdekjen e përgjithëshme).

Në vitin 1948 kemi 374 vdekje nga t.b.c. të denonsueme, nga këto 217 meshkuj dhe 157 femna ose 58% meshkuj me 42% femna, 229 qytetarë dhe 145 fshatarë, ndonse popullsia fshatare asht shumë ma e madhe rreth 80%, por njikohësish nuk duhet harrue se vdekjet pa diagnozë janë shumica dërmuese fshatare.

Simbas profesioneve, kemi në shifra absolute 77 fëmijë, 10 studentë, 39 bujq, 24 punëtorë, 20 nëpunës, 6 ushtarakë, 25 artizanat, 103 shtëpiakë 62 të ndryshmë.

Simbas grup-moshave, vdekjet ma tepër i shohim në fëmijët nën 10 vjeç dhe në grup moshë 20-29 vjeç.

Në vitin 1949 kemi 459 vdekje nga t.b.c. të denoncuem dhe nga këto 301 meshkuj ose 65.5%, dhe 158 femna ose 34.5%, 363 qytetarë nga të cilët 238 meshkuj e 125 femna ose 65.5% meshkuj dhe 34.5% femna dhe 96 fshatarë nga këta 60 meshkuj ose 62.5% e 36 femna ose 37.5%.

Në këtë vit disponojmë skedat nga të gjitha qytetet dhe janë të plotësueme më tepër me diagnozë. Kështu që për qytetarët shifrat që disponojmë i afrohen të vërtetës, prandaj mund të provojmë me nxjerr indekset përkatëse për qytetarët në krahasim me popullsinë.

Kështu kemi nji mortalitet nga t.b.c. për qytetarët 145,3 për 100.000 banorë, nga këta ma shumë meshkuj se femra, e konkretisht meshkuj 180.7 për 100.000 banorë m. dhe femna 101.1 për 100.000 d.m.th. afro për 100 femna 180 meshkuj (është marrë për bazë popullsia e vitit 1950).

Simbas grup-moshave vërejmë se: gjithsej në shifra absolute mortaliteti ma i naltë asht në grup-moshat 0-5 vjeç dhe 15-30 vjeç. Sa për profesionet asht parimi shët e pamundun me dhanë nji indeks të drejtë në

shifra relative me 100.000 banorë, por mund të jepim shifra absolute për çdo profesion e konkretisht tue përjashtue fëmijët e nxanësit kemi

	Gjithësejt	Meshkuj	Femra
Bujq .....	51	49	2
Puntorë .....	54	51	3
Nëpunës .....	44	37	7
Ushtarake .....	14	14	—
Zanatçi .....	28	25	3
Shtëpijake .....	115	—	115

Po të krahasojmë vdekjet e qytetarëve në vitin 1949 nga t.b.c. e çdo formë me vdekjet e qytetarëve nga çdo sëmundje tjeter, d.m.th. peshën specifikë do të kemi  $10.42\%$ , kjo  $\%$  duhej të ishte pak më e naltë pse kemi një numur vdekje t.b.c. të pa deklarueshme.

(Këtë  $\%$  e kemi nxjerrë nga vdekjet e qytetarëve nga t.b.c. me vdekjet totale të qytetarëve me diagnozë të shkakëtueme nga gjithë sëmundjet e tjera).

## II. MBI TË DHANAT TONA NGA VITI 1950

Të dhanat statistikore që disponohen deri në vitin 1949 nuk ishin të mjaftueshme me nxjerrë konkluzione me vlefte shkencore.

Prandaj ne muarëm në konsideratë për studim më të hollësishëm ata mbas vitit 1950 pse atëherë materialet që disponoheshin ishin deri diku ma të plota. Themi deri diku pse edhe këtu gjejmë një sërë pëngesash.

Nga vdekjet në përgjithësi kemi një numur të madh skedash pa diagnoza dhe kjo veçanërisht për fshatarët për arësyte të mungesës së mjekëve.

Me zgjanimin e shërbimit mjekësor dhe të rrjetit të instituteve mjekësore dhe me shtimin e numurit të mjekëve filloj të rritej  $\%$  e numurit të vdekjeve me diagnozë. Kështu prej  $19.3\%$  që ishte në vitin 1950, arriti në  $50.2\%$  në vitin 1963 dhe ma hollësish në  $92.3\%$  për qytetarët dhe  $39\%$  për fshatarët.

Me gjithë këto, përmirësimet në drejtim të diagnozës prapë nuk janë të mjaftueshme për ti konsiderue të vlefshme indekset që do të dilshin nga shifrat e mortalitetit nga t.b.c. në përgjithësi pse akoma  $\%$  e vdekjeve pa diagnozë asht e naltë.

Prandaj na muarëm për studim vetëm vdekjet në qytete, ku ka dhe ka pasë gjithnjë mjekë, dhe ku skedat me diagnozë kapërcejnë  $80\%$ . Nji gja të tillë kanë ba edhe shumë autorë të tjerë, kur kanë dashtë me studju mortalitetin t.b.c. p.sh. Lapina (10, 11) në B.S. etj.

## MBI MORTALITETIN T.B.C. NË DISA QYTETE TË SHQIPËRISË

Studimi i jonë këtë radhë përqëndrohet kryesisht mbi mortalitetin nga t.b.c. në disa qytete të Shqipërisë, ku na kemi pasë të dhana të rregullta prej 1950 deri 1961. Konkretisht ne e kemi studjuar më parë mortalitetin nga t.b.c. në këto 6 qytete: Tiranë, Shkodër, Korçë, Vlonë, Fier, Lushnje dhe këtë për çdo vit dhe gjatë 12 vjetave rresht. Kurse për një numur ma të madh qytetesh gati të gjith qytetet me një popullsi mbi  $85\%$  popullsi qytetarë (dhe efektivisht në 15 qytete) e kemi studjuar vetëm për

vitet 1950-1951 e 1960-1961, për vitet e tjera të dhanat nuk ishin të plotë dhe prandaj nuk i llogaritëm.


Me gjithë këtë njojha e dy grupviteve (1950-51 e 1960-61) me një interval 10 vjetësh, na ka ndihmuar me ba krahasime të vlefshme.

Njojha e mortalitetit nga t.b.c. në pjesën më të madhe të popullatës qytetare (86,6% në 15 qytete në vitin 1950) nuk na tregon mortalitetin nga t.b.c. në gjithë popullatën e Shqipnisë, por me gjithë këtë tue ba disa krahasime të disa qyteteve të vogla me karakter fshatar dhe tue pasë parasysh disa sondazhe epidemiologjike në disa fshatra ashtu dhe dinamikën e vdekjeve të fshatarëve në qytete, mund të arrijmë në disa konkluzione dhe të krijojmë një ide aproksimative mbi mortalitetin në Shqipëri.


Sido qoftë, studimi i mortalitetit nga t.b.c. në disa qytete të Shqipërisë si po mundohemi me paraqitë, mendojmë se do të vlejë të pakën si kontribut mbi epidemiologjinë e t.b.c. në vëndin tonë.

Ky sigurisht nuk asht pa të meta por asht një hap i parë që studimtarët e tjerë do ta plotësojnë e do ta vazhdojnë.

Pra le të analizojmë të dhanat tona. Me këto ne kemi formue një seri pasqyrash simbas formës, grup-moshës, seksit për çdo vit e grup vitesh për çdo qytet e grup qytetesh etj. Në bazë të këtyre pasqyrave kemi krijuar grafikët e ndryshëm:



Grafiku Nr. 1. — Dinamika e indekseve të mortalitetit T.B.C. Çdo formë për 12 vjet në 6 qytete



Grafiku Nr. 2. — Mortaliteti i T.B.C. Çdo formë M.F. në 6 qytete në 12 vjet për çdo 3 vjet (indeksi për 100 000 banorë)

1) *Dinamika e mortalitetit të çdo forme gjatë 12 vjetëve*. Kështu tue shkue grafikun Nr. 1 që paraqet ndryshimet për çdo vit në 12 vjet të indekseve të mortalitetit për t.b.c. të çdo forme në 6 qytetet e studjueme konstatojmë se gjatë kësaj periudhe *mortaliteti nga t.b.c. ka shkue progresivisht tue u pakësua me përjashtim të disa zikzakeve.*

Nga viti 1950 më 1961 pakësimi asht ulë 82%, ulje e kënaqëshme që mund të krahasohet me shumë vënde të përparueme, pamvarësish se indekset tonë të mortalitetit qëndrojnë akoma të nalta.

Kështu p.sh.

Në Itali nga viti 1948 në 1959 kemi një zbritje prej 73%	
» » » 1946 në 1958 » » » 76.8%	
Në SHBA » 1948 në 1958 » » » 76.7%	
Në Francë » 1948 në 1958 » » » 65.25%	
Në Çekoslovaki 1952 në 1962 » » » 62%	
Në Rumania » 1951 në 1961 » » » 76.3%	
Në Shqipëri » 1950 në 1961 » » » 82%	

Mortaliteti nga t.b.c. çdo formë për të dy sekset në 6 qytetet e nalt-përmëndura në vitin 1950 ka qënë 151 për 100.000. Ky indeks qëndroni gati i pandryshueshëm për tre vjetë dhe në vitin 1953 ban një zbritje të theksueme jo të zakonëshme prej 38.4%. Kjo ulje e konsiderueshme këtë vit shpjegohet kryesisht nga hyrja në përdorim e antibakterialit të rizoniazidit. Ky fënomen asht vu re nga shumë autorë të huaj dhe në vënde të ndryshme si F. Blanco (4) etj.

Në vitin 1954 mortaliteti nga t.b.c. ngrihet pak, ndoshta nga fakti që në disa raste të rënda izoniazidi i përdorur për një kohë të shkurtën e të pamjaftueshme i zgjatin jetën për pak kohë këtyne të sëmurëve por nuk pengoi që të vdisnin pas një viti.

Sidoqoftë mbas këtij viti vazhdon zbritja e mortalitetit ngadalë por në mënyrë progresive deri në vitin 1958. Në këtë vit kemi një ulje tjetër ma të fortë 76.8% në krahasim me vitin 1950 dhe 42.7% në krahasim me vitin 1957.

Kjo zbritje mund të shpjegojet jo vetëm nga fakti se në këtë vit kemi një pakësim të mortalitetit të përgjithshëm por ma tepër se në këtë vit filloj zgjanimi i përdorimit të izoniazidit në format më të rënda dhe në raste kronike ose që ishin konsiderue si inkurabile.

Por mbas kësaj ulje të theksueme të vitit 1958 kemi një rritje në vitin 1959. Kjo shpjegohet kryesisht nga se një pjesë e të sëmurëve të randë e kronikë që do të vdisnin në vitin 1958 ju zgjat jeta nga antibakteriale dhe vdiqën në vitin 1959. Mbas këtij viti vazhdon prapë ulja e mortalitetit nga t.b.c. që ka fillue në vitet e parë të këtij 12 vjeçari dhe mërin në 28 për 100.000 në vitin 1961.


Po të analizohet me kujdes grafiku i dinamikës së mortalitetit në këto 12 vjet, do të shihet se ulja e mortalitetit nuk asht e influencueshme vetëm nga antibakterialet por edhe nga një seri faktorësh të tjera me karakter ekonomikë-social.

Ulja e theksueme e mortalitetit në vitin 1953 e në vitin 1958 mund të spjegojet në pjesën më madhe nga aplikimi i antibakterialeve kryesisht i isoniazidit por ulja progresivo në mes të këtyne dy zbritjeve shpjegojet edhe nga përmirësimi i mirëqënies së popullit, i edukatës higjeno-sanitare dhe i masave anti t.b.c. të gjithanëshme që janë marrë përf Luftët kundrejt t.b.c. Për të mbështetë këtë tezë le të marrim indekset e mortalitetit

për çdo grup vitesh trevjeçar, atëherë shofim një ulje progresive të rregulltë pa shkallëzime të fortë të mortalitetit. (shif grafikun Nr. 2).

Indeksi mesatar i mortalitetit t.b.c. në 6 qytete në këtë periudhë asht 83 për 100.000.

Ulja mezatare vjetore në këtë periudhë është 6.8%. (nxjerrë nga grup 3 vjeçarët).



Grafiku Nr. 3 — Dinamika e indeksit (për 100 000 banorë) e mortalitetit nga T.B.C. Cdo formë simbas seksit në 12 vjet në 6 qytete.

2) Mortaliteti simbas seksit dhe moshës. Tue shikue grafikun (nr. 3) dinamikës t'indekseve të mortalitetit nga t.b.c. simbas seksit në 6 qytete në studim gjatë 12 vjeteve për çdo vit vrejmë se vdekjet në meshkujt janë gjithënji ma tepër se në femra dhe kjo për çdo vit me përjashtim të vitit 1960 dësh grafiku ndjek gati të njajtin drejtim për çdo seks. E njejtë gjë shifet dësh grup 3 vjeçarë (shif grafikun nr. 2).

Po të shqyrtojmë vdekjet nga t.b.c. gjatë tre vjeçarit 1950-1951-1952 dhe 1959-1960-1961 simbas seksit dhe grup moshës (shif grafikun nr. 4) do të shofim se në mes të këtyre dy periudhave kemi një zbritje të mortalitetit nga t.b.c. në të dy sekset por jo paralele.

Gjithashtu vihet re se prej moshës 1 deri 34 vjet ndryshimet në mes sekshit mashkull e femrën janë të neglizhueme në dy periudhat bile në periudhën e dytë nga mosha 15 vjeç deri në 34 vjeç, mortaliteti t.b.c. në sekxin femrën asht pak ma i naltë. Kjo mund të shpjegohet nga disa faktorë të veçantë fiziologjik si puberteti, materniteti, puerperiliteti e laktacioni që dobësojnë organizmin dhe favorizojnë zhvillimin e t.b.c. në femra. Këtu nuk ekskludoohen dhe faktorët ambiental e ekonomiko-sociale.


Mbas moshës 35 vjeç shifet se në dy periudhat vdekjet nga t.b.c. predominojnë krejtësisht në sekxin mashkullor. (Shif grafikun Nr. 4).

Indeksi mesatar për çdo seks për periudhën 12 vjeçare asht përmeshkujt 108.7 për 100.000, përfemnat 62.2 d.m.th. se predominoon sekxi mashkull (nxjerrë nga grup moshat 3 vjeçarë).

Kjo mund të shpjegohet nga fakti se sekxi mashkull asht ma në kontakt me shoqërinë dhe ka ma tepër mundësi infektimi.

Deri tashti ka qenë burri qytetar që punonte jasht dhe në kontakt me shoqërinë kurse grueja qëndronte në shtëpi, por tash që grueja merr pjesë kudo me të drejta të barabarta çdo të ngjaj? Kjo do të varet dhe nga masat që do të merren dhe do të zbatohen në luftën kundra t.b.c.

Ka disa ftiziatër si Dr. Kalmari që mendon se gratë tue mështefë sëmundjen do të jenë ma pak n'evidencë si të njoftuna dhe kështu do të




Grafiku Nr. 4 — Mortaliteti T.B.C. Çdo formë simbas grup moshe dhe seksit për çdo grup 3 vjeçar 1950+1951+1952 (1959+1960+1961)

kemi ma pak raste të denoncueme e të llogarituna. Kjo në nji pjesë sido-mos ke të rejat asht e drejtë, por na mendojmë se këto raste nuk janë edhe aq të shpeshta, me përjashtim, ndoshta në Shkodër, por nuk asht për t'u neglighue fakti që gratë i ndjekin ma tepër këshillat e rrejekut dhe kurat me antibakteriale ose operacionë. Sidoqoftë predominimin e seksit mashkullor ne e shofim dhe në shumë vende të huaja.

3) *Mortaliteti t.b.c. simbas formës.* Ne studjuam mortalitetin e t.b.c. po në këto 6 qytete simbas 4 formave që përcakton nomenklatura ndërkombëtare.

Tue shikue tabellën nr. I dhe grafikun nr. 5 konstatojmë se t.b.c. polmonar predominojn gjithnjë gjatë 12 vjetëve prej 77.45% në grup vitet 1950-1951 në 96% në grup vitet 1960-1961. Kjo % shkon progresivisht tue u ngrejtë për t.b.c. e mushkrive dhe tue u ulë për t.b.c. ekstra-polmonare dhe për nën format e këtij.



Grafiku Nr. 5 — Dinamika e Mortalitetit T.B.C. simbas formës në 12 vjet në 6 qytete

Mbas t.b.c. polmonar % ma e madhe i përket t.b.c. meningeal pastaj formave të tjera të t.b.c.; e në fund t.b.c. osteo artikular. Ndërsa po të krahasojmë t.b.c. polmonar me t.b.c. ekstrapulmonar në % me shumën do të kemi në fillim të 12 vjeçarit (1950-1951) 22.55% t.b.c. ekstrapulmonar dhe në fund të 12 vjeçarit (1960-1961) 4% d.m.th. se t.b.c. ekstra pulmonar ulet ma tepër se t.b.c. polmonar. Me fjalë të tjera pesha specifike e t.b.c. ekstra-pulmonare në përgjithësi dhe atij meningeal dhe osteo-artikular në veçanti asht ulë brënda 12 vjetëve në kurriz të t.b.c. pulmonar.

Tab. Nr. 1. Pesha specifike e formave të ndryshme të mortalitetit t.b.c. për grup-vitet 2 vjeçare nga 1950-61

Grup-viti	1950-51	1952-53	1954-55	1956-57	1958-59	1960-61
t.b.c. çdo forme	100%	100%	100%	100%	100%	100%
,, pulmonare	77.45% <sup>a</sup>	80.60%	81.20%	84.05%	87.30%	96%
,, meningit	12.25% <sup>a</sup>	11	12.70%	9.05%	7.7%	3%
,, osteortik	3.20%	0.8%	2.40%	2.20%	2.7%	
,, forma të tjera	7.10%	7.80%	3.70%	4.70%	2.20%	1

% T.B. C. pulmonar me t.b.c; ekstrapulmonar po në këto grup vite.

	1950-51	1952-53	1954-55	1956-57	1958-59	1960-61
t.b.c. pulmonar	100%	100%	100%	100%	100%	100%
+ „ „ „ ekst-apulmonar						
t.b.c. pulmon ekstrapulmon	77.45% <sup>a</sup> 22.5% <sup>a</sup>	80.40% <sup>a</sup> 19.60%	81.20% <sup>a</sup> 18.80%	84.05% <sup>a</sup> 15.95%	87.30% <sup>a</sup> 12.70%	96% <sup>a</sup> 4%

Tue studjue mortalitetin nga t.b.c. simbas seksit në format e ndryshme të t.b.c. në grup tre vjeçarë (shif grafikun nr. 2) konstatojmë se në mortalitetet t.b.c. të çdo forme në t.b.c. pulmonar kemi një zbritje të rregulltë në çdo tre vjetë. Këtë zbritje e gjejmë dhe për çdo seks. Po të studojmë seksin në format e ndryshme do të gjejmë në seksin mashkullor predominimin në t.b.c. e çdo forme e në t.b.c. pulmonar kjo dhe gjatë 12 vjeçarit, por për t.b.c. e meningeve dhe t.b.c. forma të tjera vrehet se predominimi i seksit mashkull konstatohet në 6 vjetet e para (1950-1955) kurse në 6 vjetet e dyta indeksi i mortalitetit përfshin mbi burrat. Pse? asht vështirë me shpjegue. Po të shqyrtojmë dinamikën e çdo forme veçan (veç e veç) shif grafikun nr. 5 gjejmë se t.b.c. pulmonare pëson gati po atë ulje si t.b.c. e çdo forme se grafikun ndjek pothua po atë rrugë me një ulje progresive prej vitit 1950 deri në 1961 dhe me dy shkallëzime ma të theksueme në vitin 1953 dhe në vitin 1958. (shif graf. Nr. 5).


Kurse në t.b.c. e meningeve kemi një ulje ma të rregulltë me përjashtim të vitit 1954 ku gjejmë që indeksi të jetë ma i naltë i 12 vjeçarit (21.7 për 100.000). Këtu duket influenca e epidemisë së fruthit. Me gjithë këtë prej atij viti zbret rregullisht çdo vit për të arrijtë në 0.3 për 100.000 në 1961.

Grafiku i t.b.c. osteortikular paraqet një ulje pak a shumë të rregulltë me përjashtim të një ngritjes në vitin 1954.

Kurse grafiku i t.b.c. forma të tjera paraqet disa zikzak.

Në përbledhje, në të gjitha format e t.b.c., mortaliteti nga viti 1950 deri në vitin 1961 ka pësue një ulje të kënaqëshme, siç e tregon tabella nr. 2.

Ulja asht shumë ma e theksueme në format ekstrapulmonare të t.b.c. edhe ma e pakët në format pulmonare. (shif tab. Nr. 2 e grafik N. 6).



Grafiku Nr. 6 — Pesha specifike e mortalitetit T.B.C. simbas formës nö 6 qytete për vitin 1950-1951-1952 dhe 1959-1960-1961.

### Pasqyra Nr. 2

*Ulja e mortalitetit t.b.c. në % për çdo formë nga viti 1950 në 1961.*

t.b.c. qdo formë nga 100 (ose 151 për 100.000)	% 1950	% 1961
t.b.c. pulmonare 160% (124.6 për 1000.000)	në 18.54% (ose 28 për 1000000 d.m.th. 81.5% ma pak.)	
t.b.c. mening. 100% (15 për 100000)		21.83% (27.2 për 1000000 ose 78.17% ma pak.)
t.b.c. osteoartikulare 100% (5 për 100000)		2% (0.3 për 100000) 98% ma pak
t.b.c. forma të tjera 100% (6.4 për 100000)		4.7% (0.3 për 100000) ose 95.3% ma pak.

Po të krahasojmë t.b.c. pulmonar me t.b.c. ekstrapulmonar do të kemi si vijon:

1950    1961

t.b.c. qdo formë	vdekur 211 ose 100%	78 veta 100%
» » » pulmonar	» 175 » 82.4%	76 » 97.4%
» » » ekstrapulmonar	» 36 » 17.6%	2 » 2.6%

Në vitin 1961 % e t.b.c. pulm. asht ma e madhe se sa në atë të vitit 1950, kurse asht e kundërtë për t.b.c. ekstrapulmonarin.


FORMAT E T.B.C.	GRUP VITI 1950-51-52	GRUP VITI 1959-60-61
TBC QDO FORME	100%	100%
" POLMONAR	7.9%	93.7%
" MENINGIAL	11.7%	4.3%
" OSTEOARTIK	1.3%	1%
" FORMA TIERA	9.1%	1%
" EXTRAPULM	51%	6.3%

#### 4) MORTALITETI SIMBAS GRUP MOSHËS. —

Për të studjue mortalitetin nga t.b.c. simbas grupmoshës na kemi marrë në konsideracion shifrat me grup vitesh 2 vjetor ose 3 vjetor, për arësy se numuri i të vdekunve për çdo grup-moshe gjatë një viti ishte i pakët dhe si konsekuençë indekset që do të dilshin nga ato do të kishin ma pak probabilitet. Kështu ne llogaritëm vitin 1950-1951 së bashku me vitin 1960-1961 prapë së bashku. Këto për 6 qytete veçan dhe për 15 qytete veçan.

Nga këto kemi nxjerrë dy grafikët: grafiku nr. 7 për 6 qytete veçan dhe po grafiku nr. 7 për 15 qytete veçan.

Tue i analizue këto vrejmë se indeksi i mortalitetit në një interval 10 vjeçar zbrer në të gjithë grup-moshat, por ma tepër në moshat e reja me përfjashtim të grup-moshës 0-1, 10-14 e 45-49 ku zbritja nuk asht aq e theksueme. Ky fenomen asht pothue njisoj si në 6 qytete, ashtu dhe në 15 qytete. (shif graf. Nr. 7).



Grafiku Nr. 7 — Mortaliteti nga T.B.C. që formë në 6 qytete (—) dhe në 15 qytete (---) të Shqipërisë simbas grup moshës për vitin 1950-1951 nalt dñe për vitin 1960-1961 posht.

Po të shikojmë mortalitetin simbas grup moshe dhe simbas seksit (shif graf. Nr. 4) në grup-vitet 1950-51-52 dhe 1959-60-61 do të shohim këto ndryshime interesante: mortaliteti në meshkujt asht ma i naltë se në femna, në grup moshën 0-1 vjeç që mbi 40 vjeç, kurse nga 1 deri në 40 vjet mortaliteti asht gati njisoj si për meshkujt ashtu edhe për femna.

Bile në grup-vitet 1959-1960-1961 për grup-moshat e reja prej 15 vjeç e deri 35 kemi një predominantë të lehtë të seksit femën. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se në këtë moshë kemi disa faktorë të tjerë të ve-

çantë me karakter fiziologjik që e randojnë gjendjen e t.b.c. ke femrat sikur e kemi shpjegue ma sipër.

Ndryshimet e indekseve të mortalitetit nga tuberkulozi gjatë 12 viteve dhe simbas sekxit kanë ngjasim me ato të disa vendeve të jashtëme (shif Bul. e U.I.K.Tub. e T'OMS).

## 5) MORTALITETI SIMBAS PROFESIONIT

Na kemi dasht me studjue dhe vdekjet nga t.b.c. dbe simbas profesionit të paktën për disa vite. Kjo nuk ishte e lehti, sidomos për të mjujtë me nxjerrë indekse relative me numurin ose popullatën e atij profesioni.

Me ndihmën e Drejtorisë statistikave, arritiem me gjetë dhe me nxjerrë disa të dhana për qytetet që kemi në studim nbi përbamjen shoqnonore të popullatës dhe veçanërisht për disa profesione simbas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitet 1955 e 1960.

Kështu na morëm në konsiderim mortalitetin nga t.b.c. simbas profesioneve në vitet 1955 e 1956 së bashku me 1960 e 1961.

Muarrem grup 2 vitesh për të pasur numur absolut ma të madh dhe si konseguencë për të nxjerrë indekse ma të vlefshme (shif tab. 3).

Për të qenë ma të sigurtë e ma preçiz na muarrem parasysh vetëm 6 qytetet e njohuna tashma (Tiranë, Shkodra, Korça, Vlora, Fieri, Lushnja) dhe dy profesione kryesore që kanë rëndësi të veçantë sociale.

Tab. Nr. 3

Mortaliteti nga t.b.c. në 6 qytete në puntorë e nëpunësa

grup Viti	Në puntorë			Në në punësa		
	nr. absolut i vdekjeve	numari vđ. për 100.000	%	nr. absolut i vdekjeve	për 100000	%
1955-1956	45	24	1000%	24	15.6	100%
1960-1961	30	10	41,6	20	12	80%

Nga tabella e lartpërmëndur del se:

1) Mortaliteti nga t.b.c. në fillim ka oënë ma i naltë ke puntorët se ke nëpunësit kurse tash mortaliteti paralelisht në uljen shkon drejt barazimit -puntorë-nëpunës). Kjo tregon se konditat ekonomiko-sociale të punëtorëve janë përmirësuar mjaft dhe ndryshimet në mes të këtyre dy grupeve shoqërore të rëndësishme po zhduken (gja që pritej në kondita socialiste).

2) Mortaliteti nga t.b.c. në këto dy grupe shoqërore asht ma e ulët se indeksi mesatar i të gjithë grupeve shoqërore.

3) Se mortaliteti nga t.b.c. në punëtorë dhe nëpunësa asht ulë brenda 5 vjetëve, por kjo ulie asht ma e theksueme në punëtorë se në nëpunsa.


## II. Mortaliteti nga t.b.c. në krahasim me atë nga sëmundjet e tjera.

Pesha specifike e mortalitetit nga t.b.c. çdo forme d.m.th. % (përqindja) e mortalitetit nga t.b.c. çdo forme në krahasim me mortalitetin e përgjithshëm nga viti 1950 deri në vitin 1961 asht ulë progresivisht në më-

nyrë të kënaqëshme. Konkretisht (për 6 qytetet në fjalë) nga 10.6% në vitin 1950 në 4.1% në vitin 1961. Kjo ulje shifet dhe në vendet e tjera ku më shumë ku më pak.

Nuk asht e pa vlefshme me dijtë vendin që zen tuberkulozi si shkak vdekje në krahasim me sëmundjet e tjera. Kjo do të ndihmojë ma tepër me justifikue masat që duhen marrë për me e luftue këtë sëmundje.

Për të studjue këtë anë të mortalitetit tuberkular muarrem në kon sideratë të dhënët e Drejtorisë së statistikës të viteve 1960-1961 e 1962 mbi mortalitetin në qytetarë simbas shkakut të vdekjes. Nga këto të dhana na përpunuem grafikun Nr. 8.



Grafiku Nr. 8 — Vdekjet qytetare për gjithë qytetet të R. P. Shqipërisë për vjetet 1960-1961-1962 të radhituna simbas sëmundjeve që i ka shkaktue dhe vendi që zen T.B.C. në këtë renditje.

Në këtë pasqyrë dhe shkallëzim të sëmundjeve u la veçan dhe nuk u radhit Nr. 45 i nomenklaturës, ai që shënon «pleqërin» si shkak vdekjeje as dhe Nr. 46 që përmbledh «sëmundjet e tjera», kjo për arësy se këto dy grupe si shkak vdekjeje nuk janë të përcaktueme mirë dhe nuk tregojnë kuartë se nga vjen vdekja.

Në këtë pasqyrë nga 54 sëmundje që shënon nomenklatura internacionale për shkaqe vdekjeje na muarëm në konsiderim 10 grupe sëmundjesh ose forma sëmundjesh ma të randësishme:

Në grupin «sëmundjet e zemrës» na përblohdhëm përvèg numur 26 të nomenklaturës ose sëmundjet degenerative të zemrës që përbajnjë shumicën e konkretishët në tre vjet (1399 raste ose 84.5%) por edhe grupin nr. 25 të nomenklaturës ose sëmundjet kronike reumatike të zemrës (19 raste ose 1.1%). Gjithashtu dhe grupin Nr. 27 ose sëmundjet e tjera të zemrës (238 raste ose 3%).

I. Mbas këtyne konsideratave të përgjithëshme tue shikue me kujdes këtë pasqyrë dhe grafikun del e kuartë se vendin e parë (I), si shkak-vdekjeje e zajnë sëmundjet e zemrës me 1956 raste ose 18.8% në krahasim me vdekjet e tjera qytetare me diagnozë ose 105.2 për 100.000. Këtë vend

zenë dhe në shumë vende të tjera të zhvilluara si n'Itali (Ceino, Rusticelli etj. (28).

II) *Pneumonitë dhe bronko-pneumonitë* (N. 31) zajnë vendin e dytë.

Këto sëmundje nuk kanë kët rradhë kaq të naltë në shum vende të tjera p.sh. n'Itali këto zajnë vendin e IV-të.

Numuri akoma i madh i vdekjeve nga pneumonitë dhc bronko-pneumonitë, sëmundje që sot konsiderohen të shërueme, duhet të na preku pojnë pavarësisht se mund të ketë edhe raste diagnoze të gabueme. Kjo ndoshta mund të shpjegohet nga paracitja me vonesë e të sëmurëve ose dhe mos kurimi i tyne aq sa duhet në spital.

III) Vendin e tretë e zajnë *tumoret malinje* të cilat duket se janë shtuem këto vitet e fundit siç janë dhe në shumë vende të tjera të përparueme kurse n'Itali zan vendin e dytë.

IV. *Vendin e IV-të e zajnë dispepsit tokiske të fëmijëve* që siç dihet janë akoma problem për mjekësinë infantile në vëndin tonë.

Vendin e V-të e zajnë *hemoragjitet cerebrale*, këto duket se janë ma pak se në disa vende të përparueme (p.sh. n'Itali).

Vendin e VI-të e zajnë *sëmundjet Ombilikale* ke fëmit. Këtë duhet ta kenë parasysh mëmít dhe obstetrët tanë.

Vëndin e VII e zanë *t.b.c. të çdo forme*, kurse n'Itali zen vendin e VIII (në vitet 1954-56) (shif Ceine, Rusticelli etj.).

Vendin e VIII-të e zajnë *gripi* dhe atë *IX-in* e zajnë *vdekjet aksidentale*.

Kurse vëndin e X-të e zajnë *nefritet e nefrozat*.

Cirrozat hepatike zajnë vendin e XI-të.

Po të krahasojmë të 10 grupet e sëmundjeve ma të randësishme si shkak vdekje me vdekjet e përgjithëshme me raport mjeku del se 78.3% të gjith vdekjeve kanë për shkak 10 grupet e sëmundjeve të naltpërmenduna kurse 21,7% mbeten për gjithë sëmundjet e tjera dhe në mënyrë të veçantë në mes këtyre 10 grupeve të para t.b.c. zen një vend me randësi në shkallëzimin e përgjithshëm dhe konkretisht afro 5% në krahasim me sëmundjet e tjera.

## **MORTALITETI TUBERKULAR SIMBAS MUAJVE (*tremujorve*) DHE STINAVE TË VITIT**

Tue u mundue me studjue mortalitetin tuberkular në vendin tonë në drejtime të ndryshme u përpoqëm me pa në se klima dhe sidomos muajt dhe stinat kishin ndonji influencë në kët fenomen.

Simbas thanieve të popullit të sëmundët tuberkulos vdesin ma tepër kur çelin lulet në pranverë, dhe kur bien gjethet në vjeshtë. Prof. L'Elorre dhe të tjerë tue fol për mortalitetin tuberkular në periudhën para luftës tregojnë se vdekjet nga t.b.c. ndodhin ma tepër në pranverë. Në këto vitet e fundit duket se kimioantibioterapia e kan ulë influencën stinore mbi mortalitetin tuberkular.

Të dhanat statistikore italiane ashtu dhe të vendeve të tjera tregojnë se mortaliteti tuberkular në vitet mbas luftës së dytë botnore konstatohet ma tepër në tre muejtë e para të vitit (Daddi).<sup>16</sup>

Për vendin tonë ne kemi marrë në studim 2 grup-vitesh atë 1950-1951 dhe atë 1960-1961 me dijet vjet interval për të mujt me pa ndryshimet gjatë ksjajë periudhe. Kështu me materialin që disponuen krijuem tabelën përmbledhëse Nr. 4, si vijon:

*Tabela nr. 4*

*Shpërndarja e vdekjeve me përqindje përkatiëse në tremujorë simbas vitesh 1950-1951 dhe 1960-1961 për qytetarë e fshatarë:*

**1950—1951**

Tremujori	Nr.i vdekjeve qytetarë	%	Numri i vdekjeve fshatarë	%	Numri i vdekjeve qytet. + fshat.	%
I	161	25	74	10.1	235	21.3
II	175	[27.2]	152	133.0	327	[31.4]
III	158	24.5	17	32	275	23.6
IV	149	23.1	87	19.2	236	22

**1960 - 1961**

I	90	[35.2]	126	34.1	225	[4.6]
II	44	15.16	100	27.1	144	22.1
III	63	22.4	70	19	133	20.45
IV	75	26.7	73	20	148	22.75

Me kët pasqyrë na shofim kuartë shpërndarjen e vdekjeve nga T.B.C. në tremujorët e grup-viteve 1950-1951 dhe 1960-1961 me përqindjet përkatiëse në krahasim me totalin e vdekjeve.

Tue studjue të dhanat tona në kët pasqyrë rezulton se:

A) Në grup-vitet 1950-1951 mortaliteti tuberkularë asht ma i naltë në tremujorin e II d.m.th. në pranverë. Ky superioritet në kët perjudhë shifet si në mortalitetin tuberkularë global ashtu dhe të ndamë në meshkuj e femra, në qytetarë e fshatarë.

B) Në grup-vitet 1960-1961, mortaliteti tuberkularë asht ma i naltë në tremujorin e parë të vitit d.m.th. ma tepër në dimën.

Edhe në kët periudhë ky superiotitet shifet si në mortalitetin tuberkular global ashtu dhe për çdo seks dhe për qytetarë e fshatarë të marrë vec e vec.

Ky konstatim nuk pajtohet krejtësisht me ato të autorëve të huaj që kanë ba studime në kët fushë.

Ndryshimi i mortalitetit maksimal nga t.b.c. prej pranverës në dimën me një interval 10 vjetësh (1950-1951), (1960-1961) spjegohet simbas mendimit tonë me influencën e antibakterialeve. Këto kanë ba që numuri i T.B.C. kronik në këto vitet e fundit të shtohet e veçanërisht tek ata të kaluemet në moshë.

Këto raste t.b.c. kronik i shofim ma shum ke ato që nuk kan ndjek kurat në rregull ose që kanë refuzue operacionin ose tue qenë në moshë të kalueme nuk mund të operohen. Ke këto zhvillohet ciroza, emfizoma, bronchioktazet etj.

Këto raste arrijnë shpesh në një insuficencë kardiorespiratore me kapacitet vital të reduktuem. Në kohën ma të përshtatshme kur marrim një grip ose kongestion pulmonar ose një bronkopneumoni ose pneumoni, desenkuilibrohen dhe vdesin. Këto pneumopati jo specifike ngjajnë ma tepër në dimën dhe ndihmojnë pra me shpejtue dhe shtue vdekjet e t.b.c. në kët stinë.

Po të krahasojmë vdekjet nga t.b.c. me vdekjet nga gjith sëmundjet në vitin 1950-1960 e 1961 (shif anuarin statistikor 1963 faqe 93) do ta shofim se vdekjet nga gjithë sëmundjet ngjajnë ma tepër në muajt e verës dhe të dimnit, gja që spjegohet: Për në verë nga vdekjet e fëmijve prej dispepsie dhe në dimën nga vdekjet e pleqve nga pneumopatitë siç e thekson edhe Dr. Kërçiku për popullatën katolike të Shkodrës. Sidoqoftë nuk shkojnë paralel me mortalitetin nga t.b.c.

### MORTALITETI T.B.C. NË DISA QYTETE TË VOGLA ME KARAKTER FSHATAR


Studimi i plotë i mortalitetit tuberkular ndër fshatarë ka qenë i pamundun përmungesë të dhanash siç u theksue qysh në fillim. Megjithkto na jemi përpjekë me disa të dhana të pjesëshme, me nxjerrë disa konkluzione të përgjithëshme.

Tue njoftë mortalitetin tuberkular ndër të gjitha qytetet na muarrëm në studim veçan mortalitetin t.b.c. ndër disa qytete të vogla me karakter fshatar, kryesisht bujqësor, nxorrëm indekset përkatëse për 100 mijë b. dhe këta në dy grup vitesh: Në 1950-51 dhe në 1961-1962. Këto indekse i krahasuam në mes të tyne ashtu dhe me mortalitetin tuberkular të qyteteve të tjera ma të mdhej me karakter jo fshatarë. Me kët grup të fundit bashkuem edhe ndonji qytet të vogël me karakter kryesisht puntor (miniere ose industrie), p.sh. Selenicën.

Kështu pamë se indeksi i mortalitetit tuberkular në grup vitet 1950-1951 në 8 qytete kryesore ka qenë 139.4 për 100.000 dhe në qytete të vogla me karakter fshatar kryesisht bujqësor ka qenë 96,58 për 100.000. Kurse në grup vitet 1961-1962 në 19 qytete kryesore jo fshatare ka qenë 27.4 për 100.000 dhe në 21 qytete të vogla me karakter fshatar ka qenë 24,61 për 100.000.

Këtu shifet se: a) Mortaliteti tuberkular ka qenë dhe asht akoma ma i naltë në popullatën qytetare se në popullatën fshatare. b) Mortaliteti tuberkular nga viti 1950-1951 në vitin 1961-1962 asht ulë si në popullatën qytetare ashtu dhe në popullatën fshatare por ma tepër në të parën se në

të dytën: respektivisht në qytetarë 80% ma pak dhe në fshatarë 74.6% ma pak. (shif grafikun nr. 9).



Grafiku Nr. 9 — Ulja e mortalitetit T.B.C. në 12 vjet nga 1950-1951 në 1961-1962 në qytete disa nga të cilët me karakter fshatar.

Nga të dhanat tona mbi infekzionin dhe morbozitetin tuberkular del se tuberkulozi në zonat fshatare ka qenë ma pak i përhapur por ma shum vdekje-prues. Kuadri i ktushëm nuk na lejon me e zhvillue dhe me e spjegue ma gjatë kët pik kaq interesante që mund të jetë objekt i një artikulli të veçant.

Sidoqoftë me këto të dhana aproksimative dhe nga këto konkluzione paraprake na mund të deduktojmë se duhet shiue njohja e t.b.c. në fshat dhe forcue ma tepër lufta kundra kësaj sëmundje në këto zona ku ajo asht akoma në një pjesë të mirë në fazën e epidemike.

### KONKLUZIONE TË PËRGJITHËSHME

Studim i mortalitetit nga turbekulozi në Shqipni deri në vitin 1945 ka qenë i pa mundur për mungesë të dhanash. Mbas këtij viti e deri në 1949 arrihet me pasë një ide pse disa vdekje rregjistrohen me shkakun përkatës.

Nga viti 1950 të dhanat janë të mjaftueshme për një studim të vlefshëm të mortalitetit tuberkular në disa qytete.

Nga ky studim rezulton se:

I) Vdekjet nga tuberkulozi i çdo forme gjatë 12 vjeçarit (1950-1961) në 6 qytetet e studjueme kan shkue progresivisht tue u ulë: Nga 151 për 100 mijë b. në vitin 1950 në 28 për 100 mijë b., në 1961 ose 82% ma pak. (graf. Nr. 1).

Kjo ulje e konsiderueshme spjegohej jo vetëm nga antibakterialet por edhe nga përmirësimi i konditave ekonomike sociale të popullit dhe masave të gjithanshme për luftën kundra t.b.c. në vendin tonë.

2) Mortaliteti t.b.c. asht *ma i naltë* në *meshkuj* se në femna në t.b.c. të çdo forme dhe në t.b.c. pulmonar sidomos mbas moshës 35 vjeç. (shif graf. Nr. 3 e Nr. 4).

Indeksi mesatar në 12 vjet asht për meshkuj 108.7 për 100 mijë dhe për femra 62.2 për 100 mijë.

3) Mortaliteti ma i naltë asht nga t.b.c. pulmonar (bile shum ma i naltë) pastaj nga ai meningeal dhe në fund nga ai osteoartikular. (shif graf. Nr. 5 e Nr. 6).

Gjatë 12 vjetve ulen ma tepër vdekjet nga t.b.c. ekstrapulmonar se sa pulmonar.

4) Simbas *grup moshës*, mortaliteti nga t.b.c. në grup vitot 1950-1951 dhe 1960-1961 asht gjithnjë më i ultë nga 5-15 vjeç dhe mbas kësajë moshë vjen tue u ngrejtë kurse në një interval 10 vjetesh zretë në gjith grup-moshat por ma tepër në moshat e reja. (graf. Nr. 7).


5) Simbas *profesionit* mortaliteti nga t.b.c. në vitet 1955-1956 ka qenë ma i naltë në puntorë se sa në nëpunës por në vitet 1960-1961 zretë në të dy grupet dhe ma shum në puntorë. Konkrektisht indekset e fundit (1960-1961) janë respektivisht 10 për 100 mijë për punëtorët dhe 12 për 100 mijë për nëpunsit.

6) *Pesha specifike* e mortalitetit t.b.c. në krahasim me mortalitetin e përgjithshëm në kjo 12 vjet në 6 qytetet e studiueme asht ulun nga 10.6% në 4.1% kurse tue krahasue mortalitetin tuberkular me atë të 10 sëmundjeve kryesore në gjith qytetet gjatë viteve 1960, 1961 dhe 1962 do të shofim se tuberkulozi si shkak vdekjeje zen vendin e shtatë. (shif. graf. Nr. 8)

7) Simbas *stinave* dhe tremujorve, në vitet 1950-1951, të sëmundët tuberkular vdesin ma shum në tremujorin e dytë ose në pranverë, kurse në vitet 1960-1961 ata vdesin ma tepër në tremujorin e parë ose në dimën. (tab. Nr. 4)

8) TUE krahasue po në këtë grup vitesh mortalitetin tuberkular në disa qytete të vogla me karakter fshatar me atë në disa qytete ma të mdhaj e me karakter jo fshatar shifet se mortaliteti tuberkular në fshatarë ka qenë ma i ulët se në qytetarë por tash kjo diferençë asht paksue, dhe mortaliteti t.b.c. zretë ma shpejt në qytetarë se në fshatarë në kjo 12 vjet. (shif graf. Nr. 9).

9) TUE u nis nga këto të dhana parciiale për qytetarët dhe nga konkluzioni se mortaliteti tuberkular në fshatarë nuk asht ma i naltë se ai qytetar, nuk gabojmë, në qoftë se do të konsiderojmë si mortalitet të përgjithshëm t.b.c., mortalitetin tuberkular në disa qytete dhe si i tillë mund t'a krahasojnë me vendet e huja. Kështu tue radhitë mortalitetin nga t.b.c. të 20 Shteteve gjatë viteve 1960-1961 del se Shqipnija zen një vend mesatar relativisht +5 kënaqshëm. (shif graf. Nr. 10)



Grafiku Nr. 10 — Mortaliteti nga T.B.C. çdo formë në disa shtete në vitet 1960 dhe 1961. Renditja në bazë të indekseve për 100 000 banorë:

(Paragjitur në redaksi më 15-9-64)

# DEATH RATE OF TUBERCULOSIS IN ALBANIA

## (Summary).

In this work the author discusses the death rate of tuberculosis in Albania, especially in some cities.

He treats the factors that have an influence on the changes of this index. He gives the epidemiological laws of prof. L'Eltore, discussing them impartially, with the purpose of understanding them and applying them for the conditions of this country.

After that the author mentions that before the Liberation (1944) he has not found any data of the mortality rate, but for the period after the Liberation he has studied attentively the materials of the Bureau of Statistics.

The data up to 1949 were not sufficient for the extraction of comparative indexes.

His study is based mainly on the death notices. Their analysis has shown that with the population, since many of these notices did not contain the diagnosis. After that year he finds sufficient data for conclusions, which can have a certain scientific value, but only for the citizens and for certain cities; from this incomplete study he makes valuable general conclusions about the death rate of tuberculosis in Albania. Thus he shows that:

1) The death rate of tuberculosis from 1950 until 1961 has been gradually falling from 151 per 100,000 to 28 per 100,000, which is a fall of 82%. This important fall can be explained not only with the use of antibiotics, but also with the improvement of the social-economic conditions of the population and the general measures of control of tuberculosis.

2) The mortality rate is higher among men than women.

3) It is higher in pulmonary tuberculosis, then meningitis, and lastly in osteo-articular tuberculosis. During the last 12 years the fall of the mortality rate has been more important on the extrapulmonary forms than in the pulmonary cases.

4) The fall is more considerable for the younger age groups.

5) During the period 1955-1956 it has been higher for manual workers than for office employees, but after 1960-1961 it is equal for the two groups.

6) The specific weight of tuberculosis mortality compared with the total mortality of the population during the last 12 years for the 6 cities has fallen from 10.6 to 4.1%, whereas if the tuberculosis death rate is compared with that of the 10 principal diseases, it can be seen that for the period 1960-1962 it occupies the seventh place.

7) During the period 1950-1951 the season of the highest mortality for tuberculosis was spring, while for the period 1960-1961 it is highest during the winter.

8) In comparing the tuberculosis death rate for some small towns with peasant character with that of the larger cities, it can be seen that in the past it was higher in the cities, but now this difference has disappeared, and mortality rate falls more quickly in the cities.

9) On the basis of these partial data for some cities the author concludes that the mortality rate of tuberculosis in the cities can be considered equal to the mortality rate for the whole population, and as such can be taken as a basis for comparison with other countries.

Considering the tuberculosis death rate for 20 different countries it can be seen that Albania occupies a middle place, which can be considered satisfactory.

## B I B L I O G R A F I

- 1) Prof. SH.A. ALIMOV. — Probleme të epidemiologisë regionale të tuberkolozit në Uzbekistan «Probleme të tuberkolozit» nr. 9, faqe 8-12, 1963.
- 2) A. D'AGOSTINO — U. DI LEONI. — «Lo stato attuale dell'endemia tubercolare negli Stati Uniti d'America «Lotta contro la tubercolosi» Nr. 11-12 faqe 891-903, 1962.
- 3) E. BERNARD — A. LOTTE. — Mesure de peril tuberculeux — Revue de tubere. Tom 23, Nr. 7 Faqe 759-768, viti 1959.
- 4) F. BLANCO. — Influence des nouvelles therapeutiques sur l'organisation de la lutte anti-tuberculeuse. — «Bull. Un. Inter. contre la tuberculose. F. 303-307, 1954.
- 5) P. BOURGEOIS et Coll. — Tuberculosis pulmonaire et pleurale. F. 850-881, 1954.
- 6) O. CEINO — V. RUSTICHELLI. — Determinazione della malattia tubercolare nell'Azio (morbosità, mortalità e letalità); Lotta con. tuber. Nr. 16, f. 943-959, v. 1960.

- 7) O. CEINO. — La mortalita tuberculare in Italia, nella provincia e regioni dal 1887 al 1959. — Lotta con. tuber. — Nr. 12, faqe 1337-1387, viti 1960.
- 8) DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E SHËNDETËSISË. — Statistika shëndetësore dhe demografike pér periudhën 1927-1932 dhe 1933-1940.
- 9) K. KERÇI/KU. — Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shekullit XVIII-XX faqe 168, vitit 1962.
- 10) G. L'ELTORE, O. CEINO, V. MARCHIANO. — Mortalita tuberculare» (Karakteristikat evolutive-gjeografike, influenca e faktorit luftë dhe të masave mbrojtëse.)
- 11) G. L'ELTONE. — Les trois lois épidémiologiques de la tuberculose et leur application dans le programme de la lutte contre la tuberculose. «Bulletin de l'Union International contre la tuberculose. Bull. Inter. cont. tub. Nr. 12, faqe 53-72, viti 1957.
- 12) A.L. LAPINA. — Bulletin de l'Un. Int. contre la tuber.
- 13) A.L. LAPINA. — «Probleme t.b.c. Nr. 7, viti 1961, Moskë.
- 14) A. LOTTE et ROULLION. — Mortalité par la tuberculose en France — Bulletin dz. I.N.N., Nr. 3, 1958.
- 15) PERABATOVA M. A., KUNIZINA Z.D. — Treguesit e uljes së mortalitetit në Sverdlov. «Probleme t.b.c., Nr. 4, f. 12, viti 1961.
- 16) MASSINO. — «Probleme të t.b.c.» N. 6, viti 1961.
- 17) E. MERCUSSEN. — Social Hygiene «Kapit. tuberc.» faqe 122-158 — Leipzig, 1954.
- 18) E. MORELLI — E. DADDI. — Trattato di Tisiologia «Rerlievi sulla mortalità pér tubercolosi». — faqe. 26-75, viti 1961.
- 19) SH. NDROQI — Disa konsiderata të përgjithësime zreth studimit të t.b.c. në Shqipni. Bul. pér Shkencat natur. Nr. 2, faqe 101-110, viti 1955.
- 20) NESTOROV. V. — Indeks i rëndësishëm i luftës anti-tuberkulare. — Problemet e tuberkolozit. Nr. 2, vitiit 1959, Moskë.
- 21) RABUHIN A.E. — Epidemiologia e profilaksia e t.b.c. (Kap. «Shkaqet e uljes së mortalitetit t.b.c.») Moskë 1957.
- 22) T.V. SAKOV. — La lutte contre la tuberculose dans la Republique Populaire de Bulgari «La santé publique. Rev. International — Bucarest. Nr. 2; f. 73-89, v. 1958.
- 23) St. TODOROV. — L'épidémiologie de la tuberculose et l'organisation de la lutte contre la tuberculose en Bulgarie. «Bulletin de l'Union Inter. contre la T.B.C. »Nr. 3-4, faqe 302-311, viti 1957.
- 24) B. ZEJNO, — N. BAROTHY. — Analiza kualitative e mortalitetit nga t.b.c. në rajonin e dispanserisë Tergu-Murash (Rumanie).
- 25) UNION INTERNATIONAL CONTRE LA TUBERCULOSE. — Quelques données statistiques concernant la tuberculose en Europe et en Amerique du Nord. — Mars, 1964.

## TURBULLIMET PSIQUIKE NË TUMORET CEREBRALE

Kand. shkencave mjeksore **BAJRAM PREZA** e Kand. shkencave mjeksore  
**ULVI VEHBIU.**

(Katedra e neuro-psikjatrise. Shef. i kat. Prof. **XH. GJATA**)

Studimi i sindromeve psikopatologjike në klinikën e tumoreve cerebrale filluan që në shekullin XIX-të. Punimet e para u botuan nga fundi i këtij shekulli (Ladame — 1865, Starr 1884, Jastrowitz 1888, cit. nga (4). Këtu duhet përmendur edhe kapitulli i tumoreve cerebrale në tekstin e Oppenheim-it, të botuar në vitin 1896, ku analizohen turbullimet psikike gjatë tumoreve frontale (2). Për herën e parë Schuster batoi një vepër me karakter bibliografik (Psichische Störungen her heintumoren — Stuttgart, 1902 — cit. nga 2) ku analizon të gjitha punimet e botuara deri në atë kohë mbi tumoret cerebrale. Ai gjeti gjithsejt 588 raste, nga të cilat 323, shqëroheshin me turbullime psikike. Punime të tjera të rëndësishme janë artikulli i Dupre (1903), ato të Pfeiffer (1910 dhe në traktatin e Bumke — 1930), teza e Barukut (1926), botimet e psikiatërve sovjetikë të viteve 1933-1936 (Rapoport (11), Shamburov (15), etj.). Deri sot më e plotë në drejtim të përshkrimit të turbullimeve psikike gjatë tumoreve cerebrale, është monografia e Shmarjanit e viti 1940 (16), ku analizohen 420 raste të tilla, nga të cilat 180 frontale. Vitet e fundit, punime me vlerë shkençore dhe praktike, kanë botuar Schlesinger (1950), Walther-Buel —(1951) Hécaen dhe Ajuriaguerra (1956) (6), Rozdolski (55) etj.

Turbullimet psikike, gjatë tumoreve cerebrale, takohen shpesh. Autorë të ndryshëm nuk jepin përqindje të barabarta, sepse disa prej tyre, futin në kategorinë e psikozave edhe lëkundjet e lehta të humorit. Kështu Oppenheim, (1902), Bruns (1908) Moersch (1925), Kanzer —(1941), i takuan në 100% të rasteve (cit. nga (4)), Baruk (2) në 74,6% —(1959), Pfeiffer në 3,7% (1910), Schlesinger në 51% (1951), Sonia në 51,5% (1951), Walther-Buel në 70% (1951) Hecaen dhe Ajuriaguerra në 52% (1956), në 75-78% (1961), Inger (33) në 40% (1959), etj. Duke u mbështetur në statistikat më të reja, rezulton, se, çrrregullimet psikike gjatë tumoreve cerebrale takohen në 50-70% të rasteve.

Këto turbullime mendore shpesh zotërojnë në të gjithë tablonë klinike dho të sëmurët gabimisht shtrohen në spitalet psikiatrike, duke mos dyshuar për tumor cerebral. Marchand (1939), midis 573 autopsive të të sëmurëve psikikë, gjeti 36 me tumor cerebri, d.m.th. 6,2% (Cit. nga (4), Guiraud në 1000 autopsi zhuloi 7 neosformacione cerebrale —0,7%, kurse Raskin (1950), duke bërë 2430 autopsi, arrin në përfundimin se 3,45% e të sëmurëve psikikë kanë tumore intrakraniale.

Pothuajse tumoret e qdo rajoni të trurit të madh jepin alteracione psikike, por më shpesh; këto të fundit, takohen gjatë neoplazmave të lobeve frontale, parietale, diencefalike dhe temporale (2), (4), (5), (9), (11), (12) etj). Turbullimet psikike i shkaktojnë jo vetëm tumoret cerebrale të marrë në kuptimin e ngushtë të fjalës (duke futur këtu edhe raste me-

tästatike), por edhe abseset, cisticerkozat dhe pseudotumoret e tipit Nonne.

Ne studjuam çrregullimet mendore të çfaqura në 33 të sëmurë me tumore cerebrale. Këto raste u mblodhën gjatë tetë vjetëve të fundit dhe kanë manifestuar turbullime të rënda psikike. Ndërsa rastet e tjera, tek të cilët çfaqjet psikopatologjike nuk kishin rëndësi të veçantë diagnostike, u lanë me njëanë. Shtatë nga këto raste u shtruan në klinikën e psikiatrisë, sepse alteracionet e tyre psikike ishin shumë të theksuara, dhe diagnozat e hyrjes ishin psikiatrike: skizofrenia (3 veta), psikoza maniakale, (2 veta) psikoza depresive (2 veta). Në pesë nga këta të sëmurë diagnoza e tumorit cerebral u vu në kohë dhe ata u transferuan në klinikën e neurologjisë, kurse 2 tumoret e tjera u zbuluan gjatë autopsisë (një me formën katatonike të skizofrenisë dhe një me formën hebephrenike). Po të marrim parasysh numurin e përgjithëshëm të të sëmurëve psikikë, të shtruar në klinikën e psikiatrisë këto tetë vjetët e fundit (2380 veta) rezulton se të shtatë rastet e shtruara me tumore cerebrale zënë vetëm rreth 0,3% të shumës së përgjithëshme. Të 26 të sëmurët e tjerë u hospitalizuan direkt në klinikën e neurologjisë të fakultetit, sepse ata, krahas turbullimeve psikike, kishin edhe simptome të theksuara neurologjike, që zinin një vënd të rëndësishëm në tablonë klinike. Duke krahasuar rastet e tumoreve cerebrale, që shoqërohen në turbullime psikike të konsiderueshme (33 veta) me numurin e përgjithëshëm të neosformacioneve intrakraniale, të shtruar në klinikën e neurologjisë, del se ato zënë rreth 20% të shumës së përgjithëshme të tumoreve cerebrale. Po ta krahasojmë këtë shifër me ato të autorëve të tjerë, del se është shumë e ulët. Kjo shpjegohet me faktin se ne studjuam vetëm ato raste që u shoqëruan me çrregullime psikike shumë të rënda p.sh. Baruk (2) raste të tillë gjeti vetëm në 27,2% të të sëmurëve me tumore cerebrale.

Midis 33 rasteve tonë, 19 kishin tumorë frontale, 1 frontotemporal; 2 fronto-parietale, 1 temporal, 5 diencefalo-hypofizare, 4 cerebelare, 1 i ventrikulit të tretë. Pra edhe nga materiali ynë rezulton se tumoret frontale shoqërohen më shpesh me turbullime psikike, sesa tumoret e lobeve të tjera. Kjo shpjegohet me faktin se lobet frontale lozin një rol me shumë rëndësi në aktivitetin psikik të njeriut. Nga të 33 të sëmurët, një kishte abcas serebral (*regio fronto-parietalis*), një tumor metastatik frontal, një pseudotumor Nonne frontal (*encephalitis circumscripta*). Nga shuma e përgjithëshme e këtyre të sëmurëve 24 vdiqën: 9 u operuan me sukses dhe vazhdojnë të jetojnë.

Në përgjithësi psikiatrët, turbullimet mendore që çfaqen gjatë tumoreve cerebrale, i ndajnë në dy grupe: simptomet e përgjithëshme (të shkaktuara më tepër nga hypertensioni intrakranial dhe edema cerebrale), dhë ato të karakterit lokal. Simptomet e përgjithëshme të tumoreve cerebrale janë studjuar me hollësi nga Baruk (2) Pfeiffer, Weinsenberg (cit nga 2), Dide, Guiraud (3), Oppenheim (9), etj. Turbullimet psikike, në mwartësi nga lokalizimi i tumorit, u studjuan nga Shmarjani (16), Leonora Welt, Raymond; Bruns, Gianelli, Jastrowitz, Hecaen, Ajuriagueira, Jackson etj. (cit. nga 2).

Për herë të parë, në formë të plotë, sistemi i simptomave të përgjithëshme psikotike, gjatë tumoreve cerebrale, u bë nga Baruk, i cili dallon konfuzionin mendor tranzitor (bradypsicha dhe onirizmi ekmnezik), format me gjumë patologjk, që shoqërohen me amnczinë e fiksimit dhe fabula, format apatike me torpor, që arrijnë deri në stupor me katalepsi, gjëndjet konfuzionale aktive me impulsione dhe automatizëm ambulator-

(fuga, ekuivalenca psihiqe), format e zgjatûra psihotike (pseudoparalizja gjenerale e pëershkuar nga Closton, Obernie, Baraduc, Raymond, Petiawy, Brault etj. me tablo të psikozës Korsakov, të demences së parakohëshme dhe senile, halucinacionet, sidomos vizivet, sindromi halucinatoro-paranoid i studjuar me hollësi nga Gordon, Dide dhe Guiraud (14). Si simptome të përgjithëshme gjithashtu konsiderojnë gjendjet depresive interminente, statusin maniakal pa fuga idearum, anomalinë e karakterit, epilepsinë (kriza e madhe, karakteri epileptik, gjendja krepuskulare, amentive). Sipas E. H. Bernard (4), në Gjermani, sindromi konsfuzional i Baruk-ut, njihet me emërin e sindromit të Korsakovit, që e quajnë ndryshe sindrom amnestik organik, ose «psykoorganik», sipas Bleuler-it.

Në të sëmurët tonë, çregullimet e përgjithëshme psikike, që u takuan më shpesh janë: sindromi neurastenik ose histerik në fillim të proçesit patologjik, frenimi i përgjithëshëm i të sëmurit, që kalon në disa shkallë (adinamia, apatia, obnubilacioni, somnoleca patologjike, torpori — gjendje turllosjeje, sopori dhe koma), sindromi amnestik i Korsakovit (amnezi e të fiksuarit, dezorientimi amnestik në kohë dhe vend, konfabulacione), kriatat epileptike, gjendja amentive, sindromi depresiv, maniakal, pseudoparalitik, labiliteti emocional, puerilizmi, onirizmi ekmnezik.

Ne nuk c shikojmë me vend të paragesim raste për të demostruar simptomet e përgjithëshme psikotike gjatë tumoreve cerebrale, sepse këto janë pëershkuar me hollësi nga autorë të tjera. Do të ndalemi pak më gjatë mbi onirizmin ekmnezik. Sikurse u tha edhe më sipër ëndrat ekmnezike gjatë tumoreve cerebrale u pëershkuajtën nga Baruk. Më vonë edhe Shamburov (15) pëershkroi dy raste të tillë, në njërin nga të cilat ekmnezia çfaqet në formë të aurës epileptike. Të sëmurët e tij ishin me tumore frontale, ndërsa Baruk (2) nuk ndalet në lokalizimin e tumorit. Ekmnezinë, për herë të parë, e pëershkroi Pitres gjatë histerisë. Ajo konsiston në kthimin e subjektit në një periudhë të mëparëshme të ekzistencës së tij, të cilën ai e jeton plotësisht. Bie në sy corientimi në kohë dhe vend.

Më poshtë do të pëershkuajmë një rast me onirizëm ekmnezik të konstatuar tek i sëmuri me tumor cerebral.

Pacienti H.C., vjeç 47, bujk. U shtrua në klinikën e neurologjisë, 20.XII.1960 dhe vdiq më 28.I.1961. Në hyrje ankonte cefale, vertigo, pasiguri në ecje. Objektivisht, veç lezioneve organike (sindromi paleo-cerebral), u vunë re edhe turbullime psikike. I sëmuri jetonte periudhën e viteve të para pas çlirimt, kur në fshatin e tij, akoma nuk ishin eliminuar feudalo-kulakët. Me ditë të tëra i dukej sikur ndodhej në fshat, bisedonte gjallërisht me «kulakët», u kundërshtonte atyre, jepte reaksione të gjalla emotive, protestonte energjikisht për «padrejtësitë» e elementeve reaksionarë, falenderonte «njerezit» që do të zhvillonin reformën agrare. Të sëmurët e tjerë i konsideronte si bashkëfshatarë, hynte në kontakt me ta, u ndryshonte emrat. I mungonte pra orientimi në kohë dhe vend. Kritikën e gjendjes së tij nuk e kishte. Në përgjithësi paraqitej i kënaqur. Me periudha binte në gjendje adinamie, somnolence dhe torpori. Punksioni lumbal dha një disociacion të fuqishëm albuminocitologjik. Në fundus oculi staze papilare. Është karakteritike të shënojmë se pas çdo punksioni lumbal, fenomenet e ekmnezisë i largoheshin. Para vdekjes ra në gjendje stuporoze, pastaj iu zhvillua sopori dhe më vonë koma. Në autopsi u konstatua tumor cerebral me komprimin të ventrikulit të IV-të.

Në rastin konkret duket këtë se onirizmi ekmnezik është pasojë e hypertensionit intrakranial. Këtë rast ne e paraqisim si shumë të ralle. sepse në bibliografinë e konsultuar (66 autorë) e gjetëm të pëershkuar vetëm në dy punimet, që përmëndëm më sipër.

Më poshtë po analizojmë edhe një rast për të treguar se si tumoret cerebrale mund të çfaqen me sindromin neurastenik, ose histerik.

E sëmura F.F. 48 vjeç, e martuar. U shtrua për herën e parë në klinikën e psikiatrisë, 9.IV.58 (N. Kartelës 3200), me diagnozë susp. psikoze presenile. Sëmundja iu çfaq para dy muajve, pas një traume jo të rëndësishme psiqike. Humbi gjumin, oreksin; qëndrushmérinë në punë. I lindën dhëmbjet e kokës, të lokalizuarë më tepër në rajonin fronto-temporal të majtë, vertigoja, prishjet e skemës së trupit në momentin kur ishte duke e zënë gjumi. Më vonë u bë mjaft nervoze, prekje për gjëra pa rëndësi, qante, s'duronte dot as zhurmën më, të vogël, lodhej shpejt. Pas një muaji i u çfaqën halucinacionet auditive, me përmbytje jo të kënaqëshme. Për këtë e suallënë në klinikën e psikiatrisë, ku qëndroi deri më 30.IX.59. Gjatë qëndrimit në klinikë manifstoi fenomene të sindromit depresiv me prishje të skemës së trupit (zgjatja e duarve, këputja e gjishtërinjëve etj). U mjekua me insulinë, glukozë, polivitamina dhe 6 seanca elektroshoku bitemporal. Doli e shëruar plotësisht me diagnozë: psikozë pellagroze, sepse paraqiste shënja dermatiti në qafë, duar dhe këmbë dhe kishte ngrënë bukë misëri. Ekzaminimet e përsëritura objektive të statusit neurologjik, likuorit cerebral dhe fundit të syve dhanë rezultate negative. Herën e dytë u shtrua me 7.VII.61, e dërguar nga neurologu i poliklinikës me diagnozën e formës hebefrenike të skizofrenisë (?). Nuk dihej si filloj sëmundja. U paraqit e gjëzuar, bënte naze, dukej e kënaqur, përdorte fjalë diminutive, sillej si fëmijë, ngacmonte të sëmurët e tjerë. Pas dy ditë ra në gjendje adinamie dhe somnolence, më vonë u zhvillua turpori (ishte si e turllosur, sikur e kishte goditur njeri në kokë), sopori dhe koma. Në mbrëmjen e datës 3.VIII.1961 vdiq. Në autopsi tumor fronto-temporal nga ana e majtë (meningeoma). Edhe kësaj here ekzaminimi jo shumë i thellë i statusit neurologjik nuk zbuloi lezione organike.

Duke analizuar këtë rast të tërheqin vëmëndjen dy momente kryesore: 1. Herën e parë tumori debyton me sindromin neurastenik i shoqëruar me gjendje depresive, dhe prishje të sintezës senore. Këto fenomene më tepër lidhen me dëmtimin që i bëri në fillim tumori temporal. 2. Herën e dytë në plan të parë del sindromi histerik, puerilizmi i shoqëruar me sjellje stupide, që mund të lidhen me kalimin e tumorit në lobin frontal.

Në literaturë janë përshkruar raste kur tumoret cerebrale fillojnë me sindromin psikopatik, me turbullime të theksuara të karakterit dhe perversione seksuale.

Shpesh herë, tabloja klinike psikopatologjike e tumoreve intrakraniale është shumë e ngjashme me atë të formave të ndryshme të skizofrenisë (deri në depersonalizim) epilepsisë, paralizës progresive. Të shumta janë rastet kur në autopsin e «skizofreneve» janë gjetur tumore masive cerebrale. Për këtë ka shkruar edhe Pishçugin. Një gjë e tillë do ta shikojmë edhe në të sëmurët tonë, të cilët do t'i analizojmë pak më poshtë.

Tani do të ndalemi mbi manifestimet e ndryshme psikotike që takohen gjatë neoformacioneve intrakraniale, në mvartësi, nga lokalizimi.

Nga të gjithë neuropsikiatret pranohet se tumoret frontale japid më shpesh dhe më shumë turbullime psiqike (2, 6, 15 etj), e se këto ndryshime në shumicën e rasteve, çfaqen para lezioneve organike neurologjike (16). Sipas të dhënave të literaturës, kur dëmtohet pjesa konvekse e lobeve frontale lind apatia, akinezia, torpori etj. (16), kur dëmtohet rajoni premotor çfaqet sindromi automatizmave motore, psikomotore dhe emocionale.

nale, ndërsa lezionimi i pjesës bazale manifestohet me sindromin e inhibicionit ose pseudoparalizës (4, 8, 16). Një vënd të rëndësishëm zë dismnezia (hypomnesia, çorientimi spaciotemporal, konfabulacionet) narkolepsia (Lechelle, Alajuanine, Thevenard -cit nga 2), turbullimet e karakterit dhe të humorit (1,9 16), lodhja e shpejtë, vështirësija për të përqëndruar vëmëndjen (4), gjëndjet e vërteta maniakale (4, Lange, Palish). Më rrallë takohen ekmnezia, puerilizmi, gjëndjet e tipit histeroid (Messimy, Hecaen, Ajuariaguerra — cit nga 4). Një vënd të rëndësishëm gjatë tumoreve frontale zë moria e përshkruar për herë të parë nga Jastrowitz, ose «mendjemprehtësia». Vështirësi të madhe për diagnoz- diferencialin paraqet sindromi pseudoparalitik, që mund të ngatrrohet lehtë me paralizën progresive, demendën senile dhe hebefrenine.

Midis 33 të sëmurëve tonë, 19 ishin tumore frontale të lokalizimeve të ndryshme. Nga këta 7 ishin gra, 12 burra, me profesione të ndryshme dhe moshë mesatare rrëth 35 vjeç. Tabloja klinike e 19 rasteve ishte si më poshtë: 6 paraqitën sindromin pseudoparalitik, 3 sindromin adinamik- apatik, 3 sindromin depresiv, 2 sindromin katatonik, 2 gjendjen maniakale, 2 sindromin e morias dhe një fenomene distimike.

Gjatë gjëndjeve pseudoparalitike binin në sy këto simptome: euforia e shoqëruar me ndjenja bamirësie, mungesa e kritikës karshi gjendjes së vet psikopatologjike, indiferentizmi për detyrat familjare, hypomnesia, që shpesh hynte në kuadrin e sindromit të Korsakovit; sidomos binte në sy çorientimi spaciotemporal. Të tertiqitë vëmëndjen sjellja mendjelehtë e këtyre të sëmurëve, mungesa e shqetësimit për të ardhëshmen, ezauribiliteti psiqik, me periudha idetë e madhësisë. Fenomenet e përshkruara ne i gjotëm gjatë tumoreve frontale me lokalizim bazal. Më poshtë po përshkruajmë një rast të tillë.

I sëmuri R.G. vjeç 40, bujk, i martuar. Herën e parë u shtrua në klinikën e neurologjisë në Shkurt të vitit 1961. Sëmundja i filloj gradualisht, më ndryshimin e sjelljes. Humbi gjumin e u bë grindavec, nuk i pëlgente më të punonte, nisi të përdoronte pijet alkolike. Shumicën e kohës c'kalonte jashtë shtëpisë, nuk preokupohej aspak për familjen. Largohej nga fshati pa lajmëruar njeri; nuk kujdesej si përpëra për veten e tij, rrinte në mendime. Kjo gjëndje i vazhdoi rrëth dy muaj. Si shkak për shtrimin e tij në klinikë shërbeu fakti, se në mes të dimrit, u la në lumë, gjë që s'e kishte bërë përpëra. Në hyrje në klinikë ishte euforik, i predispozuar për të hyrë sa më shumë në kontakt me mjekun, kishte logore, sikur i mbahet goja, (dizaneri), i pëlqenin bisedat erotike. Me momente të linte përshtypjen e njeriut të dehur, të turllosur, që për një çast humbiste në ëndërrimë të largëta. Objektivisht në *status neurologicus* u konstatuan lezonë organike, të ngjashme me ato të paralizës progresive (pupilat myotikë, lehtësishët të deformuara, paralize centrale faciale D, ataksi e lehtë dextra, hyperrefleksi patelare, pa reflekse patologjike D—S. *Fundus oculi*, kranigrafia dhe punktioni lumbal nuk zbuluan asgjë patologjike. Megjënjëse edhe në anamnezën familjare kishte momente që mund të dyshoje për sifilliz, të sëmurtit iu vu diagnoza e neuro-luesit. Pas dy muaj qëndrimi në klinikë doli pak i përmirësuar. Në fshat më tepër rrinte i vetmuar, apatik, indiferent. Me periudha nisi të ankojë dhëmbje koke, dobësi shikimi, pasiguri në ecie, nauze. Sipas këshillave të mjekut u rishtruar në klinikë më 26.IX.1961. Atëherë i sëmuri ishte i obnubiluar, nuk përgjigjej ndaj pyetjeve që i drejtonin, sikur kishte pësuar një kontuzion cerebral. *Fundus oculi* kishte stazë papilare, likuori ngelej normal. Pas mjekimeve me solucionë hypertonike gjendja disi u përmirësua, por mbeti

apatik, si i huaj pér ambjentin rrrethonjës, me orientim të humbur allopsiqik. I mungonte kritika karshi gjendjes së vet patologjike. Më vonë u zhvillua afasia sensore, astereognозa, obnubilacioni, sopori dhe në gjendje komatoze vdiq datë 19.X.1961. Në autopsi tumor masiv frontal që prekte në mënyrë të veçantë rajonet bazale.

Këtë rast ne e paraqesim pér të treguar se tumoret frontale mund të jepin tablonë e paralizës progresive si nga ana e jashtëme klinike ashtu dhe dekursi. Në rastin konkret sëmundja çlaqet me sindromin neurastenik, më vonë dominon sjellja stupide me fenomene demence dhe më në fund i sëmuri bije në gjendje torpori, sopori, kome dhe vdes. Nuk duhet harruar se edhe gjatë tumoreve cerebrale serorëaksionet specifice mund të jepin rezultate pozitive. Pneumoccefalografia, arteriografia dhe elektro-encefalografia, që atëherë nuk mund t'i bëheshin të sëmurit, do të kishin ndihmuar në prezicimin e diagnozës.

Edhe në rastin e dytë, që do të përkruajmë më poshtë; do të ndalemi më gjatë pér të parë se si tablonë psihotike të tumoreve cerebrale, mund të ngatrohen me psikoziat endogjene.

I sëmuri P.N. vjeç 40, i martuar, bujk. U shtrua në klinikën e psikiatricë datë 18.VIII.1961 me diagnozën «gjendje depresive». Sëmundja i u qfaq para 3 muajve, pa ndonjë shkak të jashtëm provokues. Nisi të bëhej me qejf, të hajë shumë, të humbasë ekuilibrin (anonte nga e djathta). Pastaj u izolua nga shoqëria, i pëlgente vëtmia, s'bisedonte me njeri, nuk dilte në punë, s'interesohej pér asnjë, rinte në mendime, kishte një frikë të pashpjegueshme. Nga neurologu i poliklinikës i u caktuan 4 seanca elektroshoku bitemporal, pas të cilave statusi psihik pothuajse u normalizua. Por mbas dy javë gjendja përsëri u keqësua. U bë si i ngrirë, me zi ecte, i merreshin mentë, i dridhjej trupi, nuk i fliste njeriut, preu të ngrënë. Pér këtë u risuall pér kontroll dhe u shtrua në klinikën e psikjatricë. Në anamnezën familjare dhe personale nuk u zbulua asnjë me rëndësi. Statusi psiqik i të sëmurit në hyrje paraqitet si më poshtë: Pacienti hyn në dhomën e mjekut kokë ulur. Në sytyrë duket i deprimuar. Ambjenti i ri nuk i bëri asnjë përshtypje. Ulet në karrike si pa qef, duke e parë atë me vrejtje. Pastaj, pasi ngrihet, ulet përsëri (ambitedencë). Ndaj shumicës së pyetjeve që i drejtohen nuk jep asnjë përgjigje. Me periudha përgjigjet, e me vonesë të madhe. Orientimin auto dhe alopsiqik e ka të ruajtur. Bien në sy barazhet, ndërprerjet në procesin e të menduarit. Ka raste kur përgjigjet sipas stilit telegrafik, me zë monoton, pa gjallérinë përkatëse. Gjatë bisedës nuk qëndron i qetë në karrike, disa herë ngrihet prej saj, qëndron në këmbë, pastaj përsëri ulet (lëvizje stereotipike). Formalisht ka kritikën e sëmundjes, por nuk di të shpjegojë natyrën e saj. Kontakti me të është i vështirë. Në sytyrë me momente të le përshtypjen, se nuk shpreh asnjë, duket indiferent. Ka raste kur qesh pa arësy, kur mjeku e pyet pér diçka. Nuk impresionohet nuk i kujtohen të afërmitt dhe i thuhet se do të qëndrojë gjatë në spital. Objektivisht u vu re pareze faciale centrale nga ana e majtë. Gjatë më se dy javë qëndrimi në klinikën e psikiatricë statusi psiqik i të sëmurit shkoj duke u keqësuar. Ra në gjendje somikatatonie: gjithë kohën e kalonte shtrirë, nuk preokupohej pér asnjë, s'parashtronë asnjë kërkësë, urinonte në dyshek. Gjatë vizitave të mjekut, në përgjithësi, nuk reagonë, veçse kur pyetej thoshte se ishte i sëmure. Pyetjet e mjekut s'i tërhojnë vëmërdjen, ndaj tyre nuk përgjigjet, shumë herë e shikonte atë në sy si i çuditur. Me periudha ruante duke qenë shtrirë në dyshek një pozë të caktuar. Kishte ditë kur tablojatatonike zhdukej dhe kontakti me të sëmurin përmirësohej. Ai atëherë

paraqitej somnolent, i frenuar. Ankonte dhëmbje koke, marje-mendësh dobesi te përgjithësni. Në këto momente binte në sy lodiha psiqike, që e pengonte te vazhdonte bisedën. Ditet e fundit, para se të transferohej në kliniken e neurologjisë lindën levizjet e pavullneteshme në dorçë e djaintë, që të lirin përshtypjen e simptomit te «numurimit të parave». Duke u nisur nga mikrosimptomatika neurologjike dhe atipiciteti i tableseë klinike, u dyshua për tumor. Punktioni lumbar, zbuloi në likuor një disosacion proteino-citologjik. Datë 6/IIX/1962 transferonet në neurologji. Objektivisht në status *neurologicus* u vunë re këto shenja: Fytyra amimike, gjunën nuk e nxjerr skupton fjalët, parezë faciale nga ana e majtë, hypertoni muskulare në ekstremitetet e majta, rigiditet i përgjithshëm në duart. Refleksi Marinesco-Radoviç bilateral, sidomos nga ana e majtë, simptomë i Babinskit spontan nga ana e majtë. Kernig i lehtë bilateral. Ataksia sinistra. Urinon dhe deiekton në dyshek. Më vonë çfagen edhe më kjartë simptomet e automatizimit oral, reflekset patologjike. I sëmuri bie ne gjendje subkomatoze, më pas në kome dhe vdes me 7.XI.62. Kranio, pneumo dhe arteriografia përforcuan diagnozën e tumorit frontal dexter, gjë që u vërtetua edhe në autopsi.

Tabloja klinike e këtij esntë ajo e katatonisë. Si shenja atipike, që shërbyen për diagnoz-diferencialin ishin ruajtja e kritikës karshi sémundjes; kthjellimet periodike, e zauribiliteti i proceseve psiqike. Në materialin tonë disponojmë edhe një rast ku psikoza çfaqet me histeri.

Mbi tumoret e bazës cerebrale është shkruar një literaturë shumë e pasur. Ne do të ndalem shkurtimish në turbullimet psiqike gjatë lokalizimit të neoplazmës në diencefaloni, dhe hypofize. Për tumoren hypofizaren është tipik sindromi Icenko-Kushing i shoqëruar në stadiet e avancuara me turbullime të karakterit, labilitet emocional, episode psikotike me agresivitet (5), lodihe të madhe, asteni, apati, somnolence dhe hypomnezi (10). Gjatë tumoreve diencefalike takohen më shpesh turbullimet e gjumit (hypersomnia, asomnia, dysomnia), narkolepsia me fenomene onirizmi, halucinacionet vizive (2, 16), epilepsia diencefalike, gjendjet akinetike me mutizim (4), sindromi i Korsakovit (16), rënie e aktivitetit intelektual (Cushing, Sainton, cit nga 2), instabiliteti emocional, krizat maniakale dhe depresive (2, 16), turbullimet e metabolizmit etj. Shpesh herë turbullimet psiqike çfagen në kuadrin e sindromit diencefalik anterior të Penfieldit ose atij posterior të G. de Marsier. Ne sindromet hypotalamiko-pedunkulare fusin edhe sindromin e halucinozës pedunkulare të Lhermitte, që quhet ndryshe onirizmi hypnagogjik, gjatë të cilit i sëmuri shikon «ëndra me sy hapur» (9, 14, etj.).

Më poshtë po jepim një rast me tumor diencefalik që u shoqërua me turbullime psiqike. I sëmuri Z.B. vjeç 36, shofer, i martuar. U shtrua në klinikën e psikiatrisë, i dërguar nga K.M. L. i neurologjisë, datë 13.XI.1961, (N. Kartelës 9309) me diagnozë: «*Psychopathia*, ose M. Bleule». Sëmundja i filloj para 3 muajve me pagjumësi, nervozitet, ndryshim të sjelljes. Nisi të tregoj arogant në familje, s'përfillete njeri, (përpara nuk kishte një zakon të tillë), sillej në mënyrë të ashpër me fëmijët. Më vonë mbante thikë, me të cilën kërcënonte gruan. Në punë nuk ishte i sjellshëm nuk respektonte orarin, manifestonte impulsivitet. Me periudha qante pa arësy. Më vonë filloj të bjerë në sy labiliteti emocional, rrinte si i humbur, braktisi plotësisht punën. Për këto fenomene u hospitalizua. Në hyrje statusi psiqik i të sëmurit paraqitet si më poshtë: Është me orientim të ruajtur auto dhe allopsiqik. Ndaj pyetjeve që i drejtohen përgjigjet me vështiresi, megjithëse drejt. Të le përshtypjen e njeriut të përgjumur, të trullosoj,

sikur është loddhur shumë. Referon së ka tri muaj që s'punon, sepse pa pritur e zë gjumi si natën ashtu edhe ditën, prandaj ka frikë se mos t'i ndodhi ndonjë aksident me magjinën. Ka kritikën e sëmundjes së vet. «Kam ardhur të bëjë një kurë, që të «shërohem»; por këto fjalë nuk i thotë me ekspresionin përkatës, i nxjerr nga goja si me zor. Duket sikur është në gjumë, ëndëron. Shton, se këto kohët e fundit i ka hypur një mërzitje e madhe, që s'di si ta shpjegojë. Kur pyjetet sikur zgjohet, mobilizohet të përgjigjet drejt. Paraqitet tepër i frenuar, në gjendje torporoze jo të theksuar. Objektivisht dukej se kishte një paralizë faciale centrale nga ana e majtë dhe asgjë tjetër patologjike. U diagnostikuva psikoza deprezive.

Të nesërmen, duke qenë i shtruar në klinikën e psikiatrisë, pati një krizë të vërtetë epileptike, më shumë nga goja: 24 orë pas krizës statusi psikoneurologjik i të sëmurit paraqitet si më poshtë: Velëdija e errësuar. Është në gjendje torpori. Pyetjet që i drejtohen i kuption me zor. Përgjigjet me vështirësi. Paralizë centrale faciale nga ana e majtë. Hemihypoeztetia sinistra. Prezent sindromi meningeal. Provat cerebelare janë negative. Veti i sëmuri ankon dhëmbje koke, thotë se ka patur të vjella. Me diagozën «tumor cerebri» u transferua në klinikën e neurologjisë. Këtu u konstatua edhë dizartria, rigiditeti i përgjithëshëm i këmbëve, hyperrefleksi bilaterale tendinoza dhe periostale, lëkundja në nozën Romberg. Më vonë paraqiti paralizë të nervit hypoglosus nga ana e djaththë (pa fibrilacione), hyperrefleksi më të theksuar në ekstremitetet e djathta, refleksin e Babinskiit nga ana e majtë, simtomin Bare pozitiv nga ana e majtë.

Deri me datën 20.XII.1962, nga ana psiqike paraqitet i frenuar, i obnubiluar. Ankon dhëmbje koke, të vjella. Shpesh herë e zë gjumi ditën dhe në mbërëmje. Me periudha manifeston eufori, i mungon kritika karshi gjendjes së vet patologjike. Duket si i trullostor, si i dehur. I pret me buzë-qeshje pyetjet e mjekut ka momente kur kërkon të dalë nga spitali. Nuk reagon ndaj talljeve që i bënin disa të sëmurë. Të ecurit s'ë ka të sigurtë i merren mentë. Gjumi e zë pa pritur me cigare në gojë, e mban 2-4 orë, ose edhe më tepër. Shumë herë kur e pyet të shikon në sy si i përgjumur dhe nuk përgjigjet.

Pas punksionit lumbal, që zbuloi një disociacion të theksuar proteinocitologjik, pneumoencefalografisë dhe punksionit cisternal, gjërdia e të sëmurit u rëndua. Filloi të qfaqi afazi sensore dhe motore, gjumë të fortë patologjik, refuzonte ushqimin. Terapia e shumëlljoëshme që i aplikohet e ndihmonte pak. Datë 21.XII.1962 ka patur disa atake epileptike rrjesht, që fillonin me Jackson motor nga ana e djaththë dhe që i u përsëritën disa herë edhe në mëngjiczin e datës 22.XII.62. Pas një muaji lindi agnosia optike dhe hemipareza nga ana e djaththë. Datë 14.II.62 mjeku kurues shkruan se i sëmuri paraqitet euforik. Veten e ndjen mirë, si në shtëpinë e vet. I mungon kritika e gjendies së tij. Më vonë, krahas somnolencës patologjike, gjendjes torporoze dhe euforisë, del në evidencë edhe corientimi spacialetemporal. Mendon se ndodhet në hotel. Manifeston siellie të vecanta, që të kuiton të sëmurët me paralizë progresive, nderon si ushtar. Të tërhiqte vëmëndjen amnesia e fiksimit, e shkaktuar nga gjënda torporoze. I sëmuri nuk mbante mënd asgjë nga ngjarjet e ditëve të fundit në klinikë. Binte në sy afazia amnestike.

Për tablonë klinike të rastit që ne analizojmë është karakteristike labiliteti i simptomatikës psikopatologjike, kthiellimet e përkohëshme, gjatë të cilave i sëmuri paraqiste një gjendje pseudohypomaniakale. Shtimi i krizave epileptike ditët e fundit dhe kriatat e shpeshta të narkolepsisë.

Datë 24.IV.1962 gjëndja e të sëmurit pa pritur u keqësua, tensioni arterial i hapi në 190/80 mm. Hg. ra në gjendje subkomatoze, më vonë në koma dhe vdiq ora 17.

Diagnoza klinike, tumor i hemisferit të majtë (*regionis fronto-temporalis*) me interesim të rajonit diencefalik. Kjo diagnozë u mbështet edhe në të dhënët e arteriografisë. Në autopsi u gjet tumor *cerebri regionis hypothalamicus* me penetrim në ventrikulin e III. *Gloria Cysticum*. Duke analizuar këtë rast nga ana psikiatrike, të tjerëc qin këto fenomene: sindromi psikopatik në fillim, labiliteti emocional dhe gjendja depresive, somnolencia patologjike, narkolepsia, torpori, sindromi i Korsakovit, euporia e shqëruar me mungesë kritike, sjellja e një të sëmuri me paralizë progressive, afazia sensore dhe motore, krizat epileptike.

Në një rast tjeter me tumor hypotalamik, (i sëmuri A.R. vjeç 31, shtruar në klinikën e neurologjisë datë 13.III.1961 deri në 31.III.1961) krahas adipozitetit, subfebrilitetit dhe dhembjeve të kokës të karakterit paroksistik, binin në sy edhe gjendja amentive, sindromi i Korsakovit, inkoherenca në mendime, sjellja psikopatike, obnubilacioni, somnolencia, lëkundjet e mëdha të tabllosë psikopatologjike. Në rastin konkret doli tepër pozitiv edhe reaksioni i Wassermanit në gjak.

Një nga të sëmurët me tumor hypofizar paraqiti gjendje të zgjatur depresive (N.P. 28 vjeç, shtruar në klinikën e neurologjisë me 16.VII.60 deri 13.XII.1960 me adenome bazofile, kurse një grua e re ra në gjendje të thellë katatonie me stupor, mutizëm, katalepsi, negativizëm.

Duke konkluduar ne themi se tumorët diencefalice shoqërohen shpesh me turbullime psiqike, e se këto të fundit zënë një vënd të rëndësishëm në tablonë klinike.

Të shpeshta janë rastet kur tumoret temporale shoqërohen me turbullime psiqike, sidomos kur procesi patologjik lokalizohet në lobin e majtë. Fenomenet psikotike janë aq karakteristike sa që mund të mbështetesh plotësisht për të vënë diagnozën topike. Në materialin tonë ne disponojmë një rast me tumor të lobit temporal dhe një fronto-temporal. Në të dy rastet turbullimet psiqike kanë patur karakter të përgjithshëm dhe nuk përmbajnë asgjë specifike. Në fillim kanë qfaqur distraksion, adinami, apati, obnubilacion, somnolence, gjendja torpozoze, subkomatoze dhe kanë vdekur në komë. Duhet thënë se këtu ka munguar studimi special i turbullimeve psiqike; të sëmurët janë shtruar në gjendje të rëndë dhe ekzaminimi i tyre i hollësishëm është penguar shumë.

Një vend jo pak të rëndësishëm zënë edhe çrrëgullimet psiqike gjatë tumoreve parietale, megjithëse, sipas autorëve të ndryshëm, ato nuk janë specifike (4). Këto janë më të shpeshta dhe më të shumta, atëherë kur neoplazma dëmtion lobin e majtë. Në materialin tonë kemi dy raste me tumore fronto-parietale, gjatë të cilave më tepër ishte dëmtuar lobi parietal. Në njerin, tumorri parietal, ndodhej në lobin e djathë dhe kishte komprimuar ventrikulin lateral. I sëmuri paraqiste somnolencë. Më vonë ra në gjendje stuporoze të thellë dhe vdiq jasht shtetit, pas operacionit. Në rastin e dytë do të ndalem pak më gjatë.

I sëmuri M.L. vjeç 35, i martuar, u shtrua në klinikën e neurologjisë me 27.IV.1962 dhe vdiq me 24.VI.1962. Shenjat e para të procesit intrakranial ishin dhëmbjet e kokës të lokalizuara në rajonin parietal të majtë, iritabiliteti labiliteti emocional. Më vonë u bë indiferent karshi gjendjes së vet patologjike, humbi kuriozitetin, i lindën çrrëgullimet e skemës së truvit (i dukej sikur i fryhej koka, i këputeshin duart etj.). Para se të nisej jashtë shtetit për operim ra në gjendje somnolente, ishte tepër i frenuar. Kur

kthjellohej binte në sy gjendja depressive me ide shkatërimi, qante me lot, e konsideronte veten të humbur. Lezionet e shumta organike neurologjike dhe ekzaminimet ndihmëse, fisiqnë më tepër për tumor parietal të majtë. Kjo diagozë u vertetua në autopsi.

Sikurse shihet, në rastin konkret, turbullimet psiqike mund të përmblidhen në sindromin neurastenik, depresiv, atë të Babinskit, të prishjes së sintëzës sensore dhe të somnolencës.

Alteracionet psiqike gjatë tumoreve parietale në mënyrë të vegantë u studjuan nga Jackson (1863), Monakov, Minkowski, Munk (Cit nga 2) Gureviç, Shmarjan etj. Më shpesh takon këto fenomene; 1) sindromi i anosognosizës, i Babinskit (indiferentizmi për turbullimet neurologjike-anosodiaporia, mungesa e kuriozitetit). 2. Turbullimet e imazheve trupore hemiasomatognosia 3. Sindromi Gerstmann (lobi i majtë): agnozia digitale, agrafia, humbja e orientimit «djathtas», «majtas», akalkulia, hemianopsia 4. Dysomatognozia paroksitike (i sëmuri ka përshtypjen se i mungon dora, sensacioni i deformimit të ekstremiteteve). 5. Epilepsia sensore, halucionet taktile, apraksia ideormotore (1-6 janë cit. nga 2) 7. Prishja paroksizmale e skemës së trupit (depersonalizimi), sidomos, kur dëmtohen lobi i majtë: mikropsia, makropsia; allestesia optike, dezorientimi spacial. Të sëmurët e kanë të vështirë të bëjnë konkluzione të komplikuara (2). Ndjenja e katastrofës, ose e pavdekshmërisë e shoqëruar me sindromin hypokondriko-depresiv dhe delirin nihilistik (12) 10. Automatizma të ndryshme, fenomene halucinatoro-paranoide (16) 11. Depersonalizimi me jehonën e mendimeve (16) etj.

Edhe tumoret cerebelare mund të shoqërohen me turbullime psiqike, atëherë kur kemi një ngritje të konsiderueshme të hypertensionit endokranial. Midis 4 të sëmurëve tonë që patën tumore cerebelare me çregullime psiqike, njeri manifestoi onirizëm ekmnezik (për këtë u fol me hollësi në faqet e para të këtij punimi), kurse në tre të tjerët u konstatua logorea, euporia, mungesa e kuriozitetit dhe e kritikës ndaj sëmundjes, i shoqëruar nganjëherë me ndjenjën e indiferentizmit (sindromi i anosognosizës i Babinskit). Sipas të dhënavë të literaturës, çregullimet psiqike gjatë tumoreve cerebrale karakterizohen me asteni të përgjithëshme, hypomnezi, somnolence (deri në torpor), halucinacione, sjellje stupide (7), nganjëherë dhe sindrom paralitic.

Para se të analizojmë patogjenezën e turbullimeve psiqike gjatë tumoreve cerebrale duhet të themi se edhe cisticeroza e trurit të madh mund të japi alteracione psiqike të ngjashme me ato që jepin tumoret.

Cila është patogjeneza e turbullimeve psiqike që lindin gjatë tumoreve cerebrale. Maruk (2) i lidh me hipertensionin intrakranial, intokksacionin, reaksionet inflamatore meningeale, edemen cerebrale, shkaqet e përgjithëshme dhe lokale. Sipas Shmarjanit -(16) tre janë faktorët kryesorë: 1) Faktori lokal. 2) Faktori i përgjithshëm cerebral. 3) Faktori i përgjithshëm patogenetik. Ky autor i jep rëndësi turbullimeve hemo dhe likuorodinamike, reaksioneve glioze inflamatore, fenomeneve dislokative trunkale, reflektore dhe çregullimeve kortiko-trunkale.

Knipel, Marie, Dupre i lidhin me tokositetin e vetë tumorit. Lidhur me këtë problem ka diskutime të shumta. Një pjesë e psikiatereve duan t'i shpjegojnë turbullimet psiqike vetëm me faktorin lokal, kurse të tjerët me faktorin e përgjithshëm cerebral. Zgjidhja e drejtë është ajo që i ka dhënë Pavlovit i cili ka thënë: «Hemisferat janë instrumenti special i takimeve, lidhjeve që disponon një reaktivitet të lartë, pra rrjedhimisht çdo

dëmtim i tij në një vend, duhet të japi jehonë, duke u reflektuar në të gjithë instrumentin, ose në shumë pika, ose pjesë, larg tij».

Ne mendojmë se midis shkaqeve jo lokale, që determinojnë turbullimet psiqike, roli kryesor i përket hypertensionit endokranial. Këtë që thamë do ta ilustrojmë me një rast shumë demonstrativ, shtruar në kliniken e kirurgjisë hospitaliere.

I sëmuri I.K. 40 vjec, bujk i martuar. U shtrua në klinikën e kirurgjisë hospitaliere me 18.7.1962 (Nr. kartelës 3047) dhe doli me 24.VIII.1962. Diagnoza klinike: Ca metastatik pulmonar bilateral. Në kohën kur psikiatri u thirr për konsultë statusi psikoneurologjik i të sëmurit paraqitej si më poshtë: Ishte me orientim të humbur allopsiqik, mendonte se ndodhej në shtëpinë e vet. Ndaj pyetjeve që i drejtosheshin përgjigjej me vështirësi. Perseveronëtë në mendimet, kishte ekolali, pak e interesante ambienti rrëthonjës, i mungonte kritika ndaj gjendjes së vet patologjike. Me periudha dukej euforik, urinonte dhe defektante në dyshek. Në përgjithësi binte në sy kuadri klinik i gjendjes torporoze. U bë punksioni lumbal, likuori doli me presion të lartë — 160 pika në minutë. U zbulua një disociacion jo i theksuar proteino-citologjik. Në *Status neurologicus* u konstatua paralizë centrale e djathët e nervit facial dhe *hypoglossus*, hemiparezë centrale e djathët, ataksi në anën e djathët dhe dismetri. Në *fundus oculi* — staze papilare me zhvillimin mesatar. Pas punksionit lumbal i u zhdukën fenomenet psikopatologjike të përshkruara më sipër. I sëmuri kishtë kritikën e gjendjes së tij. Kërkonte ndihmë. I ngelën simptomet neurologjike dhe doli në dritë amnezia e të fiksuarit të ngjarjeve korente. U mendua për tumor metastatik në lobin frontal të majtë.

## K O N K L U Z I O N E

1. Sipas të dhënave të literaturës dhe observacioneve tona, tumoret cerebrale shpesh herë jepin turbullime psiqike, që mund të mbizotërojnë në tablonë klinike. Ka raste kur ato çfaqen para lezioneve organike, si p.sh. gjatë tumoreve frontale.

2. Më shpesh alteracionet psiqike sipas materialit tonë takohen në neoformacionet frontale dhe diencefalice. Turbullimet psiqike që çfaqen gjatë tumoreve frontale mund të ngatrrohen me paralizëm progresive, demencen senile, alkolizmin kronik dhe formën hebefrenike të skizofrenisë.

3. Simptomi më i shpeshtë psikotik që takohet në këto raste është inhibicioni i të sëmurit, që mund të manifestohet me obnubilacion, somnolencë, gjendje torporoze, subkome ose kome. Në plan të dytë vijnë kri-zaq epiplektike, euporia, sindromi i Korsakovit, turbullimet e karakterit etj.

4. Përveç simptomeve të përgjithëshme psikotike, tumoret cerebrale shoqërohen me çrrregullime psiqike në vartësi nga lokalizimi. Më të kjarta dhe më specifike në këtë drejtë janë alteracionet psiqike gjatë dëmtimit të lobeve frontale, temporale, parietale dhe rajonit diencefalic. Zakonisht tabioja klinike psikopatologjike gjatë neoformacioneve cerebrale është kombinimi i simptomeve të përgjithëshme me ato lokalet.

5. Për të bërë diagnoz-diferencimin nga psikoza endogjene duhet të mbështetemi në këto veçori të turbullimeve psiqike gjatë tumoreve cerebrale: a) Labiliteti i simptomatikës psikopatologjike, kthjellimet e përkohëshme të të sëmurit, të zhvilluara sidomos pas punksionit lumbal ose rrejekimit me solucionë hypertonike; b) Ruajtja e kritikës në fillim ndaj

fenomeneve, patologjike; c) Shumëlojshmëria e simptomatikës psikotike kombinimi i saj me kriza epileptike dhe lezone organike. S'ka dyshim se ekzaminimet komplementare (analiza e likuorit, *fundus oculi*, pneumo, angio dhe kranigrafia) janë shumë të rëndësishme për diagnizëm, 4) Një rëndësi të veçantë ka frenimi i përgjithëshëm i të sëmurëve. Këtu s'kemi autizmin e skizofrenëve, indiferentizmin, ose otuzitetin emocional. Të sëmurët janë vetëm të inhibuar, kurse emocijet i kanë të ruajtura, synojnë të njekohen. Të tjerëq vëmëndjen ladhja e madhe, ezauribiliteti i proceseve psiqike.

6. Sipas mendimit tonë hypertensioni endokranial gjatë tumoreve cerebrale lot një rol shumë të rëndësishëm në çfarqjen e simptomave të përgjithëshme psikotike.

(*Paragitur në Redaksi më 5/X/64*)

## B I B L I O G R A F I A

1. Abaimova V.M., Bobkova K.A. «K voprosu o psihicheskikh izmenjenijakh pri opuholjah mozga». — Trudi Instituta im. Gannushkina Vipusk V M. 1940 (f. 530-549)
2. Baruk H. «Les troubles mentaux dans les tumeurs cérébrales» — Traité de psychiatrie, Tom. II Massen et Cie Paris 1959 (F. 1318-1336)
3. Dide et Guiraud. Psychiatri clinique «Etiologie neoplasique (F. 673-678) L. le François Paris. 1956.
4. Ey H. Bernard; P. Brisset Ch. — Manuel de psychiatrie, Masson et Cie Editeurs 1960 (F. 759-773)
5. Ferrio C «La psicosi de tumori endocranici» — Trattato di psichiatria clinica e forense. Vol. I 1959 (F. 914-929)
6. Hecaen et Ajuriaguerra — Troubles mentaux au cours des tumeurs intracraniennes I Vol. Masson et Cie. edit. Paris 1957.
7. Inger. I.M. — Klinika i hirurgicheskoe lechenije upoholej mozzhečka Medgiz 1959 (F. 188-189)
8. Krol M.B. — Nevrologicheskie sindromi G.M.I. Harkov-Kiev 1933 (f. 297-326; 332-333)
9. Oppenheim H. — Rukovodstvo po nervnym boleznjam (Përkthim në rusish nga gjermanishtja) Moskva 1896 (F. 506-524)
10. Popov N.A. — Opuholi gipofiza igipofizarnoj Oblasti (monografi) Medgiz. 1956 (F. 45-196)
11. Rapoport B.I. Zilbershtejn H.N., Litvak L.B. «Materjalli k Klinijke opuholej llobnoj dolji» — Opuholi centralnoj nervnoj sistemi 1936 (f. 55-63)
12. Rapoport M.J. — Nevrologiceskaja diagnostika opuholej visočnih dolej (monografi) Medgiz 1948 (F. 65-69, 103, 107, 113-122; 175-190)
13. Razdolskij I.J. — Opuholi golovnovo mozga (monografi) Medgiz 1954 (F. 94-111)
14. Razdolskij I.J. — Klinika opuholej golovnovo mozga (monografi) Medgiz 1957 (F. 18-26; 26-82; 123-125)
15. Shamburov D.A. «K klinijke opuholej llobnoj dolji golovnovo mozga» — Opuholi Centralnoj nervunoj sistemi 1936 (F. 63-75)
16. Shmarjan A.S. — Mozgovaja patologija e psiatria (monografi) Tom I Medgiz 1949 (F. 46-281)

## PSYCHIC DISTURBANCES IN BRAIN TUMORS (Summary)

The work presented by the authors is based on a rich bibliography of 66 sources. They have studied for 8 years 33 patients with cerebral tumors with serious mental disturbances. Seven of these patients were received in the psychiatric clinic, the other 26 cases were treated in the neurological clinique, since besides the psychic troubles they had pronounced neurologic symptoms.

If we compare the number of these patients with the total number of patients

of the psychiatric clinique during the last 8 years, we find that it makes 0.3%, and if we compare the number of patients with brain tumors (33 cases) that are accompanied by serious disturbances with the total number of endocranial tumors treated in the neurologic clinique, we see that they are 20% of the total number of tumors.

This percentage is low if we compare it with the figure of other authors, but we should remember that we consider only the cases with serious mental disturbances. Baruk has found such cases only in 27.2% of his patients with brain tumors. From the 33 cases of the authors 19 had a frontal localisation, 1 — fronto-parietal, 2 — fronto-temporal, 1 — temporal, 5 — diencephalo-hypophysary, 4 — cerebellar, 1 — in the IIId ventricule. So it can be seen that the frontal tumors give more often psychic troubles than the other localisations.

The second place is taken by the diencephalic tumors. The psychic troubles in the frontal tumors can be interpreted for symptoms of progressive paralysis, senile dementia, chronic alcoholism and the hebephrenic form of schizophrenia. The most frequent psychotic symptom in these cases is the inhibition with obtundation, somnolence, torpor sub-corna or coma. In second place are placed the epileptic crises, euphoria, the Korsakow syndrome, character troubles etc. Besides the general psychotic symptoms the brain tumors are accompanied by psychical troubles caused by the localisation of the process. More clear and more specific are the disturbances in the tumors of the frontal, temporal, parietal and diencephalic regions. A special interest presents the first case illustrated by the authors. This case presented the syndrome of amnesic onirism, described for the first time by Pitres in hysterical accesses. This symptom consists in the return of the patient to a previous period of his existence, which he lives in entirety. Very characteristic is the desorientation of time and place.

Shamburov describes two such cases of ekmanesy in patients with brain frontal tumors. Also Baruk describes a case of ekmanesy, but does not mention the localisation of the tumor. The case of the authors was a brain tumor that compressed the IV ventricle.

In their work the authors point out that for the differential diagnosis with endogenous psychoses should be kept in mind the following psychic troubles: a) the lability of the psychopathologic symptoms, the periods of remission, especially after lumbar puncture or treatment with hypertonic solutions; b) the perseverance of the sense of critique in the beginning of the process; c) the variety of psychic symptoms combined with epileptic crises and organic lesions. They mention at the same time the necessity of the paraclinical examinations: analysis of the liquor, examination of fundus oculi, pneumography, encephalography, craniography, electroencephalography etc.

The authors point out that in his patients is obvious a general inhibition. Usually they do not have autism as the cases of schizophrenia, or their indifferentism or emotive obtusity. The patients are simply inhibited, but with preserved amotions; they ask for medical aid. According to the authors, in the origine of the psychotic troubles should be considered, besides others, the increased endocranial pressure.

## DISA KONSIDERATA STATISTIKORE MBI VDEKJET NGA SËMUNDJET KARDIOVASKULARE

### QESEK RROKU

Shërbimi Anatomisë Patologjike të Spitaleve Tiranë

Sëmundjet kardiovaskulare dhe vdekjet nga këto sëmundje janë bamë problem shumë i randësishëm që preokupon me plot të drejtë shëndetësinë, qoftë për përqindjen e naltë që zejnë në shkaqet e vdekjeve, qoftë për vendin shumë të randësishëm që zejnë në pa aftësinë e përgjithëshme të popullatës, veçanërisht edhe për faktin se, prekin kryesish ato grupe moshash, që kanë arritun kulmin e perfektionimit në aktivitetin e tyne profesional. Simbas Bednar dhe kol.(1), vlefshësimi statistikor i arsyeve të sëmundjeve dhe të vdekjeve tregon se sëmundjet e zemrës janë vazhdimisht në rradhë të parë, dhe se sëmundjet e vazave me në krye arteriosklerozen, janë problem i rradhës së parë për njeriun modern. Simbas Davidovski (5), «Problemi i arteriosklerozës (dhe hipertoni) shtron përrapa njëcrëzimit problemin fundamental të racionalizimit të konditave dhe mënyrës së jetesës, ndryshimin e natyrës së njeriut». Problemi ashi shumë preokupant për të gjitha vendet. Simbas Boyd W. (3) «Sëmundjet e zemrës në vendet e zhvillueme, janë bamë shkaku ma frekuent i pa aftësisë dhe vdekjeve. Në qoftë se këtu inkludojmë involucionin e reneve dhe të vazave periferike, me termin e përshtatshëm të sëmundjeve kardiovaskulo-renale, nuk ekzagjerojmë po të themi se, ma shumë se gjysma e vdekjeve shkaktohen nga këto sëmundje». Po simbas këtij autori, statistikat e Metropolitam Life Insurance Company tregojnë se: çdo vit në Sh.B.A. vdesin rreth 600.000 veta nga sëmundjet e zemrës dhe se nji në çdo tre persona të popullatës që mbrin moshën 10 vjeçë, vdes nga sëmundje organike e zemrës. Jo vetëm përfaktin se sëmundjet kardiovaskulare dhe vdekjet nga ato, zejnë vendini e parë përandësinë e tyne, por edhe përfaktin se këto sëmundje, dhe vdekjet nga to vijnë gjithnjë tue u shtue, e bajnë edhe ma preokupant këtë problem. Indeksi i mortalitetit nga kardiopatite prej vitit 1938 deri në vitin 1957 në Sh.B.A., Francë, Britaninë e Madhe dhe Itali, simbas Concini, B., dhe Masini V. (4), ka pasun këtë dekurs:

1938. SH.B.A. 291,6.	Francë 268,7,	Britani 379,0,	Itali 204,1
1945. SH.B.A. 346,6.	Francë 273,8,	Britani 377,3,	Itali 224,6
1951. SH.B.A. 349,9.	Francë 216,9,	Britani 368,4,	Itali 208,0
1957. SH.B.A. 369,0	Francë 213,3,	Britani 375,7,	Itali 256,3

Në pasqyrën e ma sipërime shifet kuartë se indeksi ka ardhun gjithnjë tue u rritun për SH.B.A. dhe Italinë, kurse në Britani shënon ulje dhe vetëm në vitet e fundit nji ngjitje të theksueme.

Tue paraqitun të dhana të shumta dhe nga ma të ndryshmet, autorët e sipërpërmendun, shtimin e vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare e

shpjegojnë me argumentat e ma poshtëm si: variacionin kualitativ të popullsisë, paksimin e mortalitetit për forma të tjera morboze, precizimin ma të mirë diagnostik dhe ekspertimin ma të saktë të arsyeve të vdekjeve, variacionin e klasifikimit nosologjik të arsyeve të vdekjeve, edhe me shtrimin real të morbozitetit nga sëmundjet kardiovaskulare. Të gjithë autorët e përmendun ma sipër, shtimin e morbozitetit dhe të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare e konsiderojnë problem real dhe mjaft preokupant.

Ky problem sigurisht preokupon edhe shëndetësinë tonë. Për të mundun me kontribue sado pak në këtë problem të randësishëm, i vuem përdetyrë vehtes, që me anë të këtij artikulli me karakter statistikor të informojmë rrethet sanitare të vendit tonë, mbi përqindjen e naltë që zejnë sëmundjet kardiovaskulare në shkaqet e vdekjeve si edhe mbi vendin që zejnë ato ndër këto shkaqe.

Materiali që po përpunojmë asht nxjerrun nga 2044 raste autopsish, të spitalit klinik Nr. 1, spitalit klinik Nr. 2 dhe spitalit Nr. 3 (pediatrik). Materiali pra asht marrun nga të tre spitalet, me të gjitha llojet e shërbimeve dhe specialitetave, me përjashtim të atij gjinekologjik-obstetrikal, dhe përfshin grupe moshash nga ma të ndryshmet, që nga disa ditë dhe deri në moshat ma të nalta.

Nga studimi i këtij materiali del se gjatë viteve 1957-1963 në 2044 autopsi, në 428 raste, që janë barazi me 20,9%, vdekja asht shkaktue nga sëmundjet e sistemit kardivaskular.<sup>1)</sup>

Ato zejnë vendin e parë në arsyet e vdekjeve në materialin autopsik 7-vjeçar të marrun në studim. Siç shifet pra, pak ma shumë se një ndër pesë vdekie, shkaktohet nga sëmundjet kardiovaskulare, shifër kjo mjaftë e naltë edhe për vendin tonë.

Me gjithë vështirësít që paraqet problemi, tue marrun parasysh edhe gabimet e mundëshme, nga njihirë të pa evitueshme në ndarmjen e vdekieve simbas njësive morboze, ne jemi mundue të bajmë një ndamje të tillë dhe t'a krahasojmë me statistika të hueja. Fatkeqësisht statistikat që kemi në dispozicion nuk janë nga burime të ndryshme. Edhe ato statistika prosekturnale që kemi marrë për krahasim, për arsyet që kuptohen dhe që nuk duem t'i shtjellojmë veçanërisht këtu, nuk janë fort të përshtatëshme për t'u krahasue me materialet tona. Me gjithate jemi të detyruem t'i krahasojmë.

*Vdekjet nga anomalitë kongenitale të zemrës.* — Në materialin tonë paraqiten me 19 raste që janë barazi me 4,43% të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare, dhe me 0,82% të të gjitha autopsive. Frekuanca reale e kardiobative kongenitale asht akoma e pa njoftun mirë. Simbas Friedberg (7), ndryshon simbas moshës, ato ma të randësishmet takohen në rreth 0,8% të të gjitha lindjeve. Për Scherf D. dhe Boyd L. (8), anomalitë kongenitale të zemrës nuk janë të rralla, ato takohen në rreth 1% të të gjithë autopsive. Kësaj frekuencë, dhe për ma tepër në material autopsik i afrohet mjaft edhe frekuencia e gjetur nga ne.

*Miokarditet.* — Gjatë kësaj periudhe kemi hasun në 48 raste vdekjeve nga ato, që janë barazi me 11,21% të vdekieve nga sëmundjet kardiovaskulare dhe 2,3% mbi numurin e përgjithëshëm të autopsive. Janë hasun kryesisht në fëmijët e moshave 0-10 vjeç në 32 raste, pjesa tjetër

1) Nga 428 rastet e vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare, 38 i përkasin Katedrës së Anatomisë Patologjike të Fakultetit të Mjekësisë.

në mosha ma të nalta. Këtu janë përfshi edhe miokarditet nga difteria, të cilat përfaqësohen në materialin tonë me 16 raste që janë barazi me 33,3% të rasteve me miokardite. E theksojmë këtë këtu për arsyen se simbas Veselhoeft cituem nga Friedberg (7) duket se 10-25% të rasteve të difterisë komplikohen me miokardit dhe se arësyja e vdekjeve gjatë difterisë në 59,4% të rasteve asht miokarditi.

Për sa i përket miokarditeve në përgjithësi Saphir, cituem nga Scherf dhe Boyd L.(8) frekuencën e tyne në material autopsik ndër fëmijë e jep në 6,83%, kurse ndër të rritun 4,3%.

*Sémundjet e perikardit.* — Perikarditet që kanë determinue vdekjen kemi gjetun në 9 raste. Kjo shifër përfaqëson 2,10% të rasteve të vdekun nga sémundjet kardiovaskulare dhe 0,42% mbi numurin e autopsive. Prej këtyre 7 raste kanë qënë akute. Shifra jonë qëndron shumë larg atyne që jepen nga literatura. P.sh. Smith dhe Willius cituem nga Friedbergu, në 8912 autopsi të bame në Mayo Clinic, përqindjen e perikarditeve e jepin 1,6%. Sosman po nga Friedbergu e jep përqindjen e perikarditeve të gjetuna në 1900 autopsi të kryeme në Massachusetts General Hospital në 2,26%, kurse Moschowitz cituem po nga ky autor, në 9618 autopsi të kryerne në Mont Sinai Hospital të New York-ut, këtë përqindje e ka gjetur në 1,4%. Siç shifet pra edhe të dhanat e autorëve të huaj largohen mjaft njana nga tjetra.

*Koronaropatite aterosklerotike.* — Koronaropatite me origjinë aterosklerotike kur kanë qenë shkak vdekje, (lue përjashtue kështu koronaropatitë aterosklerotikë të gjetura si sémundje shoqëruese) në materialin tonë përfaqësohen me numurin absolut 85 raste. Përqindja e tyne mbi numurin e vdekjeve nga sémundjet kardiovaskulare asht 19,9% dhe përqindja mbi numurin total të autopsive 4,5%. Nga këto 46 raste që janë barazi me 10,74% të rasteve të vdekjeve nga sémundjet kardiovaskulare kanë qënë miokardioskleroza që kanë determinue vdekjen, dhe 39 raste barazi me 9,11% të numurit të vdekjeve nga sémundjet kardiovaskulare kanë qënë infarkte të miokardit. Përqindja e infarkteve të miokardit mbi numurin total të autopsive asht 1,9%.

Koronaropatitë aterosklerotike janë bamë sot nji nga problemet më të randësishme të mjeksisë moderne. Vdekjet nga okluzionet e arterieve koronare janë shumë frekuente dhe si duket numuri i tyne po vjen gjithnjë tue u shtue. Simbas Boyd W.(3), në Shtetet e Bashkueme të Amerikës në vitin 1930, vdekjet nga okluzionet koronare kanë qenë 28.000, në vitin 1940, 101.000, në vitin 1942, 114.000 dhe në vitin 1949, 333.757 raste. Edhe në Angli dhe Walles nga 1900 raste në vitin 1926 në vitin 1947 numuri i tyne ka arritur në 33.000. Simbas Friedberg Ch. (7) indeksi i vdekjeve nga okluzionet koronare në Shtetet e Bashkueme në vitin 1952 ka qenë 226,1 kundrejtë 145,4 të vitit 1950. Simbas këtij autorit ky shtim asht real dhe jo thjeshtësish i shkaktuem nga progresi i metodave të ekzaminimit apo të statistikave ma komplete. Ky shtim i frekuencës shpjegohet vëcanërisht me uljen e infeksioneve infantile dhe të sémundjeve të tjera dhe nga progresi i përgjithshëm i mjeksisë. Për këtë arësy nji fraksion i madh i popullatës arrin moshën kur vdekja shkaktohet ma shpesht nga tromboza e koronareve me origjinë aterosklerotike (Friedberg). Dihet se frekuencia e aterosklerozës rritet me moshën dhe se mbi 40 vjeç asht ma frekuente. Simbas Bednar dhe Kol. (1), ndryshime aterosklerotike gjemë po thuej në çdo autopsi të personave të rritun, sigurisht që jo pa përjashtime. Por me gjithë këto të dhana incidenca e infarktit të miokardit asht vështirë të vlefteşohet. Simbas Scherf dhe Boyd L (8), në 1000 autopsi të moshave dhe

sekseve të ndryshme infarkti i miokardit përmban rreth 4,9% dhe kjo 8 herë më shpesh në meshkujt se sa në femrat. Fatkeqësisht, siç thamë më sipër, nuk kemi të dhana statistikore të mjafqueshme (nga prosekura të ndryshme) që të mund të krahasojmë përqindjen tonë 1,9% mbi numurin e autopsive. Simbas seksit, në materialin tonë frekuanca ka qenë 11 burra 1 grue. Duhet shënue gjithashtu se 33 raste nga 39 rastet e infarkteve të miokardit kanë qenë mbi moshën 50 vjeçë. Ne jemi të mendimit se për konditit e vendit tonë përqindja 1,9% asht mjaf e naltë dhe se duhet të tjerheqë vëmëndjen e organeve tona shëndetësore.

*Kardiopatitë valvulare*.— Janë gjithashtu mjafi frekuente. Simbas Beretta A.(2), kardiopatite valvulare (reumatizmale), përfaqësojnë rreth 1/4 e kardiopative në përgjithësi. Siç dihet, në këto kardiopati, valvula që preket ma shpesh asht ajo mitrale e izolueme ose e kombinueme me prekje të valvulave të tjera. Whittle, në bazë të studimit anatomopatologjik, simbas Berettas, ka konkludue se në 10 raste kardiopatish reumatizmale, valvula mitrale asht prekun shtatë herë, e izolueme në 53,6% të rasteve kurse bashkë me aorten në 28,9% të rasteve. Aorta vetëm në 14,7% të rasteve. Për endokarditet bakteriale jepen përqindje të ndryshme. Whittle frekuencën e endokarditeve bakteriale akute e jep në 10% të kardiopative.

Në materialin tonë prej 428 rastesh të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare afeksionet e valvulave që kanë qenë me vdekje përsaqësohen me 57 raste që janë barazi me 13,3% të rasteve të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare, kurse në mortalitetin e përgjithshëm në materialin prej 2044 autopsishë përfaqësohen me 2,7%. Prej këtyre valvulopative ato reumatizmale janë 49 barazi 11,45% të rasteve të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare, kurse endokarditet bakteriale janë 8 raste, barazi me 1,8%.

Ndër kardiopatitë reumatizmale valvula mitrale ka qenë prekun në 30 raste që janë barazi me 61,21% të kardipative reumatizmale, valvula aortale në 2 raste, barazi me 4,08%, dhe e kombinueme aorto-mitrale në 17 raste barazi me 34,65% të rasteve të kardiopative reumatizmale. Nga afeksionet mitrale reumatizmale 25 raste barazi me 83,33%, kanë qenë stenoza dhe vetëm 5 raste barazi me 16,66% kanë paragjithun insuficiencë. Prej veseve reumatizmale aortale të dy rastet kanë qenë stenoza (raste të pa kombinueme). Në endokarditet bakteriale kanë qenë dy raste mitrale, 5 aortale dhe vetëm 1 aortornital. Endokarditi reumatizmal asht hasun ma shpesh ndër femra, nga 49 raste, 30 janë femra. Grup mosha që paragjet frekuencën ma të naltë asht ajo prej 20-30 vjeç me 17 raste.

*Sëmundjet e vazave*.— Në këtë grup kemi përbledhun sëmundjet e vazave me origjinë të ndryshme tue përgjashlue aterosklerozën. Nga sëmundjet e vazave ka pasun 18 raste vdekjesh prej të cilave 8 me arteritë luetikë (të gjitha mezoartite), tre raste me arterite inflamatore banale, tre raste periarteritë nodoze dhe katër raste endoarterite obliterante (Bürger). Vdekjet nga sëmundjet e vazave përfaqësojnë 4,20% të rasteve të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare. Nga anomalitë kongenitale të vazave ka patun 8 vdekje prej të cilave 3 anurizma idiopatike duc 5 raste angiomash të cilat bashkarisht përfaqësojnë 1,86% të rasteve të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare.

*Sëmundja hipertensive*. Asht shumë e vështirë që të përcaktosh në sëmundjet kardiovaskulare pjesën që i përket sëmundjes hipertensive të pastërt, mbasi dihet mirë se lezionet terminale konfluojnë me një numur të madh afeksionesh të sistemit kardiovaskular. Ne jemi mundur, edhe në bazë të kartelave klinike, të përcaktojmë, aq sa ka qenë e mundun, sëmun-

djen hypertensive të pastërt. Kemi mundun gjithsejt të izolojmë 54 raste që janë barazi me 12,62% të rasteve të vdekuna nga sëmundjet kardiovaskulare, barazi me 2,6% mbi numurin e autopsive. Nuk kemi mundun të gjejmë të dhana statistikore mbi vdekjet nga sëmundja hypertensive. Simbas Scherf D. dhe Boyd L.: «Direkt hypertension shkakton rrëth 15% të vdekjeve mbi moshën 60-vjeçare». Clawson (cituem nga Friedberg) në 30000 autopsi nga të cilat 4700 raste kanë qenë me origjinë kardiovaskulare supozon, se në rrëth 45% të këtyne të fundit vdekja duhet të jetë shkaktue nga kardiopatitë hipertensive. Vdekjet nga sëmundjet hipertonike i kemi pasun mbi moshën 50 vjeç.

Në këtë grup, me nji farë probabiliteti, mund të inkludojmë edhe nji numur prej 57 rastesh me encefalopati vaskulare të cilat as nga klinika dhe as nga ana anatomapatologjike nuk kanë patun të dhana të plota për të mundun me i inkludue në sëmundjen hipertonike. Për ne këto raste kanë qenë nji problem i madh të cilin nuk kemi mundun t'a zgjidhim në mënyrë të kënaqëshme dhe të inkludojmë me siguri në grupet përkatëse. Nji numur i konsiderueshme i tyne sigurisht që ban pjesë në involucionin aterosklerotik të vazave mbasi janë hasun kryesisht mbi moshën 60-vjeç.

*Vdekjet nga cor pulmonale.*— Janë mjta frekuente në materialin tonë ku përfaqësohen me 77 raste që janë barazi me 17,99% të të gjithë rasteve të vdekuna nga sëmundjet kardiovaskulare dhe 3,6% mbi numurin e autopsive. Siç dihet «Cor pulmonale» nuk asht sëmundje «sui generis» por nji kompleks simptomash që shkaktohet kur ventrikuli i djathët asht i detyruem t'i përgjigjet kërkeseve të shtueme të shkaktueme nga hipertensioni në qarkullimin e vogël, i cili nga ana e tij mund të shkaktohet ose nga sëmundjet që prekin funksionin respirator ose sëmundje që damtojnë rrjetin vaskular pulmonar. Siç shifet, vdekjet nga cor pulmonale janë shumë frekuente dhe zejnë rrëth 1/5 e rasteve të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare dhe 3,7% të vdekjeve të përgjithëshme në materialin autopsik që disponojmë. Për përqindjen relativisht të naltë të vdekjeve nga Cor pulmonale, (megjithëqë nuk ka të dhana të sakta statistikore me përfjashtim të disa të dhanave nga prosekturnat), flet edhe fakti se asht bamë problem i randësishëm për shëndetësinë botnore tue u bamë edhe objekt diskutimi në OMS, organizatë e cila ka ngritur komitelet speciale për studimin e saj. Problemi i cor pulmonale asht mjaft i randësishëm për vendin tonë, ku siç dihet për arësyenë të ndryshme afeksionet pulmonare janë mjftë shpeshta, gja që mund të çojë ma vonë në evolucionin e cor pulmonale. Randësi të madhe mer ky problem edhe për faktin e industrializimit të vrullshëm socialist të vendit tonë, gja që mund të sjellë me vchte mundësinë e zhvillimit të pneumokoniozave të cilat zanë vend të randësishëm në zhvillimin e cor pulmonale. Gjithashtu e ndjejmë të nevojëshme të rikujtojmë nji fakt që njihet mirë se cor pulmonale influencon në mënyrë të konsiderueshme në uljen e aftësisë për punë dhe bahet problem i randë për sigurimet shoqnore.

Frekuencën ma të naltë të cor pulmonale në statistikën tonë e kemi gjetun në grup-moshën 50-60 vjeç me 21 raste pra n'atë moshë ku individu mund të japi shoqnisë qoftë vlera materiale apo shpirtnore të shumta.

Së fundi duhet përmendun se 4 raste kanë mbetur pa komentim mbasi kanë qenë raste të veçanta.

(Paraqitur në Redaksi më 5-IX-64)

1. Bednar B, Fingerland A, Jedlicka V. Patologicka Anatomie. Dil II. Cast 1. Faze 577, 647, 652. Praha 1963.
2. Beretta A. Malattie dell'apparato circolatorio. Edizione Minerva Medica 1953.
3. Boyd W. A Textbook of Pathology. Seventh Edition. Lea-Febiger. Philadelphia 1961. Faze 431-463.
4. Concina B, Masini V. Il policlinico Nr. 15. Vol. 70. 1963. Faze 521-535.
5. Davidovski V.I. Problema ateroskleroza. Arkiv Patologi. Nr. 1. Vift 1961. Faze 3-20.
6. Chronique OMS Vol. 15 Nr. 5-6. Mai-Juin 1961. Faze 206-209.
7. Friedberg Ch. Maladies du Coeur. Deuxieme édition. Tom I-II. Maloine S.A. Paris 1959.
8. Scherf D, Boyd L. Cardiovascular Diseases. Third édition. Grune&Stratton. New York and London 1958.

## SAME STATISTICAL CONSIDERATIONS ON THE MORTALITY FROM CARDIOVASCULAR DISEASES.

### (Summary)

On the basis of 2044 autopsies that include the deaths of all the hospital services except those of gynaecology and obstetrics, all the age groups, the author finds 428 deaths from cardiovascular diseases, i.e. 20.9% of all the deaths.

The author points out that the deaths from cardiovascular diseases are more than those from other diseases. Congenital anomalies of the heart were 0.82%, myocarditis 2.3%, pericarditis 0.42%, atherosclerotic coronaritis 4.5% (myocardial infarctus 1.9%), valvular rheumatic cardiopathy 2.7% and hypertension 2.6%.

The author discusses especially the problem of the coronary diseases and of cor pulmonale, which occupy an important place in his material. In many instances he compares the figures of his findings with those of the medical literature.

## DIAGNOSTIKIMI DHE ZGJEDIJA E TË SËMUREVË ME VES MITRAL PËR KOMISUROTOMI

PETRAQ VESHO  
(Katedra e Propedeutikës — Shef N. SHURBAKI)

Përparimi i kirurgjisë kardio-vaskulare krijoi mundësitë e mjekimit kirurgjikal edhe të stenozës mitrale. Ky hap i madh e ngarkon terapinë me një përgjegjësi të rëndë në zgjedhjen e të sëmurevë për ndërhyrje kirurgjikale.

Në qendrat kardiologjike të të gjithë botës, paralelisht me luftën e kirurgut për një teknikë sa më të përparuar dhe të sigurtë për ndërhyrje kirurgjikale, ka filluar edhe lufta e terapeftit për precizimin e diagnostës dhe për njohjen e patiologjisë të vesisit mitral.

Komisurotomia ka për qëllim zgjerimin e vrimës atrio-ventrikulare të ngushtuar. Në qoftë se zgjerimi kryhet në mënyrë normale dhe në kushte optimale, në parim ky nuk e shndron stenozën në insuficiencë mitrale, porse nga ana tjetër, nuk lagon insuficiencën mitrale që ka ekzistuar para operacionit.

Rezultati pozitiv nga operacioni mund të shpresohet në ato raste kur shkaku themelor i shrregullimeve hemodinamike është ngushtimi i vrimës atrio-ventrikulare të majtë, i pa komplikuar me insuficiencë, ose i lidhur me një insuficiencë mitrale të lehtë, ndërsa në të sëmurë ku bashkë me një stenozë mitrale të lehtë ka dhe një insuficiencë të konsiderueshme, mjekimi kirurgjikal nuk jep rezultate të kënaqëshme.

Problemi themelor me rëndësi praktike për terapeftin është prezimimi i diagnostës së stenozës mitrale dhe i gradës së insuficiencës mitrale që shoqeron stenozën mitrale.

Në gjendje normale, sipërfaqja e hapësirës së vrimës atrio-ventrikulare të majtë është baras me  $4-6 \text{ cm}^2$ , ajo lirisht leion hyrjen e dy gishtrinjve. Kur kjo sipërfaqe zvogëlohet afersisht në 50-60% vrehen ndryshime në qarkullimin e gjakut.

Egzaminimet e Karlotit dhe bashkëpuntorëve (1952), Gorlin (1951), treguan se hapësira e vrimës mitrale më e vogël se  $1.5 \text{ cm}^2$  përfaqëson një sëmundje të rëndë me shrregullime të theksuara të hemodinamikës.

Stenoza e theksuar e vrimës atrioventrikulare të majtë, manifeston ndryshime karakteristike në kuadrin pat-fiziologjik. Një nga ndryshimet e herëshme dhe të zakonëshme në këtë sëmundje është rritja e presionit në brendësirën e atriumit të majtë. Në fazën fillestare të stenozës mitrale, si rezultat i rritjes së presionit në atriumin e majtë shtohet presioni edhe në enët e gjakut të mushkërive, sidomos në arteriolet, kështu krijuhet hipertonia pulmonare. Në qoftë se stenoza mitrale dhe hipertonia pulmonare vazhdojnë për një kohë të gjatë, si rjedhim, në mbarsat e arterieve të mushkërive, mund të zhvillohen ndryshime organike, muret e tyre trashen dhe ngushtohen (arteriosklerozë pulmonare). Në këto raste, presioni nër enët e gjakut të mushkërive rritet 10-15 herë më

shumë nga gjendja normale, në këtë mënyrë zhvillohet bariera pulmonare ose bariera e dytë, pasojat e së cilës mund të jenë më të rënda se sa në vetë stenozën mitrale, që përbënë barierën e parë.

Natyrisht, në këto raste dispnea bëhet më e theksuar, sidomos gjatë punës fizike, zhvillohet dobësia, lodi trupore, të sëmurët ankohen për hemoptizi. Në këtë mënyrë, në mjekimin kirurgjikal të stenozës mitrale; nuk duhet marë parasysh vetëm gjendja e zemrës por edhe ndryshimet në arteriet dhe arteriolet pulmonare, mbasi prognoza post-operatore mveret jo vetëm nga ngushtimi i vrimës mitrale (bariera e parë), por edhe nga ritja e presionit në enët pulmonare sidomos në arteriolet (bariera e dytë).

Në periudhën para mjekimit kirurgjikal të vesit mitral, klinicistët, shpesh herë, e patën vënë në dyshim ekzistencën e një stenoze të thjeshtë, të pa komplikuar me insuficiencë, ose të paktën e konsideronin këtë ves si shumë të rrallë. Vetëm ndërhyrja kirurgjikale krijoj mundësi për një kontroll direkt dhe in vivo, ku gishti i kirurgut i futur në atriumin e majtë nuk vërteton regurgitacion gjatë sistoles së ventrikulit të majtë. Kjo na jep mundësi të mendojmë se në këto raste praktikisht mungon insuficiencia e valvulave mitrale dhe kemi të bëjmë me stenozë mitrale.

Diagnostikimi i stenozës mitrale të pastër, në kohën e sotme nuk paraqet vështirësi të veçantë, vështirësi mund të hasen për të përcaktuar predominencën e stenozës në veset e kombinuara të zemrës, mbasi mbizotërimi i shënjavë të insuficiencës të valvulave mitrale ose të një vesi tjeter krijon një kundërindikim për operim.

Në klinikat tona, në konsultet e veçanta javore, kemi marë në analizë të sëmurët me vese mitrale. Në zgjedhjen e të sëmurëve që përbënë indikacion për komisurotomia mitrale kemi patur parasysh pamjaftueshmërinë e terapisë konservative dhe progresivitetin e sëmundjes. Për çaktimin e gradës së insuficiencës kardio-vaskulare i jemi përmبajtur klasifikimit të propozuar nga A.N. Bakulev (1954).

Të sëmurët qenë observuar për një kohë të gjatë në klinikë dhe të preqatitur me të gjitha analizat e nevojëshme. Një rëndësi i kushtuam edhe çështjes së riakutizimit ose të formave latente të rematizmit. Kirurgët Sovjetikë A.N. Bakuljev, L.A. Kuprianov, E.N. Meshalkin, të bazuar në eksperiençën e tyre, mendojnë se edhe në riakutizimet jo shumë të theksua' mund të bëhet komisurotomia, mbasi ajo skpie në një shërim më të shpejtë se sa terapia konservative. Autorë të tjerë mendojnë se komisurotomia në fazën e riakutizimit rematizmal është e kundër indikuar.

Në rastet tona, ne i jemi përmبajtur taktit të mijckimit preoperator, ku shenjat klinike dhe laboratorike të rematizmit mungonin.

Në obërvim kemi patur 22 të sëmurë, prej tyre janë operuar 9. Të 22 të sëmurët qenë diagnostikuar me vese mitral me mbizotërim të stenozës mitrale — 19 të sëmurë, dhe — 3 u diagnostikuar me stenoze të thjeshtë mitrale. Në grupin e të operuarve, para operacionit stenoza e thjeshtë u diagnostikua në 2 veta, kurse në 7 të tjerë u vu diagnoza e vesit mitral me mbizotërim të stenozës. Në kohën e operacionit regurgitacioni gjalë sistoles nuk u vërtotua në 6 të sëmurë, në 2 të tjerë u konstatua një regurgitacion i lehtë, nësa tek një u konstatua stenoza subvalvulare.

Sorokin P.A. dhe bashkëpuntorët (1958) konstatuan stenozën e thjeshtë gjatë operacionit në 44,6% të rasteve. Bejli dhe bashkëpuntorët, me 1955, diagnostikuani stenozën mitrale të thjeshtë në 64,5% në të sëmurët e ope-

ruar, tek tē cilët para operacionit mendohej ves i kombinuar i valvulës mitrale me mbizotrim tē stenozës.

Vitet e fundit, në literaturë është shkruar mbi rëndësinë diagnostike tē stenozës mitrale dhe mbi metodat e ndryshme të egzaminimit. Ndër këto metoda, një rëndësi të madhe kanë egzaminimet fizike, sidomos auskultacioni, egzaminimi rontgenologjik dhe elektrokardiografja. Nga egzaminimet indirekte vlefjanë tē përmenden katekterizimi i zemrës, angioskopjia e kardiografja etj.

Ndër tē sëmurët e observuar nga ne, në 18 vjetë u ndëgjua zhurma presistolike, në 4 zhurma diastolike që mbushte gjithë diastolen. Nga tē 9 tē sëmurët e operuar u ndëgjua zhurma presistolike në 8, dhe në 1 u dëgjua zhurma diastolike e zgjatur që mbushte gjithë diastolen.

Grada e stenozës mitrale nuk mund tē përcaktohet vetëm simbas karakterit të zhurmës, për ta përcaktuar atë duhen marrë parasysh edhe shrregullimet hemodinamikë, që manifestohen me dispne, stazë në mushkëri, cianozë, hipertrofi tē ventrikulit tē djathtë dhe me simptome kardio-pulmonare.

Një karakteristikë tjelër e stenozës mitrale është dhe ndryshimi i tonit tē parë, i cili paraqitet i akcentuar dhe trokitës, që mvaret nga mbushja jo e plotë e ventrikulit tē majtë. Në arterien pulmonare përvëç aksentit tē theksuar tē tonit tē dytë, shpesh herë dëgjohet dyfishimi i tij, që flet për një probabilitet më tē madh tē stenozës mitrale tē thjeshtë. Në patëm mundësi tē dëgjojmë dyfishimin e tonit tē dytë në dy tē sëmurë tē operuar.

Egzaminimi rontgenologjik lot një rol me rëndësi në diagnozën e stenozës mitrale. Të sëmurët tonë u janë nënështruar këtyre egzaminimeve rontgenologjike: Ro.skopisë, R.-grafisë në projeksionin e parë dhe tē dytë, egzaminimit me kontrast tē esofagut dhe rontgenokimografisë. N. R.skopi dhe R.-grafi, stenoza mitrale paraqet zgjerimin e atriumit tē majtë, hipertrofinë e ventrikulit tē djathtë dhe proeminencën e konusit pulmonar. Kimografia na ka ndihmuar për studimin më lë hollësishëm tē segmenteve tē ndryshme tē zemrës dhe për tē diferencuar në një ves mitral tē kombinuar predominimin e stenozës. Në këtë rast vrchen në konusin e arteries pulmonare dhëmbëza me amplitudë më tē madhe ose tē barabartë me dhëmbëzat e aortes, gjë që dëshmon për një hiperafluks në qarkullimin e vogël dhe hipoafluks në tē madhin. Nga aspekti i ndryshëm i dhëmbëzave tē tipit atrial, ventrikular dhe vazal ka qënë e mundur tē përcaktohesin më me hollësi hipertrofija dhe dijatasjoni i atriumit tē majtë i konusit tē arteries pulmonare dhe i ventrikulit tē djathtë. Ezofagu, siç dihet, është në kontakt me zemrën e majtë dhe qdo zgjerim i segmenteve tē zemrës shpie në spostimin e tij. Duke studjuar kalimin e kontrastit nëpër ezofag, komi konstatuar në rastin e stenozës mitrale një devijim të rëndësishëm tē ezofagut prapa dhe nga e majta në nivelin e atriumit tē majtë kurse në nivelin e ventrikulit tē majtë nuk kemi vrejtur spostime tē tillë.

Ekzaminimi rontgenologjik ndihmon edhe në diagnozën e hipertonisë pulmonare. Në këta të sëmurë, si rezultat i stazës në qarkullimin e vogël, kemi observuar jo vetëm një theksim tē vizatimit pulmonar, por edhe depozitim tē thermijave tē hekurit në lindin pulmonar (hemosiderosa), duke marë mushkëritë një aspekt miliariform. Konstatimi i hemosiderosës së konsiderueshme tregon ndryshime mjafit tē avancuara në barierën e dytë, gjë që krijon kundër-indikacion për ndërhyrje kirurgjikale. Në një

rast tē tillē, megjithëse kishim tē bënim me një stenozë tē thjeshtë, hoqëm dorë nga ndërhyrja kirurgjikale.

Eksamini i elektrokardigrafik i tē sëmurëve me stenozë mitrale ndihmon në diagnostikimin e saj dhe në vlerësimin e gjendjes funksionale tē myokardit.

Nga ndryshimet elektrokardiografike në stenozën mitrale karakteristik është dhëmbi P mitral dhe devijimi i boshtit elektrik nga e djathta që flet për hipertrofinë e zemrës së djathët.

Sorokin P.A. — dhe bashkëpuntoret (1958) dhembin P karakteristik (të zmadhuar, të zgjeruar, dhe tē dhembëzuar) e ka vrejtur në 60%, tē sëmurëve tē operuar, dekstrogramën në 90%. Ndërt tē tjerët është vrejtur normograma. Vetëm tek një e sëmurë me kuadër klinik tē stenozës mitrale është gjetur sinistrograma.

Pamvarësish nga ky fakt e sëmura u operua dhe u konstatua stenozë e konsiderueshme e vrimës atrio-ventrikulare tē majtë.

Në 22 elektrokardiogramet e tē sëmurëve tonë, dhëmbi P. mitral karakteristik u konstatua në 20 raste, dekstrograma në 20 raste, dhe tek një i sëmurë u konstatua normograma.

Përcaktimin e diagnozës së stenozës mitrale përdoren dhe metoda speciale, siç janë kateterizimi i zemrës, angio-kardiografia dhe punksioni direkти i kaviteteve tē zemrës.

Me anën e kateterizimit tē zëmrës nxirren tē dhëna tē rëndësishme mbi përbërjen kimike tē gjakut dhe veçanërisht mbi saturimin e tij me oksigen dhe gas karbonik; me anën e kateterizimit është i mundur tē matet presioni në kavitetet e zemrës dhe në qarkullimin e vogël, gjë që ka rëndësi për diagnozën e stenozës mitrale. Të dhënat e angiografisë në format e kompensuara tē stenozës mitrale, janë tē varfëra. Në format e përparuara përkundrazi shihen zgjerime jo vetëm tē konusit pulmonar, por edhe tē degëzimeve tē A. pulmonare, që paraqiten tē zgjeruara dhe tē përdredhura. Kohët e fundit ka filluar tē përdoret nga disa autorë matja e presionit tē gjakut dhe përcaktimi i përbërjes së tij, me anën e punkcionit direkt tē kaviteteve tē zemrës. Punktioni mund tē bëhet ose nga muret e toraksit, ose nga bronket nën kontrollin e bronkoskopit.

Këto metoda egzaminimi, janë tē komplikuara dhe kërkijnë një aparaturë e preqatitje tē veçantë dhe nuk janë gjithëmonë pa prezige.

Duke marrë parasysh se edhe me metodat diagnostike jo operatore mund tē vihet diagnoza e stenozës mitrale dhe mund tē përcaktohen indikacionet e intervenimit tē saj, këto metoda nuk janë përdorur në tē sëmurët tonë.

Suksesi i operacionit mvaret, në më tē shumtën e rasteve, nga mosha e tē sëmurëve, nga koha e sëmundjes, nga grada e insuficiencës kardiovaskulare dhe sidomos nga ndryshimet patologjike, që kanë ndodhur në valvulat dhe në muskulaturën e zemrës. Mosha e tē sëmurëve tonë tē operuar ka qënë ndërmjet 25-35 vjeç. Në literaturë janë pëershruar raste, ku komisurotomia është bërë cdhe në moshë tē kaluar. Koha e fillimit tē sëmundjes, nga ataku i parë i rematizmit, ndërt tē sëmurët tonë nuk i kalonte tē 7 vjetët. Përsa i përket gradës së insuficiencës kardiovaskulare, në grupin e tē sëmurëve tonë tē operuar simbas klasifikimit tē A.N. Bakulevit u paraqiten 7 tē sëmurë tē stadtit tē III-të, 1 i sëmur i stadtit tē II-III dhe 1 i stadtit tē III-IV-të.

Ndryshimet e valvulave vendosin për suksesin ose mos suksesin e operacionit, mbasi aftësija funksionale e valvulave mitrale mvaret nga

grada e rigiditetit, fibrozitetit, dhe kalcifikasiunit të valvulave, kordëve si dhe të muskujve papilare.

Në rast se ndryshimet morfologjike janë shumë të theksuara, operacioni nuk sjell dobi, mbassi valvulat nuk mbyllen plotësisht dhe formohet një insuficiencë mitrale më e theksuar se para operacionit. Diagnostikimi i këtyre rasteve paraqitet i vështirë, sepse klinikisht nuk ka simptome të vegantë për të menduar mbi ndryshimet e thella që kanë pësuar valvulat dhe muskujt papilarë.

Ndër 9 të sémurët e operuar nga kirurgu P. Gaçja tek njeri, ku shenjtë klinike dhe egzaminimi e tjera flasin për një ves mitral të kombinuar me mbizotërim të stenozës mitrale, gjatë operacionit u konstatua kalcifikim i valvulave mitrale. Po paraqitim shkurtimisht epikrizën e tij:

«I sëmuri R.S. vjeç 30, hyrin në klinikë me këto ankime: dispne të theksuar, lodihe trupore, rrahje të shpejtë në regionin e zemrës. E konsideron vehten të sémurë prej 5 vjetësh. Kufijtë e zemrës të zgjeruar. Pulsi 84 në 1 minutë ritmik, T.A. 110/75 në të dyja duart. Në auskultacion, në majë të zemrës ndihet zhurmë presistolike dhe diastolike. Toni i dytë në A. pulmonare i akcentuar.

Ekzaminimi rentgenologjik: zemra e zmadhuar në tërësi më tepër djathtas. Elektrokardigrami: P. mitral, hipertrofi e ventrikulit të djathtë.

Diagnoza: ves i kombinuar mitral me mbizotrim të stenozës mitrale.

Me datë 15/I/1962 u opera (kirurg Petrit Gaçë). Gjatë operacionit kirurgu kaloi lirisht një gisht nëpërmjet vrimës mitrale. Valvulat mitrale u paraqiten shumë rigide, të pa lëvizëshme, rrëth vrimës mitrale palphon tuberozitete të shumta të petrifikuara. Vrima mitrale e tipit «gojë peshku» me stenozë subvalvulare. Këto ndryshime shpjegojnë edhe regurgitacionin që konstatohet me gisht në atriumin e majtë.

Meqenëse zgjerimi i vrimës mitrale, përvëç rrezikut të embolive, shtonte insuficiencën ekzistuese, kirurgu nuk bëri ndërhyrje të mëtejshme.

Kuadri klinik i stenozës mitrale, tek disa të sémurë, nuk paraqitesh shumë i kuartë që të vendosesh për domosdoshmérinë e operacionit. Në këto raste, të dhënat anamnestike, (dispnea, haemoptoe, atake të edemes pulmonare), si dhe të dhënat klinike, rontgenologjike, elektrokardiografi, lejojnë të zgjidhet problemi me anën e operacionit.

Eksperiencia na shtyn të nénvizojmë rëndësinë e bashkëpunimit të mjekëve terapeutë me kirurgët, për diagnostikimin e drejtë, dhe për të përcaktuar indikacionet operatore të të sémurëve me ves mitral, në dobi të shërimit të tyre dhe të progresit të mjekimit kirurgjikal të këtij vesi në vendin tonë.

(Paraqitur në redaksi më 1/X/1964)

#### LITERATURA

1. Bakuliev A. N. Në librin: «Kirurgičeskoe lečenie mitralni stenozov». 1959.
2. Gaxhiev S.A. Në librin: «Kirurgičeskoe lečenie mitralnogo stenoz». 1901.
3. Sorokin P.A. etj. «Nekatorie voprosi diagnostiki mitralnogo stenoz v svyazi s kirurgičeskim lečeniem». Klin. Med. 1953, 1, 60-66.
4. Kuprianov L.A., Meshalkin E.N., Bakaliev A.N. Cituar nga Gaxhiev në librin: «Kirurgičeskoe lečenie mitralnogo stenoz», 1961.
5. Čizhov A.N. «K voprosu o diagnostike reskoj stepeni mitralnogo stenoz». Sov. Med. 1961, 12, 119-121.
6. Lebedieva L.N. «O predoperacion podgotovke i posleoperacionom vedeie bolni pri mitralni komisurotomia». Klin. Med. 1958, 11, 36-41.

7. Carlotti J. etj. «Etude physio-pathologique de la petite circulation au cours du rétrécissement mitral» Ar. Mal. Coeur, 1952, 5, 412-447.
8. Gorlin R. etj. «Hydraulic formula for calculation of the area of the stenotic mitral valve, other cardiac valves, and central circulatori shunts». Am. Heart J. 1951, 41, 1-29.
9. Bejli Citarua nga Gaxhiev S.A. nə librin «Kirurgiçeskoe lechenie mitralnogo stenoza» 1961.

## DIAGNOSIS AND SELECTION OF THE PATIENTS WITH VITIUM MITRALE FOR COMMISSUROTOMY.

### (Summary)

The author has had under observation 22 patients with mitral vitia with rheumatic etiology. In 19 cases predominated the stenosis of ostium atrio-ventriculare (combined mitral vitia), and only in three cases the stenosis of the left atrio-ventricular ostium was pure. From the 22 cases were operated 9. According to the author's observations, commissurotomy is indicated for the cases, when the principal cause of the cardiovascular disturbances is the stenosis of the left ostium atrioventriculare. In the selection of the patients for surgical intervention should be taken into consideration not only the state of the heart muscle (first barrier), but also the pulmonary hypertension (second barrier).

As counterindications for surgical intervention the author considers: the predomination of mitral insufficiency in the combined mitral vitia and the evolution of the rheumatic inflammatory process.

The author points out also that for the prognosis of the operated cases most important are the anatomic alterations of the valves.

## DISA TË DHËNA MBI SHENJAT FILLESTARE TË MENINGITIT T.B.C. NË FËMIJË

THOMA KRISTO

(Katedra e Pediatrisë — Shefi Katedrës Prof. S. Bekteshi)

Në sajë të masave profilaktike dhe kurative t'aplikuara në vendin tonë kemi një ulje të dukëshme për T.B.C., në përgjithësi dhe në veçanti të meningitit T.B.C. edhe në fëmijë ku zakonisht çsaqet më shpesh. Porse me gjithë uljen e dukëshme të rasteve me meningit T.B.C. aktualiteti nuk ka humbur për vetë faktin se ala vrehen raste në fëmijë siç e shosim dhe nga shifrat e rasteve të paraqitura në klinikën e pediatrisë. Në kohën e sotme meriton të flitet mbi shenjat fillestare të kësaj sëmundje mbi diagnozën e herëshme dhe fillimin e herëshëm të mjekimit specifik prej nga varet suksesi i shërimit dhe evitimi i komplikacioneve dhe të postumeve të shkaktuara nga meningiti tbc. Gjithashtu nga observimet e klinikës rezulton se kanë ardhur në gjendje të rëndë me errësim të ndërgjegjes 16.3% dhe humbje të plotë të ndërgjegjes 18.2% shifra që flasin se janë vrejtur me vonesë dhe diagnoza është bërë në nji fazë të avancuar. Gjithashtu në rastet e sipërme rezultojnë se janë dërguar me diagnoza të ndryshme si Hemiplegi, Poliomielit, dispepsi *toxica*, gjendje konvulsive, *typhus abdominalis*, *bronchoadenitis*, *grippe toxica*, *tumor cerebri*, etjera, tregojnë se nuk i është dhënë kujdesi i duhur shenjave fillestare ose nuk kanë cfaqur nji kuadër klasik për meningitin T.B.C. që ka çuar në vështirësi diagnostike.

Lidhur me periudhën fillestare të Meningitit T.B.C. theksojmë se është e përshkruar në mënyrë klasike në traktate dhe artikuj të ndryshëm me hollësit përkatëse. Ky përshkrim klasik që do ta përmendim më poshte nuk paraqitet në të gjitha rastet. Sot me përdorimin e antibiotikëve sidomos streptomycinës, izoniacidit dhe medikamenteve të tjera antituberkulare për forma T.B.C. pulmonare dhe extra-pulmonare si dhe përdorimi i streptomycinës më gjërësisht në infeksione të tjera kanë influencuar që të mos gjenden gjithëmonë të gjitha shenjat fillestare tipikë ose të mos hasim kuadrin klasik që natyrishët vështirëson diagnozën e herëshme qysh në periudhën fillestare.

Periudha fillestare me meningit T.B.C. karakterizohet në dy etapa kryesore: a) Prodromet e meningitit T.B.C. dhe b) fillimi i shenjave karakteristike.

a) Prodromet e meningitit T.B.C. përfaqësojnë nji fazë të analizuar e përshkruar me kohë. Theksojmë se është miaft e vështirë për të dhënë nji përqindje të saktë mbi frekuencën e sajë në veçanti në fëmijë mbasi nji pjesë e tyre nuk janë në gjendje të çfaqin ankesat e tyre dhe nga ana tjetër jo të gjithë prindërit kanë ushtruar nji kuides mbi kohën e fillimin e këtyre shenjave. Disa prej tyre retrograd kujtojnë disa të dhëna fillestare gjë që e vrejmë edhe në observimet t'ona. Mbi përcaktimin e këtyre shenjave autorë të ndryshëm jepin përqindje të ndryshme p.sh.

R. Debré—H.E. Brisaud e përcaktojnë me saktësi në 52%, J. Pernod—C. Chambette—J. Batime në 31%. Mbi vështirësinë e përcaktimet e shenjave fillestare vrchen edhe nga autorë të tjerë (Jean—Dry—J. T. Vainshtein N.I. Grashenkov — D.S. Futer — E.V. Prohorovic — R. Moreau — G. Boudin — E. Contamin G. Fankoni etjerë). Periudha prodromale në më të shumtën e rasteve vazhdon nga 2-3 javë deri në disa muaj (R. Debré — D.S. Futer) nö përgjithësi vihet në dukje një gjendje subfebrile, dobësim i përgjithëshëm, anoreksi, lodhje, modifikimi i karakterit (fëmija lëviz më pak, paraqitet i mërzitur, shpesh böhët nervoz, mënjanohet nga shokët dhe ambienti, shqetësohen natën etj.) ndërsa më vonë fillojnë shenjat karakteristike si të vjella, cefalë etj. Jo të gjitha rastet paraqiten në formën e sipërme. Përmenden raste ku ka çfaqje me kriza konvulsive, shenja paralize, cefalë tranzitore, kriza vazomotore, kriza motorike ose sensitive të tipit Bravais—Jacksoniens në periudhën fillestare (R. Debré H.E. Brisaud, G. Boudin, Jean-Dry D'Alba, Rovera S. etjerë). Në këtë fazë likuori cerebrospinal mund të jetë normal dhe qëndron i tillë për nji kohë. Ky konstatim është një mësim për klinicistin i cili duhet të përsërisë punksionin lumbal, eventualisht të bëjë kulturat e likuorit c.sp. për B.K. dhe inokulimet në kafshë.

b) Fillimi i shenjave karakteristike të meningitit T.B.C. është më i kuartë dhe më i përcaktueshëm. Vështirësia paraqitet në latante dhe në fëmijë mjaft të vegjël. Kjo periudhë karakterizohet nga ngritja e temperaturës. Mbi frekuencën e sajë (temp.) përmendim p.sh. nga R. Debré 83.5% të rasteve në 11% nuk është matur dhe në 5.5% javën e parë apireksi.

— R. Moreau thotë se në përqindjen më të madhe të rasteve ekziston temperatyrë; kjo temperatyrë mund të jetë pak a shumë e ngritur, subfebrile ose në raste të rralla mund dhe të mungojë krejtësisht (F. Rossi, G. Rossi —R. Bonnezza, R. Debré etjerë.) kanë përshkruar raste me fillim apireksie gjë që e konfirmojmë dhe ne në një nga observimet t'ona. Mungesa e temperatyrës në këtë fazë nuk është e mjaftueshme për të përjashtuar mundësinë e një meningiti T.B.C.

Çfaqje të tjera janë cefalë dhe të vjella këto dy simtome shifen shpesh dhe shumë herë të kombinuara (J. Pernod — C. Chambette — J. Batime në 72.5% të rasteve, Debré 62%, R. Moreau G. Boudin, F. Contamin 75% për cefalë dhe 50% për të vjella nga rastet e tyre. Zakonisht këto të vjella çfaqen të pa varur nga ushqimi.

Ka raste kur i vetmi manifestimi inicial është dhëmbje abdominale ose otalgi që mund të çojë dhe në gabime diagnostike (Debré e vren në 70% të rasteve, J. Batime — J. Pernod etj. dhëmbjet abdominale vrejnë 1.25%). Këto të dhëna përforcohen dhe nga autorë të tjerë si E. Nelson — G. Fanconi Jean Dry — R. Moreau — G. Boudin etj.

Shpesh vrhen konstipacione po nuk përjashtohen raste që shkojnë me diare kryesisht në latante (J.T. Vaishtein — N.I. Grashenkov — D.S. Futer, E.V. Prohovic etjerë). Nji gjë të tillë e kemi konstatuar dhe në rastet t'ona. Në një numur të pakët egzistojnë edhe manifestime neurologjike si p.sh. J. Batime etj. e vren në 1.25%, R. Debré 15%, R. Moreau — G. Boudin në 5% në fazën e parë fillestare, që mund të janë paraliza të nervit Oculomotor, konvulsione, hemiplegji, çrrregullime të folurit e të shkruarit etj.

Çrrregullimet e ndërgjegjes janë të rralla në periudhat fillestare prezencia e një simtomë të tillë e rëndon dekursin dhe prognozën e të sëmurit.

Vlen të përmendim gjithashtu dhe disa të dhëna të literaturës mbi disa raste të rralla meningiti T.B.C. me fillim krejt atipik, kështu p.sh. J. Chaptal — R. Jean (1962) referojnë me nji rast meningiti T.B.C. me syndrome hiponatremie në fillim të sëmundjes.

M. Cachin — S. Vegne (1959) referojnë mbi nji vajzë 15 vjeç me meningit T.B.C. ku në fillim të shenjave pati në aparençë ikter.

G. Boudin — B. Pepin — J. Barbizet (1957) referojnë nji rast meningiti T.B.C. që është paraqitur me shenja fillestare nën kuadrin e nji encefaliti letargjik me hipersonni, ptosis, sindrome extrapiramidal.


Çrregullimet vegetative janë më të rralla dhe më të vonëshme në raport me shenjat funksionale të fillimit. Në fazë më të avancuar të sëmundjes rëndësi i jepet dhe disa të dhënavë objektive si prezenca e shenjave miningeale (rigiditeti i qafës, Kerning, Brudzinski etj.) që në disa raste mungojnë sidomos në latantet ose zhvillohen pak ditë më vonë. Prej këtyre të dhënavë të literaturës konkludohet se shenjat fillestare të meningitit T.B.C. janë funksionale dhe të përgjithëshme. Natyrishët për përcaktimin e saktë të diagnostikës ndihmojnë dhe të dhëna të tjera si provat e tuberkulinës, ekzaminimi oftalmologjik, ekzaminimi R/Skopik dhe R/Grafik i pulmoneve dhe me rëndësi decidonjëse ekzaminimi kompleti i likuorit cerebrospinal.

Duke u nisur nga këto të dhëna gjatë vjetëve të fundit në klinikën e pediatrisë të Tiranës kemi observuar 55 fëmijë të trajtuar për meningit T.B.C. Për përcaktimin e diagnostikës jemi nisur nga të dhënat anamnestike mbi shenjat fillestare, nga të dhënat e ekzaminimit objektiv fizikal, interpretimin e drejtë të simptomave në hyrje si nga të dhënat e tjera plotësonjëse që janë aplikuar si provat e tuberkulinës ekzaminimi Radioskopik dhe R/Grafik të pulmoneve, ekzaminimi oftalmologjike si dhe ekzaminimi biokimik dhe bakteriologjik i likuorit cerebrospinal. Po ti analizojmë me hollësi rastet e më sipërme rezultojnë se 58.2% janë nga Tiranë, 12.8% nga qytetet tjera dhe 29% nga fshati. Shifrat e më sipërme tregojnë nji predominim në fëmijët e qytetit. Si pas moshave rastet t'ona mund t'i shprehim si pas pasqyrës Nr. 1.

0—1 vjeç	1—3 vjeç	3—7 vjeç	7—14 vjeç
7.39%	25.4 %	47.3%	20%

Nga rastet e sipërme 10.9% frekuentojnë kopështin, 20% janë nxënës dhe 69.1% të tjerë nuk frekuentojnë asnji nga institucionet e fëmijve, këta të fundit kanë qénë më pak të kontrolluar. Megjithëse shumica e tyre kanë lindur në maternitete nuk kemi të dhana të sakta për fëmijët në se janë vaksinuar nga B.C.G.. Duke analizuar kontaktin me T.B.C. nga të dhënat t'ona del se 52.7% kanë qénë në kontakt familjarë ose t'ambjentit rrëthonjës, ndërsa të tjerët nuk dinë dhe prindërit nuk referojnë nji gjë të tillë, natyrishët kjo nuk përashton mundësinë e kontaktit të tyre me T.B.C. Nga proceset specifike në të kaluarën vetëm 21.9% dinë dhe janë kuruar për T.B.C. të formave të ndryshme, ndërsa 78.1% nuk dinë ose nuk kanë patur në të kaluarën procese T.B.C. këta kryesisht janë fëmijë që nuk kanë qenë nën kontroll R/scopik ose të Dispancerisë anti-T.B.C; numrin më të madh në këtë drejtim e zënë fëmijët e fshatit.

Duke analizuar më me hollësi të dhënët fillestare të Meningitit T.B.C. nga të dhënët e më sipërme të literaturës dhe duke i kahasuar edhe më të dhënët t'ona theksojmë se është vështirë përcaktimi me saktësi i kohës



Grafiku N.1 Paraqitje e shenjave fillestare në %

së fillimit të prodromeve. Nji pjesë e prindërve sidomos nga fshati nuk i kanë observuar, ndërsa nji pjesë tjeter retrograd i kujtohen për shenjat fillestare që më parë nuk u kanë dhënë rëndësinë e duhur. Veç asaj kemi dhe konstatime të atilla me gjithë kujdesin që është treguar nga prindërit këto shenja fillestare kanë munguar krejt.

Duke i ndarë si më sipër në shenja fillestare prodromale dhe karakteristike të meningit T.B.C. në rastet t'ona mund t'i shprehini si mbas grafikut Nr. 1.

Sic shifet dhe nga grafiku i sipërmi kanë paraqitur çrrgullime të karakterit 45.5% të rasteve prej të cilëve 4% nji javë 56% 2 javë 28% 3 javë dhe 12% mbi 4 javë prej kohës së fillimit karakteristik të sëmundjes. 20% të rasteve mohohet çfaqja e këtyre ndryshimeve të karakterit, ndërsa pjesa tjetër nuk dinë me saktësi dhe nuk kanë observuar ndryshimet e tyre.

Lodhja është nji simtome që vihet shpesh në dukje në periudhën prodromale; këtë e konstatojmë në 61.8% të rasteve pjesa tjetër nuk referojnë nji gjë të tillë. Sigurishtë këtu përfshihen dhe ata fëmijë që nuk janë në gjendje të çfaqin të dhëna subjektive për arësyte të moshës. Kjo lodhje vihet në dukje midis javës së 2 dhe të 4 e llogaritur nga koha e fillimit të shenjave karakteristike të meningitit T.B.C.

Anoreksia e cila përbën nji simtom të shpeshtë në fazën prodromale e vrejmë në 81.8% të rasteve, prej të cilëve 13.3% javën e parë 31.1% javën e dytë, 33.4% javën e tretë dhe 22.2% mbi 4 javë nga fillimi i shenjave karakteristike.

Në 80% të fëmijve rezulton nga anamneza nji dobësim i përgjithëshëm me ulje të peshës që ka çuar në hipotrofi të shkallave të ndryshme dhe kaheksi në disa raste. Vetëm 20% janë paraqitur në gjendje nutricioni

të mirë. Nga anamneza del gjithashtu se prindërit kanë vënë re në fazën fillestare — djersitje në 76.3% që ka vazhduar edhe në kohën e hyrjes në klinikë.

Këto janë disa konstatime fillestare, por që më vonë kanë vazhduar dhe kohën e çfaqjes së shenjave më karakteristike. Këto të fundit që nga ana e prindërve dhe e mjekëve vizitonjës janë vënë në dukje më me lehtësi. Kanë paraqitur cefalë 72.7%, që ka ardhë duke u shtuar dhe që po ti krahasojnë me kohën e hospitalizimit rezultojnë se fillimi ka qënë në 42.5% javën e parë, 37.5% javën e dytë, 12.5% javën e tretë, dhe 7.5% javën e katër. Në 27.3% që nuk referohen ankime të tillë janë kryesisht fëmijë të moshës së vogël dhe latante.

Fillimi i meningitit T.B.C. karakterizohet me rasti ngritje të temperaturës. Këtë konstatim e kemi një 98.2%, të rasteve vetëm 1 rast është paraqitur si në fillim edhe gjatë dekursit afibril, i verifikuar si me të dhënat klinike ashtu edhe me të dhënat bakteriologjike të likuorit cerebrospinal. Temperatura ka qënë e ndryshme duke lëvizur midis  $37.5^{\circ}$  deri  $39^{\circ}$ . Për sa i përket kohës së filimit mbajmë me rezervë përfshirë fëmijët e fshatit dhe një pjesë e vogël e qytetit që nuk e kanë matur në rregull qysh në fillim. Nga të dhënat anamnestike rezulton se 46.3% u ka filluar javën e fundit; 37% dy javë 13% tre javë dhe 3.7% mbi katër javë e llogaritur nga koha e shtrimit në klinikë.

Të vjellat janë simtome shumë me rëndësi i fillimit të një meningitit T.B.C.

Në observimet t'ona e vrejmë në 83.6%. Të vjellat kanë qënë në orë të ndryshme gjatë dites pa patur lidhje me ushqimin. Në latante 7.3% këto të vjella janë shoqëruar me diare dhe janë paraqitur në kuadrin e një dispepsie acute. Kryesisht të vjellat janë vrejtur 65.2% në javën e parë dhe 34.8% në javën e dytë.

Në 54.5% të fëmijëve përmendet që kanë patur konstipacione ndërsa 12.7% janë paraqitur me diare. Përveç këtyre në periudhën fillestare është vënë në dukje hiperestezë si dhe pareza të nervave okulomotor dhe abducens me manifestime të një strabizmi gjë që që disa raste ka tërhequr vendjen e prindërve përfshirë të çuar fëmijën tek mjeku.

Megjithëse më lartë përmendëm mbi shenjat fillestare dhe çfaqje të tjera neurologjike si hemipareze, hemiplegji, somnolencë, konvulcione, çrrëgullime të ndërgjegjes e tjera, në observimet t'ona të tillë simtoma i kemi vënë në dukje në fazë shumë të avancuar të sëmundjes dhe jo në periudhën e fillimit. Kështu p.sh. në kohën e hyrjes është vënë në dukje hemipareze 7.8% konvulzione 16.3% errsim të ndërgjegjes 16.3%, humbje e plotë e ndërgjegjes (koma) 18.2% të rasteve të hospitalizuar.

Gjithashtu në periudhën e hyrjes në klinikë shenjat e tjera nga ekzaminimi objektiv rezultojnë se janë çfaqur me rigiritet të qafës 70.9%, Kerning 70.9% simtomi Brudzinskit 54%, ndërsa në latantet vëmë në dukje një bombim i fontanellës.

Duke konkluduar mund të themi se:

— Meningiti T.B.C. në fëmijët paraqit një aktualitet me gjithë uljen e tuberkulozit në përgjithësi.

— Shenjat fillestare përfshijnë prodromin dhe fillimin e shenjave karakteristike.

— Përcaktimi i prodromeve paraqit vështirësi objektive në veçanti në moshë të vogël.

— Periudha e prodromeve zgjat mesatarisht 2-3 javë.

- Fillimi i shenjave karakteristike përcaktohet më me saktësi dhe në kohë.
- Fillimi i meningitit T.B.C. në përqindjen kryesore është më temperaturë, mungesa e temperaturës nuk eksludon zhvillimin e meningitit T.B.C. kur ekzistojnë shenjat e tjera të lartëpërmendura.
- Të vjella e cefalë janë nji simtom shumë i rëndësishëm dhe i shpeshtë nën meningitin T.B.C.
- Manifestimet neurologjike në periudhën fillestare janë më të ralla.
- Çrregullimet e koshiencës janë nji simtomë prognostik i keq që zhvillohen në nji fazë të më vonëshme të meningitit T.B.C.
- Në latantet kuadri fillestarë paraqitet më i vështirë, në këta fillimi i meningitit T.B.C. në shumicën e rasteve paraqitet me të vjella, diare dhe konvulsione.
- Ekzaminimi fizikal ndihmon në orientimin e drejtë të diagnozës në prezencën e shenjave meningiale.
- Decizonjës në konfirmimin e diagnozës klinike ngel ekzaminimi biokimik dhe bakteriologjik i likuorit cerebrospinal.

(Paraqitur në Redaksi më 5/X/64)

#### LITERATYRA:

- Cahin M. Vegne S. La Semaine des hopitaux 1959 Nr. 4 F. 1868.
- Chaptal J. — Jean R; Dossa D. Pediatrie 1963 Nr. F. 253.
- D'Alba A. — Rovera S. Minerva medica 1958 Nr. 6 F. 213.
- Debré R. — Brisaud H. E. Meningite tbc. et Tbc. miliaire de l'enfant. 1953.
- Fanconi G. — Wallgren A. Trattato di pediatria. 1961.
- Futer D. S. — Prohovic V. E. Tuberkulezni meningit u detej 1963 F. 60.
- Jean Dry. Le progres medical. 1963 N. 19. F. 753.
- Mitchel — Nelson. Trattato di pediatria. 1954. F. 547.
- Moreau R. — Boudin G. — Contamin F. Encyclopédie medico-chirurgicale 17160 B. I.
- Pernod J. — Chambette G — Batime J. La semain des hopitaux 1961 F 3362.
- Russi F. — Rossi G. — Bonizza R. Minerva medica 1959 N. 17. F. 606.
- Vainshtein T.J. — Granshenkov I.N. Meningiti 1962. F. 155.

#### SOME DATA ON THE INITIAL SYMPTOMS AND OTHER DIAGNOSTIC ELEMENTS OF TUBERCULAR MENINGITIS.

(Summary)

This article discusses the importance of the initial symptoms of tubercular meningitis in view of an early diagnosis. It points out the difficulty of discovering the prodromal signs of the disease, especially in small babies, who may show no such symptoms. Some of these symptoms may not be typical, especially during the application of antibiotics. Then it presents the initial symptoms in 55 cases of tubercular meningitis observed in the pediatric clinique during the last years, some data on the beginning of the disease, analysing the age groups and the different periods of hospitalisation.

Lastly it shows the importance of the complementary elements of diagnosis, like the tuberculin tests, X-ray of the lungs, the changes in the cerebrospinal liquid, the laboratory results in looking for the tubercular bacilli with the methods of culture, of animal inoculation and other examinations.

**DISA TË DHËNA KLINIKO-STATISTIKORE MBI RADIKULITET  
LUMBO-SAKRALE GJATË VITEVE 1959-1961  
NË KLINIKËN E NEUROLOGjisë**

**JANI AVRAMI**

(klinika e neurologjisë, shef i klinikës kand. shk. mjekësore B. PREZA)

Sëmundjet e sistemit nervor periferik zenë një vend të rëndësishëm midis sëmundjeve organike të sistemit nervor. Simbas të dhënave të autorëve P.M. Saradzhishvili, D.S. Guber-Gric, S.M. Petjelin, D.A. Shamburov, radikulitet lumbo-sakrale zenë 12-20% nga 70% të të gjitha dëmtimeve organike të sistemit nervor periferik. Në klinikën e neurologjisë, gjatë viteve 1959-1961, sëmundjet e sistemit nervor periferik zenë 18-20% të të gjithë morbozitetit. Pikërisht për arsy se radikulitet lumbo-sakrale zenë një vënd të rëndësishëm midis sëmundjeve organike të sistemit nervor, menduan që të paraqitim disa të dhëna kliniko-statistikore dhe likuorologjike të të sëmurëve me radikulite, të cilat janë kuruar gjatë viteve 1959-1961.

Gjatë këtyre tre vjetëve, në klinikë janë mjekuar gjithsejt 276 pacientë, prej të cilëve 216 kanë qenë meshkuj dhe 60 femra.

Simbas të dhënave të D.S. Guber-Gric, rezulton se nga shuma e rasteve, që ay ka patur në studim, 71% të tyre e zinin meshkujt, ndërsa 29% të rasteve e zinin femrat. Observacionet tona në përqindje ndahen në 74% meshkuj dhe në 26% femra, përqindje e cila midis meshkujve dhe femrave korespondon me ato të Guber-Gricit.

Sikundër shihet tek ne ka disproporcione mjaft të madh. Ne mendojmë se një fenomen i tillë e gjen shpjegimin e vet, në faktin se burrat marin pjesë më aktive dhe më të gjérë në të gjitha fushat e prodhimit në krahasim me gruan. Burrat zakonisht kryejnë punët më të rënda fizike, ata hasen më dëndur dhe më tepër me faktorët meteorologjikë të ndryshëm e jo të favorshëm sikundër janë: lagështira, era etj. Nga ana tjetër qëndrimi për një kohë të gjatë më këmbë gjatë procesit të punës, ngritja e peshave të rënda, hecjet e gjata, shkaktojnë ndër ta lodhje të madhe fizike dhe bëhen kështu faktorë predispozues për këto sëmundje.

Nga analiza e rasteve në bazë të profesioneve të sëmurët ndahen si më poshtë:

<i>Viti</i>	<i>1959</i>	<i>1960</i>	<i>1961</i>	<i>Shuma</i>
Puntorë	31	55	94	180
Nëpunës	11	12	17	40
Shëpiake ose pension.	11	11	25	47
Nxënës	1	3	5	9
<i>Shuma</i>	<i>54</i>	<i>81</i>	<i>141</i>	<i>276</i>

Nga shuma e të gjitha rasteve rezulton se puctorë janë gjithsej 180, nëpunësa 40, 47 raste (ku përmblidhen invalidë, pensionistë dhe shtëpijake) dhe nxënësa 9. Nga pikpamja e profesionit, të bie në sy gjithashtu se puctorët zenë vendin e parë dhe formojnë kështu shumicën dërmuese të rasteve, ndërsa profesionet e tjera nuk zenë vërd të rendësishëm. Po të njëjtën gjë vërtetojnë dhe të dhënat statistikore të autorëve të lart-përmendur.

Analiza nga pikpamja e profesionit përsëri flet për faktin se njerzit e punës fizike, të cilët i ekspozohen të ftohtit, ngritjes së peshave të rënda janë më të predispozuar për tu sëmurur nga radikulitet.

Simbas moshave, në observacionet tona vihet re kjo shpërndarje:

Viti	11-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-70	70 e lart	shuma
1959	2	9	23	8	8	3	1	54
1960	2	16	24	28	10	—	1	81
1961	5	27	42	39	23	3	2	141
Shuma	9	52	89	75	41	6	4	276

Moshat prej 21-50 vjetësh mund të themi se karakterizohen me një morbozitet më të lartë se moshat e tjera, megjithëse mosha 31-50 na duket se jep një morbozitet më të madh. Këto shifra na jasin të drejtë që të supozojmë se radikulitet takohen në ato mosha të cilat janë në kulmin e forcës fizike.

Pra duke shënuar observacionet tona, duke analizuar ato qoftë nga pikpamja e seksit, qoftë nga pikpamja e profesionit dhe e moshës, në të gjitha këto momente bie në sy se: radikulitet takohen më shpesh në moshat të cilat janë në kulmin e fuqisë së tyre dhe kryesisht tek ata që merren me punë fizike. Këtë gjë venë në dukje dhe Guber-Grici, i cili shkruen se moshat më frekuente janë 30-50 vjet, që zenë 60-70% të rasteve, ndërsa simbas Saradzhishvili mosha 40-50 vjeçarcen 60% të rasteve gjë që pajtohet me të dhënat e observacioneve tona.

Në analizën simbas stinave rezulton në këtë mënyrë:

Viti	1959	1960	1961	Shuma
Pranvera	13	15	39	67
Vera	19	34	29	82
Vjeshta	14	28	32	74
Dimri	8	4	41	53
Shuma	54	81	141	276

Fra në një shikim të shpejtë kjo gjë na duket krejt paradoksale në krahasim me të dhënat e autorëve të tjerë, të cilët tregojnë se «frekuanca më e madhe e rasteve me radikulitet duket në muajt e vjeshtës, arin kulmin në dimër dhe në muajt e parë të pranverës». Në observacionet tona vërehet e kundërtë, në dimër, ku të ftohit dhe lagështira është më e madhe, takohen më pak raste, kurse në stinën që është më e nxohtë, bile që tek neve është e thatë hasen më shumë raste. Ky fenomen nga ana e jonë shpjegohet me faktin se numuri i rasteve me radikulite të shtruar në vitin 1959 dhe 1960 ka qenë i pakët, me qenë se shumë pacientë kanë qenë shtruar në klinikat e tjera të spitalit të Tiranës, kështu të dhënat tona nuk kanë patur mundësinë të përfaqësojnë numurin e përgjithëshëm.

të këtyre të sëmurëve, për këtë arsyen numuri i të shtruarve gjatë muajve të dimrit të 1959 dhe 1960 ka qenë më i pakët, në krahasim me numurin e shtrimeve të vitit 1961 (ku në muajt e dimrit numuri i pacientëve ka qenë më i madh se i çdo stine). Në 1961, nga 141 raste 41 prej tyre janë shtruar në muajt e dimrit. Ne supozojmë se radikulitet në vëndin tonë mund të takohen me disa luhatje pothuajse me të njëjtat shifra në stinat e ndryshme. Me këto shifra të pjesëshme sigurisht neve nuk kemi pretendime që të bëjmë përgjithësimin kategorike dhe absolute për dy arsyen:

E para se në klinikën tonë janë shtruar një pjesë e rastave.

E dyta se ne nuk disponojmë të dhëna përsa i takon frekuencës së radikuliteve në qytetet e ndryshme të vëndit tonë, që kanë kondita të ndryshme meteorologjike.

Radikulitet lumbo-sakrale i kemi ndarë në dy grupe të mëdha.

1. Grupi radikuliteve primare.
2. Grupi radikuliteve sekondare.

Në grupin e parë përfshihen 244 raste, ndërsa në grupin e dytë 32 raste.

Në grupin e radikuliteve primare ne kemi dalluar këto forma klinike.

1. Meningoradiculitis lumbo-sacralis	raste	3
2. Radiculitis lumbo-sacralis	raste	194
3. Funiculitis lumbo-sacralis	raste	1
4. Radiculo-neuritis	raste	8
5. Lumbago	raste	7
6. Ischias	raste	26
7. Neuritis n. peronei et tibialis	raste	8
		244

Format primare të studjuara simbas veticë ndahen si më poshtë:

Viti	meningoradiculitis L. sacralis	radiculitis lumbo-sacralis	funiculitis lumbo-sacralis	Radiculo- neuritis	Lumbago	Ischias	Neu- rite	Shuma
1959	2	36	—	8	1	1	2	50
1960	1	62	—	—	2	12	1	73
1961	—	93	1	—	4	13	5	116
Shuma	3	191	1	8	7	26	8	244

Midis të gjitha këtyre formave predominojnë në mënyrë të qartë format klinike të radikuliteve lumbo-sakrale.

Format sekondare ne i kemi takuar si simptoma të një sëmundje kryesore siç kanë qenë: spondiloatroza (*spondylosis deformans*), spondilitet, metastazat kancerozë etj. Nga të 32 rastet e radikuliteve sekondare kanë qenë:

- 27 raste të shkaktuar nga spondilo-atrozat
- 3 raste nga kanceret metastatike
- 1 rast nga spina bifida
- 1 rast nga spondiliti t.b.c.

Në klasifikimin e formave klinike, që kemi paraqitur më sipër, në i jemi përmbytjor klasifikimit të përpunuuar nga Sikar dhe pjesërisht atij të Shamburovit.

Nga 276 raste të radikuliteve lumbo-sakrale, që kanë kaluar në klinikën e neurologjisë, 250 patientëve u janë bërë radiografitë, ndërsa 133 rastev u është bërë punksioni lumbar dhe analiza e likuorit cerebro-spinal.

Nga ekzaminimi i likuorit në 133 rastet e përmendura është venë re, ashtu siç e përkruajnë dhe shumë autorë, një disociacion albumino-citologjik, që oshilon (luhat) nga 0,45 gr.% deri në 1,60 gr.%.

Po këtë gjë por me një diferençë pak të ndryshuar jep dhc Guber-Grici.

Guber-Grici dallon 3 grada apo shkallë të pozitivitetit të disociacionit proteino-citologjik tek i cili jemi bazuar ne dhe kemi bërë shkallëzimin simbas grupave për 133 rastet.

Shkalla I	0,36%	—	0,50 gr.%	=	30 raste (pozitivitet i lehtë)
» II	0,50%	—	0,80 gr.%	=	24 raste (      »      i mesëm)
» III	0,80%	—	1,60 gr.%	=	12 raste (      »      i lartë)
					66 raste

Në analizat e likuorit cerebrospinal të gjithë elementët e tjerë ishin normalë, përvèç se në njérin rast u vu re pleocitoza limfocitare (12 limfocite përfushë).

Një vëmëndje të posaqme në likuori cerebrospinal qoftë në bazë të të dhënave të literaturës së dhe nga rastet tona meriton disociacioni albumino-citologjik.

Siq vihet re nga 133 raste, të cilëve u është bërë analiza e likuorit cerebrospinal në 67 raste likuori ka qenë normal, në 30 raste verehen disociacioni i lehtë albumino-citologjik dhe në 24 raste disociacion i mesëm alb. citologjik dhe në 12 raste disociacion i lartë. Kështu pra nga të dhënët tona rezulton se nga 133 rastet kemi patur likuor patologjik në 66 raste d.m.th. në rrëth 50% të rasteve.

## KONKLUZION

1. Radikulitet lumbo-sakrale tek neve zënë një peshë specifike rrëth 18% të sëmundjeve organike të sistemit nervor periferik.
2. Nga 276 raste të marrur në studim 202 ishin burra dhe 74 gra d.m.th. predominojnë burrat.
3. Nga pikpamja profesionale rezulton se masën dërmontjëse e zenë punëtorët.
4. Observimi në bazë të stinave nuk jep prediminim të veçantë të njérës stinë mbi tjetrën.
5. Predominojnë moshat që janë në kulmin e fuqisë prodhonjëse.
6. Nga pikpamja e formave klinike rezulton se radikulitet lumbo-sakrale zenë vendin e parë.
7. Në 50% të rasteve likuori cerebrospinal del patologjik (disociacion albumino-citologjik).

(Paraqitur në redaksi më 1/X/1964)

## LITERATURA

1. Guber Gric D.C. «Zabolevanija pojačanju krestcovovo otdela periferičeskoi nervnoi sistemi» v. 1960.
2. Petelin S.M. «Infekcioni i Pojasnichno-krjescovij radikulonevrit i lezenija jevo na kurortje» v. 1961.
3. Saradzhishvili T.M. «Nekotorie spornie voprosi patogeneza r.h. radikulitov» 1960.
4. Shamburov D.A. «Ishias» 1954.
5. Shamburov A.A. Porazhenija nervov pojasičkoj krestcovoj ishemija plečevoi oblastei -Sovrannoe sastojanje osnovnih Rasdelov. Nevropatologji «Medgiz 1961, f. 65-96.
6. Pitres Vaillard, Laignal-Lavastine Maled. Des nerfs peripheriques et du sympathique. Paralysies et Neuralgies du nerf. grand sciatique. Paris 1924 f. 670-704.
7. Cotugno. Des ischide nervosa commentarius, Napoli 1784. Cituar nga Pitres dhe Veillard.
8. Lasegue. Consideration sur la sciatique (Arch. du medecin 1864, et etud medical, Tom II, f. 304) Cituar nga Pitres et Vaillard.
9. Roger M. «Nerf sciatique» Traite de Medicina 1943 -- 49 Tom XVI, 854-884.
10. Fridman A.P. «Osnovi likuorologii» 1956.

## CLINICO-STATISTICAL DATA ABOUT LUMBO-SACRAL RADICULITIS DURING THE YEARS 1959-1961 IN THE NEUROLOGICAL CLINIQUE.

### (Summary)

The diseases of the peripheral nervous system occupy a special place among the diseases of the nervous system. According to the figures of our clinique about 25% of the diseases of N.S. belong to the peripheral system. Of these about 70% are lumbosacral radiculitis.

From the point of view of the sex, age and profession, the diseases are more frequent in males (about 74%). This can be explained with the fact that men work in harder conditions. The disease is also more frequent among people of hard physical work (workers and peasants), who are more exposed to bad weather, lift heavy weights and are obliged to walk long distances.

According to the clinical forms our observations can be divided as follows: meningoradiculitis 3, radiculitis lumbosacralis 191, funiculitis 1, radiculitis 8, lumbago 7, ischialgia 26, neuritis 8.

These clinical figures are only preliminary; we need more time and more complete observations to finish our study.

The cerebrospinal liquid, examined in 133 cases, has given the following results: in 67 cases it has been normal; in 30 cases can be noticed a slight albuminocytologic dissociation (0,36-0,50%), in 24 cases the dissociation is higher (0,50-0,80%) and in 12 cases it is high (0,80-1,60%). According to these data in about 50% of the observations the liquor is pathologic in about 50% of the cases, which is very important and must oblige us to look for such pathological findings in all the cases, insistin that the examination be done very carefully.

These preliminary clinico-statistical data on the lumbo-sacral radiculites should be considered carefully, since the disease is quite frequent and is of a considerable clinical and economic interest, because the patients are invalidated for a relatively long time.

## **ENURESIS NOCTURNA DHE MJEKIMI I SAJ ME AKUPUNKTURË.**

**STEFAN VOKOPOLA — Spitali Civil Durrës**

Ndonse e pa rrezikëshme për jetën, por tepër e bezdisëshme dhe është pa kënaqëshme për patientin dhe familiarët e tijë, urinimi i pa vullnetshëm gjatë natës, asht një sëmundje e përhapun në fëmijët e moshës parashkollorë dhe 6-8% ndër fëmijët e moshës shkollorë e adoleshente, tue prekunë ma shpesh meshkujt.

Prej mesit të shekullit të kaluem, urinimi i pavullnetshëm gjatë natës, njihet si entitet nosologjik dhe trajtohet prej mjekëve. Kjo sëmundje rrjedh si pasojë e traumave psiqike dhe të edukimit jo të drejtë të fëmijës në moshën e herëshme. Çfaqet si neurozë e fëmijëve. Faktori patogenetik i kësaj sëmundje asht dobësimi i veprimtarisë frënuuese të qendrave cerebrale ndaj qendrave spinale të mikcionit që ma shpesh çfaqet në kohën e gjumit, i cili në këtë rast asht shumë i thellë. Duhet të thekësojmë se mund të ndeshemi dhe me «syndromin» nocturn ose diurn të enuresis, që asht çfaqje e sëmundjeve të ndryshme siç janë proçeset patologjike të rrugëve urinare, turbullime të metabolizmit, anomali të zhvillimit të kolonës vertebrale etj. «syndrome» të cilat duhen diferençue me sëmundjen enuresis nocturna. Mjekimi i kësaj sëmundje asht i shumëlojshëm dhe i shumëanshëm.

Studimit tonë i përkasin dy grupe fëmijësh të moshave dhe sekseve të ndryshme, të mjekuam në dy mënyra.

Në grupin e parë u përfshinë 13 të sëmurë, prej të cilëve 6 djemë të moshës 4-11 vjeç dhe 7 vajza të moshës 4-14 vjeç. Të tanë patientët u hospitalizuan gjatë vitit 1961 dhe respektivisht me kartelat klinike numër: 159, 160, 4636, 4666, 4696, 4719, 4754, 4889, 5050, 5051, 5332, 5622 dhe 5623. Patientët në anamnezën familiare nuk paraqisin ndonji sëmundje kronike ose të trashigueme (përveç një rasti, të cilin do ta paraqesim ma poshtë). Ndërsa në anamnezën personale kishin kalue turbullime dispeptike si dhe angina sezionale. Prej këtyre, një patient (Shpëtim K., me K.K. numër 4754) paraqiste spina bifida të vertebrës lumbare të IV, pa ndonji malformacion tjeter. Të sëmurët e tjerë paraqiteshin të një zhvillimi të mirë somatik pa ndonji sëmundje nga organet e mbrendëshme, thekësojmë se të tanë patientët paraqiteshin tipa neurotikë, tepër të eksituseshëm si dhe me vese të ndryshme.

Për ilustrim po paraqesim dy rastet e ma poshtëme:

Arben H. me kartelë klinike numër 5622, vjeç 6, qëndroi i shtruem në sektorin neurologjik prej datës 10.XI.1961 deri më 12.XII.1961. Në anamnezën e tijë shënohet: i lindun në të nandin muej të gravidancës, me asistencë mjekësore, me peshë 3.500 kg. Asht ushqye me gjinin e nanës deri në të gjashtin muej të jetës, mandej asht mbajtun me ushqim artificial. Shpesh herë ka patun turbullime dispeptike, dy herë asht shtrue në spital për dispepsi toksike tepër të randë. Ndonji sëmundje somatike

tjetër me randësi nuk shenohet të ketë kalue. Në anamnezën familiare i ati asht alkoolist, me turbullime psikopatike të karakterit. Gjyshja, nga ana e nanës, ka vuejtun nga psikozë preseniles dhe ka përfundue me suicid. Vetë fëmija asht i një zhvillimi të mirë fizik, pa ndonji patologji të dukëshme nga organet e mbrendëshme, sistemi nervor qëndror dhe periferik ishte i zhvilluem si në normë. Pacienti ishte i shkathët në shoqni, ngaemonte tepër të sëmurët e tjerë, të cilët e kishin frykë sepse për arësy shumë të thjeshta dhe ndonjiherë krejt pa arësy i rrithë. Ai kishte vesin e onikofagisë, kruente hundët, gjumin e bante të thellë, por shpesh ngrihej i frykësuem tue thirun: «plaku» ose «ou! qeni i zi», qëndronte pak si i obnubiluem dhe përsëri flente i qetë. Urinonte çdo natë pothuj dy ose tre herë.

Rasti i dytë i përket të sëmurës Natasha Ç. me kartelë klinike numër 4696, vjeç 5, qëndroi e shtrueme në sektorin neurologjik prej datës 13.VIII.1961 deri më 15.IX.1961. Në anamezën e sajë shënohet se ka lindun në të nandin muej të gravidancës me asistencë mjekësore, me peshë 2,900 kg. Asht ushqye me gjinin e nanës deri në të 14-in muej të jetës. Ka kalue turbullime të lehta dispeptike dhe një herë Bronchopneumoni. Në anamnezën familiare nuk shënohet asgja patologjike. Pacientja asht e një zhvillimi të mirë fizik pa ndonji shenjë patologjike nga organet e mbrendëshme, sistemi nervor qëndror dhe ay periferik qenë të zhvilluem si në normë. Pacientja qëndronte autike, sa herë që hynte mijku përvizitë, ajo nepte përgjigje negative, e kundërshtonte ate, paraqiste tendencë erotomanie ndaj pacientëve të shtruem së bashku me te. E sëmura urinonte çdo natë.

Të 13-të pacientët e këtij grupi u mjekuen me ganglioplegjikë (tableta clorpromazine 0.025) nga një tabletë për pesë ditët e para, mbas ushqimit të darkës, mandej për 15 ditë nga dy tableta (një mbas dite dhe një para gjumit në darkë); pesë ditë mbaheshin përsëri me nga një tabletë para gjumit në darkë dhe së fundi për pesë ditë të tjera i mbajshim pa mjekim. Kursi i mjekimit zgjaste 30 ditë. Njikohësish fëmijëve, në darkë i nepshim ushqime të krypun, dhe sasina relativisht të pakta uji për të pimum, gjithashtu para se të flejshin urinonin. Këto të fundit ja këshilluem dhe prindërve për t'ja vazhdue fëmijëve mbas daljes së tyne nga spitali.

Pacientët dalën të shëruem nga spitali, përveç të sëmurit Shpëtim K. i cili paraqiste *spina bifida* të vertebrës lumbare të IV-të. Simbas të dhana ve që patëm ma vonë nga prindërit e pacientëve, 15 ditë ma vonë prej daljes nga spitali, vetëm pesë nga të sëmurët nuk urinojshin ma (të sëmurët me kartela klinike numër: 160, 4666, 4669, 5051 dhe 5622). Sikundër vërehet ky llojë mjekimi na dha rezultat në 38.4%.

Në grupin e dytë u mjekuen 13 pacientë të tjerë, nga të cilët 12 nuk kanë qenë mjekue ndonji herë për këtë sëmundje, përveç njanit, i cili asht mjekue prej neshë me ganglioplegjikë pa rezultat, dhe asht rasti i sipërpermendun me *spina bifida*.

Në këtë grup u mjekuen 7 djemë 4-15 vjeç dhe 6 vajza 4-10 vjeç. Të tanë pacientët u trajtuan ambulatorisht, pranë dispanserit psiko-neurologjik të Poliklinikës së Qytetit, me akupunkturë. Të sëmurevë u përkasin kartelat individuale të «mjekimit me çpim dhe djegje» numër 2,3,5,6, 7,8,10,12,13,14,15,16 dhe 18. Në anamnezën personale të këtyre pacientëve nuk shënohen sëmundje të randësishme, përveç pacientes Ilirka M. (kartela individuale numër 6), e cila para tre vjetësh kishte kalue *meningitis specifica*. Në anamnezën familiare të këtyre pacientëve nuk shenohen së-

mundje kronike ose të trashigueme, përveç rastit të pacientes Ilirka M. (kartela individuale numër 6) dhe të vëllait të sajë Rakip M. (kartela numër 5), që kanë të vëllain e të jatit me skizofreni.

Këto patientë, njilloj si dhe ato të grupit të parë, paraqiteshin tipa neurotikë, kishin vese të ndryshme (onikofagi, kruejshin hundët, veshët etj.), njani paraqiste një tick nervor (lëvizte periodikisht vetullën e majtë), katër patientë kishin «fryka të natës». Sejcili prej tyne urinonte disa herë në çdo natë. Të gjithë të sëmurët e këtij grapi paraqiteshin të nji zhvillimi të mirë fizik, pa ndonji sëmundje nga organet e mbrendëshme.

Mjekimi i tyne u ba me akupunkturë, dhe nuk u shoqne me asnji lloj medikamenti ose diete. Fëmijët banë gjithësej dhjetë seancë sejcilli, nga nji seancë çdo dy ditë. Respektivisht nji ditë i çponim në regio vesicæ urinariae, në linea alba 2 cm. mbi symphysis ossum pubium (pika Kuan Juan, e katërtë e kanalit «përgjegjës — Zhën Mae») dhe në dy pika në kambë, 3 cm. mbi sejcilin malleolus medialis (pika San in Çjao), e gjashtë e kanalit të «shpënetkës me projeksion në kambë — T'hai In). Ndërsa në seancën tjetër çponim në po këto dy pika në kambë (San In Çjao) dhe në katër pika në shpinë: dy në regionin lumbar anash kolonës vertebrale (pikat Shén Shu — pika e veshkave; e 23-ta e kanalit të «vesikës urinare me projeksion në kambë — T'hae Jan»), dhe dy pika në regionin sakral, nën dy të parat (pikat P'han Kuan Shu — pika e vesikës urinare; e 28-ta e kanalit të «vesikës urinare me projeksion në kambë — T'hae Jan»). Kështu vazhduem alternativisht gjatë dhjetë seancave. Gjatë procedurave në pikat e marruna në shpinë dhe bark kemi përdorun metodën forcuese, ndërsa në kambë përdorëm metodën dobësuese. Duhet të cilsojmë se pikat e maruna në shpinë i përkasin zonave të inervimit të segmenteve lumbo-sakralë të medulës spinale, në nivelin e të cilave ndodhen qendrat somatike dhe vegjetative, që rregullojnë mikcionin.

Zakonisht mbas procedurës së tretë dhe rrallë mbas të katërtës, fëmijët nuk urinonin ma gjatë natës, gjendje e cila ka vazhdue gjatë tanë kur sitet të mjekimit si dhe nji muej ma vonë, kur i thirëm për tu rikon-trollue.

Rezultatet e këtij mjekimi, që në rastin tonë, sikundër u vërejt, ishte 100%, tregojnë efikasitetin e tij. Në këtë rast mendimi i ynë, darkord me studimet e Profesorit V.G. Vogralik, asht se nëpërmjet rugës reflektore ngacmohen qendrat e kateve të sipërmë nervore, tue krijue nji vatër eksitim, e cila forcon procesin e frenimit të qendrave spinale të miksionit, që sikundër theksuem në fillim të këtij artikulli asht i dobësuem.

Nga të 13 patientët, që trajtuem, në të dhanat që kishim gjashtë muej ma vonë rezultoj se i sëmuri që paraqiste spina bifida të vertebrës lumbare të IV-të dy muej e gjysëm mbas përfundimit të mjekimit rifilloj të ketë enuresis, me këtë rast ja përsëritëm mjekimin si dhe mbas përfundimit të tijë ju vazhdue për dy muej rrjesht para gjumit doza të vogla ganglioplegjikësh (Chlorpromasini 0,025). Mbës këtij trajtimi patienti nuk ka patun ndonji shqetësim tjetër (qysh atëherë kanë kalue shtatë muej). Përveç këtij rasti, patienti me kartelë individuale numër 14, shtatë muej mbas përfundimit të mjekimit ngeli në nji landë për vjeshtë dhe me nji herë, qysh natën e parë pati enuresis nocturna. Këtij të sëmuri ju përsëritën vetëm pesë seancë të akupuncturës dhe mandej çdo natë ka qenë i pastër.

Për veç këtyne dy rasteve, të sëmurët e tjera nuk patën asnjë herë ndonji rast urinimi të pavullnetshëm gjatë natës.

Në përfundim e quajmë të domosdoshme të theksojmë se vlera dhe

supremacia e këtij lloj mjekimi, ndaj metodave të tjera qëndron në faktin se:

Së parit me këtë metodë mjekimi kemi rezultate shumë ma të mira dhe ma të shpejta.

Së dyti kjo metodë paraqitet sa e thjeshtë aq dhe ekonomike.

Së terti këtë metodë mjekimi është aplikojmë lehtësisht në mënyrë ambulator, kështu që fëmijtë nuk pengohen nga shkolla, gjithashtu në stacionar nuk angazhohen vendet pér këtë nosologji.

Së katërti, ndonse praktikës sone i përket vetëm një rast fëmije me spina bifida të vertebrës lumbare të IV-të, rezultati i suksesëshëm i tijë nuk duhet përgjithësue. Vlen të shënohet se spina bifida ndeshet dhe në një seri personash të shëndoshë, dhe kjo gjendje kur nuk shoqnohet me malformacione të tjera ose patologji të tjera shoquese të sajat, nuk paraqet ndonji randësi (A.S. Malkov), pér këtë duhet tentue dhe akupunktura ndër të sëmurët që paraqesin këtë gjendje.

(Paraqitur në Redaksi më 5/V/64)

#### B I B L I O G R A F I A

- 1) Bojeva E.M. Vejn A.M. Kamenckaja B.I. Malcina V.S. Melnikova E.M. Novinski G.D. Iglokallovanie e prizhiganie. (Cen-cju tjerapia) 1962.
- 2) Fen Li Da dhe Parmenkov D.L. Igiloterapia e prizhigania (Cen-cju terapia) 1960.
- 3) Kreimer A.Ja. Noçnoe nederzhanie moçj. 1962.
- 4) Llaskov B.I. Problemi enureza. 1962.
- 5) Malkov A.S. Noçnoe nederzhanie moçj. 1958.
- 6) Preza B. Akupunktura dhe aplikimi i sajë në praktikë. Në librin «Punime të psikonevrolllogëve me rastin e festimit të XV vjetorit të çlirimit» Volumi i I 1959; faqe 112-124.
- 7) Preza B. Aplikimi i acupuncturës kinezë në sëmundjet nervore. Shëndetësia Popullore 1960. Nr. 2; faqe 12-22.
- 8) Preza B. Mjekësia popullore kinezë. Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës — Seria Shkencave Mjekësore. 1962 Nr. 1; faqe 102-114.
- 9) Simson T.P. Nevrozi u detej — ih preduprezzhdenie i leçenie. 1958.
- 10) Vinai A. Agopunctura cinese. 1958.

#### ENURESIS NOCTURNA AND ITS TREATMENT BY ACUPUNCTURE

(Summary).

After describing briefly enuresis nocturna as a childrens neurosis and after making the differentiation with the «syndrome» of enuresis as a manifestation of other somatic diseases, the author describes the treatment of the two states in neurotic children, illustrating it with the history of two separate cases. From each group he has taken 13 patients of different sexes and age groups (4 to 14 years). The patients have not been treated previously for this disease (with one exception of the second group, who presented spina bifida on the level of the IVth lumbar vertebra, treated before with ganglioplegics). These children had no other disease or pathologic alteration of the internal organs.

The first group was treated with ganglioplegics (Chlorpromazine 0.025 for 5 days, then 0.050 for 15 days and again 0.025 for 5 days; after that they remained 5 days without treatment, so that the whole treatment lasted 30 days.). During the treatment the children of this group have used salt at lunch, as well as a limited amount of water, trying at the same time to create the reflex of urinating before going to bed. This treatment have good results in 38.4% of the cases. In the second group was used only acupuncture 10 ambulatory treatments for each case once every two days. In this group the results have been 100 percent.

At the end the author explains the effect of this treatment by a reflectory mechanism, and recommends the treatment for its rapid and very satisfactory results, for the simplicity of its application, for its cheapness, as well as for the fact that the children are not stopped from going to school and do not occupy hospital beds. Finally he recommends the treatment also for the patients with spina bifida, which do not present other malformations.

## RUBRIKA EKSPERIMENTALE

### MBI SEKRESIONIN E LËNGUT BILIAR NËN INFLUENCËN E UJIT MINERAL TË GLINËS (Të dhëna paraprake)

MUNIR KARAGJOZI

(Katedra e Fiziologjisë-Farmakologjisë)

Ujrat minerale luajnë një rol të rëndësishëm në mjekimin e shumë sëmundjeve, midis tyre në çrrregullimet e heparit dhe të rrugëve biliare.

Efekti i ndryshëm i ujrateve minerale mbi funksionet e heparit në mvartësi nga përbajtja minerale, nga mënyra e përdorimit, temperatura etj., vërteton rëndësinë e madhe që paraqet ky problem në pikpamje teorike dhe praktike (E. LUTRINGER 1961, V.N. DONSKOJ, S.S. OZERJEV 1964). Por megjithë eksperiencën e madhe klinike dhe punimet e shumta në këtë drejtim, gjer më sot akoma nuk ka një mendim shkencor unik në përdorimin e diferençuar të këtij ose atij uji për kurimin e këtyre sëmundjeve. Bile edhe për një çështje kaq të thjeshtë siç është p.sh. influenca e ujrateve minerale në sekretimin e lëngut biliar autorë të ndryshëm kanë mendime kontradiktore. N.A. TJULEJNEV (1961) pohon se nuk ka një mendim të përcaktuar për ndikimin e ujrateve minerale mbi përbërjen kualitative të bilës dhe studimet në këtë drejtim janë të pakta.

Duke marrë parasysh rëndësinë praktike që paraqet ky problem edhe për vendin tonë, ku prej shumë vjetësh të sëmurëve nga mëlcia dhe nga rrugët biliare u rekomanohet mjekimi në stacionin balneologjik të ujit mineral të Glinës, ne i vumë për detyrë vehtes të studjojmë në mënyrë eksperimentale influencën e këtij uji mbi sekrecionin biliar gjë që shënon përpjekjen e parë në këtë drejtim.

Në një artikull të botuar në Buletinin e Shkencave Mjekësore në vitin 1962 Nr. 4, ne kemi publikuar disa të dhëna lidhur me ndikimin e ujit të Glinës mbi sekrecionin dhe zbraziën e stomakut. Meqenëse funksionet fiziologjike të traktit digestiv janë të lidhura ngushtë me proceset metabolike të heparit, ne i vazhduem kërkimet tona edhe në këtë drejtim duke u munduar kështu që vëgoritë fiziologjike të këtij uji të studohen në mënyrë komplekse. Për këtë qëllim si test biologjik u përdorën qenë me fistula kronike të *vesica felia*, me të cilët u kryen 150 eksperimente dhe 303 analiza duke përcaktuar në sejcilin prej tyre sasinë e lëngut biliar, acidot biliare dhe bilirubinën e sekretuar gjat 4 orëve.

*Metoda e punës.* Studimet u bënë në dy qenë simbas metodës Shiff (I.V. DANILLOV 1960), por njëkohësisht duke lidhur edhe *ductus cholangius*. Në këtë mënyrë bila eliminohet jashtë nepërmjet një fistule prej çeliku inoksidabël, njëri skaj i sëcilës vendoset në *vesica felea*, ndërsa tjetri nxirret dhe fiksohet jashtë parëtit abdominal. Duhet theksuar se kjo metodë është nga më perfektet me që jep të dhëna ekzakte lidhur me gjithë sasinë e lëngut biliar të prodhuar dhe të eliminuar nga hepari gjatë eksperimentit. Kur *ductus cholangius* nuk lidhet ose nuk pritet midis dy ligaturave, siç veprojnë disa autorë, (S.S. OZERJEV 1964 etj.) sekretimi i

bilës maskohet meqenëse një sasi e caktuar e saj derdhet në duodenum nëpërmjet *ductus choledocus* gjatë procesit të digestionit. Për këtë arësye, ashtu siç bëjnë shumica e autorëve (I.A. MIGUNOV, M.T. KOVALEV 1960 etj.), ne, me anën e ligaturës së *ductus choledocus*, evituam plotësisht depërtimin e bilës në duodenum, ndërsa lëngun biliar të mbledhur gjat eksperimentit u a kemi dhënë me ushqim qenëve çdo ditë mbas mbarimit të punës. Kafshët janë vënë në eksperiment gjithëmonë mbas shërimit të plotë të plagës dhe jo më parë se 18 orë mbas ngrënies së fundit.

Qentë kanë qenë të tipit sanguin; njeri me peshën 19 kg. («Bruno») dhe tjetri 19,5 kg. («Ngjala»). Në stativ u mësuan të qëndrojnë relativisht shpejt. Gjat eksperimentit përgjithësisht kanë qenë të qetë dhe jo agresiv me njeri tjetrin. Përsa i përket sekrecionit të lëngut biliar ata bëjnë pjesë në tipin normal.

Procedura e punës ka qenë e tillë: në fillim u bënë eksperimentet e foni për të përcaktuar tipin e sekrecionit kundrejt eksitantëve ushqimore. Pastaj u bënë provat krahasonjëse të efektit sekretor të ujit të Selitës, i cili u përdor si ujë kontroll dhe t'atij të Glinës. Zakonisht seria e parë e eksperimenteve është bërë me ujë Selite, ndërsa seria e dytë me ujë Gline tek i njëjti qen dhe në të njëjtat kondita. Mbas mbarimit të çdo serie është bërë një pushim prej jo më pak se tre dit, për të evituar efektin e njohur të mbasveprimit fiziologjik.


Kafsha është vënë në eksperiment duke zbatuar gjithmonë rrugullat e njohura d.m.th. mbasi të ketë shetitur, të ketë defekuar dhe urinuar. Në këtë mënyrë është krijuar me 'të një steriotip dinamik i stabilizuar. Para fillimit të çdo eksperimenti është bërë pastrimi i indeve rrëth fistulës artificiale dhe pastaj është dhënë uji mineral i Glinës ose ai kontroll në sasi  $300 \text{ cm}^3$  («Ngjalës») dhe  $400 \text{ cm}^3$  («Brunos») në temperaturën  $18^\circ\text{C}$ . Në shumicën dërmuese të rasteve qentë e kanë përfshirë vetë ujin (çka është krejt fiziologjike), në raste të veganta u është hedhur me sondë pa vësh-tirësi. Menjëherë mbas ujit u është dhënë 100 gr. mish («Ngjalës») dhe 200 gr. mish («Brunos»). Pastaj me një gotë të vendosur nën fistulen artificiale dhe të fiksuar përrëth abdomenit është mbledhur për çdo 15' sasia e lëngut biliar të sekretuar gjat 4 orëve, duke ndarë veçmas për çdo orë. Së fundi ekstempore, me anë e fotokolorimetrit Pulfrichk sipas R. GRIGOR, PASCOE T.A. eti. (1959) është përcaktuar sasia e acideve biliare të çdo orë veçmas sidhe bilirubina e 4 orëve të marra sëbashku, simbas metodës BAKALÇUK (V.E. PREDTENÇESKIJ etj. 1950). Sikurse është përmendur edhe më lart, pjesa e lëngut biliar që nuk qfrytëzohej për analiza, u është dhënë qenëve sëbashku me ushqimin, fill mbas eksperimentit.

#### *Rezultatet e marra:*


1) *Sasia e lëngut biliar.* Nga 48 eksperimente të bëra me qenin «Bruno» rezulton se mesatarja e përgjithshme e bilës të sekretuar gjat 4 orëve për ujin e Glinës ka qenë  $36,9 \text{ cm}^3$ . Ndërsa për të Selitës (ujti kontroll)  $35 \text{ cm}^3$ . (Shif grafikun Nr. 1).

Kështu pra në rastin e parë kemi një sekretim prej  $1,9 \text{ cm}^3$  ose  $5,42\%$  më shumë. Ky veprim kolagog i lehtë nën influencën e ujit të Glinës duhet edhe më qartë në 52 eksperimente të bëra me qenin «Ngjala» mesatarja e përgjithshëm e të cilave rezulton për ujin e Glinës  $31,1 \text{ cm}^3$ , kurse për të Selitës (kontroll)  $24,3 \text{ cm}^3$ . (shif grafikun Nr. 2).

Siç shifet edhe nga grafiku i më sipërmë, nën veprimin e ujit të Glinës kemi një shtesë prej  $6,4 \text{ cm}^3$  ose  $26,38\%$  më tepër nga uji «kontroll».



Grafiku Nr. 1 Qeni «Bruno» peshë 19 kg. Mesatarja e përgjithshme e bilës së sekretuar gjatë 4 orëve në  $\text{cm}^3$ .



Grafiku Nr. 2 Qeni «Ngjala» Peshë 19,5 kg. Mesatarja e përgjithshme e bilës së sekretuar gjatë 4 orëve në  $\text{cm}^3$ .

2) Raporti midis sasisë së sekretimit të lëngut biliar gjat dy orëve të para dhe dy orëve të dyta: Një karakteristikë tjeter që evidencohet shumë mirë për ujin e Glinës, është sekretimi më i madh i 2 orëve të para në krahasin me ato të orëve të fundit të katër orëshit. Kjo vërteton edhe një herë influencën e theksuar sekretore fillestare të ujit të Glinës, sikurse është provuar nga ne edhe në eksperimentet mbi sekrecionin e lëngut gastrik (M. Karagjozi 1962). Simbas autorëve të ndryshëm (J.K. VASILENKO 1958-1964, F.D. VASILENKO dhe S.V. SHOLLOHOV 1960, RUTENBERG 1961; A.M. LANDA 1963; A.S. VISHNJEWSKIJ 1951 etj.) ujrat minerale në shumicën e rasteve fazën e parë të sekretimit e kanë më të rritur se fazat e tjera.


Siq paraqitet në grafikun Nr. 3 të serisë së parë të eksperimenteve me ujë Gline, të bëra në qenin «Ngjala» (gjithsejt 20 eksperimente), mesatarja e përgjithshme e sekretimit të lëngut biliar në 2 orët e para është  $17,35 \text{ cm}^3$ , ndërsa në 2 orët e dyta  $9,75 \text{ cm}^3$ .

Kështu pra vërehet një diferencë e konsiderueshme prej  $7,6 \text{ cm}^3$  ose  $77,94\%$  më tepër në 2 orët e para.

Po të krahasohen këto të dhëna me ato që jepin eksperimentet e serisë së dyte të bëra me ujë Selite «kontroll» (gjithsejt 18 eksperimente) në të njëjtin qen me të njëjtat kondita, rezulton se diferenca nuk është fort e ndijeshme (shif grafikun Nr. 3).


Pra siq dcl e kjarlë nga grafiku Nr. 3 për ujin e Selitës, mesatarja e sekretimit të dy orëve të para është  $6,5 \text{ cm}^3$ , kurse për dy orët e dyta  $5,71 \text{ cm}^3$ , d.m.th. në rastin e ujit kontroll raporti nuk ndryshon shumë, kemi një shtesë jo fort të konsiderueshme në fazën fillestare të sekrecionit të lëngut biliar dhc pikërisht  $0,79 \text{ cm}^3$  ose  $13.83\%$  më shumë. E njëjta gjë vërehet edhe në dy seri eksperimentesh të bëra me qenin «Bruno» (gjithsejt 70 eksperimente) të dhënat e të cilët jepin si mesatare sekrecioni në 2 orët e para për ujin e Glinës  $13.07 \text{ cm}^3$  lëng biliar dhe për 2 orët e dyta

$7,35 \text{ cm}^3$ . Siç shifet pra ka një diferençë prej  $5,72 \text{ cm}^3$  ose  $77,83\%$  më tepër në fazën e parë, kurse kjo diferençë për ujin e Selitës «kontroll» është vetëm  $2,13 \text{ cm}^3$  ose  $25,84\%$ , meqenëse mesatarja e 2 orëshit të parë në këtë rast rezulton  $10,41 \text{ cm}^3$ , ndërsa e të dytit  $8,28 \text{ cm}^3$ . (Shif Grafikun Nr. 4).



Grafiku Nr. 3 Qeni «Ngjala»

Raporti midis sasisë së lëngut biliar të sekretuar gjatë 2 orëve të para dhe 2 orëve të dyta (në  $\text{cm}^3$ ).



Grafiku Nr. 4. Qeni «Bruno»

Raporti midis sekrecionit të lëngut biliar gjatë 2 orëve të para dhe 2 orëve të dyta (në  $\text{gr.}\%$ ).


**3. Sasia e acideve biliare.** Nga të dhënat e eksperimenteve rezulton se sasia e acideve biliare nën veprimin e ujit të Glinës shtohet në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me ujin e Selitës «kontroll». Kështu p.sh. në një seri prej 39 eksperimentesh të bëra me ujë Gline tek qeni «Bruno» (shif grafikun Nr. 5) mesataria për orë e acideve biliare është  $2,45 \text{ gr.}\%$ , ndërsa për ujin e Selitës  $1,36 \text{ gr.}\%$  d.m.th.  $1,09 \text{ gr.}\%$  ose  $80,14\%$  më tepër për ujin e Glinës.

E njëjta gjë vërehet edhe në 19 eksperimente të bëra me qenin «Ngjala», tek i cili të dhënat janë  $4,44 \text{ gr.}\%$  për ujin e Glinës dhe  $3,07 \text{ gr.}\%$  për ujin e Selitës «kontroll». Pra ka një shtesë prej  $1,37 \text{ gr.}\%$  ose  $41,34\%$  (shif grafikun Nr. 5).

Ky fakt ka një rëndësi të veçantë, meqenëse kripërat e acideve biliare e mbajnë kolesterinën në solucion dhe irritja e koncentracionit të tyre në sëmundjet inflamatore kronike të rrugëve biliare, mund të shërbëjë si profilaksi në sëmundjen e formimit të gurreve (M.F. GOLLOSAJ 1960).


**Sasia e bilirubinës.** Nga të dhënat e nxjerra prej 27 eksperimentesh të bëra me qenin «Bruno», mesataria e bilirubinës së sekretuar gjatë 4 orëve rezulton të jetë  $2,90 \text{ mg.}\%$  ose  $12,88\%$  më e paktë për ujin e Glinës në krahasim me atë kontroll. E njëjta gjë vërehet edhe në 44 eksperimente

të bëra me qenin «Ngjala», tek i cili kemi mesatarisht  $3,32 \text{ mg}/\text{dl}$  ose  $12,14\%$  më pak bilirubinë. (Shif grafikun Nr. 6).



Grafik Nr. 5

Mesataria e përbajtjes së acideve biliare të sekretuara me lëngun biliar gjatë 1 ore (në gr.%).



Grafik Nr. 6

Raporti midis mesatares së bilirubinës të sekretuar nën veprimin e ujit të Glinës dhe atij «kontroll» gjatë 4 orëve.

## KONKLUSIONET

Në bazë të tē dhënave të eksperimenteve që u paraqitën më lart mund tē nxirren këto konkluzione:

- 1) Uji mineral i Glinës, i marë sëbashku me ushqimin në temperaturën  $18^\circ \text{C}$ , në krahasim me atë të Selitës «kontroll», e shton lehtësisht sekretimin e lëngut biliar.
- 2) Sekretimi është më i theksuar gjatë 2 orëve tē para.
- 3) Koncentracioni i acideve biliare është relativisht më i madh përujin e Glinës në krahasim me atë të Selitës «kontroll» dhe kjo ka një rëndësi të veçantë praktike në profilaksinë e sëmundjes së formimit të gurëve.
- 4) Së fundi nën influencën e ujit mineral të Glinës sasia e bilirubinës pëson një rënie tē lehtë në raport me ujin e Selitës «kontroll».

(Paraqitur në redaksi më 5/9/64)

## LITERATURA E KONSULTUAR

1. S.S. OZERJEV — Vlijanije Orenburgskoj mineralnoj budi na zhölleobrazovatelju funksiju peceni — voprosi kuror, fizioter. ileceb. fiz. kult. Medgiz Moskë 1961 Nr. 2 ff. 156-160.
2. E. LUTTRINGER — Obesite plethorique et cure de Contrexeville bilan therapeutique de 305 cas. — Extrait de la semaine des Hopitaux Paris 1961 Nr. 28 ff. 1704-1707.
3. V.N. DONSKOJ, V.K. LUBINEC dhe M.N. CETMANECEVA — Effektivnost kompleksnovo lejenija bolnih s bronicskimi zabolevanijsami peceni i zholçnih

- putjej na kurorte Karlovi Vari (Češkoslovakijski) — Voprosi kurort, fizioter. i lečenje. fiz. kul. Medgiz Moskva 1961 N. 1 ff 35-40.
4. N.A. TJULENEV — Ovlijanii vodi gorjačih istočnikov zheleznovodskih na zholicodelenije i otmjen zholčnih pigmentov Voprosi kurort, fizioter. i lečeb. fiz. kul. Medgiz Moskva 1961 N. 1 ff. 41-46.
  5. M. KARAGJOZI — Te držena eksperimentalne mibi veprimin e ujut mineral te Glinës ně sekretimin e evakuimin e stomakut. Buletin i Shkencave mješavine Tiranë 1962 Nr. 4 ff. 4-10.
  6. I.A. MIGUNOV — Sravnitelna ocenka dejstvija mineralnih vod «Sojmi» i «Piloskovskaja» na zholicodelenije v eksperimente — Tezisi i referati dokladov — IV naučno-praktičeskoj konf. po vop. san. leč. bolnih na kurort. Ukrainskij cit. min. vod. Truskavec 1960 ff. 117-118.
  7. M.T. KOVALEV — O vlijanju nekotorih mineralnih vod tipa Naftusja na zholicobrazovanje — Tezisi i referati dokladov — IV naučno prak. konf. po vop. san. leč. bolnih na kurort. Ukrainskij s pit. min. vod. Truskavec 1960 II. 116-120.
  8. N.F. GOLLOSAJ — Isledovanije vlijanija mineralnoj vodi «Naftusja» Nr. 2 na sekreciju i himizm zholci — Tezisi i ref. dokl. IV naučno prak. konf. po vop. san. leč. bolnih na kurort. Ukrainskij s pit. min. vod. Truskavec 1962 ff. 82.
  9. I.V. DANILLOV — Eksperimentalna fiziologija Tashkent 1960.
  10. F.D. VASILENKO i S.V. SHOLLOHOV — Izmenanje sekretnoj funkcii zhvelludočnih zheljoz pod vlijanjem mineralnoj vodi kurorta Krainka Medgiz Moskva 1960 ff. 27-32.
  11. A.E. BABINEC, E.E. GORDIENKO, B.P. DENISOVA — Legebnie mineralne vodi i kurortu Ukrainskij — Izd. Ak. nauk Ukr. SSR Kiev 1963 ff. 26-29, 123-129.
  12. J.K. VASILENKO — O mehanizme dejstvija mineralnih vod pri vnutrenem primenjeni Voprosi kurortologii fizioterapii i leč. fiz. kult. Medicina 1964 Moskva Nr. 3 ff. 193-200.
  13. J.K. VASILENKO — Vlijanje Pjatigorskoj mineralnoj radonovoj vodi na sekretorijalnu, evakuotornaju i perjokičesbuju motornuju dejatelnost zheludka Moskva 1958 f. 13.
  14. L.A. RUTENBURG — Izuchenje legebnih faktorov kurorta «Krainka» Moskva 1961 f. 21.
  15. A.C. VISHNJEVSKIJ — Lečenje mineralnimi vodami zabolovanij pishčevoritivnogo trakta Medgiz — Moskva 1951 f. 15.
  16. A.M. LANDA — Fiziko-balneoterapia v kompleksu lečenii travm, porazhenij, Voprosi kurortologii, fizioterapii i lečeb. fiz. kult. Medgiz Moskva 1963 f. 3.
  17. V.E. PREDTENČESKIJ et al. — Laboratorine metodi. issledovaniya Medgiz — Moskva 1950 f. 506-515.
  18. R. GREGOR, PASCOE T-J: — j Biol. Chem. (Am) 83 (1929) S. 35-42.  
Falck. W: Diss. Kiel, 1944  
Griebmann H. Falck W. Wschr. 26 (1948) S. 52-55.  
Arbeitsvorschriften fur das Pulfrich — Photometer Sammlung 1 Jena 1959.

#### PRELIMINARY DATA ON THE SECRETION OF BILE UNDER THE INFLUENCE OF THE MINERAL WATER OF GLINA.

(Summary).

In this article the author describes the study he has made on the influence of the mineral water of Glina on the bile secretion. This work includes 150 experiments on dogs with chronic fistula of the vesica felea and 300 laboratory analyses.

In the beginning he studied the type of secretion, then he made the comparative tests of the effect of the mineral and ordinary water on the bile secretion.

For each test he used 300 ml water and 100-200 g meat as accitant. The bile was collected every 15 minutes for 4 hours, while the animals were kept fixed, and the analyses were made extemporaneously every hour for the biliar acids and totally for the bilirubine.

From the data of these tests the author concludes:

1. The mineral water of Glina, taken together with food at 18°C increases slightly the bile secretion.
2. The bile secretion is more intensive during the 2 first hours.
3. The concentration of the biliar acids is relatively higher for the Glina water, which has a practical importance for the prophylaxis of the forming of calculi.
4. The amount of bilirubine falls under the influence of the Glina water as compared with that of the ordinary water.

# KUMTESA

## TURBULLIMET PSIKO-NERVORE PAS VARJES.

Prof. Xh. GJATA, Kand. Shk. Mjek. ULVI VEHBIU; LLAMBRINI  
RADOVANI (klinika e psikjatrisë — Shef i klinikës prof.  
Xh. GJATA).

Për turbullimet psiqike nervore pas varjes është shkruar pak në literaturën botërore, sepse personat që varen në përgjithësi vdesin shpejt dhe të pakët janë rastet që shpëtojnë. Është vënë re se disa nga ata që shpëtojnë çfaqin ndryshime patologjike në statusin psiqik.

Sipas Avdejev (2) rastet që çfaqin turbullime psiqike pas varjes «janë shumë të rralla dhe mjaf interesante». Studime më të gjera në këtë drejtim ka bërë Maintenon (cituar nga Attilio Ascarelli-1), i cili ka gjetur në këta persona amnezi parciiale dhe totale, anterograde dhe retrograde, vetëatribute dhe humbjen e aftësisë për të njojur vetëveten. Për amnezinë retrograde në këto raste ka shkruar dhe Iljin (4). Matvejeva (5), duke bërë fjalë mbi hypoksinë akute cerebrale, shënon se simptomat që takohen më shpesh tek këta të sémurë janë konvulsionet, eksitacioni dhe amnezia retrograde në 1-2 ditët e afërta. Në një punim tjetër (6) autorja analizon një rast që jetoi vetëm 83 orë pas varjes dhe që në fillim u gjet me mungesë: pulsi, respiracioni, arefleksi pupilare dhe vetëdije të errësuar. Më vonë tek ky person u restaurua pulsi, lindi frymëmarrja, rigiditeti i përgjithëshëm i muskujve të ekstremiteteve, hyperhydroza, inkontinenca e urinës, refleksi patologjik i Babinskit dhe në sfondin e vetëdijës sërrësuar u zhvillua edema cerebrale dhe pulmonare, që e shpunë të sémurin në vdekje.

Në autopsi u gjetën më shumë të dëmtuara cortex cerebri, cerebellumi dhe cornu ammonii. Tunjina (7) konstatoi, këto ndryshime patologjike në të sémurët pas varjes: hemoragji në sklerat dhe kapakët e syve, ngjyrje të zérat, dhëmbje në grykë, ataksi, humbje të funksioneve vegjetimeve, të orientimit alopsiqik dhe akceset konvulsive. Disa nga këto fenomene i ka konstatuar dhe Vroblevski. Gofman cit. (3) jep një rast me afoni dhe vështirësi të aktit të gëlltitjes.

Ne kemi observuar dy të sémurë, që kanë manifestuar turbullime psiqike dhe nervore pas varjes.

*Rasti i parë:* E sémura D.Xh. 32 vjeç, e martuar, shitëse. U shtrua në klinikën e psikiatrës datë 13.VII.1962 ora 21, me diagnoza gjendje deprezive me veprime suicidale.

Nga të dhënat anamnestike rezulton se para këtij veprimi kishte patur një grindje me të shoqin me karakter xhelozie. Pas zënics shkoi në shtëpi dhe vari veten në banjë. Sipas përshkrimeve të ekspertëve, mjekë legjistë, duket se akti i kësaj ka patur më tepër karakter butaforik, pitiatik, për të térhequr «vëmëndjen e të tjerëve».

Rreth orës 18.30 të datës 13.VII.1962, i shoqit e gjeti brenda në vaskën e banjës, të ulur, me duar të lëshuar dhe kordonin në qafë. Kur e nxo rrën nga banja ishte krejtësisht cianotike, pa puls dhe me respiracion

shumë superficial. Pesë minuta pas kamfores, kofeines dhe respiracionit artificial zemra nisi të rrahë. Nuk dihet sa qëndroi e varur.

Ora 23.30 u çfaqën ataket konvulsive, që s'kishin rregullshmërinë e epileptikëve, as kaocitetin dhe teatralitetin e histerikëve. Kontraksionet ishin tonike dhe klonike. Gjatë përpjekjeve për ta mbajtur u konstatua fuqizimi i konvulsioneve. Pupilat izokerike, me madhësi normale, por dobët reagojnë në dritë. Reflekset osteotendinoze dhe kutano-abdominale prezente. Mungojnë sindromi meningcal dhe reflekset patologjike. Me qenë se u dyshua për karakterin funksional të konvulsioneve, të nesërmen iu aplikua një seancë elektroshoku femoral 40 volt, gjatë së cilës bërtiti dhe nga dhëmbja tërroqi këmbën. Datë 14.VII.1962 statusi psihoneurologjik i të sëmurës paraqitet si më poshtë: Nuk përgjigjet ndaj pyetjeve që i drejtohen. Reagon vetëm ndaj ngacmonjësve shumë të fuqishëm. Manifeston konvulsione tonike dhe klonike të ekstremiteteve, që s'kanë regularitet në çfaqjen e tyre. Pupilat reagojnë në dritë. Reflekset prezente. Patologjikët mungojnë. Pulsi i shpejtë, 120 goditje në minutë, ritmik, me mbushje të dobët; respiracioni superficial 28 në minutë;  $T^{\circ}39$ . Në pulmonet nuk dëgjojen zhurma patologjike, respiracioni vezikular. Ora 10 deri 12 të kësaj date të sëmurës iu bënë 1 ampule luminal (0,20), 2 ampule klorpromazine (100 mg), 10 cc sol. Glucosae 40% në vene me 5 cc sol. Magnezii sulfurici 25%, 400.000 unitete peniciline dhe 0,5 gram streptomycinë. Pas përdorimit të luminalit dhe klorpromazinës e sëmura ra në gjumë, tensioni arterial nga 120/90 mm. Hg. që e kishte, i ra në 100/70 mm HG. Pas një ore gjumë personi shqetësohet, nis të rënkojë me zë të lartë dhe të bëjë lëvizje kaotike me dorën e djathtë. Ekstremitetet inferiore i kishte krejtësisht të kontraktuara në ekstension, kurse të si-përmet të lira. Dolën më në dritë gjurmët e varjes në ftyrë dhe të bradës strangulare në qafë. Nën sy dhe kapakët e tyre u zbuluan njolla hemoragjike me madhësi të ndryshme, por në përgjithësi të vogla. Në të dv'anët e çafës u çfaoën kuartë dy vija lineare të drejtuara horizontalisht me gjatësi rrëth 6 cm. sejçila dhe ngjyrë vishnje. Vija analoge, me këto u dukën dhe në gushë. Pas dite iu bë punksioni lumbar, i cili në filim doli me presion, por ishte i kuartë. Analiza e tij dha këto ndryshime: Pandy †; albumina 0,33%, celula 2 pér  $\text{cm}^3$ , glukoza 0,40%; klorur 9,2%. Pas punkturës lumbale iu zhduk kontraktura e ekstreniteteve. Në darkë të po kësaj dite gjondja e të sëmurës paraqitet e përmirësuar, menjëherë në dukjen e jashtëme të linte përshtypjen e një pacienteje me stupor katatonik, por reagonte ndaj pyetjeve që i drejtoheshin më tepër me anën e shikimit. Nganjëherë bënte përpjekje të fliste, por nuk arrinte ta shqiptonte dot fjalën, jo vetëm sepse zërin e kishte të dobët, por kishte edhe vështirësi artikulimi. Në mbrëmje temperatura i zbriti në  $38^{\circ}$ ; u ushqye me sonde. Dy ditët e mëvonëshme statusi psiko-neurologjik i të sëmurës shkoi drejt përmirësimit. Nisi të ushqehej vetë, pa sonde. Nga dyshek u nuk ngrihej. Sjellja e saj u bë më adekuante. Nuk urinonte më, as defekonte në dyshek. Nga ana e sistemit nervor nuk paraqiste ndryshime patologjike. Sfera cerebellare nuk mund të ekzaminohei. Në kontakt me mjekët nuk hynte. Ushqimin e pranonte vetëm nga një kujdestare, me të cilën diku shkëmbente edhe ndonjë fjalë. Një herë asaj i tha: «C'turp bëra, burri nuk ka fai, ku është, le të vijë». Si terapi iu vazhdua penicilina, streptomicina, glukoza, magnezi, sulfurik, vitaminat e llojeve të ndryshme dhe klorpromazina me doza ditore deri 100 mg.

Ditën e gjashëtë të qëndrimi, datë 18.VII.1962, statusi i të sëmurës u keqësua. Ra përsëri në gjendje subkomatoze. Pupilat reagonin me përtaci

ndaj dritës. Nuk jepte asnijë përgjigje ndaj pyetjeve që i drejtosheshin. Iu zhdukën reflekset abdominale, patelare dhe akiliante, reagonte lehtësisht ndaj pickimeve me gjilpërë. Fytyra hyperemike. Temperatura u ngrit në  $40^{\circ}5$ , pulsi 140', ritmik, me mbushje të plotë, respiracioni vezikular, pa zhurma patologjike. Tonet e zemrës pak të largëta, abdomeni i butë, indolent. Sindromi meningal dhe reflekset patologjike mungonin. Për këtë arsyse iu dyfishua doza e penicilinës dhe e streptomycinës, iu caktua noradrenalinë në vene me 5% sol. glucosae, kamfora, kofeina, vitamina E<sub>1</sub> — 500 γ, serumi fiziologjik dhe kloramfenikoli 6 x 500 mg. Në mbrëmje të kësaj dite iu bënë dhe 200 cc plazme në vene. Nga mezi i natës respiracioni u bë stertoros, temperatura iu afroa  $41^{\circ}$ .

Datë 19.VII.1962 gjendja e të sëmurës u keqësua edhe më tepër. Temperatura i kaloi të  $41^{\circ}$ , tensioni arterial nuk mund të përcaktohet, pulsi filiform, 150 në minutë, me periudha aritmie, frymëmarja superficiale, stertoroze, 40 në minutë. Në mëngjesin e kësaj dite iu bë edhe 1 ampule adrenaline, me 1 ampule lobeline. Ora 9— e mëngjesit pati konvulsione epileptike. Temperatura  $41^{\circ}5$ . Ora 10 pulsi nuk prekej. Tonet e zemrës mezi dëgjoheshin, . . . Në këtë kohë iu bë edhe 1 cc. Noradrenalinë, por pa dobi. Në fillim pushoi zemra së punuar, respiracioni u bë tepër superficial dhe e sëmura vdiq ora 17.

Në autopsinë e bëre nga P. Pavli u gjetën këto ndryshime: «Në qafë shenjat e jashtme karakteristike të brazdës strangulare në gjendje rezorbimi të avancuar. Fenomene anoksie dhe iskemie, më karakteristike në pulmone dhe në tru».

*Analiza e rastit.* Për ta kuptuar më mirë dinamikën e sëmundjes do të ndalemi në disa momente me rëndësi.

1. Cfaqja me kuartësi të madhe në ditën e dytë pas varjes të brazdës strangulare dhe e mikrohemoragjive nën sy dhe kapakët e tyre, janë simptome baze, që dëshmojnë mbi shtrengimin e qafës me lak, për qëllime vetvrasjeje. Zhvillimi i mëvonshëm i tablosë klinike e konfirmoi edhe një herë këtë fakt.

2. Të tjerëq vëmëndjen dekursi i sëmundjes në orët e para dhe ditët e mëvonëshme. Në fillim normalizohet respiracioni, pastaj lind pulsi, reflekset nga mukoza, lëkura dhe osteotendinozeti, kurse vetëdija u kthjet llua pothuajse e fundit, krahas rregullimit të procesit të gjallitjes. Dy ditët e para të qëndrimit në klinikë pacientia qëndroi në gjendje torpozo e herë subkomatoze, dhe reagonte vetëm ndaj ngacmonjësve më të fuqishëm, si elektroshoku femoral 40 volt.

3. Në tablonë klinike të ditëve të para, përvëç vetëdijes së errësuar, e sëmura manifeston edhe konvulsione të ekstremiteteve që s'ishin të ngjashme me epileptikët, por më shumë u përrngjanin hyperkinezive që lindin nga encefalitet subkortikale. Gjithsejt pati dy kriza të tilla të zgjatura. Urinonte dhe defekonte në dyshek. Ushqehet me sondë. Në mëngjesin e ditës së dytë ekstremitetet e poshtme i mbante në ekstension të vazhdueshëm.

4. Duke filluar nga mbrëmja e ditës së dytë pas varjes, pasi i bëhet punksioni lumbal, që zbuloi ngritjen e sasisë së klorureve dhe uljen e glukozës, statusi somato-psiqik i të sëmurës fillon e përmirësohet. I largohet ekstensioni ekstremiteteve, përpipet ta ndjeki me anën e shikimit mjekun që bisedon me të, bënte përpjekje të fliste, por kishte disfoni dhe dizartri. Në paraqitjen e jashtme të linte përshtypjen e një të sëmure me stupor katatonik. Ditën e tretë, të katërtë dhe të pestë pas varjes, pacientia shkoi duke u përmirësuar. Nisi të ushqehet pa sonde, por hante vetëm

nga duart e një kujdestareje me të cilën diku ndronte ndonjë fjalë, kurse mjekëve nuk u përgjigjej. Manifestonte një farë negativizmi, më tepër pasiv se sa aktiv. Në përgjithësi çfaqej me një sindrom semikatatonik, jo të formuar mirë.

5. Duhet të shënojmë se që të nesërmen e ditës pas varjes, e deri sa vdiq temperatura ka qënë e lartë nga  $38^{\circ}$ — $41^{\circ},5$  e cila me sa duket katur origjinë centrale, si rezultat i dëmitimit të rajonit diencefalik, sepse në pulmonet dhe abdomen nuk u konstatuan ndryshime patologjike, si në periudhën kur ishto gjallë, ashtu edhe në autopsi.

6. Në ditën e gjashtë gjendja e të sëmurës përsëri keqësohet, bie në gjendje subkomatoze, iu zhdukën reflekset abdominale, patelare dhe akiliante. Të nesërmen pati edhe një akces tipik epileptik. Pulsi iu bë filliforme, respiracioni superficial, stertoroz, tonet e zemrës të largëta, temperatura i shkoi deri  $41^{\circ},5$  dhe në gjendje të thellë komatoze vdiq ora 17 të datës 19/VII/1962, ditën e shtatë pas varjes.

Me gjithë terapinë e shumëllojëshme të përdorur (klorpromazinë, luminal, kamfore, kafeine, noradrenaline, lobeline, glukoza në vene dhe subkutane, polivitamina me anë injekzionesh etj.) të sëmurën nuk mundëm ta shpëtonim. Nga kompresioni i enëve të gjakut të qafës, në pulmonet dhe në tru dukeshin kjartë fenomenet e anoksisë dhe iskemisë. Pa dyshim se një shok i rëndë për sistemin e saj nervor dhe gjithë organizmin ishin impulsat e forta, që lindën nga zonat e pasura reflektogjene të qafës, në kohën e shtrëngimit nga kordoni varës.

Mund të supozohet se në gjendje shoku aftësitë mbrojtëse të organizmit të të sëmurës ishin të ulura, vetitë kompensatore të kores së trunit — mjaft të kufizuara. Duhet menduar pra se vdekja është shkaktuar nga disa faktorë së bashku, që lidhen ngushtë njeri me tjetrin.

Rasti i dytë: E sëmura L.H., vjeç 25, arsimtar, e martuar, u shtrua në klinikën e psikiatrisë datë 16.VIII.1962, e transferuar nga klinika e kirurgjisë hopitaliare me diagnozë «Turbullime psiqike pas varjes».

E lartpërmendura është zhvilluar normalisht si nga ana fizike ashtu edhe psiqike. Ka kaluar pa komplikacione infeksionet infantile. Ka kryer shkollën e mesme. Me mësimë ka shkuar mirë. Nga karakteri ka qenë e gjallë, e hedhur, e qeshur, e dashur me shoqet, aktive ndaj ambientit rrëthonjës. Ngulte këmbë në mendimet e saj dhe përpinqej që ato t'i realizonte. Kohët e fundit punonte si mësoniёse duke u marë direkt me mbarëvajtjen e organizatës së pionierit në shkollë.

Nga anamneza familjare nuk zbulohet asgjë e veçantë.

Anamneza e sëmundjes. Dy muaj para se të shtrohej në klinikën e psikiatrisë u martua ne dëshirën e saj, megjithëse familjarët nuk ishin dakord dhe bënë çmos ta pengonin këtë martesë. Që në kontaktin e parë seksual që pati me të shoqin ngeli e hutuar dhe e pakënaqur, sepse ai nuk e kreua në mënyrë të rregulltë, fiziologjike (sipas të dhënave anamnesike, jo shumë të sigurtë, i shoqi ka qënë pederast aktiv dhe pasiv). Vjehra nuk e trajtonte mirë, e shante e linte pa ngrënë, përpinqej ta ndante nga i biri, e ofendonte. Si reaksion ndaj situatës së krijuar ra në depresion, nuk dilte nga shtëpia, qante, humbi oreksin, përpinqej të evitonte takimet me fqinjët. Për këtë arsyë u largua nga burri dhe u kthye në shtëpinë e mëmës. Datë 12.VIII.1962 rreth orës 9 të mëngjesit, kur nëna kishte dalë, pasi i dha nipi disa lodra dhe e largoi nga guzhina u fut në nevojtore, rrëgulloi vendin e varjes, vuri lakun në qafë, lidhi duart me rrypy dhe u var. Sipas thënieve të nënës duhet të ketë qëndruar e varur 3-4 minuta. Mjeku i urgjencës e gjeti të sëmurën pa puls, pa respiracion me cianozë

të thellë dhe me njolla të zeza në këmbët. Pupilat nuk jepnën asnjë reaktion ndaj dritës. Iu fillua respiracioni artificial. Pas pesë minutave iu bë 1 cc sol Adrenalini hydrochloridi 1,0-1000 : 1 në venë dhe 2 cc lobelinë subkutane. Me gjishtrinjtë iu pastrua gryka nga mukusi i tepërt, i grumbulluar, që kishte hyrë thellë.

Në minutën e 15 pas çlirimt nga laku i varjes, e sëmura respiroi për herën e parë. Disa minuta më vonë nisi të rrahë zemra dhe të palpohej pulsi. Por reflekset pupilare, abdominale dhe osteotendinoze ishin të zhdukura. E sëmura paraqitej në gjendje të thellë komatoze. Në gjendje të tillë u shtrua në klinikën e kirurgjisë. Gjatë dy ditëve të para qëndrimi në këtë klinikë është paraqitur në gjendje subkomatoze, me kriza konvulsive, më tepër të karakterit tonik, që shkonin nganjëherë deri në opistotonus. Urinonta dhe defekonte në dyshek. Reagonte me lëvizje të trupit vetëm ndaj ngacmonjësve më të fortë. E ushqen me sondë. Temperatura iu ngrit deri në 38°. Ditën e tretë filloj të kthjellohej, fiksonte shikimin, pupilat reagonin, iu çfaqën reflekset, por nuk përgjigjej ndaj pyetjeve që i drejtosheshin, vetëdija qëndronte akoma e errësuar. Të nesërmen njohu mëmën, bënte përpjekje të fliste, por me sa duket kishte dhëmbje, sepse mbante dorën në fyt. U mjekua me sol. Natrii chlorati 10%—10.0% në vene, polivitamina, antibiotike, glukoza 40%, kurse ditët e para iu dha për të respiruar edhe oksigjeni.

Ditën e katërt pas varjes somato-neurologjik i të sëmures paraqitet si më poshtë: Kontakti me të sëmuren është shumë i vështirë. Nuk i kupton pyetjet që i drejtohen. Në fillim u trëmb nga ardhja e mjekut, iu afroa më tepër mëmës. Përpigjet të flasë, por zëri i saj nuk ka timbrin e duhur, s'di të artikulojë mirë fjalët dhe rokjet. Ka frikë të pijë ujë dhe të gjelltitet. Të tèrheq vëmëndjen fakti se e sëmura është e inhibuar; si e trullosur, e hutuar. Nuk rri e qetë në dyshek, bën lëvizje të duarve të duket sikur synojnë drejt një qëllimi të caktuar, por në realitet s'janë produktive, këmbët i mbledh dhe i lëshon, përpigjet të ngrihet nga dysheku. Bije në sy tendencia e saj e theksuar për të kapur çdo gjë që ka pranë. Kur mjeku i afroi çekiçin, e kapi me forcë dhe s'e lëshonte. Objektivisht nuk u vunë në dukje lezione organike neurologjike, përvëç refleksit të kapjes, palmo-mental dhe nasolabial. Sfera cerebellare nuk mund të ekzaminohet. Mjeku otojatër shënon se aparati i gjelltitjes dhe kordat vokale nuk paraqesin ndryshime patologjike lokale. Shënojmë se e sëmura kishtë frikë të gjelltitez sepse mbytej. Ekzaminimi objektiv zbuloi një ulje jo të theksuar të refleksit faryngeal.

Ditën e dytë të qëndrimit në klinikën e kirurgjisë hospitaliere dolën kuartë në qafë shénjat e brazdës strangulare.

Datë 16.VIII.1962 e sëmura u transferua në klinikën e psikiatrise.

Ditët e para të qëndrimit në klinikë, me terapinë e aplikuar gjendja filloj të përmirësohej, nisi të hajë ushqimet, të pijë ujin (ditën e shtatë pas varjes), por ankonte dhëmbje në grykë, kuptonte që ndodhet në spital, njihte njerëzit e saj të afërt, por jepte të dhëna kontradiktore kur pyetej për jetën e saj. Në fillim u mjekua me sol. natrii chlorati 10%—10.0% në vene, polivitamina dhe klorpromazinë deri 100 mg. në ditë. Më vonë iu shtua edhe meprobamati.

Gjatë qëndrimit në klinikën e psikiatrise statusi psiqik i të sëmureve nuk ndryshoi shumë, prandaj ne do të analizojmë gjendjen e saj psikotike të ditëve të fundit (Datë 12.XI.1962).

E sëmura e ka të humbur orientimin në ambientin rrëthonjës. Mendon se ndodhet në shkollë. Nuk di të përcaktojë stinën e vitit, ditën, mua-

jin dhe vitin. Njeh mirë nënët dhe vëllezër. Nga ana emocionale paraqitet si e mpirë.

Në mendimet është monotore, e varfër. Përgjigjet shkurt ndaj pyetjeve që i drejtohen dhe me zë të ulët. Artikulimin e fjalëve nuk e ka të kuartë. Me momente duket se ka logokloni, të cilën përpinqet ta maskojë. Më tepër operon me të menduarit konkret. Mendimet e saj janë të lidhura ngushtë me situatën rrëthonjëse, aftësinë për abstraksione e ka humbur. Konkluzionet i ka të përcipta, jo të bazuara mirë.

Sjellja e pacientes të kujton herë atë të oligofrenëve, herë të të dehurve, ose të atyre që sa kanë bërë elektroshok bitemporal. Krethi i interesave të saj është shumë i kufizuar. Nuk i bën përshtypje të rrijë pa të mbathura, shpesh herë i heq vetë ato, s'impresionohet kur i duken organet seksuale, ecën zbathur, me gjoks të hapur, veshjen nuk e mban pastër, këmbët nuk i lan. I mungon iniciativa për veprime të koordinuara, që të shpien drejt një qëllimi të caktuar.

Ajo që bie më shumë në sy në statusin psiqik të të sëmurës është dëmtimi i kujtesës. Pacientia herë mendon se ndodhet «në pavionin e tretë», herë në «mapon A», e herë «në shkollë». Është e bindur se jemi në vitin 1953, në stinën e pranverës. Nuk mban mend ditët e javës. Ka harruar që ka qenë e martuar. Kur pyetet thotë se është «15 vjeç», se ka «14 ditë e shtruar» e se «dje» e lanë pa ngrënë drekë. Për burrin thotë se është «shumë i mirë», punon në «telegraf» (kurse në realitet punon në një sektor tjeter), e se ai, së bashku me vjehrën, vijnë dy herë në ditë dhe e takojnë. Ngatron dhomën dhe krevatin. Saherë që takohet me mijekun e përshëndet dhe s'i kujtohet që e ka parë më parë.

Pacientia ka humbur shumë shprehi të fituara gjatë jetës. Nuk di të ndezi shkrepsen, s'është e aftë të vizatojë një romb, katerkëndësh, apo trekendësh, ose t'i emërtojë ato pasi i janë paraqitur. S'di të dallojë cili numër është më i madh 729 apo 279, të përcaktojë ose të kujtojë meloditë e këngëve shumë të njobura etj.

Si paraqitet statusi neurologjik në momentin e tanishëm? Ka hyposmi bilaterale, bile alkolin nuk ishte në gjendje ta dallonte. Refleksi laringeal pak i ulur. Nuk u konstatuan lezione të tjera të nervave kraniale. Réflexet prezente. Sensibiliteti superficial dhe profund, aq sa mund të ekzaminohej, janë precise. Paraqet ataksi dextra gjatë të ecurit me sy mbyllur. Ecën si e dehur, duke hedhur këmbët anash. Dismentria në të dy duart. Bën shumë lëvizje komplementare të panevojëshme, ka humbur ato finet. Sindromi meningeal, reflekset e automatizmit oral dhe ato patologjikut mungojnë. E sëmura ka shumë jargë nga goja, lëkura e fytyrës i shkëlqen nga lyra.

*Analiza e rastit:* Duhet menduar se veprimi suicidal në rastin konkret u krye nga një person me karakter jo të theksuar psikopatik, që kishte dhënë një psikozë reaktive. Për faktin se e sëmura qëndroi për një kohë të gjatë e varur, flet mungesa e pulsit, apnoja, cianoza e theksuar dhe mungesa e reflekseve pupilare. Duke ndjekur me hollësi dinamiqen e sëmundjes të tërheq vëmëndjen fakti se me kalimin e ditëve restaurohen plotësisht ose pjesërisht, të gjitha proceset e rëndësishme jetike, kurse vetë-dija kthjellohet e fundit.

Në rastin konkret, turbullimet psiqike zënë një vend dominonjës në tabilonë klinike. Ato janë të shumëllojëshme dhe me sa duket disa prej tyre kanë karakter ireversibël. Në fillim e sëmura manifestoi gjendje komatoze, subkomatoze, torporoze, kriza konvulsive me opistotonus, fa-

sses reconnaissance, kurse më vonë, në plan të parë, dalin turbullimet emociionale dhe motore; indiferentizmi, otuziteti emocional, të qarat e papritura, apatia, puerilizmi, shqetësimi i përgjithëshëm motor («dromomania»), veprimet impulsive, poza embrionale, hutimi, ekolalia dhe eko-praksia.

Shumë demonstrativ është sindromi i Korsakovit me amnezinë anterograde dhe të të fiksuarit të ngjarjeve, pseudoreminishencat, konfabulacionet dhe dezorientimin amnestik, në vend dhe kohë. Shtojmë se ditët e fundit ky sindrom ka dalë më në evidecë.

Në tërësi, në momentin e tanishëm, e sëmura paraqitet me sindromin dement. Për këtë flet varfëria e gjykimit të saj, pamundësia për të shpjeguar edhe proverbat më elementare popullore, mungesa e kritikës dhe autokritikës, hypomnesia, akalkulia, ulja e syrit të observacionit, pamundësia për t'u përgjigjur kërkuesave të ambientit të jashtëm, paraqitja e saj e jashtme e çrrregulltë, të ngrënët pamasë dhe jo në mënyrë fiziologjike, sugjestionabiliteti etj.

Si simptome neurologjike u konstatuan: disfonia, dizartria, disfagia, reflekset e automatizmit oral, hyposmia, turbullimet cerebelare me humbjen e lëvizjeve fine, jargat e shumta nga goja, lyra e tepruar në fytyrë etj. (çrrregullime vegjetative).

Në përgjithësi sot e sëmura të le përshtypjen e një oligofrenije, e një personi të dehur, sikur i ke bërë elektroshok. Ndihma e parë që iu dha (respiracioni artificial, adrenalina etj.) ishte e menduar mirë dhe u aplikua drejt. Terapia e mëvonëshme konsistoi në rregullimin e qarkullimeve hemolikuorodinamike dhe në qetësimin e sistemit nervor me ndihmën e neuroleptikëve.

Koha prej tre muaj ndoshta është akoma e shkurtër për t'u shprehur për prognozën, por ne kemi përshtypjen se në rastin konkret kemi lezione të rënda organike të trurit.

### *Konkluzione të përgjithëshme.*

1. Pas varjes, në të sëmurët që shpejtojnë, mund të lindin turbullime psiqike e nervore që shpesh janë të rënda dho ireversibile. Edhe sipas materialit tonë më tepër dëmtohet cortex cerebri, veçanërisht lobi frontal, cerebellumi dhe gyrus hypokampi.

2. Si turbullime neurologjike më të shpeshta në të sëmurat tonë u konstatuan: dhëmbje në grykë, dizartria, disfagia, disfonia, sialorea, yndyrë në fytyre, hyposmia, reflekset e automatizmit oral, turbullimet cerebelare dhe agnoziko-apraktike.

3. Si turbullime psiqike u konstatuan a) Turbullimet e rënda të vetë-dijes: gjendje torporoze, subkomatoze, komatoze, krizat epilepike, fausses reconnaissance).

b) Turbullimet e kujtesës, që u çfagen me sindromin e Korsakovit.  
c) Turbullimet e intelektit (sindromi dement).

c) Turbullimet motore: sindromi semikatonik, poza embrionale veprimet impulsive, echolalia, echopraxia, shqetësimi motor (dromomania), sjellja e pamotivuar etj.

d) Turbullimet emocionale: gjendje depresive, indiferentizëm otuzitet.

4) Në bazën e këtyre çrrregullime neuropsiqike qëndrojnë vratat ne-krotike, që janë pasoja e anoksisë dhe iskemisë cerebrale, të shkaktuara nga komprimimi i vazave të qafës. Një rol shumë të rëndësishëm lozin

impulset e fuqishme, që lindin në zonat rëfsksogjene të qafës dhe drejtës  
hen për në koren e trurit.

Nën influencën e këtyre ngacmimive mund të lindin në tru zona të  
gjëra inhibicioni mbrojtës, që determinojnë çfaqjen e disa nga shenjat  
psikotike dhe neurologjike.

(*Paraqitur në Redaksi më 5-X-64*)

## B I B L I O G R A F I A

1. Ascarelli Attilio — Compendio di medicina legale Roma 1924 F. 461.
2. Avdjejev M.I. — Kurs sudjebnoj medicini Gosjurizdat 1959 (F. 272-285).
3. Gamburg A.M. — Sudjebnomedicinskaja eksperitza obvinjajemovo Kijev 1948.
4. Iljin A.S. — «Tri siliçaja retrogradnoj amnezii u ozhvilenih povesivshih». — Sbornik sudjebno — medicinskoj eksperitizi Nr. 15 1931 (F. 44).
5. Matvejeva T.S. «O morfologiceskikh izmenenijah centralnoj nervnoj sistemi glevjeka pri ostrom kisillorodnom golodanji». — Voprosi sudjebno — medicinskoj eksperitizi. Gos. Izd. 1954 (254-270).
6. Matvejeva T.S. «Dalnjejshe isledovanija golovnovo mozga čeloveka pri ostrom kisillorodnom golodanji (mehanicheskaja strangulacija). — Voprosi sudjebno — medicinskoj eksperitizi Gos. Jur. Jsdat 1950 (F. 203-215).
7. Tunjina E.L. «Kvalifikacija stepeni tjažhesti telesnih pcvrezhdjenij pri sđavleniji organov shei, rukami, ili petloj». — Sbornik naucnih rabot po sudjebnoj medicine i kriminalistike posvjashčenij pamjati N.S. Bokarius. Harkov 1956 (F. 110-117).
8. Vroblevski P.M. «O boleznnennih javlenijah nabludajemih u ozhvilenih posle poveshenija». — Arhiv krimin. i sudjebnoj medicini. Harkov 1926 T.I. Kn. I. (faqe 61).

## PSYCHONEUROLOGICAL TROUBLES AFTER HANGING

(Summary).

This work analyses the nervous and psychic troubles observed after an attempt to hanging in two women; one of them is still alive (two and a half months after the event) The authors conclude that after attempts for hanging may appear psycho-nervous disturbances, often serious and irreversible. The heaviest damages are caused to the brain, especially to the frontal lobe, to the cerebellum and gyrus hippocampi. The observed neurologic troubles were mainly: pains in the throat, dysarthria, dysphagia, dysphonia, sialorrhœa, hypospmia, troubles of the automatic reflexes of the mouth, cerebellar and agnozio-apraxic troubles. The more serious psychic troubles were noticed in the sphere of consciousness (coma, subcomatous state, torpor, epileptic crises, fausses reconnaissances), of memory (Corsakow symptom), of the intellect (dementia syndrome). In the motor sphere was noticed the semicathartic syndrome with embrional poses, impulsive acts, echolalia, echopraxis etc. The emotional sphere was characterised with a depressive state, with indifference and emotional obtuseness.

According to the authors on the basis of these alterations lie organic lesions of the brain, caused by ischaemia and anoxia, as well as functional troubles (inhibition of the relative zones), caused by the strong impulses sent by the reflexogene zones of the neck to the brain as a result of the compression.

## SINDROMI POSTINFARKT I MIOKARDIT OSË SINDROMI DRESSLER

Doc. JOSIF E. ADHAMI

Katedra e Terapisë së Fakultetit (Shef i Katedrës J. E. ADHAMI)

Ky sindrom u përshkrua për herë të parë në vitin 1955 nga Dressler, analogjikisht me sindromin e postkomisurotomisë dhe perikarditit idiospatik.

Sëmundja karakterizohet nga çfaqja e një perikarditi eksudativ të shoqëruar me pleurit në afro dy të tretat e rasteve dhe pneumoni në afro një të tretën e tyre. Fërkimi i perikarditit ndëgjohet më shpesh midis javës së dytë dhe të njëmbëdhjetë mbas prodhimit të infarktit të miokarditit, zgjat tre ditë deri disa javë dhe konstatohet pamvarësish nga madhësia e tij.

Me ndryshim prej perikarditit epistenokardik që zbulohet klinikisht gjatë infarkteve të murit të përparshëm, në sindromin e Dressler perikarditi ka një karakter më difuz, zhvillohet më me vonesë se i pari dhe ka prirje për recidiva. Gjatë recidivave të sëmurët paraqitin temperaturë, ngritje të sedimentacionit, leukocitozë me neutrofili dhe në një pjesë të rasteve eozinofili. Versamentet perikardiale ose pleurale janë zakonisht hemorragjikë; po ashtu pneumonitë, të cilat mund të zhvillohen që në ditët e para mbas infarktit të miokardit, të shoqërohen me hemoptoe dhe të konsiderohen gabimisht si infarkte pulmonare.

Simbas të dhënave të Damir A.M. dhe Sidoroviç S.H. (1961), Dressler mundi të mbledhë 44 raste që nga viti 1955 deri në 1960, Mandel W. dhe Jonnson E. (1957) përshkruan një rast, Stein I. dhe Weinstein J. po në atë vit 2 raste, kurse Broch O.J. dhe Ofstag J. (1960) paraqitën tre të sëmurë, por duke parë në mënyrë retrospektive 500 kartela të rasteve me infarkt-akut të miokardit, mundën të zbulojnë edhe tre të tjera.

Matusova A.P. (1961), flet për 6 pacientë dhe tregon se deri në atë vit, në literaturën sovjetike nuk qe përshkruar asnjë rast. Njëkohësisht me këtë autor, Damir A.M. dhe Sidoroviç S.H., paraqitën 4 të sëmurë me një sindrom të tillë.

Në literaturën që kemi patur mundësi të çfrytëzojmë, kemi konstatauar se Rajevskaja G.A. dhe Kazmina P.V. (1962) kanë paraqitur 3 raste, Černjak N.G. (1962) një pacient, kurse Paunescu-Podeanu A. dhe Munteanu M. (1963), dy të tjera.

Në klinikën tonë kemi patur rastin të mjekojmë tre pacientë, të cilët i përkasin këtij sindromi. Në dy të fundit, diagnoza e sindromit Dressler u vu që në fillim, prandaj u mjekuan me preparate hormonale dhe dolën nga spitali në gjendje të mirë, ndërsa në rastin e parë diagnoza u vu në mënyrë retrospektive, mbasi ne më parë nuk e njihnim këtë sindrom. Prandaj dhe demonstrimin e rasteve, nuk po e bëjmë në mënyrë kro-nologjike.

Rasti i Parë: Alije A. vjeç 55, shtëpijake, u shtrua në klinikë më 27/V/1962 me diagozën «infarkt kardiak». Nr. i kartelës 4222.

E konsideronte vehten të sëmurë që para 2 javësh, kur ndjeu një dhimbje të fortë si thikë në regjionin prekordial që i iradiohej në shpatullën e majtë, kishte dispne, djersë, dobësi të theksuar, pastaj temperaturë. Dhëmbjet i përsëriteshin gjatë natës dhe nuk e linin të flerë. Mjekohet në shtëpi për diagnoza të ndryshme, por pa rezultat, derisa më në fund dërgohet për shtrim në klinikën tonë.

Ka kaluar sëmundjet e foshnjërisë dhe një limfadenit specifik të fistuluar në regjionin sub dhe retromandibular të djathtë. Anamneza familiare pa rëndësi.

Kur u shtrua gjendja e pacientes ishte relativisht e mirë, temperatura rrëth  $38^{\circ}$ , paraqiste dhëmbje prekordiale që i përhapeshin në qafë dhe shpatullën e majtë, të cilat i theksoheshin gjatë frysëmarrjes dhe i lehtësoheshin kur rinte ndenjur në shtrat. Kiske dobësi të përgjithëshme, anoreksi, konstipacion. Objektivisht dukej e zbehtë, me cianozë të buzëve, paraqiste strumë retrosternale të gradës III-të. Pulsi 72/m, presioni arterial  $130/80$  mm Hg. Zemra e zgjëruar në të gjitha drejtimet, tonet e dobët, pa zhurma patologjike, ritmikë. Mushkëritë pa ndryshime. Mëlgja prekej 3 cm. nën harkun brinjor.


Në gjak u konstatua një anemi e lehtë, leukocitet qenë brenda normës por vihej re një polinukleozë  $75\%$ , sedimentacioni  $28$  mm në 1 orë. Indeksi i protrombinës i rritur në  $181\%$ , kurse koha e protrombinës qe ulur në  $19''$  nga  $35''$  që ishte norma. Glicemia  $1,80$  gr%.

Urina me kateter paraqiste gjurma albu-mine, shumë epiteli pavimentoze dhe 2-3 epiteli renale për fushë. Azotemia  $0.50$  gr%.

Të gjitha këto flisin më tepër për një perikardit eksudativ, se sa infarkt të miokardit. Veç kësaj, vihej re një hipertrofi e ventrikulit të majtë.

Ditën e gjashtë të shtrimit në klinikë, d.m.th. tri javë mbas fillimit akut të sëmundjes, gjendja e pacientes u rëndua, iu theksua cianoza, pulsi ariji  $96$ /m, presioni arterial u ul në  $90/70$  mm Hg., jugularet qenë të fryra, zemra e dilatuar, *ictus cordis* mezi prekej, kurse në auskultacion ndëgjoheshin fërkime pleuro-

E. K. G. 30/V/1962.



Voltazhi i ulur. Ritmi sinusal. Frekuencia  $100$ /m. Aksi elektrik horizontal. Pozicioni horizontal. P-Q :  $0,14''$  QRS :  $0,06''$ . Q-T :  $0,24''$ - $0,26''$ . S-T: II, VL, V3, V4, V5: nën vijën izoelektrike.


T I, II, VL, V4, V5, V6: negativë por jo simetrikë.

perikardiale në zonën e matitetit absolut të zomrës si dhe fërkime pleurale në 2/3 e poshtme të hemitoraksit të majtë, më tepër lateralish, ndërsa në regjionin aksilar të kësaj ane, ndëgjoheshin rale të thata, subkrepitante dhe respiracion bronkial; hipokondri i djathtë i dhëmbëshëm, mëlcia prekej 3-4 cm. Temperatura e cila qëndronte rrëth  $38^{\circ}$ , me gjithë penicilinën që i bëhej, në ditët e ardhëshme morri një karakter intermitent.

U mjekua me noradrenalinë, penicilinë, ambramycinë etj. dhe duke mejtuar për një sindrom Dressler, me gjithë rrëtjen e madhe të indeksit të protrombinoës, nuk iu filluan antikoagulante, por më 6 qershor iu shtua delta korteni me doza të vogla : 15 mg/ditën. Të bazuar mbi të dhënët specifike të anamnezës, dhe cikatricet e mbeturë si pasojë e tyre, delta korteni u përdor nën mbrojtjen e streptomycinës, kurse më vonë iu shtua dhe izoniazid. Që ditën e parë të hormonoterapiës temperatura u ul nën  $38^{\circ}$  dhe brenda disa ditësh u normalizua; ndërsa ekzaminimi radiologjik i bëre po atë ditë, tregonte se zemra që e zgjëruar «in toto», kishte fenomene staze pulmonare, versament pleural dhe probabilisht perikardial.

Më 16 qershor delta korteni iu ul në 10 mg/ditën, por mbas 48 orësh

E. K. G. 28/VI/1962.



Voltazhi është ngritur në krahasim me ekzaminimin e mëparshëm. Ritmi Sinusal. Frekuencë 85-90/m. Aksi elektrik horizontal. Pozicioni horizontal. P-Q : 0.14"-0.16" QRS : 0.06". Q-T : 0.30".

T I, III, VL, VF, V<sub>5</sub>; V<sub>6</sub>; të sheshi T<sub>1</sub>, V<sub>1</sub>-V<sub>4</sub>; negativë me pamje koronariane.

Iskemi e murit anterior të miokardit.

hematemezë të vogël, prandaj iu ndërprenë antikoagulantet me-

pësoi një ngritje temperaturë deri  $37^{\circ}9$ , e cila u normalizua brenda 4 ditësh. Presioni arterial qëndronte midis 80/60 dhe 100-110/70 mm Hg. (R. R.).

Prej këtej kuptohet se nën veprimin e terapiës hormonale, u resorbua likuidi perikardial dhe u dukën më quartë shënjet e infarktit të murit të përparshëm, me gjithëse kuadri elektrokardiografik nuk ka qënë e mundur ti shkëputet plotësisht influencës së perikarditit.

Më 29 të atij muaji, gjatë natës, iu çfaq një trombozë e venës femorale të djathtë, për të cilën mjeku i rojës i kishëtë shtuar heparinë 4 herë 10.000 U dhe pelentan 2 herë në ditë nga 0.3, por që të nesërmen pacientja pati një

njëherë, aqë më tepër që kishim të bënim me një sindrom Dressler. Në vënd të tyre u lëshuan shushunjëza në nivelin e venës së trombozuar. Gjatë tromboflebitit temperatura iu ngrit deri  $39^{\circ}$ . U konstatua një leukocitozë  $17.800/\text{mm}^3$  me neutrofile  $75\%$ , dhe shkopinj  $6\%$ . Deltakortenit e ulëm në  $5 \text{ mg/dl}$  dhe e vazhduan deri më 31 korrik, kur ia ndërpremë përfundimisht. Gjatë kësaj periode temperatura u normalizua, presioni arterial u stabilizua rrathë  $110/80 \text{ mm Hg}$ , sedimentacioni ishte i lartë  $56 \text{ mm/l orë}$ , leukocitoza dhe polinukleozë u ulën, por u çlaq një eozinofili  $11\%$ , e cila në sa duket, më parë qëndronte e ulur nën veprimin e delta kortenit. Gjatë korrikut i kaluan fenomenet e tromboflebitit. Radioskopia nuk paraqiste asnjë ndryshim. Më 18 gusht të atij viti, pati përsëri një ngritje temperaturë deri  $39^{\circ}$ , leukocitozë  $14.000$ , sedimentacioni  $36 \text{ mm/l orë}$ ; në skopi u vu re një zgjërim i zemrës në të dy anët, tonusi qe i dobët, por në mushkëri nuk paraqiste ndryshime patologjike. Në ditët e para të shtatorit temperatura qe normalizuar, por në bazën e hemitoraksit të djathtë ndëgjoheshin fërkime pleurale të cilat tregonin se krahas riakutizimit të perikarditit qe prkur edhe pleura e asaj ane. Pastaj të gjitha simptomat i kaluan gradualisht, kuqitë e zemrës u zgogëluan, por mbeti tonusi mjaft i ulët, konfiguracioni aortal, një zhurmë e lehtë sistolike në majë dhe më 24 shtator të atij viti, mbas 119 ditësh, pacientja doli nga klinika në gjendje të mirë.

Edhe EKG e bërë disa ditë para daljes, megjithë ndryshimet që kishte bërë drejt normalizimit, vazhdonte të ketë disa të dhëna që flisnin për persistencën e ndryshimeve iskemike. Këto qenë  $T_{VF}$  i sheshtë dhe  $T_{II}, V_1 - V_3$ : negativë. Dhëmbët e tjercë T, si në derivacionet e tjera prekordiale ashtu dhe në standartet qenë pozitivizuar dhe kishin arrijtur lartësinë e tyre normale.

Nga të gjitha këto del se e sëmura u shtrua në klinikë dy javë mbas çfaqjes së infarktit të miokardit, atëhere kur filloj të zhvillohet eksudat perikardial. Nga fundi i javës së tretë, krahas perikarditit eksudativ u çfaq dhe një pleurit i thatë i anës së majtë dhe një vatër bronkopneumonike në regjionin aksilar të asaj ane. Në javën e katërt të sëmundjes, u konstatua versament në kavitetin pleural të majtë, d.m.th. se pleuriti i thatë u transformua në eksudativ. Javën e pestë, pati një riakutizim të lehtë të procesit, në fund të javës së shtatë tromboflebit, kurse javën e XIV-të riakutizim të perikarditit dhe pleurit të thatë në të djathtë.

Çfaqja e tromboflebitit, simbas mejtimit tonë, duhet të jetë favorizuar nga tre faktorë kryesorë: 1. Hiperprotrombinhemja dhe hiperkoagulabiliteti i gjakut që karakterizojnë çfaqjen e infarktit të miokardit. 2. Regjimi i shtratit që iu rekomandua pacientes. 3. Përdorimi i delta kortenit, megjithëse në doza të vogla.

Në fund të javës së XIV-të pacientja pati përsëri një riakutizim të pleuroprikarditit, mbas të cilit procesi u qetësua përfundimisht.

Damir A.M. dhe Sidoroviç S.H., Matusova A.P., Rajevskaja G.A. dhe Kazmina P.V., duke iu referuar punimeve të Dressler; vënë në dukje nevojnë e përdorimit të preparave hormonale, kurse antikoagulantet ky autor i konsideron të kontraindikuara, mbasi ka observuar një rast që gjatë mjekimit vdiq nga tamponada e zemrës, për shkak të hemorragjisë në kavitetin perikardial. Megjithatë, ky autorë që krahas preparave hormonale kanë përdorur edhe antikoagulante: Rajevskaja G.A. dhe Kazmina P.V. në dy raste, Cernjak N.G. në një tjetër, pa patur asnjë komplikacion hemorragjik. Ky i fundit citon punimet e Greenfield J.C. dhe Dillon M.L.


(1959), të cilët mohojnë rolin e antikoagulantave në çfaqjen e komplikacioneve hemorragjike gjatë këtij sindromi, si dhe të Nikolay J.H. që rekomandon ndërprerjen e këtyre preparateve, vetëm kur çfaqen shënjat e rritjes së versamentit.

Rasti i II-të: Sheko B. vjeç 68, shtepijake, u shtrua në klinikë më 31 mars 1962. Nr. Kartelës 2536.

Prej 15 vjetësh vuante nga sëmundja hipertonike. Tre muaj para se të shtrohej në klinikë, pati një krizë hipertonike për të cilën iu bë salas. Para dy javësh ndjeu dhëmbje të forta prekordiale që i përhapeshin në regjionin submandibular dhe skapular të majtë, në krahun dhe dorën e majtë, duke marrë karakterin e një ataku anginoz tipik. Ditën e shtrimit iu përsërit një akses tjetër, i shoqëruar me dispne, shtërmgim në grykë të përzjera, të marra mendësh, zhurmë në veshët dhe humbje të ndërgjegjes. Vizitohet dhe dërgohet urgjent në klinikë me diagnozën e shtrimit: «Myocardiosclerosis me komplikacion të lehtë cerebral. Lipothimia».

Kur u shtrua gjendja ishte e rëndë, cianotike, pulsi 105/m, aritmik, jo i mbushur mirë, kufitë e zemrës të zgjëruar, tonet e zemrës të shpejtë me ekstrasistola të vazhdueshme dhe një fërkim të perikardit që ndëgjohej gjatë sistolës dhe diastolës. Në bazën e hemitoraksit të majtë respirationi qe i dobësuar, kishte rale staze në dy regjionet interskapulovertebrale. Mëlcia prekej 4,5 cm nën harkun brinjor, pak sensibil në palpim.

E. K. G. 21/IV/1962.



Voltazhi pak i ulët. Ritmi sinusal. Frekuencia 100/m. Aksi elektrik horizontal. Pozicioni horizontal. P.Q: 0.14". QRS: 0.06". Q-T: 0.30". S-T V<sub>2-4</sub>: subdeniveluar. T I, VL, VF, të sheshtë. T III, V<sub>3-5</sub> negativë.

Konkluzion: Shënja iskemicë të pjesës anterolaterale të miokardit.

Kishte edema vetëm në regjionin sakral. Iu fillua mjekimi me penicillinë, oksigjen etj. dhe duke marrë parasysh shënjat e insuficiencës kardiovaskulare që paraqiste pacientja, iu shtua strofantinë.

Më 3 prill gjendja vazhdonte të jetë e rëndë, u përgjigjej pyetjeve me vështirësi, gjatë natës i qenë përsëritur ataket anginoze, iu çfaq një bradikardi 56/m, kurse presioni arterial ishte i ulët 105/60 mm.Hg. Mbës dite filloj të ankojë dhëmbje në bazën e hemitoraksit të majtë dhe hypokondriu e djathë. Pulsi nga bradikardik u ndrua në takikardik 112/m, presioni arterial u rrit në 145/85 mm.Hg., në

majë ndëgjohej një zhurmë e lehtë sistolike, kurse fërkimi i perikardit persistonte. Të nesërmen ndëgjoheshin rale subkrepitante në bazën e majtë dhe nga dreka iu çfaq një atak tjetër anginoz shumë i fortë, i cili kaloi vetëm me përdorimin e morfinës, atropinës dhe iu përsërit edhe më 5 prill. Më 6 prill kishte submatitet e rale subkrepitante në bazën e djathë. Radioskopja e kraharorit tregonte se zemra kishte formë të lehtë aortale, tonusi qe i dobët, pulsacionet superficiale. Vihej re minimal likuid në të dy sinuset frenikokostalë. Ndërsa në një ekzaminim radioskopik që pacientja kishte bërë ambulatorisht më 23 mars të atij viti, në mushkeri nuk paraqiste asnjë ndryshim.

Nga ekzaminimet e tjera komplementare vlen të përmëndet, se në analizen e gjakut të bérë më 24 mars, d.m.th. një javë para shtrimit në klinikë, paraqiste një leukocitozë  $13.200 \text{ mm}^3$ , me neutrofili  $70\%$ , ndërsa kur u shtrua leukocitet genë  $9.800 \text{ mm}^3$ , sedimentacioni  $10 \text{ mm}/1 \text{ orë}$ , por më 5 prill mbas përsëritjes së atakut anginoz u konstatua një rritje e leukociteve në  $10.800 \text{ me neutrofili } 79\%$  dhe sedimentacionin  $36 \text{ mm}/1 \text{ orë}$ .


Ekzaminimi i urinës në shtrim tregonte një albuminuri të lehtë  $0.13\%$ , leukocite 4-6/fushë dhe eritrocite 2-3/fushë. Kolesterinhemia  $330 \text{ mg}\%$ .

Temperatura që ishte subfebrile deri  $37^\circ,7$ , filloj të normalizohet, por mbas dy atakeve anginoze të 4 dhe 5 prillit iu ngrit përsëri deri në  $37^\circ,8$  dhe vazhdonte të jetë subfebrile megjithëse penicilina u kombinua me streptomisinë 1 gr. ditën. Brenda 4-5 ditësh u çdukën edemat sakrale dhe fenomenet e stazës dhe ne ia ndërprenë strofantinën menjherë. Nga data 11 prill, filluan të ndëgjohen fërkime pleurale në të dy bazat e kraharorit.

Duke marë parasysh se kishim të bënim me një paciente të kaluar në moshë, e cila prej 15 vjetësh vuante nga sëmundja hipertonike dhe që kishte paraqitur atake të forta anginoze të shoqëruara me ngritje temperature, leukocitozë me neutrofilli, rritje të sedimentacionit, uje të pressionit arterial, duke u bazuar mbi fenomenet cerebrale, të cilat nga mjeku i urgjencës qenë konsideruar si komplikacione cerebrale të hipertonisë, si dhe ndryshimet elektrokardiografike, i vumë diagnozën e infarktit të miokardit tek një paciente që vuante nga miokardioskleroza atherosklerotike me aritmi ekstrasistolike dhe insuficiencë kardiovaskulare të gradës së II-të A.

Por çfaqja e perikarditit me një fërkim që vazhdoi për një kohë të gjatë, me kufijtë e zemrës të zgjëruar dhe pulsacionet superficiale, nuk mund të interpretoheshin si një *pericarditis epistenocardica*, i cili çduket brenda pak ditësh. Gjithashtu çfaqja e dhëmbjeve në bazat e kraharorit, shoqërimi me likuid pleural dhe më vonë fërkimet pleurale bilaterale, temperatuta subfebrile etj., nuk mund të konsideroheshin vetëm si manifestime të thjeshta stazike, sepse pacientja nuk kishte ederme të anësive të poshtme, por vetëm të regjionit sakral të cilat i kaluan brenda 4-5 ditësh nën veprimin e strofantinës, kurse likuidi pleural u çfaq mbas çdukjes së edemeve, kështu që duhen interpretuar si pleurit eksudativ bilateral. Përsa u përket raleve subkrepitante, është më vështirë të thuhet në se ato i detyroheshin stazëz pulmonare ose ndonjë pleuropneumonie bazale. Të gjithë këta ndryshime të çfaqur njëri mbas tjetrit, të shoqëruar me ngritje të temperaturës, leukocitozë me polinukleozë, sedimentacion të lartë etj., na bënë të menjtojmë për sindromin Dressler dhe më 14 prill filluan mjekimin me delta korten 15 mgr. ditën. Që të nesërmen temperatura u ul dhe mbas tre ditësh u normalizua përfundimisht. Ekzaminimi

radiologjik tregoi se likuidi pleural dhe perikardial qe resorbuar brenda 10 ditësh. Zemra kishte një konfiguracion aortal dhe paraqiste të dhëna për sklerozë të aortës. Ky konfiguracion i detyrohej hipertrofisë së theksuar të ventrikulit të majtë, të zhvilluar si pasojë e sëmundjes hipertonike dhe duket qartë në elektrokardiogramën e datës 12 maj 1962:



Voltazhi i mirë. Ritmi sinusall. Frekuenca 80-85/m. Aksi elektrik horizontal. Pozicioni horizontal. Rrotullim kundra akrepave të sahatit. P-Q : 0.12" — 0.14". QRS : 0.06". Q-T : 0.30" — 0.32". S-T<sub>V3-5</sub> : të subdeniveluar.

T<sub>I</sub>, V<sub>L</sub>, V<sub>F</sub>, I, aVR në vijën izoelektrike. T III V<sub>3-5</sub> negativë.

*Konkluzion :* Shënja iskemicë të pjesës antero-laterale të miokadit dhe hipertrofi e ventrikulit të majtë.

dit u shqërua me A.C.T.H. Vlen të shënohet se në gjysmën e dytë të atij muaji, atëherë kur dozat e delta kortenit qenë zbritur në 5 mg./ditë, u konstatua një eozinofili prej 8%.

Gjendja e përgjithëshme shkoi duke u përmirësuar progresivisht, por fërkimet perikardiale ndëgjoheshin deri në gjysmën e dytë të prillit, ndërsa pleuralet persistonin dhe kur doli nga klinika, megjithëse më të pakta se më parë. Në dalje të dhënat e gjakut qenë normalizuar plotësisht.

*Rasti i III-të: Ramiz H.* vjeç 68, arsimtar, u shtrua në klinikë më 21 janar 1962 me diagnozën «myocardiosclerosis. Stenocardia?» Nr. i kartës 651.

Porsa u këthyte nga pazari në shtëpi, pa pritur i lilluan dhëmbje të

Po të krahsojmë dy elektrokardiogramat e më sipërme do të shohim se ndërsa në të parën nuk mund të flijet për hipertrøfi të ventrikulit të majtë, në të dytën ajo duket qartë. Kjo gjë shpjegohet me faktin se në fillim likuidi perikardial e ndryshonte konfiguracionin e zemrës, ndërsa më vonë me resorbimin e tij doli në dritë hipertrofia e ventrikulit të majtë dhe shënjat e iskemisë së miokadit; njëkohësisht u vu re një rritje e voltazhit dhe thellim i dhëmbëve T në derivacionet prekordiale, të cilët morën karakterin e dhëmbëve T koronarianë.

Delta korteni iu vazhdua deri në fund të majaqit, kurse 4-5 ditët e fun-

forta therëse në regjionin prekordial që iradioheshin në krahun e majtë, të vjella dhe u shpu urgjentisht tek mjeku i rojës të Spitalit Klinik Nr. 1.

Pacientit i kujtohej se në vitin 1922 kishte kaluar një «plevit», por nuk ishte në gjendje të tregojë në se ishte fjala për pneumoni, bronchopneumoni ose pleurit; para 30 vjetësh ishte operuar për nefrolitiazë. Anamneza familiare pa rëndësi. Pinte duhan një paqetë ditën.

Kur u shtrua qëndronte në pozicion ortopnoik, ndëgjoheshin rale staze në fushat pulmonare, por sinusel freniko-kostalë qenë të lirë. Tonet e zemrës ritmikë me një zhurmë sistolike në majë. Pulsi 80/m., T.A. 145/100 mm/Hg. Mëlcia palpohej 1,5 cm. nën harkun brinjor, por lobi i saj i maitë prekej mirë në pjesën e sipërme të epigastriumit dhe ishte i dhëmbëshëm.

Nga mezi i natës, dhëmbjet prekordiale ju përsëritën aqë sa mjeku i rojës qe detyruar ti bënte morfinë dhe atropinë.

Të nesërmen kishte temperaturë subfebrile, kurse të pasnesërmen ajo arriji në 38°. Presioni arterial, ditën e dytë të shtrimit zbriti në 125/75, kurse të tretën 115/70 mm.Hg. Në urinë nuk paraqiste ndryshime, në gjak kishte leukocitozë 12.200, me neutrofili 72%, sedimentacioni 11 mm/1 orë. Glicemja 1.60 gr.%, azotemia 0.50 gr.%, koha e protrombinës e përsëritur 2 ditë rrësht ishte 13". Më 26 të atij muaji leukocitoza vazhdonte të jetë 12.100, kurse sedimentacioni u rrit në 25 mm/l orë.

Të bazuar mbi këto të dhëna iu vu diagnoza infarkt i miokardit dhe iu rekomandua dietësi absolute duke mos lëvizur as për ekzaminimin elektrokardiografik.

U mjekua me morfinë, atropinë, penicilinë, eufilinë, kardiocinetikë etj. Që ditën e tretë të shtrimit, krahas me ngritjen e temperaturës filloj të ketë kollë të thatë, ndëgjoheshin rale subkrepitante dhe sibilante në të dy bazat e kraharorit. Penicilina iu kombinua me streptomycinë 1 gr. ditën.

Gjendja filloj të përmirësohet gradualisht, nuk kishte më akcesë anginoze, por vetëm një rëndim në regjionin prekordial dhe impirje të qafës; më 29 të atij muaji iu ul temperatura, kurse ralet subkrepitante ndëgjoheshin vetëm në bazën e majtë.


Temperatura vazhdoi të jetë normale deri ditën e XIV-të të shtrimit, pastaj u ngrit përsëri, megjithëse vazhdonte të jetë nën mbrojtjen e antibiotikëve. Filloj të ndiqjë palpitacione dhe dhëmbje prekordiale të lehta të cilat nuk përhapeshin, por kishin më tepër një karakter rëndimi. Në të majtë, jashtë aries kardiakë, ndëgjoheshin rale subkrepitante. Mbas 5-6 ditësh temperatura u ul, por më 9 shkurt leukocitet vazhdonin të ienë 9.000/mm³. Të nesërmen konstatuan se paraqiste një submatitet në bazën e majtë, respiracioni qe i dobësuar kurse në anën laterale dhe të përparrëshme të atij hemitoraksi, ndëgjoheshin fërkime pleurale dhe pleuroperekardiale.

Më 14 shkurt fenomenet e stazës iu ricfaqën dhe kishte dispine të theksuar, prandaj iu fillua strofantinë me doza të vogla 1/8 mg. Pesë ditë më vonë, fenomenet e bronkopneumonisë së majtë iu theksuan përsëri, megjithëse temperatura për shkak të gjendjes areaktive nuk u ngrit. I rritëm dozat e penicilinës, i shtuan kalii chlorati 3 gr. ditën etj. Mbas dite iu përsërit një atak anginoz i fortë dhe ra në gjendje kolapsi: pulsi 120-140/m, respiracioni 40/m, TA 95/65 mm Hg., paraqiste zbehje dhe cianozë, djersë të ftohta, ftohje të anësive etj. Me masat e marra, pacienti mundi të dalë nga kjo gjendje. Të nesërmen u konstatuan ndryshime në urinë: albuminë 0.13%, leukocite 1-2 për fushë, eritrocite 0-1,

cilindra hialine 8-10, cilindra epiteliale 0-1/fushë. Mbasi densiteti ishte 1031, këto u konsideruan më tepër si fenomene staze; veç asaj pacienti qe operuar pér nefrolitiazë para shumë vjetësh.

Në ditët e ardhëshme gjendja sa vinte rëndohej, fenomenet e insuficencës kardiovaskulare u theksuan ,u rrit mëlcia, u shtuan dispnea dhe cianoza, u çfaq meteorizëm i theksuar. Më 20 të atij muaji, tonet e zemrës qenë të dobët, pulsi filiform 140/m, TA ra përsëri 95 Mx., kurse Mn. nuk mund të përcaktohej me saktësi. Iu fillua noradrenalinë pika-pika intravenoz dhe në mbrëmje presioni arriji 105/80 mm.Hg.

E. K. G. 21/II/1962, e bërë në shtrat.



Voltazhi i ulët. Ritmi sinusal. Frekuenca 105-110/m. Aksi elektrik horizontal. P. : 0.10" pak i deformuar. P-Q: 0.14" — 0.16". QRS: 0.8" — 0.10". Q-T : 0.30". S-T I,II : në vijën izoelektrike. S.T III : pak i supradeniveluar. T<sub>I,II,III</sub> : të sheshtë.  
Konkluzioni: Shënja perikarditi.

Porsa ndalohej noradrenalina, presioni ulej përsëri, pulsi shpejtohej, bëhej filiform. Iu shtua ambramicinë, i jepej kohë mbas kohe oksigjen dhe narodrenalinë, vitamina, sondë rektale pér meteorizmin, i bëhej katerizimi i vezikës pér retencionin e urinës etj., por megjithë masat e marra, më 22 të atij muaji pacienti vdiq.

Diagnoza klinike: *Infarctus myocardii, myocardioaorto-sclerosis, insufficientia cardio-vascularis gr.II A. Bronchopneumonia sinistra. Pleuritis sicca sinistra et pericarditis sicca.*

Në autopsi u gjend një trombozë e trunkut të arteries koronare të majtë me një infarkt të gjërë të miokardit të lokalizuar në murin e përparshëm të ventrikulit të majtë me aneurizëm akut të zemrës, me trombozë globoze në vëndin e infarktit, të gjitha këto në bazë të një ateroskleroze. Përveç këtyre u konstatua perikardit adeziv, pneumoni kronike e lobit bazal të djathë dhe disa vatra bronkektazike bilaterale.

Edhe në dy nga tre rastet e paraqitur prej Rajevskaja G.A. dhe Kaz-

mëna P.V., perikarditi ishte shumë i përhapur dhe obliteronte gjithë kavitetin perikardial. Po këta autorë citojnë punimet e Stewart dhe Turner, të cilët kanë konstatuar gjatë infarktit, raste të tillë perikarditi reaktiv, që çonin deri në obliterim të kavitetit perikardial.

Të dhënët e elektrokardiogramës qenë shumë të varfëra, por ne të bazuar mbi klinikën e vumë diagozën e infarktit të miokardit. Megjithëse në EKG mungonin prekordialet, mungesa e shënjave tipike të infarktit duhet lidhur me ekzistencën e njëkohëshme të perikardit. Lidhur me këtë Verdun di Cantogno L.(1959), thotë se shpesh herë një infarkt masiv transmural, mund të shkaktojë një reaksion perikardik dhe në këtë rast mikrovoltazhi mund të vështirësojë vlerësimin dhe njohjen e shënjave të nekrozës.

Kuptohet vet-vetiu se një mundësi e këtillë ka qenë akoma më e madhe në rastin e pacientit tonë, ku infarkti shoqërohej me një perikardit adeziv që kishte prekur gjithë sipërfaqen e kavitetit perikardial.

Natyrisht është vështirë të thuhet me saktësi në se ky perikardit ishte pasojë e infarktit të miokardit, apo ishte i lidhur me të ashtuquajturin «plevit» që pacienti kishte kaluar në vitin 1922. Ne menjomë që supozimi i parë mund të pranohet më lehtë, mbasi në autopsi kishim të bënim më tepër me adezione të thjeshta midis fletëve të perikardit, pa shëniat e një pakieperkarditi konstriktiv, kurse pacienti nuk kishte patur asnjë shoqësim subjektiv gjatë gjithë kësaj periode 40 vjeçare.

Por dhe sikur të pranonim supozimin e dytë, çfaqia e fërkimeve pleuroperikardiale dhe pleurale jo që në fillim të sëmundjes, por gjatë evolucionit të saj, ve në dukje rolin që ka luajtur infarkti në zhvillimin e mëtejshëm ose akutizimin e procesit patologjik.

Nën veprimin intensiv të preparateve antibakteriale, bronkopneumonia e majtë u resorbuat, kështu që në autopsi mbeti një pneumoni kronike e djathtë, që është vështirë të interpretohet drejt koha e zhvillimit të saj.

Nga të gjilha këto që thamë, kuptohet rëndësia e madhe që ka njohja e këtij sindromi, aqë më tepër që dhe terapia është e ndryshme, sepse ndërsa në infarktet e zakonshme shumica e autorëve nuk rekomandojnë përdorimin e kortikosteroïdëve dhe indikojnë dhënien e antikoagulantëve, kurse në sindromin Dressler ngjet e kundërtat. Kështu që nga njohja e këtij sindromi dhe nga taktika terapeutike, shpesh herë mvaret jeta ose vdekja e këtyre pacientëve.

Megjithatë nuk mund të lëmë pa përmendur se si në dekadën e kaluar ashtu, dhe tashti, ka autorë që rekomandojnë përdorimin e kortizonikëve në infarktet e thjeshtë, kurse të tjera, në kundërshtim me pikëpamjet e Dressler, përdorin antikoagulanë në sindromin postinfarkt. Edhe përsa i përket kohës së çfaqjes së pleuroperikarditit gjatë këtij sindromi, të gjithë autorët pranojnë se ky zhvillohet jo më parë se javën e dytë mbas çfaqjes së infarktit, megjithatë ka autorë si Bouvrain Y. dhe b.p. që thonë se nga ky regull bëjnë përjashtim disa raste në të cilët sindromi mund të çfaqet vetëm 36-48 orë mbas infarktit të miokardit.

Është e kuptuëshme se me tre raste nuk mund të nxiren konkluzione, por megjithatë nuk mund të mos bjerë në sy fakti që të dy rastet e mjekuar me delta korten, pamvarësishët nga gjendja e rëndë, dolën nga klinika në gjendje të mirë.

Veprimi i mirë i këtyre preparateve, duhet lidhur me natyrën alergjike të këtij sindromi, aqë sa disa autorë sikurse Rajevskaja G.A. dhe Kazmina P.V., e kanë quajtur poliserozit alergjik të çfaqur tek të sémurët

me infarkt të miokardit. Lidhur me këtë, Matusova A.P. dhe autorë të tjera, kanë treguar se proteinat e serumit të gjakut gjatë infarktit të miokardit, pësojnë ndryshime shumë të afërta me ato të reumatizmit, gjë që flet në favor të natyrës alergjike të këtij sindromi.

(Paraqitur në Redaksi 5-X-964)

#### B I B L I O G R A F I A

- 1) Bouvrain Y. e coll. Le pleuro-pericarditi consecutive ad infarto miocardico. Actual. Cardiol. Angeiol. Int. 1962, 11, 105 (Marrë nga Minerva Medica 1963, 54, 14, 479.)
- 2) Černjak N. G. Siluçaj postinfarktnovo sindroma. Terapevtičeskij arhiv, 1962, XXXIV, 7, 94.
- 3) Damir A.M., Sidorović S.H. Postinfarktnij sindrom. Terapevtičeskij arhiv, 1961, XXXIII, 7, 3.
- 4) Matusova A.P. O klinike i patogeneze tak nazivajemovo postinfarktnovo sindroma. Kliničeskaja medicina, 1961, XXXIX, 7, 78.
- 5) Paunescu-Podeanu A., Munteanu M. Locul corticozilor în terapeutica infarctului miocardic. Medicina internă 1963, XV, 4, 389.
- 6) Rajevskaja G.A., Kazmina P.V. Allergičeskij poliserozit u balnih infarktom miokarda. Sovjetskaja medicina. 1962, XXV, 3, 24.
- 7) Verdun di Cantogno L. Manuale di elettrocardiografia clinica. Edizioni Minerva Medica. 1959, 452.

#### POST MYOCARDIAL INFARCTION SYNDROME DRESSLER SYNDROME

(Summary)

After a brief survey of the literature, the author presents three cases of a postinfarcical syndrome.

The first patient was a woman 55 years old, who was accepted in the hospital two weeks after the infarction, when she began to develop pericardial exsudation. At the end of the third week she had pleuritis sicca on the left side and a focus of bronchopneumonia on the axillar region of the same side. In the fourth week was discovered some exsudation on the left pleural cavity, in the fifth she had a light reacutisation of the process, at the end of the seventh week thrombophlebitis of the right femoral vein, and in the fourteenth week a serious reacutisation of the pericarditis and pleuritis of the right side.

During the night when thrombophlebitis developed, the doctor on guard began a treatment of heparin 10,000 units every 6 hours and pelentan 0.3 twice a day, but the following day she had haematemesis, for which reason the treatment with anticoagulants was discontinued and bleeding was applied.

The second case, a 68 year old woman with hypertension from 15 years. Two weeks after the infarctus she had pericarditis exsudativa and pleuritis exsudativa on both sides.

In both cases the treatment with corticosteroids gave good results.

The third case, a man 68 years old, whose disease was diagnosed as myocardial infarct, bronchopneumonia on the left lung, pericarditis, pleuritis sicca sinistra, and at the necropsy was discovered also a pericarditis adhesiva. The co-existence of infarctus with pericarditis makes the electrocardiographic picture very poor.

The last case was not treated with hormonal preparations, since the diagnosis of the syndrome of Dressler was made retrospectively.

## NJË RAST I RALLE ENDOCARDITIS BACTERIALIS MALIGNA SILENS

SHERIF KLOSI

Spitali Klinik Nr. 1 Tiranë — Ercjtori Spitalit Dr. Sherif Klosi

Mbas luftës së dytë Botnore, në vitet 1945-1950, në Gjermani dhe në vendet e tjera të afërme të Lindjes, sipas W. Trummer, nga shkaku i vuajtjeve të shumta fizike, jo vetëm në ushtarët, por edhe në popullatën që u godit rëndë, pati një ritje të theksuar të *endocarditis bacterialis*. Një-kohësish në këtë periudhë vazhdoi me sukses edhe shtimi i prodhimit të disa antibiotikëve bazë si penicilina dhe streptomicina, u zgjerua dhe gama e tyre në përgjithësi. Ky sukses nxiti që në shumë vende të përparruara t'i jepet një rëndësi e madhe studimit të kësaj sëmundjeje të rezikëshme, e cila para epokës së antibiotikëve konsiderohej e pashërueshme. Pra për të mjekuar me kohë dhe mirë *endocarditis bacterialis* e sidomos *maligna*, lypset diagnostikë e shpejtë dhe terapi energjike me antibiotikët përkatës. Mirë po shumë raste të *endocarditis bacterialis acuta* paraqiten me simptomatologji të ndërlikuar, që vështirëson mjaft diagnostikimin. Dihet se kjo sëmundje ka një zhvillim të rëndë, me një kuadër tokso-infektivë shumë të theksuar, me anemi të madhe, me mundësi vendosje septiko-pioemike në disa organe dhe inde, temperaturë të lartë remitente, leukocitozë neutrofilike të lartë, dëmtimi me rëndësi të veshkave e tjera. Një gjë tjetër që vihet re në *endocarditis bacterialis acuta*, është se dëmtimet endokarditike vinë në radhë të dytë në krahasim me gjendjen e keqë të pacientit dhe gradën septiko të sëmundjes. Lezionet e endokardit, shpesht herë keqështen shumë shpejt, me dëmtime të rënda të pariparuara të valvulave; në ndonjë rast lezioni i endokardit zhvillohet në mënyrë aqë t'ë qetë në krahasim me sepsin e përgjithësuar, sa që rastësisht e konstatojmë atë në repertin nekropsik. Karakteristikë që bije në sy e këtyre formave është septicemija e theksuar dhe e qëndrueshme, për të cilën, hemokultura si regull është pozitive që në ditët e para dhe për gjithë periudhën që të zgjasë sëmundja.

Shkurt, duhet të dimë se kemi të bëjmë me një sëmundje shumë të rëndësishme ku faktori lïdhur me bakterin luan një rol të dorës së parë në drejtim të kuadrit klinik (sepsis), të repertit laboratorik (leukocitoza, hemokultura pozitive e tjera) dhe të terapisë (sensibiliteti ndaj antibiotikëve — antibiograma — dhe nëse antibiotiku është baktericid).

Në përcaktimin klinik të *endocarditis bacterialis acuta* kanë shkruar mjaft auktorë të dëgjuar të vjetër dhe të rinjë si për shembull: Levin, Kerr, Freidberg, Scherf, Dogliotti, Lenti etj.

Rasti që po përshkruajmë na duket si nga ata të rrallët që meriton vëmëndje.

Dhos N.B., me kartelë klinike Nr. 2537, 23 vjeç, bujk, u transferua nga spitali i Fierit në spitalin tonë me 3/4/1961.

Ankime: Në hyrje pacienti ankonte dobësi të theksuar, shpesht herë

dhibanje prekordiale, me palpitatione kardiake, epistaksis tē shpeshtë, temperaturë tē lartë ( $39^{\circ}\text{C}$ ) remitente me tē dridhura. Që prej disa ditësh, herë pas here ndjente dhibanje abdominal, e cila përqëndrohesh më tepër në hipokondrin e mëngjërt, e shoqëruar me tē vjella, tē cilat në ditët e qëndrimit në spitalin tonë vinin duke u shtuar.

*Anamnesis Vitae:* Lindur dhe zhvilluar normalisht, nuk i kujtohet tē ketë kaluar ndonjë sëmundje me rëndësi si në fëmini dhe gjatë jetës së tij. Është i pa martuar, nuk pi duhan as pije alkolike.

*Anamnesis Morbi:* Bënte një jetë aktive me punë energjike deri në Janar të vitit 1961, kur u sëmur pér afro 10 ditë resht nga një grip i parëndësishëm, siç rezulton nga anketa e anamnezës dhe nga familiarët, dhe pas disa ditësh filloj tē ketë shqetësimë në syrin e djathtë me pakësim tē pamjes. Pér këtë u vizitua me tē shpejtë në Vlorë nga mjeku okulist, i cili konstataoi se vuante nga *Irido-cyclite* tē natyrës probabilisht rheumatike, me *seclusio-occlusio pupillæ* tē syrit tē djathtë dhe si konsekuençë kishte humbje tē pamjes. Nga disa barma paliative nuk pati efekt, prandaj u rivizitua prapë atje dhe mjeku këtë radhë i shtoi dhe penicillinë; por me gjithë këtë gjendja e përgjithëshme shkonte keq dhe humbja e pamjes e njëllojtë. Me sa na rezultoi, edhe me këto mjekimë ambulatorë, i sëmuri nuk pati përmirësimë tē kënaqëshme, kështu që u detyrua mbas 2-3 javësh tē vijë në Tiranë tē rivizitohet, ku pas një mjekimi me antibiotikë më energjikë, shqetësimet e syrit u përmirësuan dhe pacienti filloj tē shkonte më mirë me syrin e djathtë, ku pamja ishte dobësuar. Në këtë gjendje vazhdoi pér afro dy muaj, kur ay ndjeu dhibanje tē forta në artikulacionet e duarve dhe tē këmbëve aq sa i lëvizte me vështirësi, i dhimbte fyt; ndjente dhibje dhe palpitatione prekordiale, kishte temperaturë tē lartë intermitente deri në  $39^{\circ}\text{C}$ , mbas dite me tē dridhura, me djersë, në mëngjes temperatura ishte më e ulët. Veç këtyre simtomave, pacienti kishte vënë re se urina ishte e kuqereme, akuzonte dhibje edhe gjatë nervave sciaticë. Në këtë gjendje ay u shtrua në spitalin e Fierit me kartelë Nr. 529 datë 23/3/1961. Gjatë dekursit në spital, pacienti vazhdoi tē keqësohej, humbi apetitin, kishte temperaturë tē lartë remitente, herë pas here epistaksis dhe skuzonte dhibje tē forta prekordiale në formë aksesesh. Pas një javë, filloj tē dëgjohesh një zhurmë e lehtë sistolike në majë.

Gjatë qëndrimit në spitalin e Fierit, në ekzaminimin e urinës: Albumin, trace, leukocite 2-4 pér fushë. Gjaku: leukocite 6.700, eritrocite 3.930.000, eritrosedimentacioni 26 m/m në orë.

Këtu u mjekua me : Penicillinë 400.000 UI x 2 në ditë, Streptomycinë 0.5 gr x 2 në ditë, Vitaminë B+C, sulfamide 0.5 x 6, Atophan 1 amp. në ditë, aspirinë 0.50 x 4.

Me mjekimet që iu bënë atje si më sipër, në tē vërtetë, tē sëmurit dhibjet e artikulacioneve i u pakësuani dhe filloj t'i lëvizte më mirë ato, kurse përkundrazi, gjendja e përgjithëshme vazhdonte tē keqësohej, epistaksi përsëritesh njësoi, ngjyra e lëkurës po bëhes më e zbehtë temperaturë e pandryshuar. Në këtë gjendje pacienti u transferua në spitalin tonë.

Në ekzaminimin objektiv në hyrje u konstatua : gjendja e pacientit e rëndë; ay pér shkak tē dhibjeve që ndjen në hipokondrin e majtë ishte i detyruar tē qëndronte në një pozicion tē detyruar, pak i përkulur nga e majta; kishte pamjen e një tē sëmuri tē intoksiuar, anemik, ngjyra e lëkurës dhe e mukozave tē dukëshme e zbehtë.

Në pulmone nuk vrehet ndonjë gjë me rëndësi.

*Ap. Kardiovaskulare:* Në perkusion zemra dukesh me kufi normale, në auskultacion dëgjohesh një zhurmë e lehtë sistolike në majë, tonet ishin pa ndonjë çrregullim patologjik. Pulsi 80-90 në minutë, ritmik i plostë, T.A.: 110/60.

*Ap. Trete:* Gjuha pak e ngarkuar, në ekzaminimin e gojës, në dhëmbët dhe tonsilet nuk vrehet ndonjë gjë me rëndësi. Barku i butë, në prekje ishte pak i dhimbëshëm, sidomos në hipokondrin e majtë, ku lieni ishte i zmadhuar 2 cm. nën harkun kostal, i dhimbshëm dhe i butë. Hepari nuk prekesh. Në prekjet e llozhave renale prap ndjente dhimbje nga e majta ku Pasternackij ishte pozitiv.

Nuk kishte edemë në artet e poshtme.

Temperatura vazhdimit ka qënë  $38^{\circ},5 - 39^{\circ},4$  intermitente.

*Ekzaminimet Komplementare:* Në ekzaminimin radiologjik të aparatit kardiovaskular nuk vrehet ndonjë gjë me rëndësi, kjo u vërtetua dhe në radiografi.

Azotemia më 7/4/1961: gram 1.40%.

Gjaku: Eritrocite 3.020.000, Leukocite 14.800, Eritrosedimentacioni 46 m/m në orë. Formula: Bazofil —, Eo. 7, Shkop. 4, te seg. 74, limfocit 12, mon. 3.

Koha e hemoragjisë 10', koha e koagulimit 4'.

Trombocitet 220.200.

Urina: densiteti 1010, Albumina gr. 033%, leukocite 15-20 për fushë, eritrocite me shumicë, ka cilindra granulare 2-4 për fushë.

Neve duke u orientuar nga një gjendje septike e rëndë prej një absesi subfrenik nuk vlerësuam sa duhet ato pak të dhëna që duhesh të na bënë të shpejtonim edhe për një E.K.G., ekzaminimin e fundus oculi dhe hemokulture; dhe kjo është arsyaja që në të vërtetë nuk arritëm t'i kryenim këto ekzaminime, të cilat mund të na ndihmonin në diagnostikimin e shpejtë të rastit tonë.

Me një herë iu fillua terapia me penicillinë bashkë me streptomycinë, transfuzion gjaku, solution glucoze, kardiotonikë, vitamina. Tre ditët e para gjendja dukej sikur ishte e pandryshueshme; Ay ankonte pothuaj të njëjtat shqetësimë që pati në hyrje, përvëç epistaksit, i cili pas pastrimit të hundës dhe tamponimit nga otojatri, u rrallua. Kjo gjendje vazhdoi deri më 6 prill 1961 ora 13, kur gjendja e pacientit u keqësua shumë. Temperatura u ngrit më lart, në hypokondrin e majtë iu shtua shumë dhimbja, e cila theksohet më tepër gjatë inspiracionit dhe në palpacion vrehesh rezistencë muskulare. Në këtë kohë në perkusionin e toraksit, në bazën e majtë vrehesh një submatitet që nga brinja e 7 e poshtë. Në perkusionin e këtij matiteti të hemitoraksit, u tërhoqën 3 cc likuid i turbullt. Që nga kjo orë iu shtua sasia e penicillinës në 6 milion UI në ditë bashkë me një gram streptomycinë. Kështu u vendos t'i vazhdohej mjekimi intensiv për suspekt të një absesi subfrenik me sepsis të përgjithësuar. Me datën 8/4/61 gjendja u keqësua edhe më tepër, defansi abdominal u bë më i theksuar dhe në konsultë me kirurgun (F. Papariston), u mendua për të njëjtën diagnozë dhe u vendos laparatomia. Pacienti urgjentisht u transferua direkt në sallën e operimit në Spitalin Klinik Nr. 2. Në këtë kohë tek pacienti, veç të tjerave që thamë më lart, vreheshin: gjuha ishte e thatë, e kuqe, pulsi i dobësuar 115 në minutë, temperatura vazhdonte e lartë, Blumberg pozitiv, prekjet në regionin e lienit shumë të dhimbëshme, ka të vjella të vazhdueshme. Gjendja preoperatore paraqitet shumë e rëndë me facies toxică.

Në laparatomni nuk kishte likuid të lirë në abdomen, lieni i zmadhuar lehtësisht, me konsistencë jo uniforme, vende-vende i butë dhe vendë-vende i fortë, i ngjitur me shumë aderenca në kupolen e diafragmës. Ngjyra e lienisit lara-lara nga cianotikë blu në të verdhë. Arteria lienale nuk pulson, venat e hilusit lienal të zgjeruara. I u bë splenektomia.

Diagnoza operatore makroskopike : *splenomegalia trombo-flebitica*.

Operacioni u krye nga doc. F. Paparisto dhe T. Theodhoshi.

Ekzaminimi anatomo-patologjik i shpretkës pas splenektomis:

Splina me dimensione të zmadhuara (1,1/2 herë). Në prerje pulpa paraqet nuanca ngjyrash, zona të bardha të rethuara me korone hemoragjike, alternojnë me pjesë të pulpës normale, ngjyra vishnjë të erët, zonat e bardha kanë formë trikëndëshe me konus të drejtuar nga hilusi i organit. Pra ky aspekt morfologjik i splinës paraqet tablonë e infarkteve multiple të madhësive të ndryshme të këtij organi që ka marë aspektin e hartës gjografike (shif foto Nr. 1). Natyra e këtyre infarkteve siç rezulton nga trombozat multiple të arterieve të vogla të pulpës kanë natyrë trombo-embolike. Nga ekzaminimi mikroskopik u konfirmua plotësisht origjina e sipërpermendur e këtyre infarkteve, dhe nuk qe e mundur të dokumentohen të ashtuquajturat «absceses» të përshkruara makroskopikisht nga kirurgët. Prandaj mendojmë se punksioni splenik bërë para operacionit na dha neve material *detritus necroticus* dhe jo eksudat purulent.



Foto Nr. 1

Pas operacionit, deri me datën 10 prill gjendja vazhdon të jetë shumë e rëndë, pacienti nuk ka urinuar, gjuha mbetet e thatë, nuk ka më të vjella, koshienca e pacientit vazhdon të jetë e kuartë, ka lemzë, dispne, pulsi filiform. Me datën 10 prill leukocitoza u rrit në 27.000 dhe azotemia në gr. 1.70%.

Me gjithë mjekimet pacienti vdiq më 11 prill 1961, me diagnozë klinike post-operatore: Infarkte multiple të lienisit me absese multiple, nefrite toksike, anuri.

Autopsia nga anatomo-patologu (Doc. P. Bitri) ve në dukje:

Zemra me kufi të zgjeruar kryesisht në drejtim transversal; në kavitet atiale dhe ventrikulare sasi abondante koagulash të përzjera. Muskulatura e zemërës me konsistencë mjaft të butë, ngjyra e saj kafe e zbehtë. Kaviteti ventrikular i majtë, i zgjeruar së tepërmë mbi endokardin valvular mitral, në drejtim të *linea Jucstamarginalis* vihen re formacione trombotikoverukoze të freskëta që prominojnë mbi sipërfaqen e valvulave dhe me madhësi të ndryshme, endokardi i paretit atrial të majtë duket sikur ka humbur shkëlgimin e zakonshëm, paraqitet i turbullt. Formacionet trombotiko-polipoze të freskëta, me dimensione më të mëdha të përshkruara në valvulat atriale, u konstatuan edhe mbi valvulat semilunare-aortale. Vazet koronare me lumen të lirë. (Shif foto Nr. 2 e Nr. 3). Renet me dimensione të zmadhuara, formë e zakonshme, konsistencë mjaft e butë, kapsula hiqet lehtësisht, sipërfaqja e lëmuar, me *venulae stellatae* të hiperemuara, mbi sipërfaqen vihen re pikë difuze të rralla hemoragjike, ashtu dhe në prerje; kryesisht në substancën kortikale vrehen disa grimca



Foto Nr. 2




Foto Nr. 3

të vogla të bardha-gri si pluhur mjaft i imët i shpërdarë në parenkimën renale. Mukoza e pelvisit renal manifeston pikë të kuqe hemoragjike. Ureteret dhe vesika urinare pa veçorira patologjike. Diafragma nga ana e majtë në sipërfaqen abdominale të sajë paraqitet hyperemike, e ashpër, dhe me disa formacione fshikzash të sipërfaqëshme. Në kavitetin pleural të anës së majtë mbi pleurën vishrale, kryesisht të lobit bazal, u vunë re formacione fibrinoze të verdha në të bardhë që shkiten lehtësisht. Pulmoni i majtë në një sektor të lobit bazal paraqet një zonë kompakte të erët, e cila ka formën në prerje të një trekëndëshi me bazë nga pleura vishrale, ngjyrë të kuqe vishnje, e thatë, me dimensione të një arre.

Në organet e tjera vishrale nuk u konstatuan lezione patologjike që vlejnë të shënohen.

*Diagnoza anatomo-patologjike : Status post-splenectomy. Endocarditis verrucosa valvulae mitralis et endocarditis verrucoso-poliposa valvulae semilunaris aortae. Nephroso-nephritis acuta. Infarctus ruber lobi inferior pulmoni sinistri cum pleuritëm fibrinosam incipientem.*

#### Diskutimi dhe konkluzioni:

Nga studimi i këtij rasti del se kemi patur të bëjmë me një *endocarditis acuta ulcerosa* (maligna), e cila ka qënë burimi i embolive, në fillim në vazot e retinës të syrit të djathjtë, pastaj nëlien dhe në veshkat, duke dëmtuar këto organe dhe shkaktuar njëkohësisht një sepsis të rëndë.

Rastet e endokarditive bakteriale, që manifestojnë si shenja të para lezione embolike të arteriave centrale të retinës janë shumë të rralla, siç rezulton nga literatura që kemi patur mundësi të konsultojmë.

Lezionet e *valvulae mitralis*, me sa duket në fillim nuk kishin shkaktuar dëmtimet e tyrc aqë sa klinikisht mund të dëgjohesh ndonjë zhurmë patologjike në funksionin e zemrës, dhe pacienti nuk ankonte ndonjë shqetësim. Ky *endocarditis bacterialis silense*, çfaqjen e tij të parë e dha me humbjen e pamjes në syrin e djathjtë që në janar të vitit 1961; pa ndonjë simtomatologji tjetër, mirë po nuk u thelluam për të studiuar më imtësisht pacientin që në shenjat e para të janarit, nga se shkaktohesh kjo ulje ë pamjes në një sy e të tjera. Edhe në mars kur u shtrua në spitalin e Fierit, dhe sëmundja kishte një zhvillim më të avancuar, prapë studimi i pacientit nuk ka qënë i plotë. Nga kjo anë edhe në spitalin tonë, sepsis i rëndë dhe ankimet në regjionin splenik na dizorientuan për disa ekzaminime të domosdoshme si hemokultura, mielokultura, ekzaminimi i syrit, E.K.G. e të tjera, dhe keqësimi shumë i shpejtë i pacientit na gaboi. Ky kuadër septik me dhimbje të forta në hipokondrin e majtë, që na orientonte për

një sepsis kriptogjen, siç u mendua për abses subfrenik sinister, na bëri që anamnezën e kaluar të mos e vlerësonim drejt, dhe suflin e lehtë sistolik që ndigjohesh në javën e fundit ta intepretonim si funksional.

Vërtetimi nekroskopik *Endocarditis ulcerosa maligna*, që siç e pamë u zhvillua në formë *silense*, duhet të na nxiti, që në raste të tillë të kemi parasysh edhe ato të pakta simtoma, të cilat janë sinjalizimet e para të fshehta, që shpesh nuk i vlerësojmë sa duhet për të orientuar nga endokarditet septike, sidomos akute, dhe nuk interpretohen ndryshe.

(*Paraqitur në redaksi më 20/9/64*)

#### BIBLIOGRAFIA

- 1) *Freidberg* Les maladies du coeur. Vol. I ff. 674-683.
- 2) *Levine* Cardiologia Clinica ff. 227-246.
- 3) *Scherf* Malattie del cuore e dei vasi — 1957.
- 4) *Kerr A. Fr.* Subacute Bacterial Endocarditis 1955.
- 5) *Dogliotti G., Lenti G.* Mbi mjekimin me antibiotikë të Endocarditis septica lenta. Minerva Medica Nr. 25 Mars 1958.
- 6) *Trummer W.* Endocardite maligne lenta. XXXI Congres français de medicine. Paris 1957. ff. 158-162.
- 7) *Lenti G., Tartarolo E.* Aspetti evolutivi delle Endocarditi batteriche suacute. Giornale delle malattie infettive e parassitarie. ff. 162-180.

#### A RARE CASE OF SILENT MALIGNANT BACTERIAL ENDOCARDITIS

(Summary)

A rare case of silent malignant bacterial endocarditis is describet in a patient, 23 years old; the disease developed without discernible clinical symptoms. The first symptom that appeared was the loss of sight of the right eye as a result of an embolus in the retineal artery. Later the state of the patient as aggravated by multiple splenic abscesses, for which splenectomy was applied. At the autopsy it was confirmed that these manifestations were caused by an endocarditis bacterialis maligna, which developed without apparent clinical symptoms of the cardio-vascular system.

## TUMORET GJIGANTO-CELULARE TË GJANDRËS TYROIDE (Paraqitja e dy rasteve anatomo-patologjikë)

### PULLUMB BITRI

(Katedra e Patologjisë Përgjitheshme Shef Doc. PULLUMB BITRI)

Tumoret malinje të gjandrës tiroide në përgjithësi janë të rralla. Frekuencë e tyre në regjonet endemike strumogjene shtohet. Simbas Hedinger, tumorët malinje të tiroides janë gjetur në 7% të të gjitha autopsive. Aspekti histologjik i tumoreve të tiroides ndryshon simbas rastit: ndërmjet tumorit klinikisht malinj, me formën e një adenome të thjeshtë dhe të një epitelioime ku e gjithë pamja e tiroides është transformuar krejtësisht, qëndrojnë një seri tipesh intermedjarë (Foot, Welti, Cabanne); epiteliomat me strukturë krejtësisht të transformuar ose epiteliomat atipike, në të cilat është e pa mundur me njohtë origjinën nga tiroidea, janë tumore të rralla (Frantz, Roussy, Lerouz, Oberling, Levitt, Nassif, Chevrel) dhe që në literaturën mjekësore janë cilësuar me emër të ndryshëm: *carcinoma sarcomatodes* (Levitt, Hedingher), *sarcoma carcinomatodes* (Cavallero), epiteliomë atipike (Roussy, Lereux, Oberling). Ky grup tumoresh, është relativisht i rrallë; simbas Frantz vihet re. vetëm në 15% të të gjitha rasteve të tumoreve malinjë të gjandrës tiroide.

Në këtë punim dëshirojmë të diskutojmë pikërisht për këtë lloj tumori me genë se në stolin e autopsisë e kemi hasur dy herë.

Frantz në studimin e tij anatomo-patologjik mbi tumoret e gjandrës së tiroides konstaton ekzistencën e tre llojeve kanceresh: një lloj janë tumoret malinje me strukturë adenomatoze, që shpesht quhen me termin «adenoma malinje» (Foot). Lloji i dytë përmblledh tumoret me diferencim të moderuar. Lloji i tretë janë tumoret e pa diferencuar me malinjitet të shkallës së lartë të cilët janë cilësuar me emra të ndryshëm; këto tumore zhvillohen shumë shpejtë dhe shkaktojnë vdekjen nga fenomene të komprimit dhe të infiltrimit lokal. Rastet tonë janë:

I. — Gj.B. femër, vjeç 42, kartela klinike Nr. 4410, spitali Nr. 2; vdes me datë 5/XI/1962; protokolli i autopsisë Nr. 86.

«E sëmura ka 15 vjet që vuani nga struma, muajin e fundit filloj t'i rritet shumë dhe shpejtë». Nga ekzaminimi anatomo-patologjik u konstatua se tumori i gjandrës tiroide me një aspekto nodular ishte zhvilluar duke komprimuar trakenë në një të tretën e sipërme të saj kaqë shumë sa që provokon asfiksinë. Gjatë autopsisë u vunë re metastaze tumorale në nyjet limfatike regionale cervikale dhe submandibulare, infiltrimi i paretit të trakesë; metastaze të vogla dhe të rralla u gjendën në pleurën visheralë si dhe në thellësi të parenkimës pulmonare të dyja pulmoneve.

II. — D.T. mashkull, vjeç 52, kartela klinike Nr. 299, spitali Nr. 2; vdes me datë 29/I/1964. Protokolli i autopsisë Nr. 8.




«Sëmündja i filloj para dy muajve; i sëmuri vuri re një nyje sa një arrë e cila ardhë duke u rritur shumë shpejtë».

Nga ana makroskopike masa tumorale me aspekt modular në pjesën

e përparëshme të gushës dhe pak lateralisht, me dimensionet e kokrës së ftoit, ka konsistencë relativisht solide, komprimon gati krejt ezofagun dhe ka infiltruar trakenë në nivelin e gjéndrës tiroide. U vunë re metastaze në limfonodulet cervikale, në hepar, si dhe në endokardin e ventrikulit të djalitët në formë vegetacionesh polipoze (Makro-foto Nr. 1).


Duke studjuar si njërin rast ashtu edhe tjetrin nga ana histo-patologjike na tërroqën vembnjën këto cilësira: polimorfizma e theksuar e celulave: krahas celulave të vogla vëmë re celula mjaft të mëdha, gjigande me nukleuse hiperkromatike dhe me mitoza të shumta dhe të çuditëshme (Mikro-foto Nr. 1). Në të dyja rastet konstatojmë celula gjigante multi nukleare me nukleuse gjithashtu hiperkromatike. (Mikro-foto Nr. 2) metastaza e tumorit në endokardium; preparat nga rasti Nr. 2).

Një cilësi tjeter që na bie në sy në materialin tonë është dhe fenomeni i metaplazisë në celulat e tumorit: p.sh. në disa preparata celulat kanë pamje fuziforme, kaq tipike sa i ka detyruar shumë autorë t'i konsiderojnë si sarkoma të gjandrës tiroide (mikro-foto Nr. 3).



Por mbi të gjitha celulat gjigante myltinukleare dominojnë indin tumoral në preparatet tonë: aspekti mikroskopik i tyre nuk është i një illojtë: krahas formave të celulave gjigante më shumë nukleuse, me një atipizëm të theksuar vihen re celula gjithashtu gjigante dhe multinukleare, por gati pa fenomene atipizmi nuklear (Mikro-foto Nr. 4), që mund të krahasohet me celulat në epulide. Ky fenomen është hasur më tepër në preparatet e rastit Nr. 1. Por në të njëjtën kohë në zona të tjera vihen re celula gjigante multinukleare më të pa pjekura sikurse vumë re në mikro-

foton Nr. 2, dhe po i njëjtë preparat i zmadhuar në mikro-foto Nr. 5, që me të vërtetë justifikojnë shprehjen e njojur të «Kancerit gjiganto cellular të gjëndrës tiroide».



\* \* \*

Carcinomat e gjëndrave tiroide, pamvarësish nga struktura e tyre histologjike gati si rregull lindin në terren të adenomave të tircidës, ose në terren të strumave të ndryshme, prandaj nën këtë aspekt duhen shikuar nga klinicistët shumë sëmundje të kësaj gjendre, sepse strumektomia ose adenomektomia e herrët, eviton kancerizimin e tyre.

(*Paraqitur në redaksi më 5/IX/64*)

#### BIBLIOGRAFI

1. — Cabanne F, et coll; Le sarcome squelettogene du corps thyroïde. Ann. Anat. Pathol. 1959, T. 4, N. 1, p. 136.
2. — Cavallero C; Anat. Patologica 1956, p. 527.
3. — Chevrel M.L, et coll; L'Epitheliosarcoma Thyroidien. Arch. d'Anat. Pathol. 1959, V. 7, N 1, p. A. 19.
4. — Welti H, et coll; Un cas d'epitheliome du corps thyroïde chez un fillette de 13 ans. Arch. Anat. Path. 1959, V. 7, N 1, p. A. 82.
5. — Werner C; The Thyroid a fundamental and clinical text. 1957 (Përkthim rusisht 1963).
6. — Hedinger Chr.; Citue nga Labhart A.
7. — Labhart A; Klinik der inneren sekretion (Përkthim italian 1960, p. 314).
8. — Nassif N, et coll; Une type special de cancer de la thyroïde: l'epitheliosarcoma sclerosant occulte. Ann. Anat. Path. 1962, T. 7, N 4, p. 615.

8. — Roussy G; R. Leroux — Ch. Oberling. *Precis d'anatomie Pathologique*. 1950 p. 1218.
10. — Levitt Tobias — La tiroide 1955.
11. — Frantz V.K. *Citue nga traktati i Werner*.
12. — Foot N; Identification of tumors (Pérkthim Rusisht 1948).

### Gigantocellular tumors of the thyroid gland.

#### (Summary)

The author presents two cases of gigantocellular malignant tumors of the thyroid gland, discovered during the autopsy. He analyses them from the histopathologic view point, which shows pronounced malignant features with polymorphism, cellular metaplasia, sarcomatous characters together with gigantic multinuclear cells, which, as may be deduced for these cases from their microphotographies, are cells in evolution: from simple multinuclear characteristic for epulis, to monstrous non-differentiated gigantic cells. The author points out that one of the cases has had goiters from a long time, and he supposes that it may have undergone a malignant degeneration, a possibility that should be kept in mind in endemic regions of goiters.

## RASTE HELMIMESH ME KËRPUDHEN AMANITA PHALLOIDES

### KATEDRA E PATOLLOGJISË SE PËRGJITHËSHME SEKSIONI I MJEKSISE LIGJORE BASHKIM ÇUBERI

Intoksikacionet me kërpudhat janë njojur qysh në kohrat e lashta. Kështu p.sh. shkrimtarit të njojur grek, Evripidit, i kanë vdekur nga përdorimi i kërpudhave: gruaja, vajza dhe të dy djemtë. Në literaturën botnore përmenden mjaft raste intoksikacionesh nga kërpudhat. Numri më i madh i intoksikacioneve është rregjistruar në maj nga kërpudhat e para, të cilat çfagjen me një herë pas shkrirjes së borës dhe nga mezi i qershori zhduken. Në shtator, megjithëse kërpudhat shtohen, numri i intoksikacioneve bie si rezultlat i zarzavave të shumta që dalin dhe i llojeve të ndryshme të kërpudhave, gjë e cila shtron kërkuesat e popullatës në lloin dhe cilësinë e tyre. Edhe burime të tjera të literaturës jepin po këto të dhëna.

Kërpudhat toksike numërohen me dhjetra, por nga këto vetëm një pjesë e vogël shakton intoksikacione. Lëndë toksike me kërpudhat është një lëndë organike e cila hyn në grupin e preparateve azotike. Këto përbërje kanë strukturë kimike të ndryshëme në kërpudha të ndryshëme. Si kërpudha me toksike konsiderohen: *amanita phalloides* dhe *helvella esculenta*.

*Amanita phalloides* ka një ngjyrë kafe ose ulliri, me kapele ngjyrë gri të mbuluar me mbeturinat e cipës në formë pare peshku. Më von kapela mund të marrë ngjyrë kafe ose ulliri. Këmba në pjesën e sipërme ka një unazë të përbërë nga mbeturinat e cipës, dhe pjesa e fundit e këmbës është e vendosur në një vaginë, e cila përfaqëson edhe kjo mbeturinat e cipës në të cilën ndodhet kërpudha në zhvillimin embrional të saj. *Amanita phalloides* përmban dy lëndë toksike: amanita-hemolizinë dhe amanita-toksinë. Amanita hemolizina në patogenezën e intoksikacioneve luan një rol të dorës së dytë. Vetia hemolitike e saj pjesërisht humbet në temperaturën  $70^{\circ}$  dhe nën veprimin e pepsinës, sekrecionit pankreatik, bazave dhe acideve të dobëta. Amanita-toksina, që konsiderohet një nga helmet më të forta të të gjithë produkteve toksike me prejardhje bimore, është shkaku kryesor i ndryshimeve të rrënda që ndodhin në hepar, ndryshime këto që në përqindjen më të madhe çojnë në vdekje (35-90% Orlov, 60-80%, Rajski etj.).

Helmimet me kërpudhat janë raste aksidentale. Aksidentet që ndodhin nga përdorimi i tyre i dedikohen faktit se ka njerëz të cilët nuk i dallojnë dot kërpudhat e ngrënëshme nga ato helmueset.

Në vendin tonë rastet e intoksikacioneve nga kërpudhat janë shumë të ralla për shkak se populli jonië nuk e preferon shumë këtë lloj bime. Nga statistikat e byrosë së ekspertimit mjekoligjor rezultton se qysh nga viti 1958 dhe deri në qershor 1964 janë takuar vetëm 3 raste intoksikacio-

nesh dhe këto vetëm në një familje, nga të cilët dy kanë përfunduar në vdekje.

Kjo është pra arsyёja që na shtyn të përshkruajmë këto raste, të cilat mjkët mund ti takojnë në praktikën e tyre mjeksore.

### RASTET TONA:

Në datën 15/IV/963 tre fëmijët e qytetarit D.K., në kohën që po kllosnin bagëtinë në një pyll, grumbulluan kërpudha të cilat, pasi i poqën në zjarr, i hëngrën. Pas 15-16 orë tek fëmijët filluan të çfaqen dhimbje të forta barku, të vjella dhe diare të shpeshta. Masat e të vjellave dhe materiet fekale përmbanin mbeturina ushqimi, gjak dhe mukus. Me qenë se gjendja e fëmijëve nga casti në cast shkonte duke u keqësuar, prindërit i transportuan për në spitalin rural të rrëthit përkatës. Gjatë rrugës, fëmija më i vogël në moshë, vdes. Fëmija i dytë sillet në spital në datën 18/IV/963 në një gjendje shumë të rrëndë. Në momentin e shtrimit fëmija paraqitej mjaft i zbehtë, lëkurën dhe sklerat i kishte të verdha, buzët të maviosura. Pulsi i vogël, i shpejtë. Tonet e zemrës ritmike, të pastërtë, por të dobëta. Raspirasiioni vezikular i eshpër dhe jo i rregullt. Pas disa minutash tek fëmija filluan të çfaqen simptomet e dëmtimit të sistemit nervor central: konvulsione dhe të humbasë koshiencën, dhe në këtë gjendje me gjithë ndihmën mjeksore të dhënë, fëmija vdes. Fëmija i tretë, më i madhi në moshë, me përjashtim të dhimbjeve të barkut, të vjellave dhe diarese, të cilat në krahasim me ato të dy fëmijëve të parë, ishin më pak të theksuara, nuk pati shenja të tjera. Në ditën e dytë të intokacionit, shënjat e përmendura filluan të qetësohen dhe gradualisht të zhduken dhe të mbetet vetëm një dobësi e theksuar.

Kqyrja e jashtëme e kufomës të fëmijës vdekur në spital vuri në dukje: lëkura dhe mukozat e dukëshme me ngjyrë të verdhë dhe të thatë. Njollat e kufomës të zhvilluara në pjesët e pasme të trupit, të cilat gjatë shtypjes me gjisht zbehen me vështirësi. Shtangimi i kufomës nuk është çfaqur në asnjë nga grupet e muskujve. Sytë të futura, sklerat ikterike, konjuktivat me pika hemoragjike të shumta. Gjatë kqyrjes së mbrëndëshme të kufomës u konstatua: indet e buta që mbulojnë kafkën të njoma, të shkëlqyeshme dhe me ngjyrë të verdhë. Dura dhe pia mater të lëmuara, të shkëlqyeshëme dhe pak ikterike. Indi trunor edematoz, në prekje ka një konsistencë të butë, në prerje struktura e rruajtur por me pika hemoragjike të shumta. Mukoza e rrugëve të respiracionit e lëmuar, e shkëlqyeshme dhe me ngjyrë të verdhë. Ezofagu i lirë, mukoza e tij e lëmuar, e shkëlqyshëme dhe me ngjyrë gri. Në pleurat vrehen pika hemoragjike të shumta. Muskhëritë në prekje të ajrosura, në prerje pak edematoze. Zemra pa ndryshime të dukshëme makroskopike, valvulet të lëmuara, të shkëlqyshëme dhe transparente. Stomaku me përbajtje kafe të errët, mukoza e saj e hyperimuar dhe me pika hemoragjike të shumta. Zorrët kanë humbur shkëlqyeshmérinë e tyre, mukoza e tyre me pika hemoragjike. Hepari me formë të zakonshëm, pak i zmadhuar, ngjyrë kafe në të verdhë, në prekje me konsistencë shumë të butë dhe që démtohet lirisht nga prësioni i gjishtit mbi sipërfaqen e tij. Shpyrta me dimensione dhe konsistencë të zakonshëm, kapsula e saj pak e rrudhur, ngjyrë gri, në prerje me ngjyrë vishnje të errët. Pankreasi dhe suprarenalët pa ndryshime makroskopike. Veshkat me konsistencë dhe dimensione të zakonshëm, në prerje: shtresat kortikale dhe medulare të gjysëremuara dhe me kufi të kjarta midis tyre; kapsula hiqet lirisht pa dém-

timin e indit renal. Fshikëza urinare përmban një sasi të vogël urine, të kuqe; mukoza e fshikzës e lëmuar dhe me pikë hemoragjike të shumta.

Ekzaminimi histologjik i organeve, (Docenti Pëllumb Bitri), vuri në dukje:

**H E P A R.** — struktura histologjike e heparit është transformuar krejtësisht: lobulet hepatike gadi janë eliminuar, rrëth venës centrale konstatohet një hyperimi dhe një hemoragji kaq e zhvilluar sa që ka bërë të zhduken qelizat trabekulare. Në këtë zonë vihet re një sasi e madhe pigmenti hemosiderinik. Vazat sinusale janë të zgjeruara përsëtepërmë, dhe trabekulat hepatike pothuaj se nuk duken fare, me përjashtim të disa mbeturinave celularebazofilkë të mbeturat në regjionin perilobular, protoplazma e të cilave është e mbushur plot me vakuole. Kapsula e heparit paraqitet edematoze dhe me vaza hyperemike. Nekrobioza, nekroza dhe distrofia e shkallës së rëndë karakterizon imazhin histologjik të këtij hepari (shif foton).

**T R U R I.** — Karakterizohet me një edemë dhe hyperimi të moderuar. Celulat nervore manifestojnë procese edematoze dhe distrofike.

**Z E M R A.** — Miokardi paraqet një edemë interfibrilare (intersticiale) dhe trubullirë të protoplazmës të miofibriteve.


**R E N E T.** — Glomerulat janë të fryra, nukleuset e tyre të shtuara. Hapësirat në kapsulën e Bowmanit janë zhdukur krejtësisht. Në hapsirën e kapsulave të Bowmanit të disa glomerulave vihet re eksudat seroz homogjen. Ndërmjet anseve vaskulare të glomerulave duket gjak i moderuar. Tubuli kontorti me epitel në gjendje distrofike, nukleuset e celulave janë të rruajtura. Në disa tubuli kontorti dukën aty këtu shenja të nekrozës të epitelit.

**P U L M O N E T.** — Paraqesin një edemë të lehtë.

**I N T E S T I N E T.** — Epiteli i mukozës të zorrëve të holla paraqet

nekroze të tipit koagulativ që vendosin në formë membranash oksigjene me thellësi të ndryshëme. Kriptet janë në gjendje hyperfunkcionale. Aty këtu vihet re ndonji infiltracion i lehtë celular i mukozës.

Ekzaminimi i kufomës të fëmi-jës, vdekur rrugës gjatë transpor-timit për në spital vuri në dukje: lëkura dhe mukozat e dukshëme subikterike. Shtangimi kufomor mungon. Në sklerat dhe organet e mbrendëshme vihen në dukje pikë hemoragjike të shumta. Edemë e



trurit dhe e pulmoneve, por më e theksuar se në rastin e parë. Heparit me ngjyrë kafe në të verdhë, në prekje pak e butë. Organet e tjera pa ndryshime të dukshëme makroskopike. Stomaku përbante një leng homogjen ngjyrë kafe të zbehtë, mukoza e tij e hyperimuar dhe me pikë hemoragjike.

Në kqyrjen mikroskopike të organeve konstatohen të njëjtat leziona, me përjashtim të hyperimisë të heparit e cila mungon.

**KONKLUZIONI MJEKOLIGJOR.**— Të dhënët anamnestike dhe klinike: fillimi i simptomeve 15-16 orë pas ngrënjes së kërpudhave, dhimbjet e forta të barkut, të vjellat dhe diaretë e shpeshta, humbja e ndjenejave, konvulsionet, lëkura dhe mukozat ikterike si dhe të dhënët makro dhe mikroskopike të ekzaminimit të kufomave: mungesa e shtangimit kufomor, pikat hemoragjike në sklerat dhe organet e mbrendëshme, ngjyra ikterike e lëkurës dhe e organeve, edemë e trurit dhe e pulmoneve nekrobioza, nekroza dhe distrofia e rrëndë e heparit si dhe ndryshimet e tjera mundësinë të konkludojmë se vdekja ka ardhë nga intoksiacioni i organizmit si rezultat i përdorimit (si ushqim) i kërpudhës — *amanita phalloides*.

(Paraqitur në redaksi më 15/9/64)

#### BIBLIOGRAFIA

- 1) M.I. Avdejev Kurs sudebnol medicini 1959.
- 2) T.S. Matvejev. Voprosi sudebnoi medicini 1955.
- 3) M.I. Bajski Sudebnaja medicina 1953.
- 4) N.V. Popov Sudebnaja medicina 1950.
- 5) A.V. Rejsler Higenia pitanja 1957.
- 6) V.M. Smoljaninov, K.I. Tatiev, V.F. Çerbakov Sudebnaja medicina 1963.
- 7) V.M. Smoljaninov, K.I. Tatiev, V.F. Çerbakov Sudebnaja medicina 1963.

(Summary)

#### Three cases of poisoning with *Amantita phalloides*

After a brief entry about the history of poisoning with fungi, the author notes that these cases are discussed quite often in the World literature from the clinical as well as from the pathological point of view. The author discusses three cases of accidental poisoning by *Amantita phalloides*, from which two died.

These cases were seen at necropsy in 1963. The author, judging from his own experience and that of his colleagues of the Bureau of medicolegal experts, concludes that these cases are rare in this country.

## DY RASTE ME URTIKARIA PIGMENTOZA

Kand. Shk. Mjek. K. S. KERÇIKU dhe Sh. BASHA  
Klinika e Dermatologjisë (Shef i Katedrës doc. K. KERÇIKU)  
Shokut Prof. DR. TORSUEV N.A. me rastin e 60 vjetorit  
té ditëlindjes së tij.

Urtikaria pigmentoza është përshkruar për herë të parë nga Nettle-shid në arshivën e Virhovit viti 1869, nën titullin «Chronic urticaria lea-wing brown stains». Piktura e parë u dha nga Baker (1875), kurse Sangster-i e quajti me emrin e sotshëm «urticaria pigmentosa» (1878). Dallimin e U.P. nga «Urticaria chronica cum pigmentatione» e bëri Unna në vitin 1887 me anë të vërtetimit histologjik të Mastcelulave në substratin tesuar të U.P., që 10 vjet më parë e kish ngjyrosur me bojrat e anilinës studenti i mjekësisë 23 vjeçar Ehrlich (H. Fischer 1962). Patogeneza e sëmundjes mbeti e paqartë, mbasi nuk njihet rëndësia e mastcelulave. Disa autorë i konsiderojnë këta si një anomali të pigmentit (Schwalb), kurse të tjera si një formë naevoide (Jadassohn, Noble, Bloch, Little) ose tumor retencioni (Darier) dhe së fundi sëmundja u rradhit në sistemin hemopoëtik (Bizzozero) ose në genodermatozet (Lever). Cacciola dha Campani menjtojnë më tepër se U.P. ka lidhje me formimin e heparinës.

Në vitin 1916 u gjet heparina në heparin e qenjve (Mc Lean, Howell, Holt) dhe në 1937 u identifikue në granulat e mastcelulave si substancë metakromatike tek njeriu (Jorpes, Holngren, Wilander). Ajo është lidhur mirë me strukturën celulare të mastcelulës dhe mendohet se vepron si substancë antikoagulante, por H. Fischer shkruan se një hiperheparinemi që të shkaktojë një koagulopati tek U.P. ende nuk është vërtetuar as me metodat më moderne të ekzaminimit (Meningnin, Hofman, Corbleet, Degos, Dentsch dhe Ellergast, Gaté, Bell dhe Jacobson etj.) Rasti i Grunebergut kishte një kohë të zgjatur të hemoragjisë prej 25-30 minuta.

Me rëndësi për U.P., ka qënë edhe vërtetimi i histaminës nga Filey dhe West (1953) në mastcelulën, gjë që spjegon reaksionin urtikal (reakzioni i Darier). Po kështu spjegohet edhe demografizmi i shtuar. Si kusht i çfaqjes të këtij fenomeni është zbulimi i deliberatorëve të histaminës (Macinton dhe Paton 1949).

Thuhet se mastcelulat kanë substanca vazoaktive si serotina, por kjo nuk është vërtetuar (Braun-Falce, Herzberg, Tamine K. Remy). Hiperpigmentacioni zakonisht nuk çfaqet kur infiltrati i U.P. është i thellë në kutisë dhe subkutis. Disa herë janë vërejtur në sipërfaqen e efloresencave të U.P. teleangiekjasie dhe gjakosje punktifore (Parker, Weber).

Si forma të rralla të U.P. konsiderohen ato tumorose (U.P. xanthelasmoide Tibur J. Fox), të mukozave, format erytrodermike, ose difuse të likenizuara dhe mastocitozat e organeve të brendëshme (Hassard 1950, Degos 1951, Ellis, Reilly, Zaks, Lednert, Touraine, Nickel etj.), vegenërisht të heparit, lienit dhe të skeletit (osteoskleroze ose osteoporozë). Sëmundja paraqitet më shpesh në foshnjëri (Bordman 1941) qysh në lindje, rrallë

me karakter familjar (Nakam, Sezary, Darier, Horowitz) dhe ndër të rritur.

Frognoza e sëmundjes është e mirë: mbas shumë vitesh, ekzantemat regenerohen dhe hipertpigmentacioni zhdukjet krejtësisht ose pjesërisht në moshën shkollore ose mbas 30-40 vjetëve duke lënë një atrofi të lehtë të lëkurës. Tek mastoidozat e gjeneralizuarë prognoza është e keqe.

Në përgjithësi, U.P. është e rrallë, Firment gjeti 152 raste (1923), Pipping-Gottron 62(1936) dhe 25 të sëmurë me Haemoblastose mastocitarë (të generalizuarë) u mblohdhën nga literatura.

Në Shqipëri sëmundja është diktuar 3 herë. Rasti i parë është diagnostikuar tek një foshnje në vitin 1957 nga doc. K. Kerçiku, i dyti në vitin 1960 nga Shyqri Basha dhe i treti po në këtë vit përsëri nga doc. K. Kérçiku. Këto dy raste të fundit përshkruhen këtu pa analizime të plota me qenë se prindërit e këtyre fëmijëve refuzuan t'i bëjshin. Vetëm tek rasti i dytë mujtëm të bënim ekzaminimin histologjik të një papule.

*Rasti i I-rë.* V.K. 5 muajsh, mashkull, diagnostikuar në shtator të vitit 1960. Është fëmija e dytë e një nënë të shëndoshë me profesion punëtore. Lindje eutocike me peshë 3100 gram dhe gjatësi 50 cm: pa patur ndonjë shënje në lëkurë. 3 muaj më vonë filluan t'i çafqen disa njolla me ngjyrë të errët në fytyrë të cilat shpejt duke u ngrejtur mbi sipërfaqen e lëkurës u përhapën në të gjithë trupin. Objektivisht vihen rë efloresanca papulose me madhësi të një maje gjilpërre, thoji ose gjysëm leku në formë përgjithësish të rrumbullakta por në mënyrë jo të rregullt me ngjyrë të kuqe të errët. Ngjyra duket me vitropresion. Në shpinë dhe në regionin gluteal efloresencat e pigmentuara janë të bashkuara ndërmjet tyre dhe formojnë rrethe ose figura trekëndëshe. Në lëkurën e kokës shenjat e U.P. janë të rralla; po kështu në regionet plantare, palmare, në skrotum dhe dorsum penis. Gjendrat limfatike nuk preken, reaksiioni i Darier i dukshëm. Gjendja e përgjithëshme e mirë, asgjë për të shënuar në organet dhe aparatet e brendëshme. (Fig. 1) Fëmija u rivizuita në frur të vitit 1963 dhe u konstatua se gjatë dy vjetë e gjysëm ka shtue gjithnjë normalisht në peshë, gjatësi, dhe ka patur një zhvillim psihomotor të mirë. Simptomatalogja e lëkurës nuk është ndryshuar (Fig. 2). Edhe tanë reaksiioni Darier-it është pozitiv dhe gjendrat limfatike nuk janë të smadhuara.

*Rasti i II-të D.A.* mashkull 8 muajsh, nga një katund i afërt i Tiranës, lindur me peshë normale nga një nënë e shëndoshë. Në lindje fëmija nuk paraqiste ndonjë shenjë në lëkurë. Mbës 2-3 muajsh (e ema nuk është në gjendje të përcaktojë kohën me saktësi) fëmijës iu çfaqën disa njolla të errëta në të gjithë lëkurën e trupit. Më vonë ato u vunë rë edhe në gojë.

Objektivisht në pamjen e parë, fëmija duket pak i zbehtë si anemik, por në fakt ka një zhvillim të mirë. Turgori i lëkurës është normal. Qëndron mirë i mbajtur në këmbë dhe ka lëvizje të gjalla. Nuk ka qënë ndonjëherë i sëmurë. Ushqehet me qumështin e nënës. Asgjë për të shënuar në organet e brendëshme. Në lëkurën e fytyrës, të shpinës dhe të ekstremiteteve shifen efloresanca papuloze të ngritura, të dalluara mirë mbi sipërfaqen, me madhësi të një gjysëm leku deri në dy lek, me ngjyrë të verdhë deri në të kuqe të errët. Ato dallohen mirë nga lëkura normale dhe kudo janë të disminuara, përvëç në regionet palmare dhe plantare, ku nuk janë të shprehura. Sipërfaqia e papulave është e lëmuar në formë ovale. Në mukozën e gojës vatrat janë gjithashtu të rrumbullakta dhe të dukshme, por me pak të kufizuara.

Përgjegje e biopsisë Nr. Prot. 858 dt. e dërgimit 21.II.1960 dhe e marrjes 26.III.1960, (kryer nga Çesk Broku):

Në preparat gjinden qeliza në formë të rrumbullakët dhe ovale me protoplazëm të mbushur me granula euzinofile (heparinocitemastcele). Ka shumë të dhëna për Urtikartia pigmentosa megjithse nuk u bë ngjyrosja me violet kresili.

U.P. sikur pamë nga të dhënat e literaturës është e rrallë dhe përgjithësisht konsiderohet si një retikulose e diferençuar mastcelulare.

Përsa i përket terapisë, është provuar röntgenoterapia (Fox), Bucky, Thorium, kortikosteroïdet dhe bismuth — të shqëruar me hemoterapi dhe dietë të vecantë (zarzavate e pemë). Baxar, Berseni dhe Pelzik (1959) duke u bazuar në të dhënat e prodhimit të serotoninës në mastcelulat, provuan dhe resorhinën me doza 0,25-0,125 mg. në ditë megjithse serotonina në njerzit nuk është vërtetuar (Blank, Blusarb dhe M. Hasegava). Edhe mjekime të tjera si Besocy-corticesteron-acetat me doza 4 mg. pro die, antihistaminike etj. nuk kanë dhënë rezultate të kënaqëshme.

(Paraqitur në Redaksi më dt. 10/5/1963.)

#### BIBLIOGRAFI

1. Fischer, H.: Zur Pathogenese der Urticaria pigmentosa. Derm. Vochenschrift 145 (1962) 10.
2. Gertler V.: Trophangeuneurosen der Haut. Dermatologie u. Venerologie von Gottron u. Schönfeld III/2. 1959.
3. Gottron, A.A.: Retikulosen der Haut. Dermatologie u. Venerologie Gottron-Schönfeld IV 1960.
4. Hertzberg, J.I. Allgemeine Therapie der Haut. Handbuch der Haut u. Geschlechts-Krankheiten-Jadassohn. Ergänzungswerk V/I Band A 1962.
5. Latz, W.: Lehrbuch der Haut u. Geschlechts-Krankheiten Basel 1957.
6. Riehl, G.K. Hekel dhe D. Lefferer: Säuglingsdermatosen. Dermatologie u. Venerologie Gottron-Schönfeld Vol. IV Stuttgart 1960.
7. Schönfeld V.: Lehrbuch der Haut u. Geschlechts Krankheiten. Stuttgart 1959.
8. Schreiner, H.E.: Hormone. Handbuch der Haut u. Geschlechts-Krankheiten Jadassohn. Ergänzungswerk V/I Bandteil A.
9. Sutton, R.I.: Diseases of the skin. Mosby Company-St. Louis 1956.

(Summary)

#### Two cases of pigmentous urticaria

The authors discuss first the literature data on this rare disease, then point out the importance of the mastcells, the heparine, histamine etc, they describe two cases of the disease in children about 5 and 8 months of age. One of the cases is completed with histologic data, the other was kept under observation for 3 years.

They have observed only 3 such cases in Albania.

## DY RASTE ME DEGENERACION KOLOIDAL TE LEKURES (PSEUDOMILIUM COLOIDALE)

Kand. Shk. Mjek. K. KERCIKU, K. MIHO.  
(Katedra e Derm.-Venerologjisë — Shif. Dr. DR. K. KERCIKU)

Një ndër sëmundjet e rralla të vendit tonë është përgjithësisht të dermatologjisë, është *pseudomilium colloidale*, të cilën e kemi ndeshur dy herë. Kjo sëmundje është emërtuar me emra të ndryshme si *pseudomilium colloidale* (Pelizzani), *Koloidamilium* (Wagner), *Koloid-degeneracioni kutan* (Besnier-Butter), *Hyaloma* është. Etiologjia e saj nuk njihet mire. Rossini supozon për rastet e moshes së re, se sëmundja është një astrofë kongenitale. Mendohet edhe se është zhvillimin e sëmundjes let-tje roj me rëndësi rrëzatimi i shumtë diellor (Brokken), por kjo nuk mund të qasht gjithmonë si shkak i vetëm, pse simbas Gans dhe Steigleder, të tilla ndryshime tështuara i obervojnë edhe tek cikatrizef, tumorët si edhe në proceset inflamatore. Disa të tjera, duen të thonë se *pseudomilium colloidale* çfarët ndër njerëz që kane kontakte me katram dhe produktet e tij (Loos). Autorët në pjesën më të madhe dyshojnë pra për ngacimme eksogene. Rastet tonë janë me origjinë fshatare që i ndeshin më shumë, per profesionin e tyre, rrëzeve të diellit. Prof. Leopold Arzt nuk mendon se *pseudomilium colloidale* është një degeneracion koloidal, por me tepër për ate të hyalinës. Unë e konsidero si të veçtojme që degeneracioni koloidal rrjedh nga transformimi degenerativ i kolagenit kutan pranda e quajti «koloid», por noga ana tjetër nuk ekskludon që ky proces të vijë edhe nga degenerimi i fijeve plastike të tesutit (Wagner). Mund të mbahen edhe për një sëmundje familiare.

Rasti i 1-re Pacienti I.C. Nr. Karteles 1196, vjet 50, nga fshatrat e rrëthit të Elbasanit. Sëmundja u diagnostikua per herë të parë nga Doc. K. Kerçiku (Foto Nr. 1) ambulatorisht para disa vjetave. Në vitin 1961 paraqitet përsëri i sëmuri në ambulancën e dermatologjisë mbasi përvèc sëmundjes kryesore kishte edhe një epitelione në dorsum nasi (foto Nr. 2). Nga ana anamnestikë asnjë per të shënuar. Në lidhje me sëmundjen *pseudomilium colloidale*, pacienti referon se ajo është çfarë shumë kohë më parë, gati 20 vjet parpara. Në fillim vuri re pa ndonjë shkak të jashtëm, se në lëkurën e ballit, në mollézat e fageve dhe në hundë u çfarët disa të ngritura të paktë dhe të vezuara, të cilat me kohë n bashkuant dha vazhdimisht duke u shtrirë në pjesën më të madhe të fytyrës, nga të cilat ai subjektivisht nuk ndjente asnjë. Një vit më parë fitoi te çfarët në shpinë të hundës një tumor i vogël i fortë në prekje, më ngjyre të erëvet i padhimbëshme, në rrëshq me ngadale. Pacienti i bën vjettesoi sëmundjen dhe nuk u paraqit per një kohë të gjatë tek injekti. Me kohë ky tumor i vogël u smadhua, u hap dhe u ulçerua.

Në ekzaminimin objektiv konstatohet në balle, në regionin orbital dhe temporal bilateralist, në mollézat e fageve dhe në dorsum nasi, papula transparente me dimensione të vogla dhe me një mëdhiçë prej një kokëri meli deri thierze. Ngjyra e tyre është e verdhë pak e celur si lëkura e limonit, me konsistencë të fortë dhe me sipërfaqe të lëmuar dhe të ratshtë. Papulat në paraqitjen e parë dukeshin si vezikula të vogla, por nuk nxorren ndonjë likuid mbas çpimit. Më tepër dolli një masë gajente. Elementi në prekje ishte i padhimbshëm. Në dorsum nasi shifet një

Doc. K. KERÇIKU — Dr. SH. BASHA



Foto 1



Foto 2

Doc. K. KERÇIKU — MIHO



Nr. 1



Nr. 2



Nr. 3

epiteliomë me madhësinë e një kokër arre e kufizuar mirë nga lëkura normale. Sipërfaqja e saj është e ulqenuar dhe e mbushur me granulacione, në prekje të forta, pjesërisht e imbuluar me kruste serohemoragjike.

Klinikisht u konstatua pseudomilium koloidale kurse epithelioma spinoçulare dorsum nasi (Foto Nr. 2) u vërtetua dhe histologjikisht. Epithelioma u mjekua me rontgenoterapi dhe u shërua, kurse për pseudomilium nuk u bë asnjë mjekim.

Analizat laboratorike rezultuan normale (RW, gjak komplet, urinë, feje etj.).

Rasti i II-të. Ishte nga fshatrat e veriu të Shkodrës, 40 vjeç (N.M.) me profesion bujk. Diagnosa iu vu klinikisht në mënyrë ambulatore mbasi refuzoi të shtrohej në klinikë. Nga ana anamnestike asgjë për të shënuar. Si bujk qëndron shpesh në diell. Sëmundja i është qfaqur para disa vjetësh me disa të ngritura të veçume në mollëzat e faqeve, hundë dhe në pak në ballë. Me kohë ata vazhduan të shumohen dhe të kufizohen në vratat e lartpërmëndura. Pacienti nuk ndjen asgjë nga ana subjektive.

Objektivisht shifet një vatér e madhe nga palpebra e poshtme e syrit të djathtë me një brez prej 1-2 cm. që fillon nga regioni os zygomaticus dhe dorsum nasi dhe si një rrrip i hollë prej 0,5-1 cm. në pjesën e majtë të fytyrës gati simétrikisht në anën që u përshkrua më sipër. Vratat janë të verdhë si të lejmonit dhe në sipërfaqta të rafshët. Elementi morfoloqjik ndahet nga rrudhat e fytyrës që shkon si viza të çregullita që përfshijnë ndërmjet tyre grupë papulash. Klinikisht u diagnostikua pseudomilium koloidale (foto Nr. 3).

Në të dy të sëmurët nuk u përdor ndonjë terapi e veçantë mbasi dihet se rezultatet me dborën karbonike ose elektokoagulimi i papulave janë të dobëta dhe disa herë të pakëhillueshme për rrjedhimet e më vonëshme nga defektet kozmetike.

Si konkluzion sëmundja pseudomilium koloidale është e rrallë dhe ndeshet më tepër ndër njerëz që i nënshtron vazhdimi i trezeve të diellit.

#### BIBLIOGRAFI

1. Arzt, I. dhe Fuhs, H.: Gutartige Neubildungen der Haut. ne Haut u. Geschlechts Krankheiten Arzt-Ziehler Band II.
2. Bude H.G. u.Kerting G.M. Lehrbuch der Haut u. Geschlechts — Krankheiten von E. Riecke, Stuttgart 1962.
3. Prendthwmal : Pseudoxanthoma elasticum (Darier) Jadassohn IV/3 Berlin 1932.
4. Gottron u. Schönfeld: Dermatologie-Venerologie-Stuttgart 1960.
5. Lutz, W. : Lehrbuch der Haut u. Geschlechts — Krankheiten 1957 fq. 125.
6. Stainer, E. : Angeborene Anomalien der Haut, Jadassson IV/I Berlin 1932.
7. Schönfeld, N. Lehrbuch der Haut und Geschlechtskrankheiten, Stuttgart 1959.
8. Wagner, G. : Altersveränderungen der Haut-Altersdermatosen, ne Dermatologie u.Venerologie IV von Schönfeld-Gottron.

#### TWO CASES OF COLLOIDAL DEGENERATION OF THE SKIN (Summary).

The authors describe the clinical picture of two cases of pseudomilium colloidale on the face of two patients at the age of 40 and 50 years, which were diagnosed for the first time in Albania. One of the cases was complicated with an epithelioma of dorsum nasi after about 20 years. Both patients are peasants. They have been exposed continuously to the sun rays, especially during springtime. This fact corresponds with the suggestion that the disease is caused by exogenous excitements.

# K R I T I K È E B I B L I O G R A F I

## RECENSION

### I LIBRIT «PROBLEMES DE BASE EN ELECTROENCEPHALOGRAPHIE».

I redaktuar nga:

H. FISCHGOLD, C. DREYFUS — BRISAC — et Ph — PRUVOT  
Masson et cie, ed. 1963

Ky libër është rezultati i pesë seminareve të mbajtura gjatë viteve 1960-61 dhe është frut i një pune 15 vjeçare të zhvilluar në fillim në spitalin Sent-Anne dhe pastaj në spitalin Pitié. Siç e thotë edhe vetë titulli i librit këtu ngrihen një varg probleme themelore dhe jepen një seri njojuri të rëndësishme të elektroencefalografisë klinike të neurofiziologjisë eksperimentale dhe të elektronikës, pa të cilat do të ishte e vështirë të kuptoheshin elementet grafike, ritmet dhe figurat e ndryshme të elektroencefalogrameve. Sigurisht, në këtë libër nuk eksposohen njojuritë elementare të neurofiziologjisë dhe të elektroencefalografisë. Këto njojuri konsiderohen nga autori si një etapë e kaluar, prandaj në tërë librin ndihet gjuha e specialistëve elektroenzefalografistë, të cilët i kanë vënë si detyrë vetes që të ngrejnë dhe të diskutojnë një varg probleme mjaft aktuale dhe të rëndësishme të kësaj disipline që prej disa vitesh ka hyrë në shumë klinikat të neurologjisë, të psikiatrisë, neurokirurgjisë etj. Gjithsej në libër eksposohen rrëth dhjetë çështje.

Në këtë seminar morën pjesë këta autorë: G. Arfel, Cl. Blanc, J. Buisson-Ferey, P. Buser, O. Creutzfeldt, A. Fessard, H. Fischgold, P. Gerin, J.F. Hirsch, M. Jouvet, G. Raoul, A. Robert, J. Weiss.

Artikulli i parë bëhet nga presidenti i elektroencefalografisë së gjuhës franceze Prof. Fischgold mbi «Disa nocione të elektrogjenezës cerebrale».

Çështja e elektrogjenezës cerebrale është një nga problemet më të vështira të elektrofiziologjisë cerebrale, thotë me të drejtë F. Bremer. Dhe në të vërtetë ne sot njohim mirë ritmin alfa, beta, valët patologjike teta, delta, fenomenet paroksizmale etj. Por natyrën e vërtetë të këtyre valëve nuk e njohim prandaj me të drejtë autorji thotë që po na ndodh me elektroencefalogramën një aventurë e njojur mirë në mjkësi: aplikohet një zbulim për vlerën e tij klinike dhe, suksesi praktik i tij na bën të harrojmë pamjaftushmërinë e njojurive tona mbi natyrën e tij. Dhe më poshtë ai shton: U zbulua dhe u përdor termometri pa njojur mekanizmin e ethes dhe digitali përpresa se të sintetizohej digitalina.

I pari që Berger, i cili dha mendimin e tij përsa i përket elektrogjenezës. Ai thonte se ritmet alfa dhe beta janë me origjinë kortikale. Përveç kësaj, ai e konsideronte këtë veprimtari «si globale» nga pikpamja që është e prodhuar nga tërësia e korteksit cerebral. Më poshtë H. Berger pranon pikpamjen e Dusser de Bareme dhe të Mc Culloch simbas të cilëve valët

alfa vijnë nga shtresat 4,5, dhe 6 ndërsa valët beta vijnë nga tri shtresat e para të korteksit.

Ky autor e argumenton pikpamjen e tij me faktin që ritmi alfa pë bën një reaksion global të korteksit dhe që ai çvendoset nga veprimitaria beta në çastin e përqëndrimit të vëmëndjes. Më von, një autor tjetër A. Kornmüller nuk është dakord me tezën që elektroencefalograma është çfaqje globale. Ai e konsideron elektroencefalogramën si një veprimitari lokale dhe e diferençuar. Ai mendon se kemi të bëjmë me një mbledhje neuronike me një sumacion të mikroaktiviteteve të dendriteve dhe të fibrave të korteksit. Po me këtë mendim bashkohet më vonë Edrian. Mjaft vonë në 1949 F. Bremer e përmbladh elektrogjenezën në tre pikpamje kryesore: 1. Valët alfa janë shprehje e automatizmit ritmik të qelizave nervore dhe sidomos të qelizave të mëdha piramidale. 2. Ajo janë triehdim i "pacem"- mit ritmik të kores nga influkset e një qendre rregulluese diencefalike. 3. Ato flasin për kalimin periodik nëpërmjet të kores së një fluksi të vazdueshëm, që vjen nga cirkuitet talamo-kortiko-talamikë.

Më në fund në simpoziumin e dytë kushtuar bazave fiziologjike të elektroencefalografisë në Kongresin Ndërkombëtar të elektroencefalografisë të Bostonit të vitit 1953 u dhanë këto tri njohuri kryesore, që endë sot pranohen prej shumë autorësh:

1. Valët cerebrale i detyrohen potencialeve dendritike të ngadalëshme të graduara lokale; potencialet aksonike, të shpejta, të çfaqura simbas ligjit të gjithçka ose hic, të përhapura gjatë fibrave, janë pjesërisht të moduluara nga këto valë dendritike pa ndërhyrë në gjenezën e lëkundjeve elektrike cerebrale.

2. Fenomene të tjera elektrike më të qëndrueshme, më të vazhdue-falogramave.

3. Veprimitaria autoritmike dhe pjesa më e madhe e varianteve të saj gjindet në preparate të ndryshme të korës së izoluar.

Artikulli i dytë i kushtohet veprimitarisë neuronike të sistemit nervor central. Kv artikull shkruhet nga O. Creutzfeldt. Një nga mënyrat brevesore për kërkimet e elektrogjenezës cerebrale simbas autorit, është studimi i veprimitarisë së neuronit të izoluar, që regjistrohet nëpërmjet të mikro-elektrodave.

Autori ekspozon metodën e tij të studimit eksperimental në trurin e izoluar të Bremerit me anën e respiracionit artificial. Veprimitaria neuronike regjistrohet me anë mikroelektrodesh prej 0,5 deri 5 mikron të diametrit të lagur me solucion KCl (3 ml.). Elektrodat futen në koren cerebrale nëpërmjet të një mikromanipulatori me një thellësi 0,5 deri 5 mm. Elektrokortikograma regjistrohet në të njëjtën kohë në afersinë immediate të mikroelektrodës.

Me anën e kësaj metodike dhe të metodikave të tjera është e mundur të studjohet aktiviteti neuronik unitar kortikal dhe marrëdhëniet e tij me elektroencefalogramën.

Në artikullin e tretë njohuri të reja mbi formacionin retikular të truncus cerebri të Xh.G. Arfel jepet shkurtimi i një pasqyrë e sukseseve të mëdha të arritura gjatë viteve të fundit në lidhje me studimin e formacionit retikular. Duke përdorur prerjet në bazë katesh të sistemit nervor qëndror simbas Bremer, Megun dhe Moruci është bërë e mundur, që të studjohet formacioni retikular, i cili shërben për konvergimin e influkseve heterogjene dhe ndihmon për koordinimin e një vargu ngacimish, të cilët drejtohen për në koren cerebrale.

Në bazë të një vargu prerjesh sagitale mediane të propozuar nga Myers dhe Sperry, të trurit të izoluar, të hemisferit të izoluar, kanë filluar të bëhen studime interesante mbi funksionet globale të trurit nën prizmin e kujtesës dhe të mësimit.

Kapitujt «Formacioni retikular dhe sjellja» e M. Jouvet Potencialet e evokuara në neurokirurgji të F. Hirsch dhe J. Buisson-Ferey, jepin një varg njojurish të reja të elektroencefalografisë eksperimentale.

Në artikullin heshtje cerebrale të Arfel, Fischgold dhe Weis diskutohet mbi një nga problemet më të rëndësishme dhe të vështira të elektroencefalografisë: mbi heshtjen e plotë cerebrale, që vihet re në elektroencefalogramën.

Gjatë regjistrimit të një elektroencefalogramës në qoftëse do të kemi një trase krejtësisht të rrafshëtë dhe të heshtur, do të thotë se jemi përdenti anoksik, në rastin e ndaljes kardiorespiratore etj. Vetëm me një regjistrim nuk është e mundur që të konkludohet në se ka posibilitet apo jo të bëhet reanimacioni. Për këtë arsyen është e nevojëshme që të përsëriten trasetë dhe të jepet një mendim më i plotë. Në Artikullin «Ekstraksion dhe trajtim i informacioneve në elektroencefalografi» jepen konsideracione interesante në lidhje me rrugën e bërë nga elektroencefalografia që nga koha e H. Berger dhe në një varg suksesesh të vazhdueshme sic janë ato të Gr. Walter, Gibbs, Brazié, Knot, Drobocki e të tjerë.

Në artikullin Truri elektronik dhe elektronika cerebrale të A. Robert dhe të H. Fischgold, përshkruhen sukseset e mëdha të arritura në sajë të ndihmës së automateve elektronike, të cilat shtojnë në një mënyrë të gjithështme disa nga funksionet e trurit tonë.

Por megjithë ndihmën e madhe që jepin këto makina, autori ka të drejtë kur thotë se këto janë shumë të ngjajshme me ganglionet e insektit që kanë një numur të reduktuar neuronesh dhe funksionet e tyre janë të kufizuara dhe të fiksuara si ato të instinktit.

Ai me të drejtë citon Jungun, i cili shton se makinat elektronike janë të ndryshme nga truri njerëzor.

Artikulli i parafundit «Paralelizma neuro-biologjike» i Prof. Fischgold dhe Blanc është një studim interesant, i cili kërkon që të argumentojë bazat e elektroencefalografisë duke u nisur nga studime në fushën e biologjisë, dhe kështu ai bën fjalë për një bazë anatomo-fiziologjike, histologjike, elektrofiziologjike, psikosensoriale, psikofiziologjike, psikofiziologjike, elektronike, neurokimiike, gjenetike dhe evolutive si dhe antropologjike.

Artikulli i fundit është mbi elektroencefalografinë klinike të prof. H. Fischgold. Në këtë artikull flitet mbi vëndin që zen sot elektroencefalografia klinike në praktikën e përditështme mjekësore. Ai shton se vëndi i elektroencefalografisë në disiplinat e neurologjisë, neurokirurjisë neopediatriçës dhe neurofarmakologjisë, as që mund të diskutohet.

Elektroencefalografia klinike sot mund të shikohet nën shumë prizma. P. sh.

1. elektroencefalografia e subjektit normal. Këtu bëjnë pjesë elektro-encefalografia e fëmijës, ajo e të rriturit, ajo e plakut, e njeriut anksioz, e njeriut të zgjuar, atentiv, të fjetur. Të gjitha këto ngrejnë një varg problemesh, përsa i përket karakteristikave individuale dhe shpesh herë kërkon prudencë.

2. Elektroencefalografia ambulatore, që është e domosdoshme për diagnostikimin e epilepsisë.

3. Elektroencefalografia hospitaliere, e cila shpesh herë paraqet vësh-tirësi të mëdha dhe kërkon studime sistematike.

*Kand. i shk. mjek. B. Preza*

RECENSION OF THE BOOK «PROBLEMES DE BASE EN  
ELECTROENCEPHALOGRAPHIE»

(Summary)

The author points out the importance of this work in connection with the problems of encephalography, discussed during the symposium at the Pitié hospital in 1960-1961. After a brief survey of the contents, the author recommends the book as a source of reference.

# Lajme shkencore nga shtypi i huaj

## MBI ROLIN E RICKECIOZAVE ATIPIKE OSE TË PA IDENTIFIKUARA, NË PATOLOGJINE VASKULARE

G. DELANOE — «La Semaine des Hopitaux» 1963, Nr. 40, f. 1483

Fisiopatologjia e Rickeciozave karakterizohet nga tropizimi i tyre i vegantë për apparatin kardio-vaskular dhe me qënë se biologjikisht afrojnë me viruset, paragonin infeksione me forma latente ose të pa dukeshme (inapparente).

Kështu rezulton që gjithë sistemi vaskular mund të goditet prej tyre shpesh me forma subakute, në mënyrë që mbulohet natyra e infeksionit.

Ky evolucion mer formë të zgjatur, alternohet shpesh me rizgjime, ku fenomenet alergjike lozin një rol të konsiderueshëm. Paraqitet i quartë zbulimi i Leo Buerger, të trombo-angjeitis, kurse paralelisht, Brill, në këtë ambient pëershruante formën e vegantë të tifos. Prej asaj kohe janë bërë shumë punime mbi rolin e Rickeciozave në angjiopatit dhe në mënyrë të vegantë në arteriet juvenile.

Autori i këtij artikulli ka depistuar 53 raste me arteriopati në formë të ndryshme duke studjuar etiologjinë e tyre; për këtë arësyë ka përdorur metodën e mikro-aglutinacionit në lame simbas metodës së Girond. Vëmëndja e autorit është përqëndruar në këto variante: në arteriopati, filluan para 40 vjetësh, në pacienta që kanë jetuar për shumë kohë në vënde ku rickeciozat paraqiten në formën endemike ose në raste ku aspekti klinik lejonte për një etiologji infektive dhe së fundi në rastin e një flebiti «kryptogenike» në të cilën reaksiioni për ricketcie Prowazecki ka rezultuar fort pozitive.

Në këto 53 raste të depistuara kanë rezultuar 11 pozitive ose 20.7% por përrast me arteriopati juvenilis përgjindja harriti në 41% (nga 17 raste kanë rezultuar 7 pozitiv). Pozitiviteti paraqitet i vogël, 7%, në rastet e çfarura 40 vjet më vonë (në 28 raste, vetëm 2 pozitiv). Nga ana epidemiologjike ndërmjet rasteve pozitive, 3 kanë jetuar në vënde ku rickeciozat paraqiten në formën endemike dhe 3 kanë jetuar në fushat e përqindrimit gjatë luftës së dyte botërore.

Autori komenton rezultatet në këtë mënyrë:

Mikro-aglutinacioni me këtë metodë zbulon ekzistencën e procesit infektiv në evolucion por duhet përsëritur shpesh për të kapur në kohën e rizgjimit.

Arteriopati të juvenile duket se korespondojnë në një entitet nosologjik të vegantë.

Njeriu është rezervuari i rickecieve dhe tropizimi i tyre arterial është i pranuar nga të gjithë, prandaj është e drejtë të mendosh, të paktën për disa raste, se këto mund të janë shtrati i një arteriopatie, së fundi duhet patur parasysh gjithmonë eventualitetin e rickecieve në sindromet vaskulare të ndryshme.

Prandaj kur jemi përparrë një reaksiuni të përsëritur pozitiv për rickecioze dhe kur anketa epidemiologjike pajtohet sidomos në formën juvenilis duhet aplikuar një njekekun me antibiotikë për të stabilizuar infeksionin dhe për të ndaluar evolucionin e asaj duke vepruar me insistim dhe me kura të përsëritura.

## MJEKIMI I ENCEFALOPATISË PORTO-KAVA ME ESKLUZION ÓSE REZEKSION TOTAL TË KOLONIT

L. LEGER, M. FOURESTIER, PH. DETRIE, S. NEVOYX

«La prese medicale» 1963, nr. 46, faqe 2181

Për mjekimin e encefalopatis porto-kava egsiston një listë e gjërë medikamentesh dhe manipulimesh. Roli i amoniemisë në krijimin e cfaqjeve neuropsiqike gjatë sëmundjeve hepatike është i padiskutueshëm, megjithëse ka shumë elemente ende të pa-determinuara.

Dihet se amoniaku i organizmit ka origjinën nga këto dy burime. Një pjesë formohet në veshkat dhe në muskulat prej diseminimit të aminoacidave, por pjesa më e madhe formohet në intestinin në kolon, prej degradimit të proteinave alimentare nën influencën e anzymeve bakteriale. Për këtë arësyen janë aplikuar shumë mjete terapeutike, si dieta hypo-protidike, antibioterapia për florën intestinale, por asnjë prej tyre ose të tjerave nuk paraqesin një mjet të sigurtë për evitim të shtimit të amoniemisë.

Një orientim i ri propozohet, me goditjen e formimit, në bazën e amoniogjenezës kollike; ekskluzioni ose rezeksioni total i kolonit.

Autorët paraqesin eksperiencën e tyre në një seri restesh në koma hepatike të komplikuar me hemoragji intestinale kanë parë zbritjen e amoniakut nga shifra të larta 2,2-3 mg ul (simbas metodës Conway) në 0,7-1,14 g me një herë pas operacionit edhe për një kohë të gjatë, të shoqëruar me zhdukjen e fenomeneve të encefalopatisë.

Indikacionet për interventin janë koma hepatike e vërtetë dhe koma portal ose encefalopati porto-kava.

Interventi bëhet me anestezi lokale.

## HEPATITIS VIRALIS ME HYRJE ATYPIKE

M. CACHIN, F. PERGOLA, Y. HECHT «La Semaine des Hopitaux» Nr. 73 faqe 2672

Kërkimet virusologjike të reja të detyrojnë të mendosh se agjentët etiologjike të hepatitis viralis nuk kufizohen vetëm midis virusave A dhe B, siç pranohet por se ka shumë të dhëna që varieteti i virus S ka shumë shtama (Souche) virale kryesisht të dalluar, por afër midis tyre.

Shumë autorë si Rightsell, Boggs, Mc Lean, Nikolau e tjerë, pranojnë se ekzistojnë tri tipa virusë.

Nga ana tjetër problemi i hepatotropizmit okazional e disa virusave jo me natyrën i këtyre rasteve nuk është i plotë, por mund të mendojmë këto variante: Është një tip i veçantë nga virusë hepatop-trope, ose janë agjente të zakonshme të hepatitis viralis okazional të një virus neurotrop.

Autorët paraqesin disa raste të rralla të cilët qëndrojnë afér këtij problemi.

1) *Hyrje me polyarritë inflamatorë*. Shumë raste të hepatitis viralis shoqërohen në fazën fillestare të sëmundjes me manifestime artikulare, duke patur një simptomatologi të lehtë, forma e cila përhapet në shumë artikulacione. Përveç kësaj forme ka raste ku fenomenet artikulare marrin një formë të rëndë që të jepin përshtypjen e një poliartriti artikolar akut.

2) *Hyrja me uretrite*. Autorët paraqesin një rast me uretrite amikrobiike, qfaqur në periudhën prej hepatitis; rasti është konsideruar në fillim si një koincidencë, por më vonë u paraqitet edhe raste të tjera me sindrome uretro-konjuktivale të typit Reiter- Fiessinger. Etiologjia e këtij sindromi është i panjohur por konsiderohet se shkaktohet prej entero-virusit.

3) *Hyrja me orchitis*. Deri më sot nuk është botuar asnjë rast me orchitis si fenomen fillestar të hepatitisë viral me gjithë këtë është paraqitur në disa sëmundje të tjera virale; Riggs dhe Sanford paraqesin disa raste me orchitis si komplikacion

e disa sëmundjeve virale (me përjashtim të parotitis) si në coxsackio, Dangue, chorio-meningitis lymfocytare, variole, grip, ose me virus ECHO.

4) Lijerja me perikarditis. Autorët paraqesin një rast të tillë por shpjegimi i tija është pak i vështirë, dhe mund të mendojmë për dy hipoteza; ose është një virus rastësish hepatotrop ose është një prej virusave të hepatitit viral, i cili në mënyrë të pa pritur ka goditur perikardin.

## AGRANULOCITOZE E RËNDË, SHKAKTUAR PREJ MJEKIMIT ANTI-EPILEPTIK

G. OLMER, P. CASANOVA, R. MURATORE, F. BATAGLINI, C. DELBOY dhe A. GIROLANMI — SANTANDREA «La Presse medicale» 1963 Nr. 47 f. 2257.

Lista e medikamenteve që shkaktojnë agranulocitozën është mjaft e gjatë. Midis medikamenteve të grupeve të ndryshme që konsiderohen si shkak i një agranulocitoze është konstatuar, se edhe prej grupit të medikamenteve antiëpileptike, janë paraqitur raste me të tillë lezione hematologjike; këto janë derivatet të hydantoinës, të paramethadionionës (Milontin, Colentin) etjera.

Tani në fund një preparat i ri anti-epileptik, kimikisht i afertë me ata me tipin kimik Alpha-ethyl-alpha-methyl succinimid, i vënë në qarkullim me emrin Zorantin, ka shkaktuar trubullimet hematologjike të tipit agranulocitoze.

Autorët përshtaku rastin e një vajze 16 vjeçare, shtruar në klinikën e tyre me një simptomatologji të një aplasia medullare të rëndë.

Nga anamneza rezultoi se pacientja vuante prej vjetësh nga epilepsia dhe se mjejkohesh me medikamentë të ndryshme anti-epileptike; kohët e fundit, para çfaqjes së fenomeneve morboze ka filluar mjejkimi me preparatin Zorantin, në doza relativisht të lartë për moshën e saj. Agranulocitoza u konsiderua se është shkaktuar prej këtyri medikamentë që përdorte para çfaqies së komplikacionit.

Rasti ishte tepër i rëndë, leukocitet harritën deri 200 kurse polynuklearët kanë munguar krejtësisht.

U mjekuar me gjithë arsenalin e medikamenteve, si kortizonet, poly-antibioterapi, transfuzione masive të përsëritura. Me qënë se gjëndja keqësoshesh më tepër dhe me mielogramin u paraqit mungesa totale e çdo elementi u apliktua një shartim (Graf).

Ky medikament ka shkaktuar edhe një rast agranulocitoze siç e ka përshtkuar Leslie Mann në 1962 në Los-Angelos që edhe në këtë rast, si rjedhim shkaktoj vdekjen e pacientit.

(Përmbledhur nga Lluka Dhimitri)

## MORTALITETI I POPULLSISE SË MOSKËS NGA NEOFORMACIONET MALIGNE

Kliničeskaja Medicina 1964, 4, 38

Rritja e mortalitetit nga tumoret maligne është vrejtur në fund të shekullit të kaluar. Cuyler tregon se më 1900 mortaliteti i popullsisë të SH.B.A. nga tumoret maligne qëndronte në vëndin e tetë dhe përbënte afro 4% të numurit të përgjithëshëm të vdekjeve më 1948 zinin vëndin e dytë dhe përbënin 14% të vdekjeve. Morë 100.000 banorë dhe në racën e bardhë përbënte 150,4 vdekja nga kanceret është rritur nga 612 të vdekur në 1922 në 12.241 më 1950. Në Francë gjithashu është rritur nga 137 për 100.000 banorë më 1936 në 184 më 1950. Autori tregon se punimet statistikore flasin për rritet e mortalitetit nga tumoret maligne si në popullsinë e Moskës ashtu dhe në qytetet e tjera në periudhën e fillimi i shekullit të XX e deri më sot.

Rritja e mortalitetit shpjegohet nga ndryshimet e strukturës së moshës së popullsisë dhe vënjes së diagnozës së herëshme dhe të saktë.

Mortaliteti nga neoformacionet maligne në Moskë pas 1938 vrehet midis personave më tepër se 15 vjeç, midis personave më të rinj se 15 vjeç ka raste të veçanta sidomos tek djentë. Mortaliteti nga të gjitha format e kancerit në moshën 20-39 vjeç më tepër shihet tek gratë, duke filluar nga 40 vjet e lart vdesin nga tumoret më tepër burrat.

Krahasimi i mortalitetit të viteve 1958, 1947, 1937 tregon se janë rritur tumoret e organeve gjenitale (4 herë), në vendin e dytë qëndrojnë ato të organeve respiratore (3 herë). Tek meshkujt dëmtimi nga tumoret e organeve respiratore i kalon gratë 8-15 herë. Vëndin e tretë e zen mortaliteti nga tumoret e gjëndrës mamare. S.A. Novosalski tregon se rritja e tyre mvarët nga njohja e përsosur dhe shumë e saktë e formave të kancereve, përsosmëria e metodave diagnostike. Me gjithë sukseset progresive në injeksi, vdekjet nga kanceri janë rritur dhe kjo tregon përhapjen e tij.

## MG KLINIKËN E GJENDJEVE KOMATOZE GJATË INSUFICIENCES SUPRARENALE

SHVEDENKO LL. A., BEREZHNIKCI M. N.  
Sovjetskaja medicina 1964, 3, 97.

Klinika e gjendjeve komatoze gjatë insuficiencës suprarenale pak është përshkuar në literaturë. M.Ja. Brejtman, G. Condek etj. krahas përshkrimit të Morbus Addison tregojnë se nganjëherë gjatë kësaj sëmundjeje zhvillohet gjëndja komatoze por nuk dhanë kuadri klinik të saj. Ka përshkrime të vetime të gjëndjes komatoze gjatë insuficiencës suprarenale nga S.G. Vajsbein, A.G. Tetelbaun etj.

N.K. Bogolepov përshkruan dy varjante të komës suprarenale me fenomene meningo-encefalitike dhe me sindrom abdominal. Autorët kanë vrejtur një rast të komës suprarenale me kolaps të shprehur, hipoksi dhe me ndryshime nga ana e sistemit nervor (fenomene meningo-encefalitike), kuadri klinik i ndryshëm i komës suprarenale mvarët siç duket nga shkalla e dëmtimit të suprarenaleve.

A.G. Tetelbaun përshkruan dy tipa të dekursit të komës gjatë insuficiencës suprarenale. 1— Koma gjatë dëmtimit të shprehur të suprarenaleve e cila çon në vdekje të të sëmurit dhe 2— Koma që zhvillohet tek i sëmuri me insuficiencë suprarenale gjatë sëmundjeve interkurrente dhe ka një prognozë të mirë.

Në rastin që përshkruajnë autorët u vrejt dëmtimi masiv tuberkular i suprarenaleve gjë që çojti në vdekjen e të sëmurit.

## DËMTIMI I VEZIKËS URINARE GJATË HERPES ZOSTER

GOLLUBJEV I. S., MAZO E. B.  
Kliničeskaja medicina 1964, 6, 134

Sipas mendimit të sotëshëm herpes zoster paraqet në vetëvehte një ganglioneurit virusal me dëmtim të rrënjeve posteriore. Simptomatika është e thjeshtë dhe bazohet në fenomene që duken në lëkurë (fshikzat). Shënjasë e tjera karakteristike janë: 1— shtrirja në grupe e fshikzave në një zonë që inervohet nga ky ose ai segment i medulla spinalis, ose gjatë rrugës së nervit më shpesh të 1— nervave interkostal 2— Më tepër lokalizohet unilaterali. 3— Dhëmbje me karakter nevralgjik në pjesën e lëkurës ku ndodhet dhe korespondon me degët e nervit.

Por në disa raste paraqet vështirësi diagnostike dhe kjo ndodh atëherë kur lokalizohet në organet e brëndëshme dhe vihen kështu diagnoza të gabuara si infarkt miokardi, apendicit, kolika renale etj.

Vezika urinare rrallë dëmtohet nga herpes zoster. Sipas Gais dhe Abrahamson 42 raste me herpes visceralis në 6 u vrejt hematuri dhe dizuri.

Në literaturën botërore autorët kanë mbledhur vetëm dy raste me dëmtim të vezikës urinare nga herpes zoster dhe njeri prej tyre u konstatua me cistoskopji.

Pastaj autorët përshkruajnë rastin e një të sëmuri me herpes zoster të vezikës

urinare. Dëmtimi i funksionit të vezikës urinare nga herpes zoster shpjegohet me marrjen pjesë në procesin patologjik të segmentit të II-III-IV lumbal-spinal. Gra-dualisht procesi inflamator shkakton hipertoni të vezikës urinare dhe fenomene dizrike.

Sipas Meyer, dëmtimit të vezikës urinare gjatë herpes zoster i bashkangjitet një infeksion sekondar që mund të çojë në cistit intersticial dhe atoni të vezikës urinare. Gjatë kësaj sëmundjeje mund të dëmtohen rrugët parasimpatike duke shkaktuar hipotoni të vezikës urinare dhe aplikimi i mjeteve parasimpatikotrope mund të forcojë tonusin e detrusorit që ndihmon kthimin në normë të urinimit.

### RAST I SHOKUT ANAFILAKTIK TË SHKAKTUAR NGA APLIKIMI I AMIDOPIRONËS

BALLAUDIN V. N.

Kliničeskaja medicina 1964, 5, 236.

Në literaturë autori nuk ka gjetur përshkrim të shokut anafilaktik nga aplikimi i amidopironës.

Përshkruhet rasti i një të sëmuri 36 vjeçar që erdhë në gjendje të rëndë, pa ndërgjegje, në lëkurën e fytyrës, gjoksit, barkut kishte urtikarie, në pulmone respi-racion të dobësuar vezikular, tensioni arterial 90/60 mmHg. Puls 96/minutë. Kur iu kthye ndërgjegjja pacienti tregoi se i filloi menjëherë me dobësi të madhe, vësh-tirësi në frymëmarrje, dhëmbje koke, prurit në lëkurë, errësim para syve dhe pastaj humbi ndërgjegjen. U sraqua se i sëmuri kishte pasur dhëmbje në dhëmb dhe për këtë kishte marrë një tabletë amidopirinë 10-15 minuta mëbas marrjes së saj i filluan shënjet e mësipërme. Një vit më parë pacienti kishte marrë amidopirinë dhe kishte pasur dhëmbje koke dhe urtikarie. Kështu që është e qartë se shoku anafilaktik lidhet direkt me marrjen e amidopironës.

### RASTI I REAKSIONIT ALERGIK PAS APLIKIMIT TË TETRACIKLINËS

KISELEVA A. S., KULLAGIN P. P.

Kliničeskaja medicina 1964, 5, 135.

Autorët kanë vrejtur një të sëmûrë tek i cili mbas aplikimit të tetraciklinës, tundi një reaksiون i rëndë alergjik që u çfaq në formën e urtikaries dhe edemës subkutane të fytyrës.

Tetraciklina jep shumë rrallë reaksione alergjike dhe prandaj nuk është e ne-vojëshme që cdo personi ti bëhet prova kutane, por është i domosdoshëm aplikimi i dozës test. Mjekimi me të duhet të fillohet me doza të vogla prove.

### KLINKA E «ABDOMENIT AKUT» GJATË PERIARTERITIT NODOZ

POPUGAJEV V. I.

Kliničeskaja medicina 1964, 5, 117.

Çështjet e diagnostikimit të «abdomenit akut» të shkaktuar nga periarteriti nodozi deri më sot nuk kanë marrë rëndësinë e duhur në literaturë. Autori përshkruan shkurtimishëm 2 raste të observuar prej tij.

Periarteritis nodozo u përshkrua në literaturë për herë të parë më 1866 nga Kusmaul dhe Meyer. Në kohën e sotme sipas R.V. Voleviç i kalonjë 1500 raste. E.M. Tarajev, Klemperer duke vrejtur se gjatë kësaj sëmundjeje dëmitohet indi lidhor-kolagen e futën atë në grupin e sëmundjeve të kolagenit-kolagenozave.

Kuadri klinik është mjaft i ndryshëm dhe prandaj ka vështirësi diagnostike.

Sympotmet e tij gjatë lokalizimit në abdomen karakterizohen me simptome të përgjithëshme dhe lokale. Sympotmet e përgjithëshme shprehë me lodhje, dobësi, temperaturë, vjellje, nauze, konstipacion. Në gjak konstatohet sedimentacioni i rritur, leukocitozë, neutrofili. Në feje ka gjak okult. Sympotmi lokal bazë është dhëmbja në abdomen gjë që e bën të sëmurin të drejtëhet dhe te mjeku. Lokalizimi dhe rëndësia e dhëmbjes varet nga vazet e kujt organi ose grup organi ka kap proçesi. Krahas kësaj kemi dhe prishjen e funksionit të organit.

Të sëmurët e përshkruar nga autori kishin të gjitha simptomat e lartëpërmëdura. Tek rasti i parë qoi në ileus dinamik, ndërsa tek i dyti në ileus mekanik me kuadrin e një peritoniti. Kështu fenomenet e një obturacioni me kuadrin e një peritoniti krahas me simptomet e përgjithëshme janë të dhëna bazë për vendosjen e diagnostës së periarteritis nodozo.

Cështja mbi indikacionet e ndërhyrjes operatorë gjatë arteritis nodoza me fenomenet e një «abdomeni akut» në literaturë nuk është përshkruar shumë. Por në bazë të atyre pak të dhënave ndërhyrja indikohet gjatë rupturës së aneurizmës, perforacionit të ulqerës së traktit gastrointestinal, apendicitit, fenomenet e ileusit.

## INFARKTI AKUT I MIOKARDIT DHE HEMORAGJITË GASTROINTESTINALE

NEBLINA E. M.  
Kliničeskaja medicina 1964, 3.

Mbi hemoragjitet gastro intestinale si një nga çfaqjet e mundësime të infarktit të miokardit kanë folur në punimet e tyre V.P. Vasilenko, M.Ju. Mjelikova, A.G. Tetelbaun etj.

E.G. Daniljak duke studjuar materialin e arkivit, nga 153 raste letale nga infarkti i miokardit 7,8% (12 raste) u konstatuan ndryshime akute në traktin gastrointestinal (ulcera dhe erozione gastrike, shumë hemoragji në mukozën e stomakut dhe të intestinit, ulcera në intestin). Të dhëna anamnestike përmorbus ulcerozus kishte vetëm n'dy. Hemoragjitet nuk janë të shkaktuar nga përdorimi i antikoagulantëve mbasi ato janë konstatuar gjatë indeksit të lartë të protrombinës, gjë që tregon lidhjen e pakët të hemoragjisë me dëmtimin e koagulabilitetit të gjakut.

Autori ka studjuar 365 të sëmure të infarkt miokardi (prej vitit 1953 deri në kohën e sotme), hemoragji gastrointestinale u çfaqën vetëm tek 6 (1,7%), prej tyre vdiqën 4. Në anamnezë morbus ulcerosus u konstatua tek një. Të gjithë ishin burra të moshë 43-70 vjeç. Pastaj autorri mirret me përshkrimin e shkurtër të këtyre rasteve.

Tek të gjithë të sëmuret hemoragjia gastrointestinale u zhvillua në periudhën akute të infarktit të miokardit, në orët e para të tij dhe jo më vonë se 31 ditë në kuadrin e kolapsit. Hemoragjia keqëson prognozën e infarktit.

Në 5 prej 6 të sëmureve u konstatua neutrofilozë, eozinopeni limfopeni, mononitrozë, ky gjithashtu u vrejt dhe në 75% të rasteve të tjera.

Autori bashkohet me opinionin e shumicës së autorëve që e shpjegojnë lindjen e hemorragjisë gastrointestinale gjatë infarktit të miokardit duke u nisur nga pozita e secilës me çfaqjen e reaksioneve jo specifike që lindin gjatë stress-it.

Hemoragjinë në orët e para të infarktit të miokardit e shpjegojnë me fazën e parë të stressit, me shokun që bën ndryshime të permeabilitetit vazal. Për konstatimin e dëmtimit në traktin gastrointestinal tek të sëmure të infarkt miokardi E.G. Daniljak rekomandon ekzaminimin e fejeve përgjak.

## MBI INFLUENCËN E ALKOLIT NË QARKULLIMIN KORONAR TEK TË SËMURET ME STENOKARDI DHE MORBUS HYPERTONIKUS

TETELBAUN A. G.  
Kliničeskaja medicina 1964, 3, 45.

Sipas Grotel në lidhje me rolin e alkoolit si një nga faktorët etiologjikë në gjenëzën e mbylljes akute të arteries koronare në infarktin e miokardit nuk ka të dhëna bindëse.

Këtë e bazon në të dhënat statistikore duke studjuar të sëmure që pinë dhe që nuk pinë alkool, dhe dei rapporti 35,7: 64,3. Megjithatë roli i alkoolit shihet nga dy pikëpamje: 1- Roli i alkoolit në dekursin e aterosklerozës dhe veçanërisht në atë

të arterieve koronare. 2- Influenca e alkoolit mbi gjëndjen funksionale të arterieve koronare (indirekt me anë të gjakut ose me rrugën e funksionit rregullues të kores së trurit).

Sipas Grotel, alkooli nuk juan ndonjë rol esencial në zhvillimin e aterosklerozës dhe vesanërisht asaj të arterieve koronare.

Pastaj autorë mirret me përshtimin e rasteve ku alkooli ka favorizuar zhvillimin e infarktit të miokardit dhe del me konkluzion se aplikimi i dozave të mëdha të alkoolit mund të shkaktojë tek të sëmurët me stenokardi dhe me morbus hipertotonikus infarkt miokardi dhe shpesh në një zonë të gjërë. Tek të sëmurët me aterosklerozë të shprehur të koronareve, infarkti i miokardit mund të provokohet dhe me doza të vogla alkooli.

Influenca e alkoolit tek njeriu i rritur mivaret nga sensibiliteti individual kundrejt tij. Rëndësi të madhe kanë gjithashu këto ose ato fenomene patologjike në organizëm. Vesanërisht sensibilitet të madh kundrejt alkoolit sipas vrejtjeve të autorit kanë njerëzit që vuajnë nga stenokardia ose morbus hipertotonikus ku sipas autoritës shtesë konstatuar që dozat e mëdha të alkoolit mund të shkaktojnë infarkt miokardi ndërsa dozat e vogla dhe mesatare jo rrallë favorizojnë lindjen e atakut të stenokardisë. Në E.K.G. në shumë raste vrehen ndryshime dinamike të qarkullimit koronar.

L.I.L. Fogelson tregon se marrja e dozave të vogla të alkoolit rrit shpejtësinë e qarkullimit të gjakut dhe sasinë e gjakut qarkullues shkakton shpesh rritjen e pressionit arterial. Dozat e vogla sipas tij zgjerojnë arteriet koronare. Këto që u thanë më si përkasin njerëzve të shëndoshë. Çështja mbi influencën e dozave të vogla të alkoolit mbi qarkullimin koronar tek të sëmurët me stenokardi ose morbus hipertonicus akoma është e pa qartë.

Patogjeneza e infarktit të miokardit dhe stenokardisë nga përdorimi i alkoolit akoma nuk është e plotë. Mund të lejohen disa hipoteza: 1- Ngritja, nën influencën e alkoolit, e permeabilititeti të mureve të arterieve koronare. 2- Ngritja e koagibilitetit të gjakut dhe shtimi i formimit të trombozave. 3- Veprimi i alkoolit në arteriet koronare nëpërmjet sistemit nervor (duke u dëmtuar funksioni rregullues i kortexit).

Sipas Llangut frenimi i korteksit cerebral dhe eksitimi i subkorteksit nga alkooli mund të kondicionojnë ataket e stenokardisës dhe të infarktit të miokardit.

Sipas I.A. Cernogorov alkooli mund të shikohet si agent që dëronton funksionin normal të sistemit nervor central dhe vesanërisht kontrollin ndaj sistemit vazal.

Pra shumica e autorëve mendojnë se alkooli vepron në sistemin kardio-vaskular nëpërmjet sistemit nervor dhe jo direkt mbi të.

## SINDROMI MARTORELL GJATË MORBUS HIPERTONIKUS (Patogjeneza, klinika, mjekimi)

ALEKSEJEV P. P.  
Kliničeskaja medicina 1964, 3, 79.

Në vitin 1964 Martorell mblodhi disa raste të ulçerës së gjurit, klinika e së cilës nuk vendosej në kuadrin e dëmtimeve vazale të njohura. Sëmundja u vrejt tek gratë në moshë 35-70 vjeç që vuanin për një kohë të gjatë nga morbus hipertotonikus.

Sipas Hines sëmundja ka patogenezën e saj dhe duhet konsideruar si morbus *suigeneris*.

Shkaku i dëmtimeve lokale të qarkullimit të gjakut gjatë këtij sindromi është obliterimi i arterieve dhe arteriolevë në një pjesë të kufizuar të ekstremiteteve Inferiore. Çrrëgullimi i trofikës dhe ulçerat lindin si rezultat i iskemisë së shkakëruar nga dëmtimi obliterues i arterieve të vogla të lëkurës më tepër në gjunjë. Hines, Alonso etj. konsiderojnë karakteristikë për këtë sëmundje presionin e lartë diastollik i cili është tregues i shkallës së lartë të spazmës vazale.

Sëmundja mund të lindi si rezultat i një traume të vogël ose presionit të veshjeve, influencë të keqë ushtron ngarkesa e gjatë për këmbët. Siç u tha më si përpjekohet më tepër në gra me presion të lartë diastolik mbi 100 mg., më shpesh në gjunjë në sipjërfaqen e përparëshme ku qfaqet një njolië e kuqe e dhëmbëshme e cila brënda 10 ditëve bëhet ciançtike dhe rrëth e gark purpurike, lëkura në këtë vënd është më e ftohtë se sa për rrëth. Fenomenet akute për disa muaj zhduken dhe janë pas një atrofi të lëkurës dhe hiperpigmentacion. Nganjëherë dëmtimet janë simetrike dhe bilaterale. Jo rrallë në këtë vend ngelet ulcer, me dhëmbje të forte

që atuk pushon as në shtrat, me diametër 1-15 cm. Karakteristike janë ndryshimet në fundus okuli të tipit të angiosklerozës. Ulçera herë çfaqet dhe herë çduket, por kurë nuk çduket krejtësisht. Autori ka vrejtë shpesh kombinimin e sëmundjes Reino me sindromin Martorell, të cilat kanë afërsi patogjenetike. Në fillim duhet mjekuar morbus hipertonus dhe pastaj preparanti me veprim lokal që të blokojnë angioreceptorët. Të gjithë autorët rekomandojnë simpatetominë.

### **MBI APLIKIMIN E DOZAVE TË MËDHA TË ACIDIT NIKOTINIK GJATË DËMTIMIT TË METABOLIZMIT TË YNDYRNAVË** (Tek të sëmurët me aterosklerozë dhe ksantomatozë).

**GANELINA I. E. KRIVORUÇENKO I. V.**  
Kliničeskaja medicina 1964, 3, 55

Vitamina PP gjeti aplikim në mjekësi nga viti 1930, në fillim u përdor specifike në pellagër, pastaj si vazodilatafore.

Sipas shumë autorëve, acidi nikotinik në doza 0,15-0,45 në ditë i përdorur për os ose parenteral tregohet efektiv në stenokardi për sëmundje të tjera që shoqërohen me angiospazmë.

Në metabolizmin yndyror sipas disa autorëve acidi nikotinik tregon veprim jo të kënaqëshëm në dozat e më sipërme duke shkaktoj tendencë për hipertolesterinemi dhe duke shtruar zhvillimin eksperimental të aterosklerozës tek lepujt.

Më vonë Altschu e b.p. përsëri tërroqën vëmëndjen e mjekëve se dozat e mëdha të acidit nikotinik 1-4 gr. pro die jepin efekt të shprehur hipokolesterinemik. Është konstatuar se prej tij ulet niveli i triglicerideve dhe përbajtjes së lipoproteideve (O'Reilly, Comesana etj). Sipas disa autorëve futja parenterale e tij shkakton tendencën në ngritjen e koagulabilititetit të gjakut kurse të tjerë në të njëjtën kohë thonë se ai favorizon fibrinolizën (Weiner, Wilson, Imhofel).

Autorët kanë mjekuar me acid nikotinik 30 të sëmurë me dëmtim të shprehur dhe të qëndrueshëm të metabolizmit të yndyrave për 2-3 vjet, 8 prej tyre (3 burra dhe 5 gra) vuanin nga ksantomatoza, ndërsa 22 nga aterosklerozë me predominim të asaj koronare. Të gjithë të sëmurët para mjekimit kishin dhëmbje anginoze, tek rë sëmurët u ekzaminua kolesterina sipas metodës Caketta, fosfolipidet sipas metodes, Devis, betalipoproteidet me elektroforezë.

F.A. Abdurahmanov përcakttoi gjithashu nxjerrjen e kolesterinës me feje dhe përbajtjen e kolesterinës dho acideve biliare në bilën hepatike (në porcionin C). U studjuat protrombina fibrinogeni, funksioni i gjëndrës tiroide me metabolizmin bazal dhe përbajtja e jodit lidhur me proteinat e gjakut. Mjekimi u fillua në klinikë dhe pas stabilizimit të kolesterinës u vazhdua ambulatorisht. Të sëmurët gjatë këtij mjekimi nuk morrën preparate të tjera që vepronin në metabolizmin e yndyrave. U fillua 100 mg. 3 herë në ditë mbas buke, pastaj u rritën dozat gjatë 4 ditëve 1,5 gr. në ditë, të tilla doza kanë marrë gjatë 2 javëve në qoftë se niveli i kolesterinës nuk ulet doza rritet deri në 3 gr. Zgjatja e kurës tek shumica e të sëmurëve ishte 4-8 javë, tek 6 të sëmurë zgjati 3-6 muaj. Kolesterolina ulet 2 javë mbas fillimit të kurës, ndërsa para mjekimit kolesterina ishte mesatarisht 350 mg%, mbas mjekimit 276 mg%. Niveli i larë i kolesterinës ishte më shumë tek ata me ksantomatozë 300-600 mg% dhe pas 4 javë ishte nën 300 mg%. Fosfolipidet u ndryshuan më pak gjatë mjekimit. Beta lipoproteidet e ngritura në ato me aterosklerozë, mbas mjekimit filluan të ulen. Tek ata me ksantomatozë serumi i gjakut që para mjekimit kishte pamjen e qumështit mbas mjekimit u bë transparent, kjo tregon uljen e nivitet të tri glicerideve në gjak. Kolesterolina e eliminuar me feje u ekzaminua në 10 të sëmurë, ndërsa përcaktimi i kolesterinës dho acideve biliare në bilë u bë në 3 të sëmurë. Vërehet rritja e nxjerrjes së kolesterinës me materjet fëkale dhe me bilë. Ekzaminimi i tyroides me anën e metabolizmit bazal u bë në 10 të sëmurë, ndërsa përcaktimi i jodit lidhur me proteinat e gjakut u bë në 9 të sëmurë. U vret tendencë e rritjes së metabolizmit, ndërsa niveli i jodit nuk u ndryshua 18 të sëmurë krahës këtyre u vret dho përmirësim i gjendjes së përgjithshme u ndërprenë ose u rralluan ataket e stenokardisë, u përmirësua gjumi, u zhduk zhurma në vesh, në ata me ksantomatozë, u zhdukën plakat ksantomatoze. Shumica e të sëmurëve e suportoi mirë acidi nikotinik. Sipas autorëve ky acid forcon funksionin e gjëndrës tiroide dhe ngren metabolismin bazal (Foffer, RD. Vjazovskaja, Perry etj).

Hipokolesterinemia që jep acidi nikotinik mund të lidhet me eliminimin e saj me bilë dho materje fëkale, normalizimi i metabolizmit yndyror lidhet me ngritjen e funksionit të gjëndrës tiroide.

Sipas Altschult veprimi i këtij acidi lidhet me forcimin e pro-

ceseve oksiduese intracelulare dhe krijimin e oksikolesterinës që lironet më lehtë nga gjaku se sa kolesterina. Efekti i mirë i Vit. PP gjatë stenokardisë mund të shpjegohet me krijimin në gjak të koncentracioneve të tillë të tij dhe me uljen e nivelit të kolesterinës. Gjatë përdorimit të dozave të madha dhe për një kohë të gjatë vreten fenomene anësore, më i shpeshti është shtimi i atakeve të stenokardisë.

## MBI INFLUENCËN E RESERPINËS NË QARKULLIMIN KORONAR

KURIANOVA E. I.

Kliničeskaja Medicina 1964, 3, 66.

Influenca e preparateve të Rauvolfies në qarkullimin koronar nuk është studjuar plotësisht.

B.P. Kushelevski dhe N.N. Kollotova tregojnë keqësimin e qarkullimit koronar gjatë mjekimit me reserpinë, forcimin e atakeve të stenokardisë, zhvillimin e infarktit të miokardit, duke i shpjeguar këto me aftësinë e preparatit për të ulur tensionin arterial dhe të eksitojë nervin vagus ateroskleroza koronare e shprehur sipas tyre është e kontraindikuar për të përdorur reserpinën.

Në të njëjtën kohë L.I. Veretjanov, A.G. Gukasian etj. vrejtën influencën pozitive të reserpinës në qarkullimin koronar dhe këtë e shpjegojnë jo vetëm me uljen e tensionit arterial por me tonizimin arterialis të miokardit i cili përmirëson ushqimin e tij dhe proçeset metabolike në të. Autori ka vrejtur 193 të sëmurë me morbus hipertonus prej të cilëve më 148 të sëmurë kjo shoqërohet me aterosklerozë koronare dhe qfaqje klinike të stenokardisë.

Të gjithë të sëmurët gjatë hyrjes në klinikë në fillim u mjetet me një positiivë të reserpinës në qarkullimin koronar dhe këtë e shpjegojnë jo vetëm me uljen e tensionit arterial por me tonizimin arterialis të miokardit i cili përmirëson ushqimin e tij dhe proçeset metabolike në të. Autori ka vrejtur 193 të sëmurë me morbus hipertonus prej të cilëve më 148 të sëmurë kjo shoqërohet me aterosklerozë koronare dhe qfaqje klinike të stenokardisë.

Të gjithë të sëmurët gjatë hyrjes në klinikë në fillim u mjetet me një positiivë të zakonëshme hipotensive. Në qoftë se tensioni arterial nuk ulej ose ulej pak atëherë pas 7-14 ditë i jipej reserpinë në doza 0,1-1 mg. në 24 orë e ndarë në 1-4 porçione, doza më e madhe në pjesën e dytë të ditës. Dozat ishin individuale dhe në mwartësi nga respiracioni i të sëmurit nga efekti i mjekimit.

U kontrollua tensioni arterial, ndryshimi i tij, i kontraksioneve të zemrës, u gjyku mbi ndryshimin e qarkullimit koronar në bazë të E.K.G. që u bë para dherës mësimeve, u pakësua shpejtësia e rrahjeve të zemrës në 60,6%. Tek 30 të sëmurë u zhduk dhëmbja në zémër. Forcimi i atakeve të stenokardisë gjatë përdorimit të reserpinës u vrejt në 2,7% të sëmurëve, pakësimi në 37%, zhdukja në 46,6%. Ndryshime nuk u vrejtën në 13,7%.

Zhudja osc pakësimi i shënjave të insuficiencës koronare në periudhën e mjekimit me reserpinë u regjistrua me E.K.G. në 23 të sëmurë.

Presioni arterial u ul deri në normal osc afér saj tek shumica e të sëmurëve me përmirësim të qarkullimit koronar, në krahasim me të sëmurët ku qarkullimi koronar u keqësua.

Në grupin e të sëmurëve me morbus hipertonus në shoqërohet me aterosklerozë koronare, përmirësimi klinik i qarkullimit koronar në periudhën e mjekimit me reserpinë u vrejt në 83,6%, të rasteve dhe u keqësua në 2,7%, të rasteve. Gjatë 3 vjetëve të sëmurët me morbus hipertonus marrën vazhdimisht doza reserpine nën kontrollin e repartit të kardiologjisë. Autori studjoi një grup tjetër të sëmurësh si kontroll me morbus hipertonus shoqëruar me aterosklerozë koronare të mjetuar me preparate vazodilatatore, një grup që u mjetet me ganglioblokuese etj. gjithësesit 32 të sëmurë me moshë 41-70 vjeç.

Si rezultat i mjekimit u arrit përmirësimi në 21 të sëmurë. Kështu që tek të sëmurët që u përdor reserpinë, përmirësimi i qarkullimit koronar është në një numër më të madh rastesh.

## REZOKINA NË KLINIKËN E SËMUNDJEVE TË BRENDËSHME DHE FENOMENET E MUNDËSHME ANËSORE GJATË APLIKIMIT TË SAJ

MAKARENKO I. I., LEVICKI E. R.  
Sovjetskaja medicina 1964, 3, 72.

Krahas veprimit të saj kryesor si antimalarike rezokina kohët e fundit ka gjetur përdorim në praktikën dermatologjike, akoma më gjërë në mjekimin e sëmundjeve alergjike, në disa forma të dëmtimit të veshkave (glomerulonefrit, amiloïdozë), dhe në aritmitë e zemrës.

Freedman dhe Bach propozuan me e aplikue rezokinën gjatë aritmisë reumatoide dhe kolagenozave.

Rezokina rekomandohet të aplikohet gjatë kolagenozave në doza 0,25 një herë në 24 orë mbas ushqimit.

Kron rekondon në dy javët e para 2 tableta në ditë, ndërsa Bäumer dhe Schwiete 3 tableta.

Vykdyal futi 1% solucion rezokinë në hapësirën e artikulacioneve në vënd të hidrokortizonit. E.M. Tarajev, V.R. Nasonova gjatë kolagenozave rekomandojnë mjekim të gjatë nga disa muaj deri në 2-3 vjet. Veprimi i preparatit është gradual dhe çafqet 4-6 javë mbas mjekimit.

Jep efekt të mirë në artrite, tek të sëmurët me stadh të herëshëm, pa ndryshime të thella organike.

Sipas autorëve kombinimi i rezokinës me preparatet hormonale gjatë kolagenozave jep efekt të dukëshëm dhe kjo rekomandohet të jepet gjatë ndërprerjes së hormoneve ose pakësimit të dozave të tyre. Në rast se mbas 2-3 muaj nuk jep efekt atëherë duhet të ndërpritet.

Mekanizmi i veprimit të rezokinës gjatë kolagenozave akoma nuk është studjuar në mënyrë të mjaftueshmë. Sipas Haydu preparatet frenojnë përpunimin në organizëm të adenozin-trifosfatazës si rezultat i së cilës përmirësohet kërkesa e indevetë të sëmurit me kolagenozë për acid adenozin trifosfatik. Ka gjithashtu të dhëna për veprim anestetik, jo specifik antilinflamator Rezokina tregon veprimin e saj antiinflamator si lokalishë ashtu edhe nëpërmjet rregullimit nervor. Überlant tregon përf influencën e rezokinës në zhvillimin e indit të granulacionit në vatrën e inflacionit. Keleman dhe Csoka panë ngritje të dukëshme të sekrecionit të 17 ketosteroideve nën veprimin e rezokino-terapisë.

## PËRMBAJTJA E DISA MIKROELEMENTEVE NË GJAKUN E TË SËMURËVE ME DIABETES MELLITUS

Kliničeskaja medicina 1964, 4, 113

V.P. Llisun, Lobanova duke elzaminuar përbajtjen e manginanit, bakrit dhe zinkut në gjakun e të sëmurrëve me diabet, vrejtën mvarësinë e elementeve të më sipërme me gjatësinë dhe formën e sëmundjes. Sipas disa autorëve mikrodozat e manginanit ndihmojnë depozitim në organizëm të vitaminës C dhe B<sub>1</sub> dhe tregojnë efekt lipotrop. Jonet e mangananit dhe të bakrit tregojnë veprim të ngjashëm me insulinën, sipas disa autorëve të tjerë pjesëmarrja e mikroelementeve në proceset biokimike përcaktojnë marrëdhënet midis mikroelementeve, hormoneve, vitaminave, proteinave dhe në veganti fermenteve.

Koncentrimi i mangananit, aluminxit, titanit, bakrit në gjak u përcaktua në 122 të sëmurrë me diabet mellitus me moshë nga 15,5-81 vjeç. Forma e lehti u konstatua në 19 të sëmurrë, mesatarja në 74 che e rëndë në 29. Në bazë të pasqyrave të përpunuara nga autori vrehet se tek njerëzit e shëndoshë kemi një sasi më të madhe alumini dhe titan dhe më pak mangan dhe bakër. Duhet nänvizuar se ulja e mikroelementeve në gjak me përjashtim të mangananit shkon krahas rritjes së sëmundjes. Sipas S.G. Genes në kohën e sotme nuk mund të kuptohet patogeneza e diabetit mellit përmarrë parasysh rolin e korteksit, hipotalamusit, sistemit vegetativ, endokrin dhe veganërisht hipofizën anteriore me suprarenala. Sipas V.R. Soroki eksitim i sistemit nervor shoqërohet me ngjiten e përbajtjes së mangananit, aluminxit, titanit dhe bakrit në gjak, dhe uljen e këtyre elementeve në hepar, tru dhe organe të tjera.

## NDRYSHIMET NË ARTIKULACIONE DHE NË KOCKA GJATË FORMAVE TË NDRYSHME TË HEMOFILISE

SHEVÇENKO V. J., SUHOVJEVA E. Ja.  
Kliničeskaja medicina 1964, 4, 109.

Ndryshimet kliniko rentgenologjike në artikulacione gjatë hemofilise janë përshtuar nga një sërë autorësh: Konik, S.A. Frejdberg, Doub, Davidson etj. Të gjithë këta autorë thonë se në artikulacione dhe kocka këto ndryshime fitojnë karakter shkatronjës dhe shpesh përfundojnë në ankiloza fibrocockore.

Më tepër vrehet hemoragi i artikulacionet e gjurit dhe të brylit, më rrallë në

kokso-femoral dhe talo-krural. Artikulacionet e vogla dëmtohen rrallë. Këto artroyatë hemofiliqë disa autorë (Jordan O.SH. Bauçitse) e klasifikojnë sipas stadeve.

Stadi i parë ose i herëshëm karakterizohet me rritjen e hijes artikulare si rezultat i hemorrhagjisë ose i sinovilit me kontraktura lëvizëse. Stadi i dytë karakterizohet me defekte tipike në sektorin subkondral në formë ovale ose në formë kistikë. Kemi dëmtime në formë krateri ose tubeli që janë karakteristike për hemofilinë e kockave, osteoporozë, rritja e epifizave dhe zvogëlimi i diafizave.

Shkaktohen kartilagot që çojnë në rafshim të sipërfaçes artikulare dhe ngushten qafa artikulare.

Stadi i tretë ose forma e rëndë karakterizohet me destruksion të plotë të sipërfaçes së dëmtuar dhe deformimin e strukturës trabekulare të metafizave. Vërehen kontraktura të qëndrueshme dhe fenomene të osteoartrozave deformante.

Petersen, Kahn tregojnë për disa raste të veçantë gjatë hemofilitës së përfshirur, miozite osifikante, dëmtime hemofilitike jashtë artikulacioneve dhe kockave.

Autorët kanë patur nën observacion 20 të sëmurë me forma të ndryshme të hemofilitës. Me ndihmën e testit tromboplastik hemofilia A u konstatua tek 9 të sëmurë, hemofilia B tek 4 të sëmurë dhe C tek 7 të tjerrë. Me hemofili A të sëmurët ishin në moshë prçj 2,5-36 vjeç. Sipas protrombinës nga 10-30% ishin 7 veta kurse mbi 30% 2 veta. Sasia e globulinës antihemofilitike ishte shumë e ulur. U vrejtën hemorrhagi në artikulacione që shoqërohej me ndryshime tipike të stadit të II dhe të III, më tepër në artikulacionet e gjurit dhe të brylit. Kishte në këtë grup hemartroza nga format më të lehta gjëra më të rëndat.

Nga 4 burra me hemofili B në moshë nga 12 deri në 23 vjeç 3 kishin hemartroza të shprehura të artikulacioneve të gjurit dhe të brylit. Sipas autorëve të sëmurët e të njëjtës moshë gjatë hemofilitës B përsa i përket ndryshimeve artikulare nuk ka ndryshim nga hemofilia A.

Interes të veçantë paraqesin ndryshimet osteoartikulare gjatë hemofilitës C. Në literaturë ka të dhëna se hemofilia C rrjedh më lehtë dhe nuk shoqërohet me hemorrhagi abundante dhe hemorrhagi në artikulacione. Ndërsa sipas autorëve gjatë hemofilitës C mund të kemi një dekurs të rëndë të sëmundjes që nuk dallohet në disa raste nga hemofilia A dhe B e i ndajnë të sëmurët në dy grupe. A-forma e shprehur e hemofilitës C që rrjedh me hemorrhagi të rëndë dhe hemorrhagi në artikulacione. B-forma e lehtë që karakterizohet me çafqjen e hemorrhagive të gjata dhe të hollësisht me vetëm pas traumave dhe ndërhyrjeve operatore. 7 të sëmurët me hemofili C kishin ndryshime artikulare të stadit të dytë dhe të tretë megjithëse gjatë kësaj forme takohen rrallë. Tek të sëmurë me protrombinë nga 13-24% dhe në remision 40% u vrejtën hemartroza të rënda që lindin që në periuadhën e herëshme të jetës. Kur protrombina është 23-26%, dhe në remisione 54% kemi hemartroza të stadiit të parë dhe të dytë që lindin vetëm në moshën 4-6 vjeç. Krahas ndërhyrjeve terapeutike kundër hemorrhagjisë influencë të mirë gjatë hemartrozave tregon rontgenoterapia e artikulacionit të dëmtuar. Përcaktimi i karakterit të ndryshimeve, metodat efektive të terapiës ndihmojnë në prevenimin e hemorrhagive nga artikulacionet dhe ruajtjen e funksionit të ekstremitit.

#### **PËRMBAJTJA E VITAMINËS B<sub>12</sub> NË GJAKUN E TË SËMURËVE ME DIABETES MELLITUS DHE RËNDËSIA E SAJ NË KOMPLEKSEN E TERAPISË**

GUMBATOV N.B.  
Terapevtiqeski arhiv 1964, 2, 59.

Gjatë diabetit melitus dëmtohen edhe metabolizmi i vitaminave. Metabolizmin e vitaminës B<sub>12</sub> dhe C e kanë studjuar shumë autorë.

Sipas Bosoli mekanizmi i vitaminës B<sub>12</sub> kondicionohet me prezencën në hepar i një lende të veçantë që duke u bashkuar me cianokobalaminën krijon një holoferment aktiv që vepron si katalizator në procesin e transmetitmit.

Autori studjoj përbajtjen e kolesterinës, lecitinës dhe vitaminës B<sub>12</sub> në gjakun e të sëmureve me forma të ndryshme të diabetit melitus të komplikuar dhe jo, para injekimit dhe pas, me insulinë e me sulfanilamide dhe të kombinuar me vitamинë B<sub>12</sub>.

Nën mbikëqyrjen e tij u ndodhën 110 të sëmurë me diabet melitus me moshë nga 19-72 vjeç, zgjatja e sëmundjes nga 1-5 vjet me formë të lehtë 34 të sëmurë, formë mesatare të rëndë 60 të sëmurë dhe të rëndë 16. Përbajtja mesatare e vitaminës B<sub>12</sub> tek njerëzit e shëndoshë është 450-800 mkmkg/ml. U përcaktua vitamina B<sub>12</sub> tek 76 të sëmurë me diabet, në 19 të sëmurë me formë të lehtë vi-

tamina  $B_1$ , ishte nga 420-760 mikromg/ml, në 36 të sëmure me formë mesatarsht të rëndë 380-540, në 15 të sëmure me formë të rëndë 280-400. Vitaminë  $B_1$ , tek të sëmure me diabet mellitus ulet paralel me rrjeten e rëndësisë së sëmurdjes dhe zgjatjes së saj. Nga autorë u vrejt se më e ngritur është kolesteroli dhe më e ulur lecita i në format e rënda të diabetes mellitus ose në format e kombinuar me aterosklerozë, endarterit etj.

Në bazë të vrejtjeve të autorit del se gjatë çdo forme të diabetit mellitus dhe me zgjatje të ndryshme terapija komplekse me vitaminën  $B_1$ , siguron efekt shumë të mirë, viganërisht kur diabeti është i komplikuar ose i shoqëruar me sëmundjet e tjera.

### ASMA BRONKIALE NË KLINIKËN E KOLAGENOZAVE

ELLKONIN B. LL., SHIMELJOVIC LL. B.  
Terapevtikë arhiv 1964, 5, 101.

Roli i faktorit atergjik në zhvillimin dhe dekursin e kolagenozave njihet prej shumë autorëve.

Interes paraqet studimi i raportit midis asmës bronkiale- sëmundjes klasike alegjike dhe formave të ndryshme të kolagenozave. Më tepër takohet shqërimi i asmës bronkiale me periarteritis nodoza dhe sipas Vilson dhe Aleksandér vrejtën asmën bronkiale në 18% të të sëmureve me periarteritis nodoza. Sipas Jimenez-Diez në disa raste astma bronkiale të çon në kolagenoza me transformimet e saja atipike.

Autorët kanë vrejtur shumë të sëmure tek të cilët astma bronkiale mund të shikohen si një qfaqje e sëmundjes kolagenoze. Pastaj ata mirren me përshkrimin e një rasti që paraqiste një vaskulit më tepër me dëmtim të enëve pulmonare dhe të zemrës që quan në zhvillimin e infarktit të miokardit dhe të shumë infarkteve pulmonare. Astma bronkiale tek i sëmuri që përshkruajnë ata që një nga qfaqjet e para të vaskulitit të qarkullimit pulmonar.

(Përmbledhur nga Margarita Vullkaj)

### RASTI RIGJENERIMIT TË SPLINËS MBAS SPLENKTOMISË

KRASOVSKIY I. J. KONDRAKOV V.M.  
Kliničeskaja medicina 1964, 5, 1924.

Disa autorë flasin për rigjenerimin e mirë të licnit, ata sjellin fakte mbi këtë mundësi dhe pas heqjes së tij të plotë. Zhvillohen fenomene hiperplastike në pulpë dhe në nyjet limfatike duke marrë këshfu funksionin e tij.

V.A. Florens mendon se pas splenektomisë së plotë tek lepujt mund të rigjenerohet plotësisht duke krijuar strukturën dhe funksionin e saj. Burim rigjenerimi janë nyjet limfatike të shtrira në hyrjen e arteries lienale duke krijuar një ndërtim tipik të ngjashmë me lienin.

Autorët përshkruajnë rastin e një personi me rigjenerim të lienit mbas splenektomisë që vdiq mbas një viti nga fenomenet e një ileusi akut dhe në abdomen u vrejt një organ  $10 \times 9$  mm që të kujtonte lienin. Siç treguan ekzamintimet mikroskopike ndërtimi i tij përsërisht atë të lienit. Ka disa autorë që mohojnë mundësinë e rigjenerimit të lienit. Mundësia e rigjenerimit të lienit tek njeriu është i mundur dhe sidomos në moshë të re ku fuqitë kompzesatore rigjenatore të organizmit janë të shprehura më shumë.

### MJEKIMI I MORBUS HIPERTONIKUS ME PREPARAT TË RI GANGLIOBLOKUES SINAPLEG (PEROLIZEN)

SULTANOV M. N., ERINA E. V.  
Kliničeskaja medicina 1964, 3, 71.

Preparatet ganglio-blokuese filluan të përdoren për mjekimin e morbus hipertonikus nga viti 1961. Aplikimi më të madh morën pentamina, heksametoni, pentapirolidina që kanë veprim hipotensiv gjatë përdorimit parenteral. Dobësia e tyre qëndron se veprojnë për një koqë të shkurtër.

Më vonë u përdor preparati i ri sinapleg dhe kramfon që kanë një veprim më të madh gangliosimpatik dhe që thithen peroral. Qëllimi i autorëve ishte studimi në

klinikë i veprimit kurues gjatë *morbus hipertonicus* të preparatit hungarez sinapleg ose anglez perolizën.

Mjekimit iu nënshtruan 50 të sëmuri me moshë 30-59 vjeç 5-7 ditë para mjekimit u përcaktua tensioni arterial. Doza fillëstare 2,5 mg. në fillim iu mat tensioni arterial shtrirë, ulur dhe në këmbë qdo gjysëm ore dhe pastaj qdo orë për 6-8 orë. I sëmuri duhet të qëndrojë 1-1,5 orë mbas marrjes së preparatit shtrirë. Ulja e tensionit arterial nganjëherë shoqërohet me shpeshtësimin e pulsit sidomos gjatë qëndrimit në këmbë. Doza efektive e preparatit është 5 mg; ulja maksimale e tensionit arterial fillon mbas 1-2 orë dhe ruhet për 5-12 orë, prandaj preparati i jipet 2-4 herë në ditë. Doza ditore ndryshon simbas individit nga 10-60 mg. Nga 50 të sëmuri i5 u mjekuan vetëm me sinapleg, ndërsa tek 35 u përdor ky preparat në kuadrin e efektit të pamjftueshëm të rezerpinës për 20-25 ditë. Si rezultat i mjekimit vetëm me këtë preparat ose të kombinuar, u arrit efekti hipotensiv dhe u pakësuat shumë simptomet tek 31 të sëmuri, presioni sistolik u ul 30-50 mmHg, ndërsa diastoliku 20-40 mmHg. Si fenomen atësor i preparatit ishte blokada parasimpatike e ganglioneve intestinale me zhvillimin e konstipacionit dhe meteorizmës dhe nganjëherë pareza e vezikës urinare. Për të zhdukur këto fenomene është përdorur kombinimi me preparatet e reserpinës ose me hipotiazid për 2-8 javë. Sipas autorëve është më mirë të fillohet kura me reserpinë dhe kur kjo nuk ka efekt të mjaftueshëm pas 10-15 ditësh fillohet sinapleg-u. Ulja duhet të bëhet gradualisht për 5-8 ditë dhe të ngrihet doza e reserpinës ose e hipotiazidit. Dozat e orepidatit janë individuale dhe nganjëherë preparati mund të japi kriza hipertonike.

### MBI ÇËSHTJEN E TERAPISË ME ANTIKOAGULANTE

SHAHBAZIAN E.S.

Kliničeskaja medicina, 1964, 3, 122.

Interes të madh praktik paraqet çështja e zgjatjes së terapisë me antikoagulantë, veçanërisht në periudhën mbas infarktit. Antikoagulantët, sikurse dihet, dozohen në mënyrë individuale nën kontrollin e kujdesëshëm dhe sistematik të mjekut. Afati i aplikimit është i ndryshëm dhe mvarët nga vëgoritë e këtij apo atij rasti, nga disa ditë deri në 3-6 muaj dhe disa herë më tepër. Janë të njohur rastet e përdorimit të antikoagulantëve gjatë 5,5 vjetësh. (Suzmann, Ruskin, B.P. Kushelevski).

N.G. Rabinoviç përmënd vrejtjet e disa kardiologëve amerikanë të publikuar në vitin 1958 mbi mjekimin e të sëmuri të me antikoagulantë me afat 1-8 vjet me rezultate pozitive.

Autori përshtkuar rastin e një të sëmuri që mori antikoagulantë pa pushim për 7 vjet me radhë pa ndryshime të dukëshme të funksioneve jetësore dhe në mungesë të ndryshimeve morfollogjike të gjakut. Nuk është vrejtur ambientimi i të sëmurt ndaj pelenantit dhe fenilinës. Gjatë sklerozës së arterieve korenare të kombinuar me sklerozën e arterieve të ekstremiteteve inferiore, me fenomenet e një endarteriti obliterans, përdorimi i gjatë dhe pa pushim i antikoagulantëve, duke mbajtur indeksin e protrombinës 40-50%, janë një nga mjetet më racionale në luftë për formimin e trombuseve.

### NDEYSHIMET E PËRMBAJTJES SË PROTEINAVE TË PËRGJITHËSHME DHE FRAKSIONEVE PROTEINIKE NË SERUMIN E GJAKUT GJATË REUMATIZMIT

BACEVIÇ A.A.

Sovjetskaja medicina 1964, 3, 33.

Elektroforeza është një metodë e saktë dhe objektivo për të pasqyruar ndryshimet proteinike të gjakut dhe ka gjetur aplikim të gjërë në klinikë.

Disa autorë mendojnë se përmbajtja e proteinave në gjak gjatë reumatizmit nuk ka të normën, ndërsa të tjerë thonë që niveli i proteinave të përgjithëshme gjatë fazës aktive ka tendencë të ngrihet, krahas kësaj në literaturë ka të dhëna mbi uljen e proteinave të përgjithëshme gjatë kësaj faze. Në fazën aktive është karakteristike ulje e sasisë së albuminave në mvarësi uga rëndësia e fenomeneve

klinike dhe rritja e globulinave dhe si rezultat koeficienti albuminë globulinë ulet. Tregues të procesit aktiv konsiderohen ndryshimet e fraksionit të globulinave sipas M.S. Vovki etj., tregues i procesit aktiv janë ngritja e alfa<sub>1</sub> globulinave, ndërsa M.V. Bavina, Hansen, Baser etj. konsiderojnë si tregues më të mirë rritjen e një-kohëshme të alfa<sub>2</sub> dhe gama globulinave.

Autori ka patur si qëllim të tregojë ndryshimet e kuadrit proteinik të gjakut gjatë fazave dhe formave të ndryshme të reumatizmës.

U muan një grup kontrolli me njerëz të shëndoshë prej 20 vëtash në moshë 19-35 vjeç. Sasia e proteinave ishte 7,91 prej të cilave albuminë 60,8% alfa<sub>1</sub> globulina 4,8%, alfa<sub>2</sub> globulina 7,1%, beta globulina 10,7%, gama globulina 16,3%. Koeficienti albuminë globulinë 1,55%.

U ekzaminuan 111 të sémurë me reumatizëm me moshë 16-67 vjeç. Në mvar-tësi nga faza dha dekursi i procesit reumatizmal të gjithë së sémurët u ndanë në pesë grupe. 56 të sémurë dhe fazë aktive me dekurs akut dhe subakut. 2-12 të sémurë fazë aktive me dekurs latent. 3-19 të sémurë fazë e qetësimit të procesit aktiv, 4-14 të sémurë faza jashë atakut. 5-10 të sémurë me endokardit septika lenta. Pastaj autorri përshkruan një tablicë nga del se përmbytja e proteinave të përgjithëshme në fazën aktive me dekurs akut dhe subakut ka tendencë të ulet dhe vazhdon të qëndrojë e tillë në fazën e qetësimit të fenomeneve aktive. Gjatë kësaj faze shihet ulja e albuminave me ulje të koeficientit albuminë globulinë. Rriten alfa<sub>1</sub> dhe veçanërisht alfa<sub>2</sub> dhe gama globulinat. Këto sipas autorit janë tregues të procesit aktiv reumatizmal. Rritja e beta-globulinave nuk u vrejt.

Në fazën e dytë ulja e albuminave është më pak e shprehur por ruhet ngritura e alfa<sub>2</sub> globulinave dhe më pak e alfa<sub>1</sub> globulinave. Në fazën e tretë, shihet përmirësimi i proteinogramës përfi logari të sasisë së albuminave dhe ulja e alfa<sub>2</sub> globulinave. Përmbytja e alfa<sub>1</sub>, beta dhe gama-globulinave i afrohet normës. Faza e katërt nuk ka ndryshim në fraksionet proteinike nga grupi i kontrollit.

Gjatë prezencës së insuficencës kardio vaskulare gr. II-III tek 16 të sémurë me fazë aktive u vrejt ulja e sasisë të proteinave dhe albuminave.

Pas 20-30 ditë mjekimi të poliartritit reumatizmal vrehet normalizimi i proteinave.

Një kuadër tipik i proteinave u vrejt tek 10 të sémurë me endokardit septika lenta. Përmbytja e proteinave të përgjithëshme është pak e ngritur, vërehet ulja e albuminave dhe alfa<sub>2</sub> globulinave. Janë shumë të rritura gama globulinat që është karakteristike përfi këtë endokardit dhe e dallon nga endokarditi reumatizmal. Kur kemi ngritje të njëkohëshme të alfa<sub>1</sub>, dhe gama globulinave flet përfi një formë kalimtare, të endokarditit reumoseptik.

## MBI QËSHTJEN E MJEKIMIT TË EDEMËS AKUTE PULMONARE

RABINER A.P.  
Kliničeskaja medicina 1964, 5, 138

Edema pulmonare paraqet një rrezik direkt dhe serioz.

Vëmëndja e autorit është tërhequr nga propozimi i Lusid në lidhje me aplikimin gjatë edemës pulmonare akute të inhalacionit të alkoolit etilik. Përfi këtë oksigjeni kalon nga balloni në një enë me alkool 96° dhe mbasi ngopet me avujt e tij jetet me një shpejtësi 2-3 litra në minutë dhe pastaj 10 litra në minutë. Këtë metodë autorri e kombinon me respiracion të drejtuar nën presion. Duke hyrë me presion krijon një kundër-veprim ndaj likuidit që fillohet në alveole, nga ana tjetër ngritja e presionit në rrugët respiratore krijon një presion të rritur intrapleural me pakësim të rrymës së gjakut në ventai e zemrës së djathtë dhe në garkullimin pulmonar.

J.A. Lazaris dhe I.A. Serebravskaja mendojnë se shkaku më i rëndësishëm dërekt i edemës pulmonare është ngritia e presionit hidrostatik në kapilarët e qarkullimit të vogël dhe rritja e permeabilitetit të murit kapilar. Prandaj duhen përdorur mjete që ulin permeabilitetin vazal (CaVI, Vitaminë C, mjete antihistaminoke). Po të ketë hipertoni ose tension normal përdoret eufilina, përdoret morfinë përfi hequr eksitacionin psiko-motor. Po të ketë bradicardi bëhet atropinë.

Autori ka vrejtur edemë pulmonare në 8 raste. Tek njëri u zhvillua 6 orë mbas komisurotomisë mitrale në sfondin e një insuficencë kardiovaskulare progresive. Tek një tjetër 1,5-2 orë mbas perikardektomisë etj.

Pastaj autorri tregon skenën e mjekimit të edemës akute pulmonare.

1— Dhënia e oksigjenit që kalon në alkool 96°. Ingalesioni vazhdon 30-40 minuta me 10-15 minuta pushim.

2— Futija intravenoz 10 ml 10% CaCl<sub>2</sub>.

3— Futija subkutane 1%-1 ml morfinë.

4— Gjatë bradicardisë 0,1%-1 ml atropinë.

5— Në fenomene të dobësisë kardiakë 0,5 ml 0,05% atrofiminë në 20 ml 40% glu-

kozë intravenoz ngadalë.

7— Kur tensioni është normal ose i rritur 0,5 ml 5% pentaminë në 10 ml 40% gluközë.

8— 2 ml 2,5% pipolfen intramuskular.

9— 20 ml 40% gluközë me 100 mg vitaminë C.

Në qoftë se këto masa nuk ndihmojnë dhe tek i sëmuri theksohen shënjat e insuficiencës respiratore, atëherë mirren këto masa:

1— Bëhet trakeostomia ose intubacioni i trakesë dhe i dërgohet oksigjen i ngorpur me avaj të alkoolit.

2— Hiqet në mënyrë periodike mukusi nga trakeja.

3— Me anë të aparatit të narkozës bëhet respiracioni i drejtuar nën presionin 20-30 cm. të shyllës së ujit.

## RËNDERESIA E ALDOSTERONIT NË PATOGENEZËN E SINDROMIT EDEMATOZ DHE HIPERTONIK GJATË SËMUNDJEVE TË VESHKAVE

GERASIMOVA E. N., PALEJEVA F. M., RATNER N. A.

Terapevtikësh arhiv 1964, 3, 40.

Që nga viti 1953 u nda hormoni i ri i kores së suprarenale aldosteroni por akoma qëndron i paqartë roli i tij në patogjenezin e edemave dhe të hipertonive.

Nga ekzaminimi klinik është vrejtur sekrecioni i rritur i aldosteronit tek të sëmurët me edema nefrotike e tek të sëmurët me hipertoni renale.

Autorët për të studjuar rëndësinë e aldosteronit në patogjenezin e edemave dhe hipertonisë, kanë marrë nefritin kronik i cili sikurse dihet paraqitet në 3 forma, edematoze, edematoze-hipertonike dhe hipertonike. Gjithashtu autorët kanë marrë hipertonitë simptomatike renale lidhur me sëmundjet e tjera si pielonefriti kronik dhe okluzioni i arterisë renale kryesore.

U studjuan 56 të sëmurë, 47 me nefrit kronik difuz (12 forma edematoze, 22 hipertonike, 8 edematoze-hipertonike dhe 5 pa edema dhe hipertoni), 7 me pielonefrit kronik, 2 me okluzion të arterieve renale. Ekzaminime analoge u bënë në 30 persona të shëndoshë, si grup kontrolli. Iu dha një dietë ku përbajtja e natriumit ishte 2,6-2,8 gr. ndërsa të shëndoshët morrën ushqim pa kufizim të natriumit. Më poshtë autorët paraqesin një tablicë me rezultatet e arritura ku shihet se tek të sëmurët me nefrit kronik në formë latente përbajtja e aldosteronit ishte 5,3 mkg. për 24 orë. Tek pacientë me edema në formë edematoze ose edematoze hipertonike sekrecioni i aldosteronit ishte i ngritur, gjatë formës edematoze 19,8 mkg. në edematoze hipertonike 20,4 mkg. hipertonike 14 mkg. Kemi ulje të dukeshme të natriumit në urinë. Në formën edematoze 0,9 gr. edematoze hipertonike 1,4 gr. tek të shëndoshët 4,5 gr. Tek ata me hipertoni 24 gr. që korespondon me natriumin që mbahet në racionin ushqimor.

Kështu, në formën edematoze dhe edematoze hipertonike rritet shumë nxjerrja e aldosterosit dhe ulet ajo e natriumit, ndërsa në formën hipertonike rritja e nxjerrjes së hormonit nuk çon në uljen e natriumit. Në rastet e tjera të hipertonive renale simptomatike rritja e nxjerrjes së aldosteronit nuk çon në pakësimin e nxjerrjes së natriumit.

Tek të sëmurët me edema në formën edematoze dhe edematoze hipertonike të nefritit kronik, shikaku që çon në ritjen e nxjerrjes së aldosteronit është humbja e proteinave në urinë, kjo çon në uljen e proteinemisë, të volumit intravazal dhe stimulimit e surenaleve për prodhimin e aldosteronit siç është treguar në eksperiment tek kafshët nga Bartter. Rritja e aldosteronit në gjak influencon në furnizimin e absorbimit të natriumit në kanalët renale dhe kjo bën të kalojë natriumit dhe uji në hapësirat interceliare që pakëson volumin intravazal dhe shton stimulimin e surenaleve për sekrecionin e aldosteronit. Lind kështu një rreth vicioz që ndihmon renat që pakëson volumin intravazal dështim që lindjen e edemave. Gjatë formës hipertonike humbja e proteinave me urinë nuk është e madhe prandaj nuk vrehet ulja e proteinave në gjak, dhe hipertonitë nuk mund të quhet si faktor stimulues i sekrecionit të aldosteronit.

Gjatë formës hipertonike dhe hipertoniive renale simptomatike mund të shënohet se vepron mekanizmi renin-hipertensiv. Kjo është provuar në mjekimin e hipertoniive simptomatike renale me démitim të njerës veshkë ku nefrektomia ka treguar jo vetëm influencë hipotensive por ka çuar dhe në uljen e nxjerries së aldosteronit. Gjatë sindromit edematoz dhe hipertonik tek të sëmurët me sëmundje renale vretet një hiperaldosteronizëm sekondar, porse mekanizmi që çon në sekrecionin e aldosteronit është i ndryshëm ashtu si dhe çfaqjes klinike janë të ndryshme. Tek disa vreten edema, tek disa hipertoni dhe tek të tjera edeme dhe hipertoni së bashku.

Në sindromin hipertonik hiperadosteronizmi realizohet me rrugën e katunit të joneve të sodiumit prej hapësirave ekstracelulare në celula dhe në vegantë në muskulaturën e murit vazal që çon në fryrjen e saj, në ngritjen e tonusit dhe të rezistencës periferike. Mekanizmi renin-hipertensiv çon nga njëra anë në ngritjen e tonusit të enëve periferike dhe nga ana tjetër në stimulin e sekrecionit të aldosteronit nga surenalet. Influensa e aldosteronit gjatë sindromit hipertonik qfaget me démitin e metabolizmit të elektroliteve në murin e arterioleve. Të dy këto mekanizma shihen në formën edematoze hipertonike si në shtimin e reabsorbimit të sodiumit në kanalëzat renale dhe mbajtjen e sodiumit në organizëm dhe zhvillimin e edemave dhe në ndryshimin e elektroliteve në murin e arteriolës që ndihmon në zhvillimin e hipertonisë. Sekrecioni i aldosteronit në këtë formë bëhet nën influencën e proteinurisë dhe iskomisë renale me mekanizmin renin hipertensiv.

## MBI QËSHTJEN E AGRANULOCITOZAVE RECIDIVANTE

RUBZITIS M. F.  
Terapeutiqeski arhiv 1964, 3, 50.

Schultz në vitin 1922 solli përherë të parë termin agranulocitozë gjë që karakterizohet me ardhjen e shpejtë dhe dekursi akut dhe përfundim letal.

Beck më 1933 përshkroi 5 tipe të dekursit klinik: *Agranulocitosis fulminans, agranulocitosis subacuta, subcrónica, ciclica, recidivans* ose *recidivans*.

Karakterin recidivues të saj për herë të parë e vuri re Leabe më 1910. Reiman dhe De Berardini publikuan 17 raste me agranulocitozë recidivante dhe vunë re si metodë të vetëm efektive splenektominë. Tek shumica e të sëmurëve zhvillimi i recidivave kondicionohet nga aplikimi i medikamenteve.

Disa autorë mendojnë se në bazë të agranulocitozës recidivante janë infeksionet periodike që akutizohen. Sipas Fitz-Hygh dhe Krumbhaar agranulocitoza periodike vjen si rezultat i deficitit të atyre lëndëve që janë të nevojshme për të phekur leukocitet.

Autori ka mbledhur vetëm arganulocitoza recidivante nga viti 1958-1961. U mjekuan gjithësejt 30 veta me agranulocitozë prej të cilëve 9 me agranulocitozë recidivante; nuk janë futur agranulocitozat simptomatike nga medikamentet, rontgeni etj, pra janë vetëm agranulocitoza esenciale. Ishin 8 gra dhe një burrë me moshë 35-72 vjeç. Me dy recidiva ishin 3 të sëmurë, me 3 recidiva 3 të sëmurë, me 5 recidiva 2 të sëmurë, një e sëmurë kishte 12 recidive. Nga 9 të sëmurët një që ishte dhe më e vjetra në moshë vdiq, kurse të tjerët u përmirësuan. Në shumicën e rasteve recidivat predispozoohen nga lodhja fizike ose psiqike, dhëmbja e fortë ose ndërhyrja operatore. Intervalalet midis recidivave ishkunden nga 2 javë deri në 41 muaj. Pastaj autorë me përshkrimin në tre rasteve më interesante.

Kuadri kliniko hematologjik i sëmundjes tek personat e studjuar nga autorë nuk ndryshon nga ai i zakonëshmi por në disa raste mund të rrjedhë me numur normal leukocitesh.

Kohët e fundit si mijete terapeutike përdoren hormoni adrenokortikotrop dhe kortizoni. Zgjatja e periudhës akute tek ata që u mjekuan me horimonoterapi ishte mesatarisht 6 ditë, në atë që u mjekuan me preparate të tjera 13,5 ditë.

Fakti që me agranulocitozë sëmuren më tepër gratë lidhet me vëgoritë hormonale të grave. Rëndësi në zhvillimin e agranulo-citozës ka gjithashtu reaksioni i organizmit dhe në një sërë rastesh mund të shikohet si sëmundje adaptimi.

## **MBI QËSHTJEN FUNKSIONIN E KORES SUPRARENALE GJATË MJEKIMIT TË ZGJATUR ME KORTIKOSTEROIDE**

FLEISHMAN E. V.

Terapevtiqeski arhiv 1964, 4, 98.

Kortikosteroide kanë gjetur një fushë të gjërë aplikimi por megjithatë dhe komplikacionet janë të shumta. Në eksperiment është provuar se futja e korrikosterolave shikton pakësimin e peshës së suprarenaleve, të shtrësës kortikale, pakësimin e sasisë së lipideve dhe acidit askorbinik në pjesën kortikale dhe pakësimin e sekrecionit të kortikosteroideve. Lindin gjithashtu ndryshime degenerative dhe atrofike në hipofizë. Salossa, Goth, Bierich vunë re uljen e funksionit të sistemit hipofizo-adrenalin nën influencën e terapisë së zgjatur me kortikosteroide në klinikë. Në bazë të të dhënave të literaturës hipofunksioni i sistemit hipotalamo-hipofizosurenal pas futjes së zgjatur të steroideve është i përkohëshëm dhe reversibël, vendoset funksioni i humbur pas 10-20 ditë, këtë e kanë provuar në mënyrë eksperimentale dhe klinike Money, Andersson, Winter etj.

Sipas E.M. Tarajev nga 13 të sëmurë të mjekuar gjatë me kortikosteroide vetëm tek njëri në seksion u vrejt atrofia e kores së suprarenaleve.

Autori ka si qëllim të sqarojë shkallën e shpejtësisë së vendosjes së funksionit «bazal» dhe «rezervë» të sistemit hipofizo adrenalin gjatë terapisë së zgjatur me kortikosteroide. Si tregues i funksionit dinamik të kores së suprarenaleve u morrën 17 hidroksi-kortikosteroide në afazë të ndryshme mjekimi. Në influencën e ACTH, testi i Thornit, kurba glicemike, metabolizmi elektrolitik hidroksikortikosteroidi është një hidrokorizon dhe produkti i metabolizmit të tij një glukokordikoid bazë tek njeriu. Si kontroll u muarrën 6 persona të shëndoshë në moshë nga 20-32 vjeç dhe 14 të sëmurë pa shënja të dëmtimit endokrin. Nxjerra e 17 hidroksikortikosteroideve tek personat e kontrollit ishte nga 1,2-1,5 mg në 24 orë që korespondon me vlerat normale të tyre. Pastaj u studjuan 46 të sëmurë 30 gra dhe 16 burra të mjekuar gjatë me kortikosteroide. U përdorën dhe injeksione ACTH. 17 hidroksikortikosteroide pas futjes së ACTH u rritën 2 herë. Tek të gjithë të sëmurët, pamvarësishët nga zgjatja dhe taktika e mjekimit, sekrecioni i kores suprarenale filloj jo më vonë se 2-3 javë mbas ndërpërjes së kortikosteroideve dhe tek shumica në ditën e dytë. Kështu që terapia e zgjatur me kortikosteroide krijon një rrezik për një sëmundje të dytë, insuficiencën kronike suprarenale, funksioni bazë i së cilës vendoset menjëherë mbas ndërpërjes së tyre. I sëmuri duhet të jetë nën kontrollin e mjekut të paktën një vit mbas ndërpërjes së tyre.

(Përbledhur nga Milto Kostaq)

## **USHQIMI I PREMATUREVE**

M. LELONG

Pres. Med. 72 Nr. 27 30 Maj 1964. fq. 654.

Autori përmend metodat që ka përdorur në qendrën e prematurëve të shkollës së Puerikulturës, gjatë 15 vjeteve, në të porsalindurit me peshë lindje nën 1800 gram. Ushqimi bazë duhet të plotësojë nevojat kualitative dhe kuantitative, racioni hidrik mbas të 10-tës ditë të lindjes është të paktën 150 cm. kubik për kg. peshë në ditë që duhet të përbajnjë mesatarisht 120 kal. për kg. peshë në ditë. Fëmija premature ka nevojë sidomos për protide (nga 4-6 gr. për kg. peshe në ditë) dhe glucide (12-15 gr. për kg. peshe në ditë). Qumështi nënës është ideal por më konditë që të jetë i pasuruar. Ushqyerja kryhet me anë të sondës që përdoret në çdo ushqim. Volumi i dhenës në çdo gavazh ka pak rënësi, ushqyerjet të janë të shpeshta (10-12 në 24 orë). Përpara ka qenë zakon që 48 orët e para fëmija të lihes pa ngrenë por tashtë ka argumenta kundër këtij «agjërimi» sistematik (acidoze, humbje e tepërt e rezervave glucidike) dhe prandaj sot ka prirje që fëmija të ushqehet sa më horët dhe bille t'i jepen glukoze me anë pâraenterale në rastet e anoksisë.

**GABOB-I NË PEDIATRI**  
(Studim klinik dhe elektroencefalografik i 28 rasteve).

F. BERTAMINO, R. VENTO  
Min. Ped. vol. 16. Nr. 20-30 Qershor 1964, fq. 714-730.

Autorët jepin njoftime mbi dy preparate farmakologjike, «Gaba» dhe «Gabob» që në këta vjetet e fundit janë përdorur për kurimin e epilepsisë. I pari (Gaba) që është vrejt për herë të parë në trurin e sisorëve në 1950 nga Awapara dhe që identifikohej me «Factor I» të Flory, bën pjesë në metabolizimin oksidativ cerebral dhe rrjedh nga acidi glutamik për veprim të 1 glutamik — dekarbossilasi (enzimë që gjendet vetëm në S.N.C.) në presencë të vitaminës  $B_6$  si koferment.

Punimet e shumta kanë treguar në mes tjerash, një paksim të Gaba-s dhe të Gabob-it në Korteksin e irurit të njeriut që vuan prej epilepsie, një pakësim të Gaba-s në korteksin e kafshëve të trajtuar me substanca konvulsionante dhe me antimetabolite të vitaminës  $B_6$ , një veprim mprojës së Gaba-s ndaj shfaqjeve konvulsive të provokuara (nga megimidi, metionina, sulfomixina, idrazidi, pentametilen tetrazoli, striknina dhe stimulim elektrik i korteksit).

Megjithëse nuk ka qenë e mundur të tregohesh eksperimentalisht shtimi i koncentrit encefalik të Gabo-s, mbas soministrimit të kësaj me rruge të ndryshme, shumë autorë mendojnë se, në disa rrethana të veçanta, ky aminoacid kalon nga bariera ematoencefalike sepse është konstatar prezenca e saj në liquor c.s. mbas dhënieve për os.

Përsa i përket «Gabob»-it, është treguar nga shumë autorë se ky është 5-10 herë më aktiv se «Gabo» dhe se ndryshe nga ky i fundit që mund të japë konvulsione të përgjithëshme kur jepet me rruge endorakide, shkaktor një veprim inhibitor konstant. Autorë japonezë (Takashita e Nagai) kanë trajtuar me Gabob 50 epileptikë dhe kanë patur përmirësimë në 38 prej tyre (76%), Ikiishi në 83% të pacientëve dhe mbas këtyre edhe autorë të tjerë, kanë patur rezultate kush më të mira e kush më të pakta. Në të gjitha rastet e përshtkuara «Gabob»-i është dhënë me doza nga 0.5 në 3 gr. pro die per os dhe rrallë për rruge paraenterale; në disa raste është përdorur si i pari dhe i vetmi farmak antikomial por në shumicën më të madhe të rasteve është dhënë bashkë me preparate antiepileptike që pacientët merrin përapara por që pastaj u reduktuan ose u lanë fare.

Përmirësimet e vrejtura ishin nga ana klinike, pakësimi numerik deri në zhdukjen e plotë të krizave konvulsive me ndikim të mirë edhe mbi çrrregullimet e karakterit që janë tipike për disa epileptikë. Ky përmirësim klinik, shoqërohet në rastet e kontrolluara me E.E.G. me një pakësim ose zhdukje të çrrregullimeve elektrografike parosistike të tipit konvulsiv.

Klegjithëse në shumë raste, Gabob-i në fillim ka shkaktuar një keqësim të kuadrit elektro klinik, më vonë, jo vetëm që ka zhdukur kegësimin fillestar por ka dhënë përfundime të kënaqëshme si klinike ashtu edhe elektroencefalografike. Të gjithë autorët janë dakord mbi faktin se rezultatet zgjatajnë deri sa jepet Gabob-i dhe se shpesh gjendja klinike dhe elektro-encefalografike shfaqet si më parë, posa ndërpritet medikamenti.

Në fushën klinike, përveçse si farmak antikomial, Gabob-i është përdorur, duket me përfundime gjithashtu të mira, edhe si «psikostimulus» në pacientë me debilitas mentalis ose oligofrenikë; si ipotensiv në rastet me hipertension arterial. Asnjëherë nuk janë vrejtur rrjedhime anësore të këqija të Gabob-it.

Autorët kanë studiuar ndikimin e «Gabob-it» në kuadrin klinik dhe encefalografik tek 28 fëmijë me moshë prej 2 muajsh gjëri në 5 vjeç të ndarë në 11 me kriza konvulsive të rënda e të shpeshta dhe vizatim e.e.g. të tipit komicial; në 8 më kriza konvulsive sporadike dhe vizatim e.e.g. jo specifik; në 9 me vonesë psihomotore dhe çrrregullime në sjellje dhe në 2 raste «kontrollis» që nuk kishin çrrregullime neuro-psihike por për të vrejtë modifikimet eventuale klinike ose elektroencefalografike të shkaktuara nga «Gabob»-i.

Doza e përdorur që nga një minimum 250 mmgr. në një maksimum 500 mmgr. pro die, si mbas moshës, e dhënë per os dhe për një kohë prej 10 ditësh gjëri në 6 muaj.

Në bazë të studimit klinik dhe elektroencefalografik të këtyre rasteve, rezulton se Gabob-i pranohet mirë prej të gjithë pacientëve, ka veprim terapeutik kryesisht në fushën e epileksisë ku dha përmirësimë të qarta klinike dhe elektro-encefalografike në 6 raste ndërsa veprimi i tij terapeutik në rastet me vonesë psihomotore nuk që i qartë dhe në rastet normale nuk u vrejtë asnjë ndryshim.

## SINDROMI I MBIDOSAZHIT TË VITAMINËS D.

C. DE LUCA — M. COZZI  
Min. Ped. vol. 16 Nr. 6 25 Frues 1964 f. 210-219

Vitamina D e dhënë me doza të larta ose me doza mesatare për një kohë të gjatë, shkakton një sindrom ipervitaminik të karakterizuar me anoreksi, të vjeila, konstipacion, ethe të parregullta, hepatomegalie, iperkalcemie, palezem të fosfatëve në serum, iperkalciurie, ipostenurie dhe polidipsi. Ky sindrom çon edhe në vdekje. Frontali ka tërheq vëmendjen mbi këtë fakt duke përmendur 17 vjetorët në 300 raste të leteratyrës me ipervitaminosi nga Vitamina D<sub>2</sub> qysh në vitin 1953. Autorët duke u nisur nga këto të dhëna dhe duke konstatuar në një periudhë të shkurtër prej 60 ditësh 8 raste mbidosazhi të vitaminës D. pëershkruanjë 12 raste të tillë në të cilët kanë studiuar funksionimin renal, (s.d.m kapacitetin funksional tubular) ionet e eliminuar në urinë në 24 orë, aftësinë e acidifikimit të renit me përcaktimini e pH. It të urinës. Mbasi jepin përfundimet e kërkimeve të tyre dhe mendimin e autorëve më të njohur përsa i përket dozës së vitaminës D (Bulgarelli si dozë profilaktike 400 U. pro die vit. D<sub>2</sub> për moshën e gjirit dhe 800-1000 U. pro die për fëmijen imature, dhe si dozë terapeutike 6000-10.000 U. pro die; De Toni, Debré, Fanconi 5 mgr. vit. D ose 200.000 U. për rachitis gravis), arrinjë në këta konkluzione:

1) Vitamina D, duhet dhënë gjithmonë me dije e nöergjegje mbasi të kontrollohet mirë mirë gjendja e qdo pacienti sidomos kur vitamina jepet me qëllim profilaktik.

2) Duke genë ngritur niveli i jetesës së popullit, rastet e rahiizmit janë të rralla dhe prandaj duke ditur se Vitamina D mund të shkaktojë gjendje toksike të përdoret me shumë kujdes për të mos shkaktuar sëmundje «iatogene».

3) Mjeku duhet të zgjedhë mbas një studimi t'imi të çdo rasti momentin e përshtatshëm të dhënes së vitaminës D. dhe njëkohësisht të lajmojë prindët mbi rrezikëshmërinë eventuale të këtij medikamenti.

(Përbledhur nga Xh. Basha)

## MRI LEZIONET REUMATISMALE TË DIENCEFALIT

M. G. GOLDEMAN  
Korsakov, 1963, 63, 10 1445-1448

Autori ka ekzaminuar 32 raste (11 burra) nga 17 deri 45 vjeç me diencefalite reumatismale: të gjithë patientët paraqesnin lezione kardiak aktive (9) - dhe inaktive (13). Tre nga të sëmurët kishin kriza artikulare primare ose recidivuese. Në kundërshtim me autorë të tjerë, ai ka observuar çrrëgullime diencefalike jashtë periudhave aktive të reumatizmit. Natyra diskrete e çrrëgullimeve irofike është karakteristike për encefalitet reumatismale, ndryshe me sa ndodh në lezonet neurovirale, në të cilat çrrëgullimet qafqen shumë shpejtë e janë më të theksuara.

Në 27 raste vërehen kriza diencefalike me ndjenjën e nxehësisë, marrje mendsh, ftohje të ekstremiteteve, skruqje dhe edema lokale që i përngrajnë urtikarien ose edemës së Quinckut. Ai ka observuar gjithashut gjendje nevrotike: histeri, neurasteni, psikasteni, depresion, hipokondri, etj. Gjatë zhvillimit të manifestimeve nevrotike, me kalimin e kohës ndodhin alteracione vegjetative konstante (sidomos vaskulare dhe sekretore), paroksizme vegjetative (kriza diencefalike dhe epilepsii), çrrëgullime të reflekseve (anisorefleksi, reflekse patologjike, sindrome automatizmi oral) dhe çrrëgullime të tonusit muskular.

## MENINGOENCEFALITIS REUMATISMAL SI PASOJË E INTERVENTIT KIRURGJIKAL NË LEZIONET E FITUARA TË ZEMRËS

A. N. LUK  
Korsakov 1963 63 10 1449 - 1452

Shumica e aksidenteve të përshkruara janë të natyrës embolike. Autorë të tjerë (Bogolepov e Badalian) thonë se çrrëgullimet hemodinamike dhe respiratore të insuficiencës kardiak shqërohen me manifestime hipoksike dhe angioparetiqe, pastaj vjen staza dhe ramolimenti.

Autori ka studjuar status neurologicus të 147 pacientëve që i janë nënshtruar komisurotomisë dhe ka konstatuar raste me emboli, edemë cerebrale, ramoliment jo trombotik, psikoza delirante akute dhe konfuzion mental delirant.

Në këtë punim autori përshkruan raste encefalitit dhe meningoencefalitit reumatismal që janë çfaqur 3-5 ditë mbas interventit të komisurotomisë mitrale. Duke u nisur nga konceptet etiopatogenike aktuale, autorri vërteton se interventi kirurgjikal në zemër luan një rol deklansues jo specifik dhe nxit në organizmin e sensibilizuar aktivizimin e procesit neuro-reumatismal. Simbas tij ky aktivizim është një komplikacion i interventit për komisurotomin mitral. Në encefalitet ose meningoencefalitet reumatismale qëregullimet vazhdojnë nga dy deri katër muaj, ndërsa në menengismat vetëm disa ditë. Kriteri më i saktë është përbërja e likuorit cerebro-spinal. Tek 147 të operuar autorri ka gjetur 1,4% meningo-encefalite.

#### KONSIDERATA ETIOPATOGENIKE MBI EPILEPSINË: STUDIM STATISTIKOR I 362 RASTEVE ME AFEKSIONE CEREBRALE

C. PAOLOZZI, E. DE DIVITTIS  
Annales médico-psychologiques 1964 122, 1, 5, 860

Autorët paragjeni një studim statistikor mbi akseset epileptike motore të përgjithësuara apo të pjesëshme tek 362 të sëmurë që vuajnë nga sëmuundje të ndryshme cerebrale: 100 tumore cerebrale primitive, 30 tumore metastatike, 30 hematomë intrakraniale, 30 abcese cerebrale, 20 tromboza të karotidës së brendëshme, 22 aneurizma, 50 raste atrofie cerebrale, 50 arteriopatish, 20 atrofi tek arteriopatë dhe 10 sindrome pseudo-tumorale.

Në secilën prej këtyre kategorive, autorët studiojnë në pikëpamje statistikoren numurin e krizave konvulsive të përgjithësuara e të pjesëshme. Observimet klinike janë plotësuar e kontrolluar me ekzaminime elektro-encefalografike dhe neuro-radiologjike. Tumoret janë klasifikuar simbas rezultateve të ekzaminimit histologjik.

Më në fund autorët studiojnë faktorët e ndryshëm që janë në origjinën e 362 rasteve të epilepsisë «simptomatike», të shkaktuar nga lezonet cerebrale. Si faktorë etiopatogenikë më të rëndësishëm ata konsiderojnë hipertensionin intrakranial, vandin e lezonit, natyrën e procesit anatomik, kronicitetin e lezonit, predispozicionin ndaj epilepsisë.

#### SINKOPI DHE EPILEPSIA

L. ROUVES dhe G. ROUVES  
Revue Neurologique 1963, 109, III, 334-338

Autori paraqet rastin e një fëmije 22 muajsh me kriza konvulsive apiretike qysh në moshën 1 vjeç. Pacientit iu bë E.E.G. gjatë një krize që fu qfaq për shkak të drejtimit të gabuar të biberonit. Në kohën e krizës pati kolë spastike, apne, kongestion të fytyrës, revulsion oksular, agitacion. Këtë tablo autorë e konsideron sinkop. Frymëmarrja u rivendos mbas 15 sekondash edhe u konstatua një lëshim muskulær. Mbas kësaj u qfaqën konvulsione toniko-klonike të përgjithëshe tipikisht epileptike. E.E.G. vuri në dukje, në fillim, tri fazat klasike të sinkopit, kurse në fazën terminale ndodh kriza toniko-klonike me valë të theksuara epileptike.

Autori është i mendimit se nuk kemi të bëjmë me një sinkop respirator që vë në dukje epilepsinë, por me një sinkop epileptogen që është shumë i rallë.

#### STUDIM MRI 240 RASTE EPILEPSIE INFANTILE TË NDJEKUR GJATË 5 VJETVE E MË TEPËR

A. LERIQUE, J. MISES, M. BASSET, M. DAVEAU etj.  
Revue Neurologique 1963, 109 III 3 342-348

Autori ka studjuar 240 fëmijë që kanë paraqitur kriza konvulsive epileptike (nga disa muajsh deri moshën 12 vjeç) dhe i ka ndjekur nga shtatë deri dyshëdhjetë vjet. Ata paragjeni në përgjithësi epilepsi esenciale, duke përfashtuar edo epilepsi simptomatike. Në 125 raste (85%) krizat janë kontrolluar të paktën qysh prej dy vjetësh. Ndërsa në 115 raste krizat ose nuk janë kontrolluar aspak ose

janë kontrolluar keq. Në zrehanat më të mira, krizat zhduken në vitin e parë të mjekimit. Rrallë herë ato ndërpriten në pubertet. Elektroencefalografia nuk përcaktokt në fillim të sëmundjes prognozën, mbasi në format e ndryshme evolutive rastet mund të mbeten për një kohë të gjatë të alterueme. Përkundrazi, elektro-encefalogrami na jep mundësi të ndjekim evolucionin, të vlerësojmë gravitetin e rastit dhe është një ndër elementet më të rendësishëm për të vendosur në se duhet të vazhdohet apo të ndërpritet terapija.

### MBETURINAT KONVULSIVE TË LOBOTOMISË PREFRONTALE

C. FEUILLET, R. POIRE, P. MABILLE, M. DEGRAEVE  
Revue Neurologique, 1963, t. 109, nr. 3, 306.

Autorët kanë praktikuar lobotominë prefrontale tek 479 të sëmurë (190 burra dhe 289 gra), shumica e të cilëve skizofrenë, nga mosha 16 deri 78 vjeç. Nga 447 raste klinike 69 kanë paraqitur konvulsione epileptike, që nuk kanë prirje të zhduken me kaiimin e kohës. Këto kriza tonikoklonike gjeneralizohen menjëherë pa aura dhe prodrome. Herë të tjera krizat janë të menjëherëshme dhe çfagjen në formën e status epilepticus jo fort të rëndë. Më shpesh krizat mbeten të izoluara. Këtu kemi të bëjmë më tepër me «mbeturinave konvulsive». Numuri më i madh i këtyre mbeturinave epileptike takohet tek të operuarit nga lobotomia prefrontale në mosha 16-30 vjeç (35%). Më shumë preken burrat se sa gratë (17%). Sismoterapia post-operatore, kura e Sakelit nuk e kanë lehtësuar çfagjen e epilepsive spontane. Medikamentet psikotrope mund të pakësojnë çfagjen e epilepsive post-operatore.

### VEPRIMI I RESERPINËS NË KOMAT POST-TRAUMATIKE NË NEURO-KIRURGJI

P. FOSSATI, Mme CARIDROIT, PH. PRUVOT, J. PARIS, M. FONTAN.  
M. LINQUETTE dhe E. LAINE  
Revue Neurologique, 1963, T. 109, nr. 4, 476-481

Përdorimi i reserpinës me doza nga 2 deri 3 mg në ditët që pasojnë traumën e kranit, shqërohet me pasoja të papritura; tek 71 të traumatizuar ka shkaktuar 8 rikativizime të ulcus dhe 5 ulcus duodenale akute.

Për të spieguar këtë veprim të dyfishtë të reserpinës vlen të kujtohet ndikimi që ajo ushtron mbi amino-aminet cerebrale e digestive, veçanërisht në rastin e inhibimit të mono-amino-oksidazës:

— në sistemin nervor qendror, reserpina ciliron serotoninë dhe amine kateshike, ndërsa mbas inhibimit të M.A.O. ajo humb vetitë e saja sedative dhe mund të shkaktojë një eksitim, si pasoje e clirimit të adrenalins.

— në nivelin e regionit gastro-duodenal, reserpina ciliron histamindë e serotoninë dhet mund të shkaktojë ulcere akute të tipit vaskular. Patogjeneza e ulcerave akute të shkaktueme nga reserpina është komplekse dhe ndodh si pasoje e gjurmimit të aminoamineve ose e stimulimit vaginal.

Duke pastur parasysh lokalizimin e amino-amineve, autorët mendojnë se në hypotalamus grumbullohen katekolaminet e serotonina dhe në nivelin e duodenit serotoninë.

Autorët kanë vërejtur se ulceret duodenale mbas një traume të kranit çfagjen kur pacienti përmirësohet e zgjohet, prandaj ata këshillojnë një kujdes të veçantë në përdorimin e reserpinës dhe dhënjen e antiserotoninëve si terapi preventive të ulcerave duodenale.

### TUMORET E SEPTUM LUCIDUM

M. CASTAIGNE, F. LHERMITTE, J. C. GAUTIER, G. GEOFFROY  
Revue Neurologique 1964, T. 110, nr. 1, 58-62

Për arësyen të lokalizimit dhe natyrës së indit në të cilin zhvillohen, tumoret e septum lucidum dallohen vështirë. Megjithatë eksereza e tyre është e mundësishme në disa raste.

Autorët paraqesin trë raste anatomo-klinike dhe bëjnë fjalë për 69 raste të përshtkuara në literaturë.

Sintomat klinike më të shpeshta janë hipertensioni intrakranial, çregullimet i sëmrigjikë e sidomos ato të kujtesës dhe krizat epileptike të gjeneralizuara ose të lokalizuar.

Në një nga observimet anatomo-klinike të këtij punimi bëhet fjalë për një pinealomë ektopike të septum lucidum. U konstatua një diabetë insipide dhe shenja insuficiencë multiglandulare.

Ndër analizat komplementare klinike rezultate më të mira jep encefalografia gazore. Ndërryrja kirurgjikale ka dhënë përfundime të kënaqëshme për arësyve se disa nga tumoret e septumit kanë qenë beninje (astrocitome susepludimare dhe subependimare).

## AMNEZIA E RËNDË POST-TRAUMATIKE

PETIT-DUTAILLIS, CHAVANY J. A., MESSIMY R.  
Presse Médicale, 1959, 67, nr. 14, fq. 537-540

Autorët mbasi vënë në dukje karakteristikat e zakonëshme të amnezisë post-traumatike, thonë se ajo në përgjithësi është një amnezi traumatike që ka lidhje me vet aksidentin dhe me periudhën para ose mbas aksidentit. Megjithatë ata paragjenin një rast amnezie masive me depersonalizim të plotë të plagosurit; në këtë rast nuk mund të dyshohet as përfundim, as përmes simulimit. Natyra organike e kësaj amnezie është e sigurt: çregullimi i kujtesës përfshin gjithë jetën e pacientit dhe shqërohet me një sindrom afaso-apraksik. Kemi të bëjmë me dy manifestime që nuk janë pasojë e njera tjetrës dhe që përfundojnë me demencë përfundimtare shkak të lezioneve difuze në nevraks. Ndofta këtu është prekur edhe rinencefali.

## NGRITJE E PSIKOTERAPI E PARAKOHËSHME PËR MJEKIMIN E TRAUMAVE CEFALIKE TË MBYLLURA

RAGNAR MULLER, BENGT NAUMANN  
Revue Neurologique, 1961, t. 110, nr. 1, 87-91

Megjithëse qysht prej disa vjetesh psikoterapia është këshilluar gjérësisht në rastin e traumave të kokës të myllura, ajo nuk është përdorur aq sa duhet.

Në punimin e tyre autorët paragjenin 253 raste pacientesh të prekur nga trauma të myllura të kranit (të shkaktuara sidomos nga aksidente rrugore) dhe të mjekuara me ngritje e psikoterapi të parakohëshme. Mosha e të sëmurëve luhat midis 13 dhe 79 vjetve. Zakonisht pacienti mbahet në shtrat për 24 orë mbas aksidentit, pastaj ai është i lejuar të gohet, veçse mund të ketë ndonjë cefale apo marrje mendsh. Psikoterapia përdoret njëkohësisht me ngritjen nga shtrati. Kur i plagosur është amnezik apo ka humbur ndërgjegjen, vetkuptohet masat e përmendura nuk zbatohen deri sa ai të vijë në vete.

Autorët janë të mendimit se ngritja e psikoterapia e parakohëshme janë mjete efikase përfundimtare për të evitar komplikacionet e traumave cefalike të myllura.

## VETPROVOKIMI I KRIZAVE TEK EPILEPTIKËT FOTO-SENSIBËL

H. R. RICHTER  
Revue Neurologique, 1962, t. 107, nr. 3, fq. 281

Autori përkruan këto dy raste:

1) E sëmura epileptike është 30 vjeç; dy herë në vit (mesatarisht) i çfaqen kriza të gjeneralizuara. Ato i çfaqen gjatë ditës, përjashta, kur e sëmura hap e myll sytë përfshin të dritës së fortë që e bezdis. Pacientes i kujtohet se kur ishte në shkollë nuk e ka ndjerë veten mirë dhe ka pasur miokloni sa herë përqëndronë shikiminë në drejtim të diellit përmes gjishtërinjve që i dridheshin. Elektroenzefalogrami flet përfundimtare përfundimtare të tipit epileptik. Nuk ka qenë e mundur ripërsëritja e krizave të vetprovokuara duke përdorur aparate ndriçimi të forta fotografike e kinematografike.

2) Fëmijë në moshën 10 vjeç, me prapambetje mendore. Prindërit

karië vërejtur se absence-t ndodhin zakonisht imbrëmjeve në veturë, kur nje dritë oblike intermitente bije mbi fytyrën e fëmijës. Shpesh fëmijën e kanë gjetur me shkimin e përqëndruar nga dielli e duke tundur kokën; në këtë mënyrë ai provokonte «absence-t». Fëmija nuk është rrëzuar ndonjë herë për tokë, nuk ka pasur humbje të ndërgjegjes ose manifestime motore. Ekzaminimi elektroenzefalografik ka vënë në dukje episode disritmike me valë theta delta polimorfe. Gjatë marrjes frymë janë vërejtur valë të theksuara.

### EFEKTI I DRITËS NË EPILEPSI (analizë e 115 rasteve)

FENG JING-KUM, HUANG HUEJ-PEN  
Chinese Medical Journal, 1962, vol. 81, Nr. 3, fq. 187-194.

Tek 115 epileptikë u përdor stimulimi me dritë intermitente dhe ritmike. Vëtem në 13,9 përqind të rasteve u përfshuan të dhëna klinike. Intensiteti i reaksioneve ishte i dobët, por më i lartë se sa në grupet e kontrollit, tek psikonevrotikët dhe tek të sëmurët e prekur nga ulceria peptike. Kur tek epileptikët disfunkioni cerebral ose ndryshimet strukturale janë më të theksuara, edhe stimulimi me dritë shoqërohet me një reaktivitet më të lartë.

### ASPEKTI NEUROLOGJIK I SËMUNDJES BASEDOW

EMANUEL J. COHEN  
Revue Neurologique, 1963, t. 109 nr. 5, 580

Si përfundim i kërkimeve klinike autori thotë se shenjat neuropsihike dhe neuro-vegjetative në sëmundjen Basedow kanë lidhje me hipertiroksineminë, ndërsa shenjat ekstra-piramidale spiegohen me tepricën e tireotropeve. Autori i studjon tireotropet në pikëpamje klinike dhe fiziopatologjike.

### PROBLEMI I ALERGJISË NË PSIKIATRI

I. G. RAVKIN  
Korsakov, 1963, 63, 5, 722-728

Nën ndikimin e një toksikoze endogjene që zhvillohet në disa sëmundje psikike, sidomos në skizofreni, mund të formohen auto-antigenë që luajnë rolin e endoalergjenëve. Substancë të përcaktuara si histamina, acetylolina dhe serotoninina shkaktojnë reaksione alergjike dhe luajnë një rol me rëndësi në patogjenezin e skizofrenisë. Megjithëse nuk është e mundur të provohet roli i alergjisë në të gjitha format klinike të skizofrenisë për shkak të kompleksitetit të manifestimeve dhe tendencave evolutive të kësaj sëmundje, nuk mund të përjashtohet roli i alergjisë në zhvillimin e disa sindromeve psikopatologjike dhe disa gjendjeve psikotikë që çfaqen në format e ndryshme të skizofrenisë.

Simbas autorit, alergjia është në bazë të gjendjes së stuporit katatonik dhe të sindromit delirant akut (si në format hipertoksike febrile të skizofrenisë ashtu dhe në disa encefali të shkaktuara nga intoksikacionet). Në favor të kësaj hipoteze flasin jo vetëm nuancat klinike (hiperpati, çregullime trofike e vegjetative, manifestimet kutane alergjike), por edhe të dhënat biokimike, imunologjike dhe histokimike.

Alergja duhet të jetë faktor determinues në disa kriza epileptike dhe sidomos në status epilepticus. Krizat konvulsive çfaqen shpesh si pasojë e edemës Quincke në regjionet përkatëse të trurit.

Përkundrazi, simbas autorit, mund të flitet për kriza epileptike gjatë afeksioneve alergjike (epilepsi reumatizmale, kriza konvulsive të perlarteritis nodosa). Edhe konyvulsionet gjatë barrës janë të natyrës alergjike. Të së njëjtës natyrë janë edhe krizat që çfaqen menjëherë pas përdorimit të arsenikut, të disa neuroleptikëve, të akrininës (që përdoret lokalisht në lupus eritematosus).

Autori konsideron gjithashtu si alergjike manifestimet psiqike që çfaqen tek tuberkolitikët, sidomos në T.B.C. të rëndë, të mjekuar me streptomicinë.

Simbas autorit i duhet kushtuar një kujdes i veçantë faktorit alergjik në mjevin e sëmundjeve psiqike.

## NEVROZA E SKOPTOFOBISË

F. N. DOSUZKOV  
Korsakov, 1963, vol. 63, nr. 1, fq. 130-136

Duke përdorur termin skoptofobi (frika për tu paraqitur qesharak), autor i përshkruan një sindrom që karakterizohet me timiditetin patologjik, turpin se jemi të sémurë (*pathoaidie*), belbzimin, tikit, eritrofobinë, dismofobinë, hidrosfobinë, kakoteknofobinë (frika për tu dukur qesharak për arësyte të kontrollimit të keq të funksioneve organike). Timiditeti mund të ketë si pasojë vëçmin e individit. Turpi mund të shoqërohet me një delir të vërtetë, sikurse e përshkruan autor i në rastin e dismorphofobisë. Shenjat e tjera përshkruhen si nevroza autonome.

Simbas autorit, rastet e belbzimit të shoqëruara me turp janë më të shumtë 2/3 dhe u përkasin nevrozave të ndryshme (edhe histerisë). Si eritofobia ashtu dhe hidrosfobia shoqërohen me të gjitha simptomat e sindromit.

Sindromi çfaqet zakonisht nga mosha 3 deri 7 vjeç dhe janë konstatuar dy tipë evoluciioni: 1) zhduket në moshën shkollore e riçfaqet gjatë pubertetit; 2) evolucioni vazhdon e rëndohet në kohën e pubertetit ose fill mbas saj. Diagnoza diferenciale me gjendjet paranoide lehtësitet nga theksimi i ndjenjës së inferioritetit gjatë skoptofobisë.

Në pikëpamje nosologjike, autor i konsideron skoptofobinë si një nevrozë autonome dhe rrallë herë një gjendje psikopatike e shumë më rrallë një sindrom skizofrenik. Mjeckimi më i përshtatshëm, simbas tij, është logoterapia.

## MBI RIADAPTIMITIN SHOQËROR TË EPILEPTIKËVE

O. MASSARO, D. RAGOZZINO  
Annales médico-psychologiques, 1963, T. 1, nr. 5, 758

Autorët parashtrojnë rezultatet e kërkimeve të tyre mbi 104 epileptikë të rëndë (me konvulsione dha çregullime psiqike të rëndësishme). Mbas një periudhe të mjaftueshme injekimesh e riedukimi me anë të punës, 48 pacientë u nxuarrën nga spitali. Nga kontrolli i bërë në shtëpi të tyre rezultoi se 17 nga këta të sémurë ushtronin rjë profesion, sidomos në degën e artizanatit, gjë që u lejoj të riadaptohen në gjirin e shoqërisë.

Autorët këshillojnë si përfundim të studimeve të tyre që të krijojen gendra të posaçme mjekimi e riedukimi në mënyrë që të shpëtohet, të paktën, një pjesë e të sémurëve epileptikë të rëndë, sepse po të braktisen në fatin e tyre, ata do t'i bëhen bartë shoqërisë.

## EPILEPSIA — PROBLEM SHOQËROR

GONZALO MOYA  
Annales médico-psychologiques, 1963, t. 2, nr. 1, 156

Autori thotë se epilepsia shtron një varg problemesh të rëndësishme me karakter shoqëror. Mënyra më e drejtë për zgjidhjen e këtyre problemeve qëndron në adaptimin e të sémurit ndaj sëmundjes, në adaptimin e shoqërisë ndaj të sémurit dha, më në fund, në adaptimin e të sémurit ndaj shoqërisë. Mjerisht shpesh vernenja kryesore i kushtohet vëllimi aspektit të parë (injekimi i epileptikëve), ndërsa dy aspektet e tjera, megjithë rëndësinë e tyre, liben pak a shumë mbas dore.

Më tej, në punimin e vet, autor i merr në shqyrtim me radhë personalitetin e epileptikëve, vëshlizësitë që ata hasin në gjirin e shoqërisë dhe më në fund munësitetë terapeutike e shoqërore (e sidomos edukimi i fëmijve epileptikë dhe prezentata e tyre për ndonjë profesion).

## **EKZISTENCA E NJEHËRESHME E EPILEPSISË ME PREDOMINENCE TEMPORALE DHE E ULCERËS GASTRO-GUODENALE**

R. MESSIMY, G. LOBEL, F. MIKOL

Annales médico-psychologiques 1964, t. 1, nr. 4, 655

Autorët analizojnë 9 raste me epilepsi dhe kanë konstatuar se më të shumtën e herëve që regjullimet digjestive paraprijnë çfaqjen e krizave epileptike, me përfjashtim të një rasti që ulcera u çfaq më vonë. Tek 4 të sëmurë kriyat u përgjashin krizave të epilepsisë abdомinale ose digjestive. Mjekimi me barbiturikë jo vëtem zhduk kriyat, por ndonjëherë mund të përmirësojë edhe gjendjen digjestive.

Më tej autorët marrin në shqyrtim një varg problemesh; roli i ulcerës dhe i gastrektomisë; në se prekja nervore ose epilepsia me predominancë temporale është pasojë e qëregullimit gastrik apo ajo vëtë shkakton ulcerën kronike?

## **ANOREKSI MENDORE PRIMARE DHE SEKONDARE**

ARTHUR KING

Annales médico-psychologiques, 1964, t. 1, nr. 2, 346-347

Simbas autorit anoreksia mendore nuk ka karakter specifik. Studimin e tij autorit e mbështet në 21 raste anoreksie mendore pa lezione organike të dukëshme dhe menjëherë ai dallon dy grupe patologjike të veçanta: ose anoreksia është pasojë e mospasjes dëshirë për të ngërënë dhe kemi anoreksinë primare, ose prapa saj fshihen shkaqe të ndryshme (delir, fobi, depresion) dhe kemi anoreksinë sekondare. Duke u mbështetur në këtë klasifikim, autorit i ndan të sëmurët në dy grupe: 12 në të parin dhe 9 në të dytin. Përgjithësisht tërë të sëmurët janë gra. Në grupin e parë sëmundja çfaqet në moshën 7 vjeç mbas pubertit, ndërsa për grupin e dytë nuk ka ndonjë moshë të caktuar.

Duke u mbështetur në të dhënët anamnestike, autorit shpreh mendimin se anoreksia mendore është një afeksion psikosomatik që shogërohet me qëregullimin e apetitit në një farë moshe tek individë me konstitucion specifik dhe që gjatë jetës kanë përballuar rrëthana të veçanta shogërore.

## **MBI NEVROZAT KARDIAKE**

F. VEGA DIAZ

Annales médico-psychologiques, 1964, t. 1, nr. 3, 458

Mjeku tërheq vemëndjen e të sëmurit mbi ndonjë anomali (suflë, aritmji, galop, hipertension, etj.) dhe lind nevroza kardiale jatrogene. Në grupin e kardiopative jatrogene autorit dallon dy varietete: kardiopatitë organike ose funksionale të shkaktuara nga një terapeutik agresiv (bloc aurikuloventrikular si pasojë e digitalinës, hemoragji nga anti-koagulantët, iskemi cerebrale tek senilët si pasojë e purgantëve ose diurektikëve të fortë, etj.) dhe pseudokardiopatitë funksionale ose nevroat kardiale të shkaktuara nga diagnoza e gabuar, nga ndonjë frazë e pa peshuar mirë, nga medikamente jo të përshtatëshme (50 deri 80% të të sëmurëve) të dhëna pacientëve që nuk kanë lezione organike (lezione valvolare minimale të kompensuara mirë), për të cilat mjeku caktion një regjim medikamentoz e higjenik (pakësimi i veprimitarës, etj.). Në këto raste faji rëndon mbi mjekun, i cili tregohet i pamatur, nuk ka siguri profesionale, është vet hipokondriak.

Gjithashtu autorit bën fjalë për nevroat kardiale të ambientit, të cilat lindin kur një pjesëtar i familjes apo një mik pëson një aksident kardiak; në nevroat kardiale somatogene rrefton një aerofagji, një nevralgji interkostale që pacienti të përqëndrojë vemëndjen në zemër dhe ta bëjë vet interpretimin e sëmundjes së tij. Kjo illoj nevroat lind si pasojë e interpretimit të gabuar që i bëhet një simptom real. Nevroat akute të ankitit lindin si pasojë e tronditjeve të thella e të forta, që shogërohen me reaksione të shumta kardiovaskulare, që lehtësojnë nevroatën. Në vargun e nevroatëve kardiale të shkaktuara nga abuzimi seksual (masturbim, coitus interruptus) pacienti ndjen dhimbje në regionin prekordial të majtë, i pëngohet frymëmarrja, etj.

Në 72 raste me ekstra-sistol rebelle pa lezione organike, po me nuanca ankhë,

simptomatologja në 42 raste është zhdukur mbas gjumit dhe 68 herë gjatë gjumit të përforuar me barbiturikë. Administrimi i sedativëve gjatë ditës pakëson frekuencën e ekstra-sistoleve deri 70% me zhdukjen e plotë të ekstra-sistolit natën edhe pa përdorimin e barbiturikëve.

Nevrozat kardiakë autorë i përfshin në sindromet psiko-neurokardiovaskulare të mos adaptimit.

### **MUJ QFAQJEN E NJËHERËSHME TË FORMAVE «SKIZOFORME» DHE EPILEPTIKE TEK FËMIJËT**

S. S. MNUKIN  
Korsakov 1963, 63, 7, 1047-1051

Autori përshkruan një grup të sëmurësh, të përbërë nga 17 fëmijë (nga 5 deri 12 vjeç), tek të cilët modifikimet «skizoforme» që kanë lidhje sidomos me psikizmën qfaqen njëkohësisht me manifestime të ndryshme epileptike (veçanërisht «status epilepticus»).

Më të shumtët e këtyre fëmijve janë meshkuj dhe sëmundja ka karakter kongenital: është pasojë e një barre patologjike të nënës dhe e «traumave të barrës». Tek shumica e pacientëve u konstatuan çregullime cerebro-endokrine dhe vegjetatofrike të ndryshme, si dhe të meta kongenitale të zhvillimit (obesitet, mikrocefali, oligofreni në shkallë të ndryshme, iktiozë e përgjithësuar ose e pjesëshme, dekalcifikim në tru, katarakte kongenitale, ptoze, etj.).

Të gjitha këto simptoma, simbas autorit, të bëjnë të mendosh për prekjen e rrurit të mesëm, në qfaqjen e së cilës lot pa dyshim një roli të dukshëm toksoplazmoza kongenitale. Gjithashu, simbas autorit, çfaqja e njëherëshme e manifestimeve «skizoforme» dhe epileptike tek fëmijët nuk spiegohet me veprimin e përbashkët të genotipëve të ndryshëm, por me qenjen e lezioneve organike në tru (megjithëse oneumoencefalogramet janë thuaçse negative).

### **PËRDORIMI NE PSIKIATRI I DISA PSIKOTROPËVE GJATË BARRËS**

Q. BEGHI  
Annales médico-psychologiques, 1963, 87, 2, 829-851

Autori shqyrton disa medikamente psikotropë që mund të përdoren me dobijatë barrës. Në fillim ai merret me Reserpinën, që ka gjetur një përdorim të gjërë efektiv i së cilës mbi barrën është krejtësisht i parëndësishëm. Klorpromazina nuk ka efekt teratogen, por e përdorur me doza më të mëdha se 150 mg. në ditë mund të shkaktojë dështim; promazina, që është një preparat thuaçse i njëllorjë, ësra i përket efektit dhe përdorimit, paraqitet më i sigurt. Edhe perfenazina dhe proklorpromazina paraqiten më të sigurta në përdorim. Ndërsa klorperazina dhe proklorpemazina duhet të përdoren me kujdes. Në fakt, proklorpemazina po të ruadoret me doza më të vogla se 250 mg. në ditë, nuk ka asnjë efekt teratogen tek ruaja.

Në fund autorri propozon një klasifikim praktik lidhur me përdorimin e këtyre medikamenteve:

- medikamente që nuk duhen përdorur për mungesë rezultatesh eksperimentale: tipet nialamide;
- medikamente që duhen përdorur me kujdes: reserpina, haloperidoli, imipramina, isocarboxazide;
- medikamente të sigurta po të mos kalohet doza e përshtatëshme: klorpromazina, promazina, klorperazina,
- medikamente që nuk paraqesin asnjë rrezik: perfenazina, meprobamatet.

### **LIBRIUM NË RRUGË PARENTERALE NË MJEKIMIN E PSIKOZAVE ALKOLIKE AKUTE**

C. CAVAGNA, E. CABURRI  
Annales médico-psychologiques 1963 121, 2, 851

Në 40 raste aksidentesh alkollike akute apo subakute, ndërmjet të cilëve 17 me elirium tremens, autorët kanë përdorur librium në rrugë intra-venoze osc intravaskulare me doza 100 mg. në 24 orë, duke bërë deri 2-3 injeksione në 24 orë. Ky

mjekim éshjtë shoqëruar edhe me terapin kimike klasike: rehidratim në rrugë subkutane, poli-vitamina, analjeptikë dhe antibiotikë në rast nevoje. Me kaiimin e periu-dhës së rëndë të agjitolacionit dhe të gjendjes konfuzo-onirike, administrimi parteral i libriumi u zevendësua me rrugën orale duke dhënë në çdo 24 orë doza nga 60 deri 100 mg.

Autorët janë të mendimit se libriumi ka një veprim sedativ të dukshëm mbi "ankthin psiko-motor" që shoqeron aksidentet alkohlike akute dhe subakute, si dhe ndihmon në lëshimin muskular. Gjithashtu libriumi nuk ka ndonjë efekt sekondar mbi aparatin kardio-vaskular.

(Përbledhur nga H. Dibra)

### MJEKIMI KIRURGJIKAL I TUMOREVE TË KOCKAVE TË BACINIT

V.P. SELJUVANOV ORTOP. TRAUM. I. PROTEZ. 1964, Nr. 3 f. 58-63.

Në artikull mbasi tregohet mbi frekuencën e tumoreve primare ose metastatike në kockat e baginit, bëhet fjalë për mjekimin kirurgjikal të tyre. Për tumoret benigne me një lokalizim të vetëm në kockat e baginit rekombinohet rezekcion i pjesës së dëmtuar deri në kufitë e shëndosha. Për disa tumore malinj si Chondrosarcoma, fibrosarcoma etj., rekombinohet rezekcion i gjërë i baginit, në vend të amputacionit transileoabdominalis, kur ka shpresë të ruhet funksionimi i ekstremitetit.

17 burime literaturat.

### MBI PSEUDOARTROSEN POST-TRAUMATIKE TË CLAVICULES

V. CALCAGNI — Min. Ortop. v. 1964. Vol. 15, f. 136-145.

Autori mbas një paraqitjeje të shkurtër mbi frekuencën e pseudoartrosave post-traumatike të clavicules, paraqet rezultatet e 14 pacienteve me këtë lezion. Ndërmjet shkaçeve kryesore të pseudoartroses, autorit flet për mos krijimin e një kontakti të mirë ndërmjet fragmenteve dhe nga prishja e qarkullimit të gjakut mbas traumës. Për mjekim ndërmjet metodave të shumta kirurgjikale, preferon sintezën aksiale të fragmenteve dhe vendosjen e një kocke autoplastike. Kur bëhet rezekcion i gjërë i vatrës së pseudoartroses, autorit rekombandon një metodë personale që konsiston në filksimin e fragmenteve me tel Kirschner dhe riforçim me një rryp kocke tibiale 7 X 1 cm. duke e mbështjellë me një fletë periosti të marë nga tibia. Në hapësirë futen copa spongiosa.

40 burime literature

### MBI TRAJTIMIN E FRAKTURAVE TË METAEPIFISËS PROKSIMALE TË RADIUSIT.

A. CAGNAZZO — L. RICCHIONI Min. Ortopedica 1963, Nr. 11, 600-608.

Në artikull mbasi jepen një seri të dhënat mbi etiologjinë, dhe anatomo-patologjinë e frakturave të metaepisës proksimale të radiusit në fëmijë dhe adulte. Autorët paraqesin studimin mbë 117 raste të mjekuar në klinikën ortopedike të Universitetit në Bari prej vitit 1949-1962. Për mjekimin e tyre jepen metoda të shumtë të përputhje me moshën dhe formën e frakturave. Autorët kryesisht preferojnë metodën konservative. Metodën operative e përdorin rrallë dhe këtë në ditët e para të traumës deri në tre javë, pse më von kemi shumë ndryshime funksionale në artikulacion. Në frakturat komisititëve në adultet, e vetmja metodë mjekimi është hecja e kokës së radiusit. Nuk është partizani i protezave acriliche ose metalike.

19 burime literaturat.

## TRUPA TË LIRE DHE OSTEOCONDROMATOSA ARTIKULARE

A. MAGISTRONI, G. ROCCO — VISCONTINI Minerva Ortopedica, v. 15, v. 1964.  
Nr. 1-2 f. 23-30.

Autorët i referohen tro rasteve personale me osteokondromatosë artikulare. Në fillim paraqiten punimet e autorëve të ndryshëm për këtë sëmundje duke filluar nga Dore që bëri heqjen e parë të një trupi të huaj nga artikulacioni. Për etiopatogenëzën skorma sot ka teori divergjencie.

Së fundi autorët janin më hollësi simptomatologjinë, o cilë karakterizohet nga dhimbje në artikulacione në fillim të lëhta dhe më von shkohen, duke u ndërrprerë nga periudha qetësie. Shpesh vërtë pacientët ndjejnë një trup të huaj që i pengon në lëvizjen e artikulacionit më vor dhimbjet shkohen dhe akutizohen në një blokim të artikulacionit. Artikulacioni është i fryrë, pastaj mund të bemi hidroartrozë. Në Ro-grapi vërejmë trupa të lirë, por ka raste që nuk shohim gjë kur trupat e lirë kartilaginoz nuk janë radio-opak, prandaj kryesore nënvisojnë autorët është simptomatologjia dhe kur dyshon duhet të bëjmë artrotoni. Ngas tre rastet e përshkruara dy në gjë dhe një rast në bryl janë mjekuar me intervent kirurgjikal. Një nga ato raste është e bazuar në një artrozë deformante.

40 burime literatyre

## ARTRODESA TREFISHE ME METODËN E HEQJES SË PËRKOHËSHME TË TALUSIT.

M. BELGRANO — N. CAPPELLO — R. TARDELLA Min. Ort. V. 1964, vol. 15 f. 90-94

Në artikull paraqiten rezultalet e largëta të një studimi klinik dhe radiologjik të 40 patienteve me paralizë të këmbës mbas polionyelitit, të cilëve ju është bërë artrodesa trefiske me heqjen e përkohëshme të talusit. Metoda e përdorur nga autorët është si metoda e Lorthior dhe konsiston: 1) në brimin e përkohëshmë të talusit duke prerë të gjitha ligamentet e tij; 2) në dekortikacionin e talusit dhe sipëriqeve respektive artikulare të calcaneus, scaphoides dhe harkut tibio-peroneal; 3) në ripozicionin e talusit të dekortikuar.

Mbas kësaj autorët rekomandojnë imobilizimin e talusit me dy tela Kirschner dhe pastaj aligj.

Nga të 40 rastet e operuara 37 kanë patur rezultat të mirë; tre raste jo të mjaftushëm për mungesë të funksionit në tibiotarsal. Në asnjë rast nuk është konstatuar nekroze e talusit. Autorët këtë metodë e rekomandojnë si më të mirën për mjekimin e deformimit të këmbës paralitike, përmundësinë e modelimit të mürë të talusit dhe kockave të tjera të farsit.

## NË TEMËN E OSTEOTOMISË TË DETORSIONIT (modifikim personal i teknikës)

L. TOS Min. Ortop. v. 1964 Vol. 15 f. 145-149

Autori bën një përshkrim skematik të osteotomive të detorsionit në kockat tubulare për të koriguar intra ose ekstravartacionin e ekstremitetit, të shkaktuar nga: dëmtimë kongenitale, dëmtimë të fituara jo traumatike ose mbas fraktureve të konsoliduar në pozicion vicioz. Së fundi bën përshkrimin e metodës personale të osteotomisë në formë dhëmbëzimi. Në artikull paraqitet dhe një rast i operuar me këtë metodë.

18 burime literatyre.

## OSTEOARTRITI I LATANTËVE

A. FACANL, F. C. PAVETTO Min. Ortopedica v. 1964 vol. 15 F. 70-77

Autorët kanë paraqitur studimin e 28 rasteve me osteoarbit, në muajt e para të jetës. Duke u bazuar dha në rastet e tyre thiksojnë se infeksioni osteoartikular në latantë është më i theksuar në dy muajt e para të jetës, kjo nga disekulilibri hormonik dhe neurovegetativ të kësaj moshe. Ndërsa sipas Agrifoglio nga që fëmijët kanë vetëm një imunitet pasiv nga antikorpet e nënës. Në latantët osteomyiliti krye-

sisht është i tipit «metafiso-epifises». Në latantet kartilagoja e rritjes nuk është e ndarë nga epifisa, si rezultat vazot nga metafiza kalojnë direkt në epifizë duke formuar sinuse, kështu infekzioni prej metafizës shumë shpejt kalon në epifizë dhe artikulacion. Në latantët osteomyeliti nuk shkatron gjithë kockën, pse kartilagoja e hollë çahet shpejt nga qelbi dhe i len vend të lirë përjashta. Por ndryshimet në qelizat epifizare dhe kartilagon e rritjes sipas Truete janë ireversibël. Kështu kemi ndryshime të dukeshme osteoartritike. Simptomatologjia nuk është karakteristike për të gjitha rastet, shpesh dominojnë simtomat lokale mbi të përgjithëshmet.

Në Rd.grafi ndryshimet në artikulacion vihen re qysh në 24 orët e para në dallim nga osteomyeliti i diafizo-metafizes.

Për mjekim autorët kanë përdorur me rezultat të mirë antibiotikët, imobilizim me alkji pér ekstremitetin superior dhe ekstension leucoplastik pér inferiorin që të evitojnë kontrakturën flexu punksion të artikulacionit.

25 burime literat.

### MBI SËMUNDJEN E KOCKËS SË MERMERIT

V. CALCAGNI Min. Ortop. v. 1964, Vol. 15 f. 77-84

Autori i referohet 24 rasteve të botuara në literaturën botnore në këto vitet e fundit me sëmundjen e kockës së mermerit e përshkruar më 1906 nga Albers-Schonberg, gjithashtu jep karakteristikat e një rasti të tija. Nga rastet e botuara del se në 80% të rasteve sëmundja çfaqet në moshën infantile. Ndryshimet e kuadrit hematopoetik takohen në 56%, të të sëmurëve. Simptomi i hershëm është dhe anemja me një limfocitozë relative. Përveg tre simptornave kryesore: a) osteoskleriza e gjeneralizuar, b) fragiliteti i madh i kockës dhe c) anemia, në 12%, të rasteve është takuar osteomyeliti i mandibules dhe në 16% qorimi.

Në rastin e paraqitur nga autori, e sëmura ka arritur moshën 61 vjeç, pa shumë çrrëgullime me përjashtim të frakturave të përsëritura. Osteosclerosa si të gjitha rastet, por mungonte anemja dhe splenonepatomegalia. Ro-grafinë e kokës përvëç sklerosës kishite dhe një dendësim të kockave te volta croni që nuk është observuar në dy rastet e tjera. Pacientja kishë dhe fenomene artrose.

24 burime literat.

### VEÇORITË E MJEKIMIT OPERATIV TË PESEQUINUS TEK TË RITURIT

Prof. Ja. S. JUSEVIÇ Ortop. travm. i protezirov. 1964 Nr. 2 f. 47-51.

Autori jep një përshkrim të shkurtër të shkaqeve dhe formave të pesequinus tek të riturit, tregon se ndryshimi kryesor është në talus. Për mjekim rekomandon osteotomi kuneiforme horizontale të alusit brenda sipërfaqeve artikulare dhe Achilotomi.

Rezeksioni i përparsëhëm në artikulacionin e Shopart nuk e korigjon deformacionin. Autori tregon shtatë raste të operuara sipas kësaj metode me rezultate të mira.

### FASHATURA E ALLÇISË MBAS OPERACIONIT NË TORTICOLLIS

V. P. SAVADEROV — Ortopedija-traumat. i Protezic. 1964 Nr. 2 f. 73.

Autori mbas mjekimit radikal të torticollit që konsiston në rezeksionin e muskulit sternokleido-mastoideus, i jep rëndësi aplikimit të allçisë në hiperkoreksion. Për këtë propozon një fashaturë të lehtë allçie: një rrëthi allçie në kokë duke lënë veshët e zbuluar dhe një rrëthi në pjesën e poshtme të toraksit. Mbasi ven kokën në koreksion, të dy allçitë i bashkon me një bosht metalik që e gipson.

## KONSIDERACIONE MBI TRAJTIMIN E FRAKTURAVE TË KLAVIDUKLES ME BANDAZH TË THJESHTË TË BUTË

A. MAGISTRONI, G. ROCCO VISCONTINI Min. Orb. 1964, Vol. 15, 281-285.

Autorët i referohen eksperiencës së tyre në trajtimin e 186 pacientëve me frakturne të klavikulës. Në artikull përshkruhen dizavantazhet e injekimit kirurgjikal të sintezës metalike aksiale dhe i referohen, rezultateve të arriuta në injekimin e 181 pacientëve me bandazh të butë në formë tetschi. Kur ky bandazh aplikohet mirë fragmentet e reponuara nuk do të pësojnë lëvzje dhe arrihet një injekim ambulator me sukses. Bandazhin e heqim mbas një muaji. Funksioni i rrëthit të krahut tek këta pacientë është më i plotë dhe fitohet më shpejt se tek seria e operuar me fiksime metalikat.

20 burime literat.

## MBI INDIKACIONIN E MOSHËS NË MIJEKIMIN KIRURGIKAL TË SYNDACTILIS CONGENITALE TË DUARVE

G. S. GODUOVA — Ortop. traumat. i Protezir. 1964, Nr. 8, 27-31

Autorët paraqesin mendimet e autorëve të ndryshëm, për moshën kur duhet të operohen fëmijët me syndactili. Bauer, Tondra, Truales etj. rekomandojnë operacion në moshën e hershme kur fëmija është në gjil. Por shumica e autorëve duke parë shpesh recidiva, rekomandojnë operacion në moshën e rritur 18-20 vjeç dhe disa në moshën parashkollore. Në artikull duke u bazuar në eksperiencën e 65 të sëmurëve me syndactili, paraqesin rezultate shumë të mira në fëmijët e operuar në vitin e parë të jetës. Për këtë nuk kanë përdorur metodën e Celler ose Dicöt, por përmbylljen e defektit kanë kombinuar plastikën lokale me transplantim të lirë të lëkurës. Lëkurën e transplantuar e marrin me gjithë trashësinë pa dhjam, e qepin me qime kali. Imobilizimi mbas operacionit zgjat 5-7 javë.

23 burime literat

## PATELEKTOMIA NË LUKSACIONIN RECIDIVANT TË PATHES

F. LETIZIA, G. L. E MOLI Milano Ortop. 1964, V. 15, 35-42

Në fillim autorët japidin definicionin e luksacionit recidivant të pathes duke e dalluar nga luksacioni abital i luksacioni permanent. Në etiopatogenezën lot rol anomalia e vetë kockave të artikulacionit, kur kondili lateral më i shtrypur është gjuri në pozicion valgus, lot rol vetë muskulu quatriceps kur është shumë oblik nga jashtë, inserimi i ligamentit të pathes lateralish tubarosites tibiof dhe së fundi vërti sistemi capsulo-ligamentoz. Ndërmjet metodave operatorë kemi osteotominë suprakondilicë e Mac Ewen, Lucas Championuere, Pillard dhe Albee operojnë gjithashtu për të koreguar deformacionin kockor. Vinditi dhe Forcella bëjnë torsion intern të gjithë diafizës femorale, kështu medializohet quatricepsi. Të shumta janë operacionet në sistemin capsulo-ligamentoz; ndërmjet tyre autorët përmendin: Roux, Delitalia, Putti, Hoffa, Zanolli, Goldewait. Ndër metodat operatorës në sistemin muskulo-tendinoz kemi: metoda e Krogius, Boeke, Galeazzi etj. Ka raste që kemi një inkongruencë ndërmjet pathes dhe braxdës femorale, në këto raste mbas operacionit shpesh kemi recidive. Autorët propozojnë patelektominë për injekimin e luksacionit recidivant të pathes, mbasi paraqesin eksperiencën e autorëve të ndryshëm që e indikojnë ose kontraindikojnë patelektominë. Si paraqesin dy raste të klinikës së tyre që i u është bërë patelektomia, autorët konkludojnë që patelektomia është një intervent i domosdoshëm kur kemi luksacion të përsëritur me fenomenë atroze të Pathes. Funksioni i gjurit mbas patelektomisë ka qenë i kënaqshëm.

Përmbylli. P. Karagjozi

## PËRDORIMI I SARKOLYSINËS ME KOLNAMINË NË CARCINOMA OESOPHAGUS

L. P. LARIONOV, M. A. ÇUDAKOVA, Voprosi Onkologii H. 63, Nr. 12 Faqe 3-8

Autorët nga Shkurti i vitit 1959 deri në shkurt 1962 kanë përdorur sarkolysinë dhe colhaminë në 50 të sëmurrë (22 burra dhe 18 gra). Moshet nga 40-70 vjet. Lokalizimi i tumorit në esofag ishte i ndryshëm; stadiet II-III-IV. Sarkolysina u përdor me doza 10-20 mgr. dhe kolamina 5-6 mgr. Kursi i injekimit zgjati 4-5 javë. Doza përkurs e të parës ishte midis 110-225 mgr. o të dytës 50-75 mgr. Pas 1-3 muajave përdorej injekimi i dytë. Dita të sëmurrë përsëriten tre kurse injekimi njëri deri në 5. Të sëmurrë me pakalueshmëri komplete të ezofagut preparatin e morën nëpërmjet gastrostomisë. Kombinimi perorat i këtyre dy medikamenteve dha në 37 të sëmurrë d.m.th. 74% përmirësim klinik. Ky i fundit konsiston në përmirësimin e kalueshmërisë së ezofagut, uljen ose zhdukjen e dhëmbjeve, përmirësimi i gjëndjes së përgjithshme dhe rritja në peshë. Në kurset e përsëritura të injekimit ky efekt vjen duke u dobësuar dhe sëmundja ecën vazhdimisht.

Ne dy të sëmurrë me Ca të së tretës së sipërme të ezofagut të stadir të dytë, pas tre kurse mjeckimi, a fitua regresimi i plotë i tumorit dhe shërimi praktik përnjë afat 2-3 vjet. Zhdukja e tumorit pas kursit të parë të mjeckimit duke gjykuar nga të dhënat rongenologjike u fitua dhe të një i sëmurrë me Ca të së tretës së mesme. Ky afat shërimi është i shkurtër, kanë kaluar vetëm 6 muaj.

Përparimi i mëtejshëm i kimioterapisë se Ca të ezofagut duhet të konsistojë në përdorimin më të gjërë të preparateve dhe në kombinimin e rontgen-kimioterapisë.

Literatura 5 burime

## NBI MUNGESËN KONGENITALE TË VENAVE PROFUNDE TË EKSTREMITETEVE TË POSHTËME NË ANGIOMATOSIS.

R. P. ZELENIN, O. P. BLIAU, Hirurgjia, 1963, Nr. 12, Faqe 84-88.

Angiomat, këto vese të lindura të zhvillimit të vazave takohen shpesh në moshten fémimore dhe zanë 3-3% të sësisë së përgjithshme që 7% të tumoreve benignë (I.E. Kornman). Angiomat e ekstremiteteve të poshtëme takohen rrallë. Mjeckimi kirurgjikal i angiomeve të ekstremiteteve të poshtëme është radikal dhe jep rezultate të mira. Operacioni duhet të bëhet vetëm atëherë kur konditai anatomike lejojnë të kryhet ai pa prishjen e funksionit ekstremitetit. Përparrë operacionit kirurgu pa tjetër duhet të dijë kufijtë e saktë të angiometës dhe thellësinë e shtrirjes së sajë, gjithashtu gjëndjen e venave të thella të ekstremiteteve të poshtëme. Te të sëmurrët me angiortë të lokalizimeve të mësipërme, mund të ketë trombozë të venave të thella ose në përgjithësi ato mund të mungojnë (anomali vazore kongenitale). Diagnoza e saktë vihet pas flebografisë e cila nga autorët është bërë 15 herë në 12 të sëmurrë. Diagnoza e atrezisë kongenitale të venave të thella në përgjithësi mund të vihet më anën e triadës: 1) angiometzoza, 2) zgjaja e ekstremitetit, prezenca e njollave të pigmentuara, 3) flebografia dyfisive. Venat superficiale të zgjeruara angiometore të të sëmurrëve me afrazi kongenitale vënde të thella nuk duhet t'ju nënështrohen injekimit operativ. Mjeckimi operativ i angiometzoës të të sëmurrëve që kanë kaluar trombozë të venave të thella është i mundur vetëm në rastet e rivenësjes së rekanalizimit të plotë për të cilin kirurgu sigurohet me anën e flebografisë.

Literaturë 13 burime

## T.B.C. I APPENDIXIT SIMBAS TË DHËNAVE TË 34300 APPENDEKTOMIVE

A. S. ALBERG dhe S. V. SKVORCOVSKI, Hirurgjia, 1964, Nr. 2 feje 97-100.

T.B.C. i appendixit gjidis lokalizimeve të tij të njohurë zë një nga vëndet e fundit. Në spislet e Magnitogorskit nga viti 1951-1959 janë bërë 34300 APPENDEKTOMI 75 nga të cilat u janë bërë të sëmurrëve që vuani dhe nga T.B.C. pulmonum. Të gjithë appendizet ju nënështruan ekzaminimit histologjik, vetëm në 4 u konstatua T.B.C.

Të dhënat pat-histologjike si dhe dekursi postoperator lejojnë që të mendohet se T.B.C. i procesus vermiciformis në këta të sëmurrë ardhë si rezultat i prezencës

**SE INFESIONIT T.B.C. LATENT DHE KUR U AL AFTËSIA IMUNOBIOLLOGJIKE ME IRUGË LIMFATIKE OSE HEMATOGENE U DHANË NDRYSHUME SPECIFIKE NË APPENDIX.**

Nga të 75 të sëmurët me T.B.C. pulmonum që ju bë appendektoria tek asnjë nuk u konstatua T.B.C i appendixit me gjithë se në shumicën prej tyre kishte përgjese të akutizuarë specifiqe pulmonare. Në lidhje me këtë, autorët konkludojnë se mendimet e përparëshme në lidhje me gonezen e infeksionit tuberkularë të appendixit me irugë enterogene kanë humbur rëndësinë e parë,

#### LITERATURA 12 BURIME

### INFLUENCA E THELLËSISË SË NARKOZËS NË NIVELIN E ELECTROLYTEVE TË SERUMIT TË GJAKUT NË TË SËMURËT ONKOLOGJIKË

A. V. SUDZHIAN. Hirurgia, 1963, Nr. 12, faze 93-94.

Për të parë influencën e thellësisë së narkozës në nivelin e elektrolyteve në të sëmurët onkologjikë u vizatuan 90 të sëmureve me lokalizime të ndryshme të përgjessit kanceror. Ndëshqyjet u bënin në organet e toraksit, abdomen dhe efstremicit. Përendimacioni 6.1% atropine dhe 2% solucion promedol. Për narkozën endotrakeale u përdor 2.5% Hekzenal ose tiopental. U përdor NO<sub>2</sub> me ete dije NO<sub>2</sub> me O<sub>2</sub> me shtrimin e 2%, solucion promedol nën respiracion të drejtuar. U përdorën rëlaksantë tipit depolarizues (dilitinë, miorelaksinë, Isononi). Shumica e narkozave u dhana me aparatin «Hirana 5». U bënin gjithësesi 3 prava e para u bë mbas injektimit të rëlaksantit, e dyta para injektimit të dorës së parë të rëlaksantit e treta 10 minuta pas injektimit të dozës së parë të rëlaksantit, pas 20 minutash e katërtë pas 30 minutash e pesta, pas një ore e gjashtë, pas dy orëve e shtatë, provën e tërë të fundit pasi i sëmuri u zgjue. Autorët konkluduan se në shumicën e të sëmureve onkologjikë në serumin e gjakut vijet re ulja e përbmbajtjes së joneve K,Ca,NanMg, NO<sub>2</sub> me O<sub>2</sub>, dhe NO<sub>2</sub> me ete në stadin e III<sub>1</sub> të narkozës ulin sasinë e K pa ndryshuar përbmbajtjen e Mg,Ca dhe Na. Në stadiet e thella të narkozës (III<sub>2</sub>-III<sub>3</sub>) rritet niveli i K, dhe Mg, dhe ulet Ca dhe Na. Rëlaksantet e tipit depolarizues risin sasinë e K në serumin e gjakut në 20-30 minutat e para pas injektimit, dozat e mëvështimit të tyre nuk influençojnë në përbmbajtjen e kaliumit.

#### BIBLIOGRAFIA 15 BURIME

### REKANALIZIMI I EZOFAGUT SI OPERACION PALLIATIV NË KANCERIN INOPERABEL TË TIJ

Profesor A. V. VISHNJEVSKI. Kandidat i shkencave mjekësore T. T. DAUROVA Kirurgija 1963, Nr. 12, Faze 47-52.

Në këtë artikull autorët rekomandojnë përdorimin e rekanalizimit të ezofagut në Ca inoperabel të tij. Ata vënë në diktje prioriterin e kësaj metode para metoda të tjera palliative siç janë gastrostomia dhe jejunostomia, diafragmokrurotmit, ekspliracioni palliativ i tumorit, vendosja e anastomozës tërthor tumorit. Rekanalizimi bëhet me tuba poliütilenike me trashësi 0,8-1 mm. Diametri i protezës mund të ndryshojet nga 6-12 mm. Më shpesh përdoren proteza me diametër 10 mm.

U rekanalizuan 44 të sëmure, 28 nga të cilët u bënin gjatë laraktomive probatore dhe 16 si operacion i vegenit.

Jepet teknika e operacionit me anën e ezofagotomisë cervikale dje me anën e ezofagoskopisë. Operacioni kryhet me anën e anestezisë lokale ose në rastin e ezofagoskopisë me narkozë intratrakcale. Në 44 pacientët vdiq vetëm i me fenomenet pleuritit purulent dhe mediastinit. Në autopsi u konstatua se ezofagotomia ishte bërë në ind me ndryshime patologjike. Pacientët të cilëve nuk ju bërontgenoterapi rojtës 5-7 muaj po aq sa dhe në operacionet e tjera palliative. Të tjerët që bënin dje rontgenoterapinë post operatorre rojtën mesatarishit 14 muaj e gjysëm. Si rezultati i rekanalizimit restaurohet kalueshmëria normale e ushqimit që i jep të sëmurit iluzionin e mjekimit të plotë. Ata kanë mundësi që deri në fund të jetës së tyre të ushqehen nëpërmjet gojës. Rekanalizimi zgjeron mundësinë e përdorimit të rontgenoterapisë kështu që zgjatet jeta e këtyre të sëmureve që vuajnë nga kjo sëmundje e rëndë e pashërueshme.

#### LITERATURA 2 BURIME

## BEZEKSION I STOMAKUT NË DISA FORMA TË GASTRITEIT KRONIK

A. P. MIRZAJEV  
Voprosi Onkologii, 1964 Nr. 2 faqe 41-47

Shpesh ndodh që kirurgët operojnë të sëmurë për ulcera, polipe. Ca të stomakut dhe gjatë operacionit vihen në pozitë të vështirë mbasi nuk konstatojnë ndonjë patologji të tillë, atëherë operacioni mbarohet vetëm me laparatomë. Shumë forma të gastriteve mund të simulojnë ulqerën, polipin ose kanseri. Në artikullin e dhënë studijohen 36 të sëmurë që kanë vuajtur nga forma të ndryshme të gastriteve kronike dhe që u është bërë rezekzion i stomakut. Në rastet e rukejimit të gjatë, ju efektiv të disa formave të dyshimita rentgenologjikisht të gastriteve sidomos kur dyshohet për Ca duhet bërë rezekzioni i stomakut. Autori mendon se të sëmurët me gastrit krontik, më shpesh anacit, në format polipoze, gastritet rigide antrale, gastritet adenomatotik duhet t'ju nënështrohen rezekzionit të stomakut. Të sëmurët që vuajnë nga gastritis hemoragiqa shpesh i nënështrohen gastroktomisë totale. Studimi i të sëmurëve si menjëherë mbas operacionit dhe në afatet të largëta deri 11 vjet tregoi se operacioni është i indikuar në raste të tillë.

Literatura 32 burime

## MEI AFTËSINË NË PUNE TË TË SËMURËVE ME KARCINOMA VENTRICULI PAS OPERACIONEVE RADIKALE

A. M. Korkmasov  
Onkologia 1964, Nr. 2 faqe 56-60.

Në sajë të sukseseve të mëdha që ka arritur onkologjia në kohën e sotme janë përmirësuar dhe rezultatet e largëta të karcinoma ventrikuli. Në literaturë janë përshkruar raste që i sëmuri me këtë sëmundje ka rojtur 30 vjet mbas operacionit.

Efektivitetin e operacionit autor i nuk e shikon vetëm me zgjatjen e jetës pas rukejimit kirurgjikal, ai merr si indeks dhe aftësinë për punë. U studjuan 45 paciente të cilat ishin operuar. Afatet pas operacioneve radikale për Ca ventrikuli kanë qënë 10-18 vjet. Burra ishin 25, gra 20. Mosha; nga 41-50 vjet 18 të sëmurë dhe 51-60 vjet 20 të sëmurë. Të gjithë të sëmurët u operuan në klinikat e spitalave dhe institutet e specializuara të Moskës. Simbas strukturës histologjike, tumoret ishin si më poshtë: adenokarcinoma 26 raste, Ca solid -9, Ca i mukozës 2 raste dhe forma të tjera 6 raste. U operuan në stadin e parë 6 të sëmurë, në të dytin 22, në të tretin 10. Stadi nuk u përcaktua në 7 të sëmurë. Pas operacionit 42 të sëmurë rojtën nga 10-15 vjet dhe 3 mbi 15 vjet. Gjëndja e përgjithësime e mirë asnjëri nuk pati metastaza ose recidiva. Rezekzioni i stomakut u bë në 42 të sëmurë, gastrektomia në 3.

Ndërmjet të operuarve u konstatua në 7 raste dymping sindrom. Në 13 të sëmurë u vrejt një ulje në peshë prej 5-10 kg. në 10 më shumë se 10 kg. Te 22 patientët e tjerë nuk patën humbje në peshë.

Në 39 të sëmurë analiza e gjakut komplet ishte normale, u konstatua në gjak anemija hipokrome. Nga 45 të opuruar u kthyen në punë 35; filluan punë 1 vit mbas operacionit 20. Pas një viti 15 patientë. Punën e tyre të mëparëshme e kryejnë 21, tek 14 të tjerë është vënë re ulja e kualifikimit në punë. Autori mendon se si të dhënat e literaturës po ashtu dhe të tijat shpie në konkluzionet e mëposhtëm:

1) Në kohën e sotme është i padiskutueshëm dhe shkencërisht i bazuar fakti që Ca ventrikuli është plotësisht i shërueshëm, 2) të sëmurët që kanë bërë operacione radikale jetojnë për një kohë të gjatë dhe pjesërisht ruajnë aftësinë për punë dhe mënyrën e zakonëshme të jetesës.

Literatura 21 burime

## PËRCAKTIMI I PERHAPJES SË CA VENTRIKULI ME NDIHMËN E SPLENOPORTOGRAFISË

G. I. VERONSKI. Onkologia, 1964, Nr. 2 faqe 28-34.

Splenopertografia në Ca ventrikuli është më pak e studjuar në studimet me kontrast të sistemit portal. Të parët bënë spleno-portografi në Ca ventriculi Bulren, Shevale, Gallius dhe Razhel në vitin 1951. Studimi u bë në një të sëmurë me hipertension portal, në splenoportogram u konstatua blok i venës lienale në vëndin

e derdhjes së sajë në vena porta dhe në kohën e operacionit u konstatua Ca inoperabel i regionit prepilorik të ventrikullit. Autori ka bërë 38 splenoportografi në të sémurë me Ca ventrikuli ku nga të dhënat e ndryshme dyshohej se ishin inoperabёl. Manipulacioni është bërё simbas metodës së përpunuar nga autorë. Në pragu e splenoportografisë në paranefralin e majtë injektohen 60 ml. 0,5% solucion novokaini, me po këtë gjelprerë me ndihmën e aparatit për pneumotoraks në hapësirën retroperitoneale fiten 300-400 cm<sup>3</sup> ajér. Një ditë përpëra i sémuri ka marrë 0,05 dimedrol dhe 0,01 luminat. Në darkë dhe në roëngjes i bëhen klizma pastruese, gjysëm ore para splenoportografisë i bëhet 1 ml. 1% promedol subkutan. Në skopinë e abdomeve kur pacienti ri shtrivë, shkohet shpërtka e rethuar nga ajri. Pasi lyhat lëkura me jod dhe bëhet anestezia futet në kontrollin e rezeve rontgen në lién agi sa më afër ilusit të tij. Që agi është në vëndim e duhur e provojmë duke dhënë 1-2 ml. kontrast. Substancën kontraste (50%, kardiotorasti ose 70% solucion diosonit) e lësim për 2 sekonda 20-40 ml. Në fund bëjnë rontgenografi me një eksponicion 0,3-0,4 sekonda. Nga 38 të sémurë u operuan vetëm 27. Studimi me kontrast i sistemit portal mund të dalloj përhapjen e Ca ventrikuli në organet dhe indej fqinj (pankreas, hepar, ligamentum hepato-duodenale, lién, hapsira retroperitoneale) dhe metastazë në hepar, në linfo glandulat rrëth venes portë dhe venes liénale. Splenoportografia mund të ndihmojë të vendoset diagnoza e inoperabilitët të Ca ventrikuli dhe të evitohen kështu operacionet e panevojshme.

### LEIOMIOMAT E STOMAKUT

Doktor i shkencave mjekësore A. P. BEZHNOVA, H. KAMILLOV  
Hirurgia, 1964, Nr. 2, faqe 152-158.

Leiomomat e ventrikulit zënë 0,5-5%, të gjithë neoformacioneve të këtij organi dhe 30-65%, të tumoreve beninje jo epiteliale të stomakut.

Në institutin ku punojnë autorët janë bërë 2120 operacione në stomak. Në 26 raste u konstatuan tumore beninje jo epiteliale dhe 8 leiomoma d.m.th. 30,7%. Më shpesht sémuren femrat, mosha 32 deri në 72 vjeç. Sémundja nuk ka shënjë patognomonike, megjithatë të sémurët që kanë dhëmbje në regjionin epigastrik, dobësi, hemoragjira gastrike, ulje të aciditetit të stomakut, ngadonjërë akili dhe që indeksin e hemoglobinës e kanë normal duhet të dyshohen se vuajnë nga leiomoma ventrikuli.

Veçanërisht është i vështirë diagnostikimi i sémundjes kur në stomak ka dhe sémundje të tjera si Ca (dy raste), ulkus kronik (3 raste etj). Ekzaminime rontgenologjike tu bënë 8 të sémurëve dhe u vunë këto diagnoza: Në 5 Ca ventrikuli, njërit polip dhe në 2 tumore beninje intramurale ventrikuli. Leiomomat zhvillohen nga fibrat muskulare të lëmuara të mureve të stomakut. Ato mund të rriten ose në kavitetin e organit ose subseroz, në raste të rralla mund të janë intramurale etj. Më shpesh lokalizohen në murin posterior të stomakut në kurvatura minor. Megjithëse është e vështirë disa autorë janë përpjekur të studjojnë lidhjen që kanë veçoritë e rritjes të leiomomës dhe lokalizimit të sajë. Mjekimi i sajë është vetëm operativ, por mbi karakterin e ndërhyrjeve kirurgjikale ka mendime të ndryshme. Autorët mendojnë se në tumoret intramurale, submukoze dhe subseroze duhet bërë rezekcion tipik i stomakut, përjashtim mund të ketë vetëm për tumoret që shtrihen në pjesën kardiale ose në regjionin subkardial të ventrikullit. Autorët nuk kanë ndeshur asnjë të sémurë me leimyosarkoma. U studjuan dhe rezultatet e largëta të mjekimit të sémurët rojnë gjatë një periudhe observacioni 1-15 vjet.

Literatura 16 burime.

### REZULTATET E LARGËTA TË MJEKIMIT KIRURGIKAL TË CANCER PULMONUM

Profesor I. S. KOLESNIKOV. Docent M. V. SHELJAKOVSKIJ.  
Hirurgia 1964 Nr. 4 faqe 63-68

Nga viti 1952 deri 1958 në klinikë janë mjekuar 613 të sémurë me Ca pulmonum, nga ata 235 dolën pa operacion dhe 378 u operuan (298 të sémurëve ju bë resectio pulmonum dhe 80 torakotonia probatore). Autorët kanë patur në kontroll 218 të sémurë nga ata që dolën të pa operuar. 97,3% të tyre vdiqen gjatë 3 vjetëve nga çfaqja e simptomave fillestare të sémundjes me shumë se 5 vjet jetuan vetëm 2 të

sëmürë (6,9). Nga 80 të sëmürë të cilëve ju bë vetëm torakotomia probatore dolën nga spitali 74,6 vdiqën. Torakotomia probatore nuk e shkurtoi jetën e të sëmürëve me Ca pulmonum dhe këta zakonisht vdesin 3 vjet pas çfarqes së sëmundjes dhe afersisht 2 vjet pas operacionit.

Midis atyre që u janë bërë operacione radikale 33,4% rojnë më shumë se 5 vjet. Nga 298 të sëmürë me rezectio pulmonum 32 vdiqën në periudhën post operatorre kurse 246 dolën nga spitali. Autorët kanë pasur në kontroll 245 të sëmürë. Nga këta 184 vdiqën në afat të ndryshme pas operacionit, kurse 61 prej tyre (deri në nëndor dhjetor 1962) jetonin dhe e ndjenin vërtet mirë.

Në artikull janë krahasuar të dhënat e zgjatjes së jetës të 245 të sëmürëve që kanë bërë resectio pulmonum dhe 54 të cilët ishin operabël por refuzuan ndërhyrjen kirurgjikale. Nga të parët 25,5% rojtën më shumë se 5 vjet dhe më shumë se 6 vjet 22,2% e të sëmürëve, kurse nga grupi i dytë 51 vdiqën në dy vjetet e para pas dëljes nga klinika, kurse 1 rojtë më shumë se 5 vjet. Autorët mendojnë se progrezoza pas resectio pulmonum nga canseri në një gradë të konsiderueshme varet nga struktura histologjike, lokalizimi i tumorit gjithashu nga seksi dhe motha. Rezultatet e largëta të mira në të sëmürët me stadi të parë të Ca pulmonum meren dha në rastet që bëhet pulmonektomia dhe në rastet e lobektomisë. Në stadin e II-III të mira janë rezultatet pas pulmektomisë. Nga 184 të sëmürë të operuar dhe vdekur në kohë të ndryshme të 90 u vu shkaku i vdekjes. Ata vdiqën nga metastaza në organet e ndryshme (27), nga recidivat lokale 52 dhe nga arsyë të ndryshme 11.

#### Literatura 26 burime

#### MBI CA VENTRIKULI PRIMAR-MULTIPLEX

Profesor S. I. HABİÇEV dhe Kand. i Shkencave mjekësore G. N. Arzhigitev.  
Hirurgia, 1964, Nr. 4, faqe 88-91

Turner primar-multiplex qubet dalja në mënyrë indipendente n'organizëm, panvarësishët njeri nga tjetri i dy ose më shumë neoformacioneve. N.N. Jellanski duke studjuar për shumë vjet (1923-1963) patogenetëzin e Ca ventrikuli harin në konkluzion se qfaqja e primar-multiplex Ca nuk duhet të shikohet si përcjashtim por si ligjëshmëri. Neoformacionet qfaqen në mënyrë unicentrike dhe multicentrike. Në rritjen unicentrike kapet diku një organ nga i cili në t'arthem mund të lindin metastaza të tjera. Rritja multicentrike karakterizohet nga dalja e disa tumoreve në një ose disa organe të ndryshme.

Dallohen Ca primar-multiplex sinhronik kur tumoret dalin në të njëjtën kohë ose në një interval prej 6 muajsh dhe metahron kur tumori i dyte del pas një kohe me të gjatë.

Autorët për Ca ventrikuli primare-multiplex jepin klasifikimin e më poshtëm:  
1) Carcinoma multiplex ventrikuli, 2) Carcinoma ventrikuli dhe të tjera të traktit digestiv, 3) Carcinoma ventrikuli dhe organeve të sistemeve të tjera. Në artikull janë përmblehdhur të dhënat mbi klinikën, diagnostikimin dhe rezultat i mjekimit operativ të Ca primar multiplex ventrikuli. Nga 809 të sëmürë që kanë bërë resectio ventrikuli ose ekstirpcion total për Ca në 29 (19 burra dhe 10 gra) u konstatua kjo sëmundje. Shpesh recidivat pas resectio ventrikuli mund të janë si shkak i rritjes sinhronë të tumorit tjetër. Tumoret primare multiplex sipas histologjisë mund të janë të njëjtë ose të ndryshme. Dekursi eshtë me karakter më malinj. Nga 27 të sëmürë të operuar që dolën nga spitali pas një viti mbeten gjallë 11 veta, pas 5 vjetësh vetëm një njeri i operuar për Ca labi inferior dha pas një viti për Ca ventrikuli. Shkaqet e polineuplasizë nuk janë të qarta akomia.

#### DISA PROBLEME MBI DIAGNOSTIKIMIN DHE MJEKIMIN KIRURGJIKAL TE Ca PULMONUM

Docent O. S. SHKREB. Hirurgia, 1964, Nr. 4, faqe 119-126

Nga viti 1958-1963 në klinikën e parë të kirurgjisë së fakultetit MOLNI janë ekzaminuar dhe kuruar 440 të sëmürë me Ca pulmonum primare (230 nga këta u operuan).

Autori në artikull përdor klasifikimin klinik të Ca pulmonum.

I) Central (69%) a) endobronchial, b) peribronchial nodos. c) peribronchial i degëzuar.

2) Perifertik (28%) a) Tumor sferik; b) forma kavitaire; c) forma subpleurale, d) tumor penkost.

Në artikull janë përmëndur pothuaj të gjitha ekzaminimet që duhen bërë për diagnostikimin e sëmundjes. Studimi i vegantive të metastazimit në lokalizimet dhe format e ndryshme histologjike janë mundësinë autorit të rekomandojë për punën praktike skemën e mëposhtëm për ekzaminimet speciale:

1) Në Ca lobë superior pulmoni dextra duhet bërë pneumotomomediastinografja dhe flebografia mediastinale.

2) Në Ca lobë superior pulmoni sinistra është e domosdoshme të shfrytëzohet pneumotomomediastinografja.

3) Në Ca të lobit inferior duhet të përdoren angiopulmonografitë selektive për të studuar gjëndjen e vazave të miëdhë pulmonare.

4) Në tumocet penkost duhet të përdoret studimi me kontrast i venes subklavia. Rendësi vendimtare për suksesin e operacionit ka sistemi kardio-vaskular dhe respirator. U kryen 121 pulmonektomi, 20 lobektomi dhe bilobektomi, 9 operacione palliative dhe 80 torakotomi. Letaliteti pas operacioneve radikale ishte 8,2% që shkaqet ishin: hipokesi në kohën e mbas operacionit, insuficenza kardio-vaskulare akuta, pacumonia, hemoragjje tromboembolika e arterisë pulmonare, pagjendueshmëria e bronkial që empiema e përcure. Metoda bezë e kurimit të Ca pulmopum duhet të jetë pulmonektomia me heqjen e linfo glandula e trakeobronkiale, të bifurkacionit të linfo glandula e paratraktale dhe paraesofagale. Autori jep mendimin e liq në lidhje me disa çështje të teknikës operatore dhe përdorimit të kimioterapisë që favorizon kryerjen me sukses të operacionit.

## MRI SËMUNDJJEJ E STOMAKUT TË OPERUAR, KLASIFIKIMIN E TYRE, MJEKIMIN KIRURGIKAL DHE PROFILAKSINË ME NDİHMËN JEJUNOGASTROPLASTIKËS

Prof. E. I. SAHAROV Hirurgia 1964, Nr. 4 faze 127-135

Me sëmundje të stomakut të operuar duhet të kuptohen gjëndje morboze të ndryshme, që ndryshojnë nga vegantitë anatomike dhe patofiziologjike por që gjithmonë janë të lidhura me këtë ose atë operacion që është bërë më përparrë në stomak.

Autori klasifikimin e sëmundjeve të stomakut të operuar i ndan në dy grupe. Në grupin e parë futen gjëndjet morboze në bazën e të cilave qëndrojnë ndryshimet funksionale, që lindin tek të sëmûrët e operuar në konditat e prishjes së proçesave antomo-fizikologjike në traktin gastrointestinal pas *resectio ventriculi* sipas Billrot II dhe modifikimeve të tij. Midis këtyre gjëndjeve morboze me të njohurat janë: 1) astenia gastrike dhe astenia gastrointestinale (Dumping sindrom); 2) sindromi i stomakut të vogël; 3) sindromi hiperglicemik; 4) hiper-hipoglicemik sindrom; 5) sindromi postgastrorrezekcion; 6) astenia psikosomatike; 7) diskonforti abdominal; 8) shoku i zorëve të holla dhe sindromi jejunai; 9) astenia enterogcne; 10) kolapsi alimentar.

Në grupin e dyte hyjnë gjëndjet morboze të lidhura me ndryshime anatomo-morfologjike destruktive, këtu hyjnë: 1) ulzerat pepiliqe, 2) fistulat; 3) stenoza e katrizante të anastomozës; 4) «circulus vicicus» nga gabimet teknike në operacion; 5) kanceri i kullit të stomakut pas rezekzionit të tij; 6) recidiva e sëmundjes ulzeroze; 7) ezoftagitet ulzeroze.

Shpeshtësia e gjëndjeve morboze të grupit të parë sipas shumicës së autorëve është 30-60%. Autori konkludon se në rastet e formave të rënda dhe progresive të astenise të lidhura me operacionin sipas Billrot II indikohet reducendizimi me ndihmën e plastikës së zorrës së hollë. Në forma destruktive që kërkojnë rezekcionet të «dyta» dhe «të tretë» jejunoplastika lehtëson shumë plotësimin e këtyre operacioneve të vështira. Qëllimi i operacioneve të sotme radikale në stomak nuk duhet të jetë vetëm heqja e organit por dhe mundesa e rivendosjes së gjendjes anatomike dhe funksionale me ndihmën e jejunogastroplastikës. Rezultatet e largëta do të tregojnë në qoftëse kjo metodë ka rëndësi profilaktike.

Literatura 106 burime

## MBI MJEKIMIN E MYELOMËS ME SARCOLYSINË

N. V. MERKULOVA Veprosionkologji, 1964, Nr. 3, faqe 51-58.

Duke u nisur nga afërsia genetike e qetizave myelomatoze dhe qelizave të tumorit Ewing dhe retikulosarkomatozës prej 1956 filloj studimi i përdorimit të sarkolysinës tek të sëmurët me morbus Rusticki-Kaler.

Në institutin e onkologjisë eksperimentale dhe klinike A.M.N. të B.S. nga viti 1956-1962 nga 55 të sëmurë me mieloma 40 u mjekuan me sarkolysinë. Myeloma multiplex kishin 37 të sëmurë, në 3 u konstatua myeloma solitare. Midis të sëmurëve 23 ishin mëshkuar dhe 17 lemta, shumica ishin midis 46-60 vjeç. 2 të sëmurë me myelomë solitare ishin 8 dhe 11 vjeç. 17 të sëmurë ishin mjekuar pa efekt me rontgenoterapi, fosfor radioaktiv, preparate hormonale, degranel; 23 ishin mjekuar në mënyrë simptomtik. Sarcolysina u përdor intravenos në formë solucioni 0,25%. Dosa ditore 40-50 mgr. në fillim të kursit të injektimit dhe 30 mgr. në fund. Preparati injektohej një herë në javë. Doza e përgjithëshe midis 150-300 mgr. Në këto doza u përdor dhe në formë tabletash. Në rastet e rënda kur pacienti nuk është në gjendje të mari doza kaq të mëdha mund të përdoren 15-20 mgr. në ditë me një interval pushimi 3-4 ditë ose një javë. Mjekimi bëhet me ndihmën e terapisë hemostimuluese. Doza e përgjithëshe 120-220 mgr. Modifikimi i kësaj terapië është përdorimi i 10 mgr. sarkolysine çdo ditë për 10-15 ditë rrjesht (doza e përgjithëshe 100-150 mgr.). Më vonë përdoren 10 mgr. një ditë po një ditë jo deri në dozen e përgjithëshe 200-250 mgr. pastaj intervali i pushimit bëhet 2-3 ditë deri sa të bëhet doza e përgjithëshe 300-400 mgr. Për forcimin e mjekimit mund të aplikohet terapia mbajtëse prej një muaji e gjysëm deri në dy, 10 mgr. në javë. Pas 2-4 muajsh mund të fillohet përsëri mjekimi në «mënyrë profilaktike».

Doza e përgjithëshe e sarkolysinës në mjekimin e përsëritur 100-210 mgr. Në kohë e sotme janë në observacion 29 të sëmurë, 12 ruajnë aftësinë për punë, kanë vdekur 10 pacientë në një interval kohe nga 2 muaj në 5 vjet.

Rëtensionet zgjasin nga 6 muaj deri në dy vjet. Komplikacionet dhe fenomenet sekondare nuk janë kundërindikacione dhe mënjanohen lehtë me ndihmën e terapisë hemostimuluese. Rezultatet e mara tregojnë efektin e preparatit në mjekimin e myelomës.

Literatura 37 burime.

## EKSPERIENCA E JODOTERAPISË NE MASTOPATIT

M. I. BOBROV  
Onkologia, 1964, Nr. 4, faqe 57-69

Sot njihet mirë lindhja midis prishjes së regularitetit endokrin dhe çfaqjes së cancer mammae.

Lazarev dhe bashkëpunëtorët kanë treguar në eksperiment se mastopatia lind në bazë të cisteve folikulare ovariale dhe se heqja e këtyre ovareve ndalon zhvillimin e mastopatisë. Autori ka aplikuar jodoterapinë në mjekimin e 50 të sëmurëve: 49 gra dhe 1 burrë. Mjekimi u bë me solucion 0,25%, kall i jodatit një lugë çaj dy herë në ditë. Mosha e patientëve nga 20-59 vjeç, 75,6% ishin në moshën 30-49 vjeç. Të gjithë të sëmurë u ndanë në dy grupe: i pari — me çregullime të ciklit menstrual (32,7%) dhe i dyti pa çregullime menstruale (67,3%).

Një e treta e grupit të parë në anamnezë kishin inflamacione të adnekseve, në të njëjtën kohë si dhe në grupin e dytë 15 gra (36,1%) kishin bërë aborte.

Shumica e të sëmurëve 75,7% u mjekuan gjatë 2-3 muajve. Efekti i pari i mjekimit ishte pakësimi dhe më vonë zhdukja e sindromit të dhëmbjes. Sindromi doloroz u zhduk në 29 të sëmurë, në 8 dhëmbjet recidivuan dhe në 8 të tjera nuk pati efek mjekimi (17,8%). Mastopatia u zhduk fare në 11 të sëmurë, në 24 pati zvoglime të shkallëve të ndryshme, në 14 (28,2%) masa nuk pati ndryshime.

Efekti i mirë u muar në 71,8% dhe vetëm në 28,2% nuk pati asnjë rezultat. Rezultati më i mirë (76,6%) ishte në të sëmurët që u mjekuan për 2-2,5 muaj.

Autori konkludon se jodoterapia është metoda efektive për mjekimin e mastopatisë. Ajo është e pa dëmëshme mund të përdoret gjërësisht dhe duhet të rekomandohet si profilaksi e mundëshme e carcinoma mammae. Një pjesë të rasteve sindromi i dhëmbjes mer karakter recidivant dhe kërkon kurse të përsëritura mjekimi

Literatura 13 burime.

## MBI DIAGNOSTIKËM E FORMËS KAVITARE TË CANCER PULMONUM

I.I. NEJMARK dhe D.A. NAJMARK  
Onkologja Nr. 5, 1964, faqe 11-15.

Midis formave të ndryshme kliniko-rontgenologjike të kanser-pulmonum, takohen ati periferik me shkatërrim dhe me prezencën e një ose më shumë kaviteve dhe me eparërin «kavitar», «kavernoz», «absceduar». Mekanizmi i formimit të kavitetit në Ca periferik nuk është i njëjtë.

Kaviteti mund të vijë si rezultat i degjenerimit të indit të vëtë tumorit ose në vjeç të abcedimit të pjesës pulmonare të ateletizuar, varet nga trombozimi i vazave ose nga kompresioni i tyre.

Një rol të rëndësishëm mund të luaj infekzioni. Nga 34 të sëmurë që u shtruan në klinikë për Ca periferik të pulmoneve, në 5 u vua diagnoza e formës «kavitar».

Vështirësi e madhe haset në diagnozën diferenciale të formës «kavitar» të Ca pulmonum me absesin kronik, tuberkulumën, kavernat e izoluara, cystet.

Forma «kavitar» në fillim çfaqet pa simptoma, shpesh diagnostikohet rastësisht. Vetëm kur tumori kap bronket e mbëdhë, çfaqet kolla, hemoptizia, dhëmbja në toraks, dispneja dhe anksesa të tjera.

Rëndësi të madhe ka ekzaminimi rontgenologjik i cili ve në dukje hije në formë ovale ose sfere, në bazën e hijes patologjike shihet kaviteti i cili ze pjesën centrale ose periferike dhe ka formë jo të rrregulltë.

Kaviteti mund të mos përbajë likuid, mund të ketë pak ose mund të jetë i mbushur plot. Nga ndonjëherë në të konstatohen sekuestra të indit tumorit.

Në 5 të sëmurë me forma kavitar të kanserit pulmonar klinikisht u diagnostikuar. Në dy të sëmurë diagnoza preoperatorre ishte abscessus pulmonum.

Literatura 13 burime

## TUMORET E URETRËS TË FEMRAT

A.E. KUSHELEV Onkologia, 1964, faqe 56-62

Në 17 muajt e fundit në dispanserinë onkologjike të rajonit të Donecit u konstatuan 71 gra të sëmura me tumore të uretrës nga të cilat 6 ishin neoformacione maligne dhe 65 benigne. Midis malinjeve të 6 ishin Ca, që përbëjnë 0.15% të gjitha carcinomave të femrat. Nga 65 me neoformacione benigne 58 ishin polype, 5 fibroma dhe 2 kondiloma.

Autori sipas strukturës histologjike tumoret maligne të uretrës i ndan në tre grupe: a) karcinoma, b) sarkoma, c) melanoblastoma.

Për klasifikimin e tumoreve benigne përdor klasifikimin e M.P. FhtoKoves të modifikuar nga V.I. Lozinski: 1) polype uretrale që vinë nga mukoza e uretrës dhe gjëndrat e saj; 2) fibroma, fibromioma, mioma, angioma paraurertrale nga indi konjunktiv dhe shtrresat muskulare; 3) cistet e uretrës. Kanceri primar i uretrës është sëmundje e rrallë, zakonisht zë moshat rrëth 56 vjeç. Faktorë etiologjikë janë tumoret benigne. Predominon kanceri planocelular. Nga ana makroskopike u konstatuan dy raste me forma infiltrative dhe egzofite dhe një rast me formën polypoide dhe ulceroze.

Kur neoformacionet janë të vogla, të kufizuara, bëhet heqja radikale me elektrobisturi e pjesës së lezionuar të uretrës në kufitë e indeve të shëndosha; në rastet më të avancuara bëhet rezekzioni i uretrës 2-2.5 cm. larg tumorit. Si rrregull bëhet radioterapia e regionit të shtrirjes së tumorit dhe rontgenoterapia e lymphogladulave inguinale. Në 81.7% të të sëmurëve u konstatuan polype uretrale, zakonisht sëmuren vjerezit nga 41-70 vjeç. Rol të rëndësishëm në etiologjinë dhe patogenezin e polypeve kanë sëmundjet gjinekologjike të zgjatur, në veganti proceset inflamatorë. Autori konsideron metodë të drejtë elektroexisionin e tumorit në polypet e vëçanta dhe resektion uretre me elektrobisturi në poliposis multiple. Autori tërheq vëmëndjen se pothuaj se më shumë se gjysma e të sëmurëve u drejtuat në dispanseri me diagnozë të gabuar.

Literatura 24 burime

## MBI MJEKIMIN KIRURGJIKAL TË PNEUMOTORAKSIT VALVULAR SPONTAN

Kandidat i shkencave mjekësore E. F. FISHER, S. Ja. RIZENFELD dhe  
B. N. POKROVSKI

Vjesnik Hirurgii, 1964, Nr. 4, faqe 25-28.

Pneumotoraksi valvular spontan është një nga komplikacionet e rralla por shumë të rëndë për një sërë sëmundjesh pulmonare (emphizema buzoze, T.B.C. sëmundjet purulente), e cila kërkon masat të menjëherëshme për shpëtimin e jetës së të sëmurit. Metoda konservative bazë e terapisë së pneumotoraksit valvular është aspiracioni i vazhdueshëm i ajrit nga kaviteti pleural, me qëllim që të ulet presioni intrapleural dhe të kthehet pneumotoraksi valvolar në të mbyllur ose në të hapur në mvarësi nga madhësia e perforacionit pleuro-pulmonar. Analiza e të dhënave të literaturës tregon se nëga metodat e ndryshme kirurgjikale përmjekimin e këtij komplikacionit në kohën e sotme përdoren metodat e më poshtëme:

1) Punktioni i toraksit me anën e Leichisky që ta përmirësojë uljen e presionit intrapleural deri në atë atmosferik.

2) Drenimi i kavitetit pleural sipas metodës Bewlow.

3) Torakoskopji me dissacion të adhuzimeve pleurale.

4) Torakoskopji me eparësim e formacioneve buzoze përmë të krijuar hencitë përshtërim sa më të shpejtë të fistulës pleurale. Nga njëherë përdorimi i metodave të sipërpermendura nuk ja harrin qëllimit përmbylli radikal të perforacionit pleuropulmonar, por bën vëtin kalimin nga pneumotoraksi valvular spontan në pneumotoraksi të mbyllur. Pulmonet duan deri një muaj e gjysëm përmë ardhur në gjëndjen e mëparëshme. Gjatë kësaj kohe pleura te disa të sëmurë pëson transformime fibroze dhe hialinoze. Sëmundja kalon në një fazë të re; formohet pneumotoraksi spontan kronik, mjekimi i të cilit është i inundur vetëm me një ndërhyrje kirurgjikale shumë traumatike siç është pleurektomia. Përmë këtë përdorimi i metodave kirurgjikale që zhdukin perforacionin pleuropulmonar në fazën akute të pneumotoraksit spontan valvolar dhe që sa më shpejt bjen pulmonia në normë duhet t'u jepet rëndësi e veçantë.

Përdorimi i metodave kirurgjikale radikale në fazën akute të pneumotoraksit spontan valvular bën të mundur të evitonet formimi i pneumotoraksit spontan kronik dhe që i sëmuri të shërohet në një afat sa më të shkurtër. Autorët nuk kanë konstatuar recidiva në të sëmurët e operuar prej tyre.

Literatura 18 burime

## RËNDËSIJA E TERAPISË KOMPLEKSE NË EFEKTIVITETIN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKAL TË T.B.C. PULMONUM

A. RABUHIN, M.I. PERELMAN, V.M. ALEKSEJEVA, V.O. GARGOLLOJAN,  
E.M. GOREVA, F.M. JOFFE, I.F. LEVITIN

Vjesnik Hirurgii, 1964, faqe 28-32

Autorët kanë studjuar 787 të sëmurë me tuberkuloz pulmonar të cilët ishin operuar në klinikat tuberkulare të institutit qëndror të perfeksionimit të mjekëve.

Në 573 prej tyre u bë resectio pulmonum, në 214 pneumoliza ekstrapleurale, torakoplastika dhe kavernotomia.

Rezultatet më të mira dha komplikacionet më të pakta post operatorre u konstatuan të sëmurët të cilët u operuan në gjendje remisioni, në mungesë ose kur lezonet specifike të mbëdhia kanë qenë të shëruar dhe kur ndjeshmëria e mikobakterieve tuberkulare është e ruajtur ose tek abacilaret. Përmë këtë duhet patur parasysh se efektiviteti i operacionit është i mvarun nga efektiviteti i mjekimit kompleks. Sipas obseracioneve të autorëve forma destruktive tuberkulare nën veprimin sistematik të terapisë tuberkulostatike të kombinuar me hormone steroide kanë mbylljen e kavernave në 66.4% përmë 6 muaj dhe 74.6% në një mjekim prej 12 muajsh. Rezultatet e obseracioneve shumë vjeçare i lejojnë autorët të nxjerrin konkluzionin e mëposhtëm: Mjekimi kompleks në të cilin rolin kryesor e luat terapija tuberkulostatike duhet të vazhdojë deri atëherë kur shikohet involucioni i sëmundjes, ndalimi i zhvillimit të progresive reparative duhet të shpjeri në rishikimin e taktikës së mjekimit që në etapat e para të tija. Atëherë në bashkëpunim me kirurgun duhet të vendoset zgjidhja e problemit mbi indikacionin e këtij apo atij operacioni.

Sipas eksperientës së autorëve, ky afat është midis 4 deri 6 muajsh. Përmë prega-

itjen preoperatorre preferohen substancia kimicoterapeutike tō ciljti pacientet nuk i kanë përdorur më parë dhe që ruajnë aftosinë mjekonjëse (viciot, cicloseria, treceptor). Përdoren gjérësisht në këto raste medikamentet hormonale dhe antiinflamatorë, vitaminal, aplikimi intrabronktal i antibibiotikëve transfuzionit o gjakut, shpesh përdoren pneumoperitonemni dhe ngandonjshëm rreumotoraks.

## MBI DIAGNOSTIKËN E CA RECTI

V. P. PETROV Vjesnik Hirurgii, Nr. 4 1964, faqe 65-70.

Sëmundjet e rektumit takohen shpesh. Kohët e fundit në klinikë u shtruan 1512 të sëmurë me sëmundje të ndryshme të zorrës së trashë, 107 prej tyre ishin me neoformacione malinje.

Operacione radikale ju bënë 38 të sëmurëve, palliative 41, laparatomë probatore 2, nuk u operuan përfshirë sëmundjet e ndryshme 26 të sëmurë.

Në këtë mënyrë ju nënështruan operacione radikale 35,5%. Mosha e të sëmurëve nga 22 vjeç, pothuaj 3/4 ishin mbi 50 vjeç. Midis të sëmurëve që ju nënështruan mjekimini radikal shumica ishin nga 5 deri në 70 vjeç, kurse ata që bënë mjekim palliativ nga 61 në 90 vjeç.

Burra ishin 26, femra 81 dm.th. 1:3.

Tumori shtrihesh në ampulla recti në 76 të sëmurë, shumica e tyre ishin në regjionin infra-ampular. To një i sëmurë i cili u operua në mënyrë radikale u konstatuan 2 tumore njëri në regjionin supraampular (jetri në regjionin rectosigmoidal).

Sipas të dhënave të autorit zgjatja mezatare e sëmundjes nga simptomat e para deri në operacion radikalish ishte 13.4 muaj, në të sëmurët që u operuan palliativisht rrith 15 muaj. Diagnostika e Ca recti nuk paraqet vështirësi të mëdha duke përdorur metodat e zakonëshme (tushë rectale, rektoskopë, metoda rentgenologjike), megjithatë shumë të sëmurë diagnostikohen në stadiet e vonëshme. Nga 107 të sëmurë 25 u drejtuat në klinikë me diagnoza jo të drejtë, ose pa diagnozë fare. Në 25 të sëmurët diagnoza e saktë mund të vijet vetëm me tushë rectale. Diagnostikimi i vonëshëm i Ca recti ka dy shkaqë kryesore: i pari vonesa e paraqitjes të të sëmurëve të mjekut dhe e dyta diagnoza jo të drejtë, kjo e fundit është kryesorja. Nga 107 të sëmurë 57 ishin drejtuar në poliklinikë për ndihmë mjekësore dhe i vunë diagnoza të ndryshme si hemoroide, dizantë, paratito etj. Simptonat më të herëshme janë: melenë, konstipacion, dhimbje, ndryshimi i formës së materieve fekale etj. Autori nuk është partizan i ekzaminimit histologjik të domosidhën preoperator.

Literatura 12 burime

## VEÇORITË E BRONKOSKOPISË TE FËMIJËT

Kandidat i shkencave mjekësore I. G. KLIMKOVIC  
Vjesnik Hirurgii, 1964, Nr. 4, faqe 112-117

Në klinikën e kirurgjisë përfshirë fëmijët të Institutit Qëndror të perfeksionimit të mjekëve, prej vitit 1959 janë bërë më se 400 bronkoskopi të fëmijëve me mosha të ndryshme.

Anestezia e përgjithshme veçanërisht më përdorimin e relaksanteve muskulare lehtëson përdorimin e bronkoskopisë tek fëmijët dhe ka avantaž shumë më të madhe para anestezisë lokale. Momentet psikologjiku e shkudheshen krejtësisht. Fëmija nuk ka asnjë shqetësim dhe ai vullnetarisht bie dakord që të përsëritet interventi.

Në sajë të relaksanteve muskulare bronkoskopi futet lirisht në trake dha bronke. Bronkoskopia është bërë më barbiturik dhe protoksid azoti të kombinuara me miorelaksante me veprim të shkurtër të tipit ditilir. liston në solucion 2<sup>nd</sup> më doza 2-3 milligram për kg. pesë.

Bronkoskopia bëhet më qëllim diagnostikimi dha kurativ. Përdoret si më perjuhën pre dhe postoperatorre më operacionet e pulmoneve.

Përdorimi i bronkoskopisë ndihmon më shumicën e rasteve të eliminohen komplikacione të vërtë postoperatorre.

Randë-indikacion për bronkoskopi tek fëmijët mund të shërbetë gjëndja shumë e rëndë më qollë se kjo e fundit nuk është e licha më pakalueshmërinë e rrugëve respiratore. Komplikacionet më pjesën më të madhe lidhet me nungesën e eksperiencës së anesteziologut.

Komplikacioni më serioz regurgitacio çfaqet në ato raste kur fëmija ka ngrënë para manipulacionit. Ky komplikacion mund të evitohet në qoftë se para futies të relaksanteve përdoret sonda gastrike.

Në artikull jepen indikacionet e bronkoskopisë.

Literatura 12 burime

## MBI DIAGNOSTIKIMIN DHE MJEKIMIN E TUMOREVE TË MEDIASTINIT

N. ANÇEV dhe A. PINKAS Sofia Bullgaria Onkologjia 1964. Nr. 5 faqe 31-37

Në artikull autorët kanë dhënë eksperiencën 10 vjeçare të diagnostikimit dhe mjekimit të tumoreve të mediastinit në Institutin e Lartë Mjekësor ushtarak.

Në observacion dhe mjekim kishin 23 të sémurë. Me termin «Tumore të mediastinit» autorët kanë inkluduar jo vetëm neofornacionet tipike beninje dhe maligne por dhe gjithë cistet parazitare dhe jo parazitare, gjithashtu disa procese inflamatorë kronike të inkapsuluara (T.B.C.).

Në termin «tumore të mediastinit» nuk janë futur tumoret e organeve kryesore të këtij regjioni: zemrës enëve të mëdha etj, sepse kanë karakteristikë të veçantë në diagnozë dhe mjekim.

Zakonisht sémundja kalon pa simptoma të theksuara dhe shpesh diagnostikohet rastësisht. Metodat themelore të përcaktimit të diagnozës janë ekzaminimet rontgenologjike. Vetëm në 8 të sémurë u vu diagnoza e saktë preoperatorre. U konstatuan 7 adenopati paratrakeale, dy teratoma, një cist dermoid, dy ciste bronkogene, një cist celionic, një lipome, dy fibroma, dy neurinoma, një adenocarcinomë e glandules tymus, dy cyste ekinokoku, dy cyste me prejardhje të pa kuartë. U konstatua se tumoret ishin në pjesën më të madhe në regjionin e përparëshëm të djathtë të sipërme të mediastinit.

Të gjithë të sémurëve që ju vihet diagnoza «tumore të mediastinit» duhet të operohen sa më shpejt sepse mund të jepin komplikacione (malinjizimi, supurim, perforim etj.) dhe në kohën e sotme torakotomia është një ndërrhyrje e perezikëshme.

Në pamundësi për të diferençuar tuberkulozin e linfoglandulave trakeobronkiale nga neoformacionet mediastinale dhe cystet duhet të bëhet torakotomia. Evaluimi i materies kazeoze nga linfoglandula dhe futja lokale e antibiotikëve të shqëruara me terapinë specifike antibakteriale çojnë në shërim të plotë.

Literatura 13 burime

## Ca POLYPOID PULMONUM

N. K. SHUKAREVA. Onkologjia, 1964 Nr. 5 faqe Nr. 24-31.

Qëllimi i artikullit është përshtrimi i veçorive kliniko-morfologjike të tumoreve polypoide bronkiale që zënu 5-8% të gjitha kansereve pulmonare. Shumica e tumoreve polypoide janë kanseroze.

Metode vendintare për diagnostikimin e këtyre tumoreve është bronkoskopia e cilës ndihmon jo vetëm për të parë tumorin po për të marrë dhe biopsi.

Autori ka studjuar 16 të sémurë, në 12 nga të cilët sémundja filloi në mënyrë akute, zgjalja e simptomave te shumica ishte nga 2 deri në 6 muaj. Vetëm në 3 të sémurë (në 1 me kancer dhe 2 me papiloma të bronkut të malinjizuar) sémundja u zhvillua në formë pneumonie obturative kronike të riakutizuar për 3 deri 8 vjet. Në 16 të sémurë dëj u bë bronkoskopia vetëm në 7 u pa tumori.

Të gjithë të sémurëve u ishte vënë diagnoza preoperaore Ca pulmonum, 15 të sémurë ju bë pulmonotomia, njërit lobektomi superiore.

Tumoret polipoide të bronkeve më shpesh janë nga ana histologjike kansere planocellular cornificans që mund të vijnë nga malinjizimi i papilomave ekzistuese në bronke. Këto illoj tumorë takohen me shpesh në bronket e mëdha, në raste të veganta në bronket e sipërme të lobeve të poshtëme dho akoma më rralle në bronket segmentare.

Rezultatet e largëta të mjekimit kirurgjikal tek të sémurët me Ca polipoid planocellular janë më të mira se sa të atyre me Ca polipoid pak të diferençuar.

Në bazë të studimit morfoligjik dhe analizës së rezultateve të mjekimit kirurgjikal të Ca polipoid të pulmoneve mund të konkludojmë se në tumoret me ndërtim planocellular pa metastaza mund të kufizohemi vetëm me metodën kirurgjikale.

kurse në tumoret me ndërtime jo të diferençuar, bile kur kanë dimensione jo të mëdha dhe pa metastaza krasas operacionit duhet të fillojnë dhe kimioterapi. Në kanë jetuar 5 vjet pas operacionit 8 njerëz, vdiqën 2 1/2 deri 4 vjet pas operacionit nga metastaza 2 kanë jetuar më pak se 1 vit dhe vdiqën nga metastaza; 8 jetojnë 3 muaj pas operacionit 3; vdiqën pas operacionit 2, fati i njërit nuk dihet.

#### Literatura 16 burime

### MBI SEKRETIMIN E UROPEPSINËS NË TË SËMURËT ME CA. VENTRIKULI

I. F. GREH dhe E. A. BOGNIKOV Onkologja, 1964, Nr. 4, fakje 25-29

Përbajtja e uropepsinës në urinë me përcaktimin në të njëjtën kohë të sekretionit gastrik u studjuar në 24 të sëmurë me Ca ventrikuli të diagnostikuara klinikisht, rontgenologjikisht, me biopsi dhe të konfirmuara me operacion.

Qëllimi është studimi i uropepsinës tek të sëmurët me Ca ventrikuli dhe i krasasimit të këtyre të dhënave me të dhënat e klinikës, radiologjisë dhe histologjisë. Më poshtë autorët jepin metodikën e studimit.

Përcaktimi i uropepsinës është bërë me metodën e Uesi-it sipas modifikimit të tyre. Tek të sëmurët me Ca ventrikuli përbajtja e uropepsinës lëkundet midis 2 deri 100 unitete në orë. Në 52 nga 84 të sëmurë përbajtja e sajë nuk harriti nivelin e ulët 20 unitete që vihet re tek njerëzit e shëndoshë. Në të sëmurët e tjerë niveli i fermentit ishte normal ose i rritur. Niveli i ngrijuar i uropepsinës në urinë u vuve re në të sëmurë me Ca ventrikuli të stëdit të trejtë dhe të katërt që kishin tumore pak të diferençuarat.

Ulja e përbajtjes të uropepsinës në urinë nuk mund të shërbejë si një shönjë absolute e proçeseve atrofike të mukozës së stomakut. Ajo më shpesht flet për një inhibicion funksional gjendror dhe të mukozës së stomakut që kondicionohet me uljen e aktivitetit të sistemit hipofizio-suprarenal. Përcaktimi i fermentit te të sëmurët me Ca ventrikuli ka interes për të gjykuar në shtrirjen e tumorit ose graden e diferençimit të tija.

#### Literatura 18 burime

### MBI DIAGNOZËN DHE MJEKIMIN KIRURGIKAL TË TUMOREVE BENIGNE PULMONARE

Prof. V. I. STRUCKOV, A. V. GRIGORJEN, G. L. HOL-EPSHITEJN., Kirurgia, Nr 4, 1964 F. 24-31.

Në klinikën e kirurgjisë së përgjithëshme të fakultetit të parë të mjekësisë MOLMI prej vitit 1952-1963 janë bërë 270 operacione për Ca primar të pulmoneve dhe 25 operacione për tumore benigne (9,2%) adenoma (10 të sëmurë), fibroma pulmonare (1), linfangiona (1), tumore neurogene (2), hematochondroma (10), teratoma (1).

Shumë nga tumoret benigne nuk kanë dhënë simptoma, janë konstatuar rastësisht gjatë ekzamimeve rentgenologjike. Adenonë bronkiale zë 5-8% të të gjithë tumoreve bronkogene dhe është më e shpeshta midis tumoreve benigne të rugeve respiratorë (60%).

Më shpesht takohet në femra se në meshkuj (21), mosha mesatare e të sëmurëve 38-40 vjeç. Në pulmonin e majtë takohet 40% në të djathtin 60%. Forma centrale e adenomës bronkiale takohet në 75% të rasteve periferikja në 25%. Adenomat bronkiale kanë astësi të metastazojnë në linfoglandulat parashiliare dhe paratrakeale, më rrallë hepar, kokë, tru, surena etj.

Malinjizimi është konstatuar në 10% të rasteve. Karakteristika e sëmundjes është i quajturi «Sindromi i edemës» komponentë e të cilit janë hemorrhagjia dhe hemopizitë e shpeshta, shënjet e bronkostenozës, zgjatja e sëmundjes. Dekursi klinik i adenomës bronkiale ndahet në tre stade.

Adenoma endobronkiale e pa komplikuar me inflamacion dhe ndryshime në pulmone, mund të hiqet por pa tjetër me rezeksjonin e bronkut ose me rezeksjonin segmentar të pulmonit. Kur konstatohet malinjizimi operacioni minimal është lobektomia, linfoglandulat regionare duhet pa tjetër të hiqen. Në adenomat periferike është i indikuar rezeksioni segmentar i pulmonit ose lobektomia, në restë të tjera ndërhyrja kirurgjikale mivaret nga shtrirja e proçeseve sekondare në pulmone.

Në klinikë janë operuar dhe 8 burra e dy gra me hematoma pulmonum. Në 5 të sëmurë diagoza u vu para operacionit. Në artikull jepen shënjet karakteristike të sémundjes dhe mjekimi i saj kirurgjikal.

Literaturë 20 burime

### ANESTESIA NË OPERACIONET E ZGJERUARA PËR ELEFANTIASIS

I. G. DUTKEVIC, P. M. MEDVEDEV,  
Vestnik Birurgii, Nr. 4 1964 f. 97-101.

Në kohën e sotme përdoren shpesh operacione të zgjeruara për linfozatat kronike dhe elefantiazet e ekstremiteteve. Këto lloj operacione janë shumë të vështira, sepse heqja e lëkurës dhe e shtrësës suksikanë është një moment shokogen që shqyrron me hemorrhagi dhe plazmoze. Shokun e ndihmon dhe prezencia e shqyrtit i cili në këto lloj operacione mbahet për një kohë të gjatë.

Weinstein, Roberts etj. operojnë vetëm me narkoz, të tjerë në anestezi spinale. Kirachner dhe bashkëpunëtorët përdorin hipotonin e drejtuar. Zwicher etj. e ndajnë operacionin në disa etapa me intervale deri në 48 orë për të evituar shokun.

Autorët kanë studjuar 67 operacione të bëra në 60 të sëmurë me elefantiazis duke u përqendruar në metodën e anestezisë.

Nga 60 të sëmurë 58 kishin elefantiazis të ekstremiteteve të poshtëme: i kishte linfozatë të ekstremiteteve të sipërme dhe një kishte elefantiazis të organeve genitale. Vëljam në 14 të sëmurë nuk u konstatuan ndryshime patologjike të organeve të brëndëshëm.

Përparrë operacionit, të sëmurët u pregetiten me tonik (solucion glukoze me vitamina, kordiamin, kanforë) dhe substancë sedative.

Premedikacioni u bë në pragu e operacionit me luminal, dimedrol, pantopon, atropinë, në dozat e zakonëshme. Pas futjes intravenozë të barbiturateve të tipit tiopental, heksenal, intranarkon dho injektimtë të miorelaksantëve depolarizues (fiseton) u bë intubimi i të sëmurëve. Narkoza bazë me eter, rrall me protoksid azoti, Thellësia e narkozës në stadin analgozik ose më shpesh në fazën e parë të stadiut kirurgjikal. Gjatë kohës së operacionit përdoren fuzjone të solucioneve makrocelulare, 0,25% solucion novokainë me glukozë dhe gjak.

Tensioni arterial dho puls i shin stabël në 34 të sëmurë. Një moment me përgjegjësi është heqja e zhgutit, para heqjes së tija futet gjak; në sasi të madhe, në fund të operacionit u vendos respiracioni dhe pas kësaj u hq tubi intratrakeal. Hapnije e zgjatur u konstatua 19 herë. Zgjatja e apnoës ishte mesatarishi 20-30 minuta. Tek tre të sëmurë në fund të operacionit nuk u stabilizua respiracioni aktiv individual, ky i fundit u stabilizua vetëm pas dekuarizimit me prozerin (1-1,5 mg). Në asnjë rast nuk u konstatua shoku operator gjatë narkozës me respiracion të drejtuar. Vdiq vëtëm një i sëmurë të cilët gabimisht në vend që ti jepej narkozë endotrakeale me respiracion të drejtuar ju dha pa këtë të fundit, i sëmuri vdiq nga shoku i rendë në kohën e operacionit. Periudha postoperatoriore te shumica e të sëmurëve kaloi mirë. Në 19 pacientë u konstatuan komplikacione të ndryshme (hipotonji, nauze, vomitus, dhimbje muskulare, dhimbje gjatë gëlltësjes, ndryshime në zë), vetëm një i sëmurë kaloi pneumoni postoperatoriore. Metodika e narkozës së përshtkuar më lartë lejon që të mos ndahet operacioni në etapa por të kryhen intervente të mëdha në të njëjtën kohë jo vëtëm në një por dhe në dy ekstremite bashkë.

Literatura 13 burime  
Përbledhur nga Zino Matathia

### STUDIMI RONTGENOLOGJIK, ME KONTRAST I SINUSEVE MAKSLILARE, NË PROJEKSION OBLIK

S. I. ALEKSEJEV, L.L. SULAK  
(Vjestni. Otorinolaring. 1963, Nr. 6, fq. 19-20)

Diagona diferencale në alteracionet inflamatorë të sinuseve maksilarë, deri iashti dhe me ndihmën e ekzaminimeve roentgenologjikë, paraqet vështirësi, për arësyte të kuadrit klinik të ngjashëm.

Studimi roentgenologjik me kontrast i sinuseve maksilar asht rekomandue nga Ginzburg, Troiokaja-Trogubova, Bardak etj, por jo me metodën e futjes së kontrastit në një moment.

Janë ekzaminuar 68 të sëmurë (136 sinuse maksilarë). Jodolipoli asht introductue

në dy sinuset, në nji moment. Pacienti i shrimë në bark, mbështetet në njenin nga tuberat frontiale, tue afruit mjekekrrën te gjoksi, në mënyrë që plani i mescm sagital i kokës, me atë të tavolinës, të formojë nji kand 45 gradë. Koka duhet fiksue.

Sinusel maksilarë, në grafi, kanë formë ovale të pa rregulltë, dukej njeni mbas bjetrit. Në këtë mënyrë krijuhet mundësia që të observohet gjendja e mukozës së sinuseve në pjesët anteriorë, superiorë dhe posteriorë. Këmblimi me roentgenogramën nazomeatalë të sinuseve na jep mundësi me prizëzue jo vetëm karakterin e procesit patologjik por edhe gradën e përhapjes së tij. *Higaritis Catarhalis chronica* karakterizohet me nji trashim marginal të mukozës prej 0,3 — 0,6 cm., forma purulente krouke 0,8 — 1 cm., konturat janë të lëmuara, nga njihetë të valëzuara. Në formë polipozosupurative vrehet hije jo e barabartë e masës së kontrastit.

Në format polipoze dhe me hiperplazi të zhvilluar, masa e kontrastit vendoset në qendër të kavitetit të sinusit, kurse në periferi ka defekte të mbushjes me madhësi të ndryshme. Konturat e masës së kontrastit janë të pabarabarta, me hymje dhae dalje.

Në rastet e kisteve prizëzohet ekzistenza dhe lokalizimi i tyne.

Me anë të këtij ekzaminimi, tue përcaktue llojin e procesit inflamator dhe graden e përhapjes, përcaktohet drejtë taktika e mjekeitit. Kështu shkurtohet dhe afati i ekzaminimeve.

## MBI DIAGNOZËN DIFERENCIALE TË KISTEVË MAKSLILARE DHE FORMAVE SEROZE TË SINUSITIT MAKSLILARE KRONIK

M. I. KADIMOVA, M. P. BOGOMILSKI  
(Vjestn. Otorinolaring. 1963, Nr. 6 fq. 21-24)

Diferencimi midis formës seroze të sinuzitit dhe kisteve ka rëndësi të madhe për caktimin e llojit t'interventit.

Janë obervuar 62 raste (41 me formë seroze dhe 27 me kiste). Në 34 raste me forma seroze ishte evident tereni alergjik ndërsa në kisetet në 9 raste.

Hinoskopja në format kistikë ka vje në dukje edemë dhe hiperemi të mukozës, sidomos në *meatus nasi meditus*.

Në rastet me inflamacione seroz asht vrejtë gjithmonë proces hiperplazik.

Moment deciziv për diagnozën diferenciale asht punksioni maksilar. Kur punktura bjen në lumenin e kistit, gjatë tërheqjes me shiringë, del likuid seroz, po të hetet lavazhi fillon dhimbje e tortë koke. Mbështetet shingës së shiringës, nga gjylpana rrjedh lëng pika pika.

Kur punktura kalon ma tej se kisti, gjatë aspiracionit del ajër lavazhi bahet lehtë.

Në rastet e sinuzitit maksilar seroz, kur punktura bahet në kavitetin e sinusit, gjatë aspiracionit me shiringë del shumë likuid, gjatë lavazhit, në se aperfura e sinuzit asht krejtë e myllun, fillon dhimbja.

Kur punktura kalon në trashësinë e mukozës, gjatë aspiracionit dhe lavazhit ka shumë dhimbje.

Makroskopikisht transudati në kisetet asht nga njihetë mukoz, ngjyra si qehlibari, ka shpesh kristale kolesterine, rrallë epitel të deskuamar, nga gjylpana del me presion, me pika të shpeshita ose si curril.

Në format seroze, transudati nuk asht kurr mukoz, ka ngjyrë të verdhë të zbehtë, nuk përmban kristale kolesterine, ka shpesh epitel të deskuamar sidomos në sediment, vjen në shiringë me aspiracion, nga njihetë pika pika.

Kur procesi inflamator okupon gjithë kavitetin e sinusit, diagnoza diferençiale vështirësitet. Në këto raste randësi të madhe ka simptomë i «currilit» që asht karakteristik për kisetet e mëdha. Në këto raste nevojiten dhe ekzaminime të tjera komplementare si rontgenograma me kontrast e tjera.

## DISA ÇESHTJE TË MJEKIMIT TË SËMURËVE ME DISFAGI, TË ZHVILLUEME NË TERRENIN E KOMBUSTIONEVE AKUTE TEZOFAGUT DHE SI REZULTAT I STENOZAVE KRONIKE TË TJJ.

Prof. P. D. BUJEV  
(Vjestn. Otorinolaring. 1963, Nr. 6 fq. 80-83)

Në rastet e kombustioneve akute, kondicionohet nga ezofagospazma kurse në stenozat kronike nga ozofagostenzoa.

Në kombustionet akute disfagia shpesh nuk ka karakter konstant, në mëvartësi

në gjendja funksionale dhe tipi i SNC. Kjo disfagi mund të jetë krejt e lehië, deri në pamundësi të plotë për kalim t'ushqimit.

Përdorimi i novoksinës në këto raste, pakëson spazmën dhe influencon pozitivisht në organizëm. Novokaina (0,25 — 0,5%) përdoret nën lëkurë, në muskul, venë ose kockë. Ka rëndësi individualizimi. Mund të përdoret dhe blokada vago-simpatike. Mjekimi me novokainë duhet kombinuar me preparate hormonale (kortizon, ACTH), me rekonstituentë, simulantë.

Në format kronike (stenoza) përdoret buzhimi i cili në stenoza mbas kumbustioneve gr. II/III dhe strukturat kalozë, bahu për një kohë mjaft të gjatë. Në çregullime të randa alimentacioni rekamandohet gastritomia që lejon dhe buzhimin retrograd.

Stenoza shumë të vjetra, shpesh, influençohen pak nga buzhimi.

Shumica e autorëve kërkojnë sot mënjanimin e zgjerimit mekanik dhe zavendësmin me biologjikë, me përdorim të peritoneumit heterogen të teutoterapisë, përdorimin e aloe dhe placentës).

Të tjerë përdorin me efekt kombinimin e Lidazës me ACTH. e kortizon (vepron pak ma dobët se në format akute).

Nga procedurat fizioterapeutike përdoret Jontesoreza me 0,5% novokainë.

Përbledhur nga Simon Fistani

## PROBLEME AKTUALE TË KURIMIT TË SIFILIZIT.

M. P. de Graclansky.

Pres. Med. 72. Nr. 25. 23 maj 1964.

Autori merr në studim efikasitetin e penicillinës në luftimin e formave të ndryshme të sifilizit:

Për sifilizin praecox (gjer në fund të periudhës sekondare), duhet t'i përbahemi këtyre principeve:

1) Doza efikase e penicillinës të mos jetë më pak se 0,03 U për ml. serum por edhe duke ndejtur brenda këtyre kufive, duhet patur parasysh se çdo sifiliz nuk është i njellojë dhe se përbajtja e penicillinerisë ndryshon prej një pacienti në tjetrin. Me një fjalë duhet patur gjithmonë një penicillinemë të efektëshme dhe prandaj duhet vepruar në këtë drejtim e jo vetëm në njësi penicilline të dhënës.

2) Skemat e ndryshme të propozuara janë të vlefshme deri sa sigurojnë një mbajtje penicilline në gjak simbas sasisë që thamë më sipër.

Preferencat që kanë disa autorë për njerëz apo tjetër apo lloj penicilline (aquosa apo retard) nuk kanë ndonjë mbështetje shkencore.

Çdo sifiliz i trajtuar në periudhën preserologjike negativizohet me çdo lloj skemë por negativizimi i plotë i serologjisë së sifilizit është aq më i zorshëm sa më vonë të fillohet kura mbas çfarjes së lezonave. Në rastet e serologjisë pozitive (mbas kurimit), nuk duhet të shqetësohem sepse asnjëherë vërejtja klinike nuk ka vënë në dukje një acarin të sëmundjes dhe kontrolllet e likuorit c.s., në këto raste, nuk kanë tregue prekje të meningeve aq sa, këto kontroile të fundit, na janë dukur të tepertë. Përvec kësaj, pacientët me këtë gjendje, kanë lindur fëmijë të shëndoshë pa bërë kura gjatë shtatzanisë.

Pa hyrë në diskutime doktrinale të shumë studiozoëve që o kon siderojnë seropositivitetin permanent si shkak të qëndrimit të treponemës n'organizmë ose si një difiket serologjik si mbas të cilët organizmi edhe i sterilizuar vazhdon të prodhojë antikorpë si në shumë sëmundje infektive, autorë mendon se në këta raste, s'ka arësyte të vazhdohet mjekimi.

Penicillinoterapisë mund t'i shtohet Bismuthoterapia pse simbas Gougerot, ka shumë të ngjarë që kështu «ti jepet pacientit një mundësi e dyfishtë shërimi».

*Sifilizi i vonshëm.* Këtu është shumë i vështirë negativizimi i këtyre pacientëve. Simbas Huriez, negativizimi, shifet në 3-5% të rasteve me sifiliz të vonshëm. Vazhdon të mbetet e pagzjidhur përshtatshmëria e kohës së zgjatjes të penicillino terapisë dhe e bashkimit me këtë kurë të cianure Hg. për efektin antiskleroz dhe të Bismuth-it e jodit për efektin risolutiv që kanë.

*Sifiliz asimptomatik.* Disa raste të rralla të këtij lloji sifilizi negativizohen shpejt sepse pa dyshim janë të një sifilizi të hershëm (recens) i pakonstatuar por shumica janë irrediktibël. Është interesant në këtë drejtim, konstatimi i Bolger-it mbi irrediktibilitetin e Wassermannit në 90% të meshkujve dhe 35% të femrave në mes të cilave shumë prostitute të ekspozuara infeksionit.

Përsa i përket gruas shtatzane, autori pohon se sifiligratet, duke u nisur riga vërejtje personale dhe nga njohja e ekzistencës së spiroketës në formë granulare, nuk e vlerësojnë absolute pamundësinë e transmetimit të sifilitit në fetus përparratë së pestës javë dhe se pranojnë sifilizin patern. Për këtë qëllim ata trajtojnë me penicillinë dhe sa më parë, gdo grua shtatzane sifilitike dhe bile edhe një grua jo sifilitike por që ka të shqoq të infektuar.

Në lidhje me trajtimin profilaktik të një personi që ka patur kontakt me një sifilitik, autori pohon se shumë studiozë këshillojnë një injektiun të vetëm me një dozë mesatare penicillinë retard.

### TRANSPLANTIMI I ORGANeve.

Idem. fage 1525  
A. Ravina.

Pengesa më e madhe e transplantimit është sistemi antigenik që mpron trupin kundër organizmave patogene: çdo person duhet se prodhon një sasi antigenesh që luftojnë ata (antigenet) «subversivë» të organëve të transplantuar duke prodhuar antikorpë që shkatërrojnë qelizat e huaja dhe këshiu kontribuojnë në largimin e transplantit.

Megjithëse në gjendjen e sotshme të mekanizmit biologjik ne nuk kemi njohuri të plota, në këtë drejtum e dimë se «anilgenet T» (antigene të transplantimit) gjinden në të gjitha qelizat me nukleus të të njejtë person. Megjithë këtë gjendje errësire, ka dalë një farë dritë nën mbrojtjen e specificitetit organik. Disa regjione jo fort të vaskularizuara ose me drenazh limfatik të dobët, janë më të favorëshme për transplantim këshu p.sh. dhoma e përparshme e syrit, spatiu ndën kapsular renal, truri dhe testis.

Disa bine nuk shiyhen (luftohen) prej organizmit. Kornea mund të transplantohet me qenë se duke mos patur enë gjaku nuk atakohet prej qelizave të organizmit marrës. Hindi ovar, për arësyera të panjohura, mund të qëndrojë gjatë në një organizëm të huaj. Këshiu ka qënë e mundur të ndërrrohet mosha e minjve duke grefuar ovaret e të rijeve në plegjë dhe të pleqve në të rinj.

Ka patur sukses grefimi i kockave dhe i enjave të gjakut (arterie) por vetëm sepse homografi është shkallëruar dhe zëvendësuar sistematikisht me bind të furnizuar prej organizmit marrës.

Sukseset më të dukshme janë vërejt në transplantimin e renit të një viçi univitellin (të formuar prej fertilitimit të një veze të vetme dhe prandaj në çdo pikëpamje, edhe nga ana e antigjeneve e njejtë) në një tjalë.

Këto raste janë të rralla sepse — në rastet e tjera — është e domosdoshme të prishet ose të dobësohet mekanizmi i imbrojtjes ndaj grefeve alogene.

Ndonjëherë për të patur jecësë të transplantimit, kur dhënësi dhe marrësi nuk janë të ngajshëm ngushtësisht ose janë krejt të ndryshëm, janë përdorur doza mësive rrezesh X me qëllim që të zhdukesh përgjegjja imunologjike dhe të vonohesh eliminimi i grefeve. Por ky sterilizim absolut i marrësit, zbuluk mundësinë e imbrojtjes ndaj infeksioneve dhe prandaj ai vdes prej septicemie.

Edhe kemioterapia ka ndërrhyrë në këtë drejtum me përdorim të substancave si steroidet, antimitotiket dhe në mës të këtyre sidomos të aktinomycinës D, të cilët duke ndërrhyrë në prodhimin e acidit desoxyribonukleik në gjendrat limfatike, ndalojnë prodhimin e antikorpeve por vështirësia e këtyre medikamenteve të ndryshëm gjëndron në dosazhin e tyre i cili, duhet të jetë i tillë, që të ndalojë eliminimin e grefeve dhe njëkohësisht, të mos prishë imbrojtjen e organizmit dhe gjendjen fiziologjike të individit të trajtuar.

Me këto metoda ka qënë e mundur të transplantohet veshka në raste ku dhënesi e marrësi ishin krejtësisht të ndryshëm dhe të këtë funksionuar përmes teplës së një vit e gjysëm.

Disa autorë, duke menduar se në grefet problemi imunologjik do të sqarohet, mendojnë qysh tashti për gjetjen e organeve për transplantim. Në qoftë se është e lehtë të jetojë njeriu vetëm me 1/5 e kapacitetit renal, mund të gjinden persona që të jepin një veshkë për transplantim por organet e tjera si zemër, hepar nuk mund të merrë vegzë prej kadaverash gjë që ngren shumë probleme legale dhe teknike. Megjithatë, thonë disa autorë, në qoftë se kadaverat do të bëhen, përmes pak kohë burime «pjessësh shkëmbimi» mund të studiohen masat që lejojnë konservimin dhe përdorimin e organeve. Eksperimentet mbi kafshë kanë treguar se pjessë të trupit si anësítë, mund të mbahen të padëkompozuara në ftohtësi të madhe si p.sh. në temperaturë minus 15°.

## CILAT JANË INDIKACIONET E KORTIKOTERAPISË NË DERMATOLOGJIT

M. R. Tourain. Pres Med. 72, Nr. 40 20 Qershor 1964.

10 vjet përdorimi të kortikosteroive kanë lejuar përsaktimin e disa indikacioneve të vlefhime por kanë dhënë edhe shkas përshkrimi të saj jo të drejtë në disa raste. Për të evitar këta keqpërdorime, autori i ndan në katër grupe indikacionet e kortikoterapisë në Dermatologji.

### I. Indikacione të thjeshta.

Këtu përmblidhen dermatozat akute, të ashpëra dhe me natyrë reaktive si fjalë vjen ekzema akute e përhapur, urtikaria e menjëherëshme, erytema me natyrë alergjike (shpesh medikamentozë) si dhe dermatozat hyperpruriginose. Doza në këto raste nuk duhet të kalojë të 50 mgr. të deltakortenit që mund të përdoret edhe me rrugë intramuskulare ose intravenoze duke patur kujdes që të mos përzgjatet shumë dhe të paksohet në mënyrë të rregullt, jo të menjëherëshme. Në sifilizin sidomos në format e saja sekondare, në të porsalindurin dhe në gruan shtatzane, kortikoterapia e shoqëruar me penicillinë gjin një aplikim të përshtatshëm.

### II. Indikacione të plota.

Këto duhen njohur mirë sepse kortikoterapia lejon në këto raste, të ndryshohet prognostiku i sëmundjeve të rënda o vdekjeprurëse. Në mjekimin e këtij grupi që kryesohet prej pemfigus vulgaris në të cilin kortikoterapia ka ulur vdekshmëri në 20%, duhet të pranoher disa fakte:

Nuk ka aq rëndësi zgjedhja e kortikosteroidit të sulmit (mbasi të gjithë kanë të njejtën veprim) sa doza, që mesatarishi duhet të jetë prej 80-200 mgr. deltakortizon dhe e përzgjatur (gjithnjë nën mbikqyrje të mjekut në Spital) deri sa të cikatrizohen lezionet mukoze, mesatarisht 1-2 muaj. Rrjedhimet e këqia digestive o tromboembolike të kësaj terapi, janë të rralla.

Pakësimi i dozës duhet bërë në mënyrë të rregullt, sa më ngadal pa u influencuar as prej aksidenteve të shpeshta e të ndryshme as prej atyre me të rënda as edhe prej gjendjes së mirë të pacientit.

Doza e mbajtjes së kortikosteroideve, mesatarisht 8-12 muaj, është 10-15 mgr. deltakortizon.

Përsa i përket sëmundjeve të kollagenit, këtu indikacionet e kortikoterapisë janë klasike. Kështu për Lupus erythematoses sistemik në të cilën doza e sulmit nuk është aq e lartë sa në pemfigus por e njejtë doza e mbajtjes. Këtu terapija shoqërohet me antimalarikë. Gjithë kjo terapi (kortiksteroide + antimalarik) përdoret edhe për Lupus Erythematoses Acutus por përfundimisht e një kohë shumë të shkurtër.

Për dermatomyositis, një dozë prej 50-80 mgr. është përgjithësisht e mjafuschme pér të ndaluar menjëherë sindromin kutaneomuskular sidomos në lokalizimet e saja të rënda laringo-faringeale ose respiratore; në periarteritis kortikoterapia përdoret gjithashftu në të njejtë doza kurse në skleroderminë e gjeneralizuar, me gjithë zhvillon një veprim të favorshëm në infiltrimin e lëkurës dhe mbi retraksionet muskulare, paraqet shpesh kundërrindikacione. Sidoqoftë në këtë rast, kura duhet të jetë e përzgjatur dhe e kryer më shumë kujdes.

Së fundi në eritrodermite kronike që as klinika as ekzaminimet histocitologjike nuk mund ti dallojnë në se janë ekzema apo hematodermi dhe, kur të gjitha mjekimet e tjera nuk kanë dhënë ndonjë përfundim të kënaqshëm, mund të përdoret kortikoterapia. Në këto raste në të cilat doza e mbajtjes nuk duhet të jetë e pakët, të mos harrohet se insuksese eventuale mund të shpijenë në një retikulopatië të lëkurës.

### III. Indikacionet e arësyeshme.

Në këtë grup, përmblidhen sëmundje në të cilat kortikoterapia nuk është e domosdoshme por mund të përdoret kur të gjitha medikamentet e tjera kanë qënë të paefektshme, disa dermatata bulloze si p.s.h. Dermatitis herpetiforme Duhring kur injetet e tjera klasike (sulfamide, antibiotikë, sulfone) nuk kanë dhënë përfundim të kënaqshëme. Kortikoterapia është e efektshme në raste të tillë por me kushte që të paksohet ngadalë dhe të vazhdohet doza e mbajtjes 3-5 mgr. deltakortison. Po ashtu e efektshme është kortikoterapia në eritemat polimorfë të rënda të lëkurës dhe të mukozës si ekziderma Fiessinger-Renda, Stevens-Jonson, sidomos tek fëmijët dhe me komplikacione okulare.

Në hematodermite, si mukosis fungoides mund të përdoret sa më vonë dhe mbasi të jenë shfrytëzuar mijete tjera terapeutike, sidomos radioterapija.

Në retikulosen e lëkurës kortikoterapija mund të përdoret në doza të larta e shodhëruar edhe me antimitotike; në leukosat mund të përdoret sa më vonë. Në sarcoidosat e Besnier-Boeck-Schumann, kortikoterapija mund të përdoret mbas dëshitim të isoniacidit. Së fundi kortikoterapia gjë aplikim në Hypodermite, në vaskularitet akute dhe në disa forma lichen planus akute të përhapura dhe hyperpruriginise.

Kundraindikacione të përdorimit të kortikoterapisë janë psoriasis në të cilën përmirësimi i përkohshëm pasohet me një koçsim që këthehet shpesh në erithrodermi, ekzemat dhe lepra.

Duke përbledhur mund të themi se kortikoterapija është shumë e vlefshme në Dermatologji me kusht që të njihen mirë indikacionet duke mos patur kundrejt saj as entuziazëm as edhe aversion të tepruar.

## TRAJTIMI I RI I ALOPECISË SEBORROIKE. LIDHJA E ENËVE TEMPORALE SUPERFICIALE

**Raymond Marechal (Bruxelles).**  
Pres. Med. 72 Nr. 13. 14 Mars 1964.

Autori mbasi përmend se q'farë traume psihike shifikton ramja e flokëve dhe se si deri më sot të gjitha mijetet terapeutike kanë qënë të pavlefshme në ndalimin e rënies së tyre, përshkruan punimet e fundit mbi rritjen dhe mirërritjen, fizio-patologjinë e flokut dhe sidomos zhvillimin e endokrinologjisë që ka lejuar përcaktimin e etiologjisë së seborrhoeas, pytiriasis dhe të alopecias.

Simbas këtyre studimeve, prezenca anomale në gjak e androgeneve që shtojnë aktivitetin e gjendrave sebace dhe të qelizave epiteliale të lëkurës së kokës nga një anë (Hamilton, Montagne) dhe grumbullimi, nga ana tjetër, në fund të gjendrave sebace të lyrës jo të tretur (të metabolizuar) që vjen nga ushqimi dhe që dallohet nga lyra e gjendur në qendër të këtyre gjendrave (Behrman, Policard e Tritkovich), janë para së gjithash shkaqet e sëmundjes.

Mjekimi i pranuar tek femra, në këta raste është përdorimi i estrogeneve ose i inhibitorëve hipofizare dhe në përgjithësi është i efektshëm në alopecisë seborrhoike por nuk lejohet gjithmonë. Tek mashkulli përkundrazi, dhënia e hormoneve estrogene nuk lejohet pse shifikton humbjen e karaktereve sekondare mashkulllore dhe të libido-s. Duke qënë pra kështu, për t'i hequr lëkurës së kokës veprimin e tepruar të androgeneve dhe të lyrës jo të metabolizuar, autorë ka menduar të paksojë gjakimin e saj (të lëkurës së kokës) për të patur më pak lyrë dhe kështu të ndalojet ramja e flokëve.

Duke u nisur edhe nga konstatimet kirurgjikale mbi mosvërejtjen e alopecisë në raste ndërprerje të qarkullimit të lëkurës së kokës mbas traumatizmash ose në raste teknike neurokhirurgjikale, mbas hemostaze të lëkurës së kokës ose mbas arteritis temporalis, në të cilën sindromi qarkullimit në arterien e lëkurës të kokës është paksuar shumë bile ndonjëherë zhduk fare, autorë, me anë të legaturove së enëve temporale superficiale mbi arkatën zigomatike, ndënë anestezi lokale, ka operuar 15 meshkuj me moshë prej 18-31 vjeç që kishin, para së gjithash flokë të lyrtë, skuama e dha ramje flokësh të bollshëm dhe tek të cilët injekimet e zakonëshme kishin dështuar.

Simbas autorit mbas 48 orësh, shumë mbas një javë, flokët e këtyre pacienteve të operuar humbasin lyrën e tyre dhe bëhen të thatë, hedhat zhduken mbas 2-6 javësh ndërsa ramja e flokëve pakësohen me më ngadalë: ato paciente që humbën çdo ditë 100-150 fije flokësh, mbas 10-12 javësh, nuk i humbisnin më.

## GJENDJA AKTUALE DHE PRESPEKTIWA E APLIKIMIT TERAPETIK TË GRIZEOFULVINES.

**S. D. Bandazzi, A. Giardina.**  
Min. Derm. Vol. 39, Nr. 3. 1964 fq. 81-85.

Autorët përshkruajnë përvëç rezultateve dhe efekteve anësore që kanë konstatauar me përdorimin e grizeofulvinës në luftimin e dermatomikozave, edhe mundësinë e shtrirjes të këtij përdorim në fusha ekstra-fungine.

### a) Patologji fungine.

Rezultate të mira janë vërejtë me përdorimin e grizovinës qoftë me doza ditorë një gr. për një muaj mesatarisht qoftë me doza të mëdha (5-30 gr. ditën për 1-15 ditë ose po me këtë dozë në dy periudha të ndryshme 15 ditorëshe) në favus. mikrospori e trihafitit të kokës, lëkurës pa qime (cutis glabra), të adneksave (qime e thoj) dhe në trihofilitet. Përfundimisht të mira janë vërejtë edhe në rastë sporotricosis (nëga Sporotrichum Schenckii dhe Nocardia brasiliensis) në një kohë prej 1-2 muajsh. Me qëllim që të shpejtoshesh shërimi, bashkë me grizovinën, është këshilluar prerja e lloköve, e llojnjeve dhe aplikimi i pomaçave keratolitike dhe antimikotike.

E përdorur lokalisht në vaj arachidis me 2.25%, grizovina nuk ka dhënë përfundimisht të mira përmundësi shtrirje të saj në keratine, përmundësi që ana e enximeve të lëkurës.

Rezultate negative janë vërejtë në erithrazma, pityriasis versikolor, në kandidosat dhe në mykosat e thella jo dermatofitike.

### b) Patologjia ekstrafungine.

Autorë si Kaminsky kanë patur efekt të mirë në raste të psoriasisit ungaal, Aleksander në pustolosa me prejardhje prej kafshës, në herpes zoster: doza të larta (5 gr. ditën për një javë) dhanë ramjë të etheve përmësuar, paksim në fillim dha zhdukje më vonë të dhimbjeve dhe të kuadrit klinik qysmë në ditët e para.

Cohen e bashkëpunorë kanë konstatuar efekt antiinflamatore në sindromin shpatull dore, në reumatizmin neurotrop të anësive të epërm, por asnjë efekt në rastet e poliartritit kronik. Në doza të forta (mbi 3 gr. ditën) grizovina ka dhënë rezultate të mahnitëshme në goutte.

Sere dhe Simon mbas një studimi mbi 94 pacientë, e kanë çmuar të vlefshëm veprimin antireumatik të grizevinës në këto forma: sindrom shpatull dore, periartrit scapolo-omerale, reumatizëm rizomelik të pleqve, në algodistrofisë reflekse postraumatike dhe në goutte.

### c) Efekte anësore.

Dhënia e grizovinës për os ka shkaktuar të përzier, (nausea), vjellje, diarre, dhimbje abdominale, ekzantemë morbilllo dhe skarlatiniformë të përhapura, qfaqje eretimatoze pamfoide, makuloze dhe petekiale të përhapura, urtikarie në persona jo alergjike përparrë, dermatitis ekzamtiforme, likenoide, eriteme eksudative, furunkulose. Por përvëç këtyre, janë vërejtë edhe trazime neurotoksike si céfale, vertigo, nervozizëm, depresion mental, pagjumi, lodihi, trazime hemopoietike si leukopeni, linfopeni, eritropeni dhe shtim të eritrosedimentacionit.

## PREVENIMI I KANCERIT.

Chron. O.M.S. vol. 18, Nr. 9 Shtator 1964.

Komiteti i ekspertëve të O.M.S.-it për prevenimin e kancerit ka lëshuar, në Nëntor 1963, një report mbi prevenimin e kancerit, prej të cilit po marrim pikat kryesore.

Prevenimi i kancerit quhet veprimtarija që ka për qëllim eliminimin ose neutralizimin e faktorëve të njohur ose të dyshuar të karcinogenësës dhe trajtimin e gjendjeve prekancerore. Përsa i përket këtyre gjendjeve, duhen dalluar rastet e kancerit të vërtotuar nga ato të dyshimitë se përsëri në mes disa lezonesh dhe kancerëve që zhvillohen më vonë është shpesh i diskutueshëm. Në këtë drejtim, një vlerësim sistematik dhe një klasifikim anatomo-patologjik i lezonave prekancerose tek maskulli, do të ishin shumë të vlefshëm. Duket e sigurtë se kancerë i collus uteri mund të njihet në fazën pre-invazive ose intraepiteliale. Gjithashu mund të diagnostikohen si gjendje prekancerore disa lezione osteo-muskulare ndërsa ato që pojnë në limfome maligne ose nö leucemi, nuk diagnostikohen kollaj.

Është e domosdoshme që menjëherë mbas diagnostikimit të gjendjeve prekancerore, të fillohet mjekimi dhe prandaj mjekët duhet të jenë informuar mirë mbi të dhënat e fundit në këtë drejtim.

Në bazë studimesh dhe eksperimentesh të ndryshëm, supozohet se shumë alteracione jo kancerogene në vëlvete, kanë një ndikim të fortë mbi procesin e kancerizmit.

Përsa i përket faktorëve të kancerogenësës më me rëndësi tek njeriu ata janë, në radhë të parë drita e fortë e diellit dhe kjo sepse janë vërejtë shpesh epitelioma të lëkurës sidomos në fytyrë dhe në qafë tek popujt e regjioneve që kanë shumë diell dhe sidomos në persona që kanë pak pigmentë në lëkurë.

Prej studimesh të kryera në Afrikën e Jugut, në Australi dhe në Zelandën e Re del se zhvillimi i melanomëve të lëkurës mund të rrjedhë prej një ekspozimi të

tepruar në drithën e diellit dhe se prandaj evitimi i kësaj i prevenon ato. Edhe krema antisolare është e vlefshme.

Roli kancerogen i irritimit mekanik akut ose kronik nuk është provuar por është treguar se cikatrizimi i një plaje ndonjëherë, mund të lozë rolin e një shtyesi në kancerogenenët dhe duket se po këshiu vepron edhe irritimi mekanik. Djegëjet nuk përfundojnë në kancer veçse në shumë pak raste por acarimet mekanike o termike mund të veprojnë së bashku si faktorë kancerogenët prandaj duhet imrojtuar që nga çdo acarim mekanik sidomos kur ojo ka qenë ekspozuar ndaj një aksioni kancerogen.

Në rajonin e është përhapur zakoni i të përtypërit një far piperi vetëm ose të përzier me gëlqerë e duhan, është vrejt zhvillimi i kancerit të orofaringsit, prandaj duhet evitar përtypja e këtyre landeve (s.d.m. e duhanit) dhe duhen marrë masa asepsie të gojës. Dyshimi se pija e alkollit në mënyrë të tepruar favorizon kanceret e gojës, të laringit dhe të ezofagut, nuk është konfirmuar në mënyrë të qartë, por kur shqërohet me karençë ushqimore mund të loz një rol shpërthyesh të tyre prandaj luftimi i alkollizmit kontribuojnë pakësimin e këtyre formave të kancerit.

Përsa i përket duhanit pranohet që ky shkakton kanceret e mushkërijve me gjithëse nuk njihet mekanizmi i një veprimi damtues të tillë. Autorët porosisin në këtë drejtim të mos teprohen në pirjen e duhanit dhe njëkohësisht të bëhen përpjekje përi ti bëre më pak të dëmshme cigareta.

Mbiushqyerja mund të favorizojë shfaqjen e disa kancerëve si atë të geses së taminit ndërsa ndënuhshqyerja favorizon llojë tjetër kanceresh, sidomos të heparit.

Ushqimet kur hassen shumë të nxeha, duket sikur favorizojnë shfaqjen e kancerit të esofagut. Cilësi kancerogene duke se kanë prodhimet industriale që i shthon ushqimeve të preqatitura artificialisht.

Cirkoncionisi prevenon kancerin e penis-it dhe të collus uteri tek partneri femër, ndërsa ekzistencë e një raporti në mes të martesës së moshës së re dhe kancerit të collus uteri, nuk është përcaktuar.

Prodhime industriale përi higjenë e zbulurim shpesh herë janë treguar kancerogene prandaj përdorimi i tyre duhet të jetë i kujdeseshëm dhe nuk duhen lenë në vende nga ku mund ti marrin fëmijët që janë në mënyrë të vëçantë, sensibël ndaj kancerogenëve.

Raporti jep pastaj një listë të kancerogenëve të dyshuar ose të njohur të tillë si p.sh. përi lëkurë e mushkëri janë të dërmshëm: 1) prodhimet e distillimit të qymrit duke përfshi edhe ziftin, kresozotin, vajrë antracenin, vajra zifti, prodhimet e vajgurit dhe të vajrave minerale të hidrogenuara; përi qesen e ujët, benzidina e prodhime analoge; përi lëkurë, kocka, mushkëri, sistem hemato-limfopoietik, rezatimet ionizuese nga rrezet X dhe elementë radioaktiv etj.

Prishja e arrit nga tymra prej burimesh industriale automjetesh është gjithashtu faktor kancerogen.

Edhe disa medikamente si ormonet estrogene, substanca të grupit të thio-urea-s që përdoren përi kurimin e sëmundjeve të gjendrës tiroide kanë efekt kancerogen prandaj duhen përdorur me shumë kujdes.

Gjithashtu me shumë kujdes duhen përdorur rezatimet therapeutike që në doza të larta janë të dërmshme.

Mbas përskrimit të jëndëve kancerogene, autorët nën vizojnë randësinë e masave që duhen marrë përi tu imprejtë nga përhapja e kancerit. Në radhë të parë ka rëndësi që masat vunorëse të njohin substancat e rrezikshme në këtë drejtim, të keni vizita mjekësore të herëpashterëshme dhe mjete mbrojtëse si tesa etj.

Por përvëç këtyre masave, kanë rëndësi të madhe në njohjen dhe prandaj në luftinë e kancerit, studimet epidemiologjike dhe sidomos depistimi sistematik që përblohdh ekzaminimet profilaktike periodike përi personat mbi 30 vjeç. Me këtë mënyrë zbulohen jo vetëm shumë gjendje kancerore dhe prekancerore por edhe shumë sëmundje të tjera që kërkojnë trajtim të vëçantë. Këta ekzaminime që është mirë të përsëriten sa më shpesh (simbas mundësive të çdo vendi), duhet të drejtohen në kontrollin e imtë të lëkurës dhe të të gjithë birave natyrale të kësaj, të thoraksit dhe në kryerjen e analizimit të urinës të rektoskopisë: në meshkujt të bëhet ekzaminimi i prostatës në femrat ekzaminime mikroskopike të materialit marrë nga cerviksi. Në rast dyshimi të kancerit, do të kryhet ekzaminimi citologjik i pështymës, radiografia gastro-intestinalë, numurimi i elementëve të gjakut, kolposkopia dhe në qoftë se është e mundur, mammografja.

Ka rëndësi të vëçantë përi zbulimin e kancerit të uterus-it, ekzaminimi citologjik i collus-it gjë që mund të kryhet si në konsultimet gjinekologjike obstruktivale pre ose post natale ashtu edhe në dispensorira të vëçanta duke përfshi të gjitha femrat mbi 20 vjeç në një periudhë të paktën 5 vjeçare në qoftë se nuk është e mundur

krye qdo vjeti. Është venç rë në Kanada një paksim 45% i frekuencës së kancerit në një popullsi në të cilën gjysma e femrave është vizitue rregullisht gjatë 8 vjetëve.

## MBI XANTHOMATOSIS NGA IPERKOLESTEROLEMIA ESENCALE

M. Pisani, C. Biondi, M. de Luca  
Min. Derm.

Autorët mbassi kujtojnë vështirësitë e një klasifikimi të lipidosëve të pranues prej të gjithë studiozëve për shkak se ky kapitull përmblehdh formën morboze të ndryshme nga ana klinike, morfologjike, biokimike, istomorfologjike, istokimike dhe se prandaj të ndryshëm janë edhe kriterët që ndiqen për qdo klasifikim të propozuar, përmendin se si dermatologët ndjekin një kriter të bazuar mbi të dhëna istokimike dhe prandaj i dallojnë lipidozat në ekstra dhe intracellulare sinjebas sësiz së lipidëve.

Xanthomatozat nga iperkolesterolmia dhe xanthomatosis nga iperlipemja qoftë esenciale ose sekundare, me patologji që zhvillohen në pjesën më të madhe në lëkurë, janë intracellulare.

Në grupin e xanthomatosave iperlipidemike esenciale hyjnë edhe kuadra hereditare si xanthoma nga iperkolesterolmia esenciale (xanthomatosis iperkolesterolmica familiare — Thannhauser), që nuk paraqet gjithnjë iezione xanthomatose dhe prandaj disa autorë e quajnë «iperkolesterinemia esenciale familiare» për të treguar se trazimi primitiv është në metabolizimin e kolesteroli.

Sintomatologjia përbëhet prej manifestimesh me karakter xanthomatoz, tuberoz ose të përfushët, trazimesh kardiovaskulare, nga leziona ateromatoze në enë e gjakut dhe në endokardium.

Xanthomatosis nga iperlipemja esenciale ka përkundrazi karakter populoz që shqërohet me një gjendje diabetike të lehtë, epatosplenomegali dhe dhimbje abdominale. Në mes këtyre dy formave, ka edhe të tjera «të përziera» (Borrie) në të cilat shifër shfaqje klinike qoftë nga iperkolesterolmia qoftë nga iperlipemja.

Mbas kësaj hyrje në kapitullin e lipidosave autorët përshkruajnë një rast xanthomatosis nga iperkolesterolmia esenciale interesant qoftë për zhvillimin e manifestimeve në lëkurë qoftë pse bashkë me këta paragjiste edhe lezione tendine, kardiovaskulare dhe ndryshime të metabolizmit lipidik. Përvec kësaj u konstatua edhe një shtimtë kolesterolmisë në disa pjesëtarë të familjes dhe prandaj e quajtën këtë xanthoma nga iperkolesterolmia esenciale të tipit familiar.

## SËMUNDJE VIRALE TË LEKURËS: FREKUENCA DHE TRAJTIMI I TYRE ME NJË AGENT ANTIVIRAL

M. El Zawahry  
Min. Derm. Nr. 1964

Duke u nisur nga konstatimi se sëmundjet virale të lëkurës paraqiten në 3-4.1%, në ambulancat dermatologjike dhe se shumicë prej tyre prekin moshën e ré, autori mbasi përshtaku përpjekjet e studimtarëve për të gjetur një imjet specifik për ti luftuar, ndalet mbi përfundimet që ai ka patur me përdorimin e xenalamina-s në kurimin e këtyre sëmundjeve.

Ky medikament i ri antiviral, i përdorur per os me dozë 4-8 kompreza ditën dhe për një periudhë 2-3 ditëshe e deri më një muaj, ka dhënë përfwridimë të mira në verruche (vulgaris et planac) dhe deri diku të kënaqëshme në stomatitet aftosë rikorrens dhe në erythema polimorfa.

## -PAMJE RADILOGJIKE E LOKALIZIMEVE SKELETIKE NË LUËS CONGENITA PRAECOX-

G. C. Maggi — E. Grassi  
Min. Ped. 163 Nr. 37.

Duke qenë se R.W. në gjakun e fëmijës me lues c.p. del shpesh negativ, të dhënat anamnestike të prindërve nuk janë gjithnjë të besueshmë dhe se ekzaminimet serologjike të muajve të fundit të shtatzanisë dhe në lehon rezultojnë në një përgjindje të lartë të dyshimta, përfundimisht që sifilizit c.p., duhet dhënë rëndësi ekzami-

nënit radiologjik të kockave. Aq më tepër del vlera e këtij ekzaminimi kur mendohet se kuadri rontgenografik i kockave, përbën shpesh, të vetmen të dhënë për të vendosur diagozin lues c.p. Por ka autorë si Mc Lean (1931) dhe Coffery (1939) që menjnjë se vetëm të dhënët radiologjike nuk janë të mjaftueshme për të vendosur diagozin L.c.p. dhe prandaj, simbas këtyre, ekzaminimet radiologjike të kockave nuk dëshin përdorur si bazë për të vendosur terapinë antitumore.

Lues c.p. që transmetohet prej nënës në fetus nga muaji V i shtatzanisë si infeksion ematogen matern-fetal, paraqitet me lezione kockore në 80% të rasteve (Lefort 1930). Shpesh këtë lezione paraqiten në mes të të dytët dhe të tretit muaj të jetës kurse mbas të gjashtit muaj ato janë të rralla.

Lezonet paraqiten zakonisht në kockat e gjata të anësive, shumë rrallë në kockat e sheshët dhe në vertebra, me osteocondritis, periostitis dhe osteomielitis.

Autorët paraqesin disa raste pacientësh të vegjel që kishin qysmë në lindje lezione të cilat i diskutojnë gjerësisht duke i barazuar të dhënët e tyre me ato të literaturës.

Osteochondritis apo osteochondrosis siç e quajnë disa për të theksuar se kocka nuk ka pësuar ndonjë malcim (inflamacion) nga spiroketa por një shndrrim me karakter distrofik, shkaktohet nga një absorbim i pamjallueshëm i zonës së kockifikimit të përkohëshëm dhe formim anomel të spongiosis primitiva nga një aktivitet i pakusuar i osteoblasteve. Për shkak të këtyre çregullimeve, në radiogram, nuk duhet si zakonisht, zona e përkohëshme e kockifikimit por një rryp opak, më i dëndur, i gjërë, me kartilago epifisare si me «dhëmbë të sharrës». Përvog kësai, për shkak të formimit të një hinda granulimi nga procesi pathologjik, në mes të epifizit dhe të diafizit të kockave të gjata, formohet një zonë hinda spongios që duket si një rryp radiopermeabël.

Periostitis që vërehet edhe në të porsalindurët, por më shpesh në fëmijët e moshës 2-3 vjeçare, mund të jetë diafizare primitive ose sekundare mbas gumash ose me destruksion të metafizit kurse osteomielitis përmbledh lezonet që shfaqen në diafizis sidomos në zonat diafiso-metafizare.

Dactilitis që duhet dalluar nga spina ventosa me origjinë specifike, është një tjeter shfaqje karakteristike e lues congenita.

## SHKAQE TË VDEKJEVE: NEOPLASMAT MALIGN

Rap. epid. démog. vol. 17, Nr. 5 1964. O. M. S.

O.M.S. ka marrë informata prej autoriteteve shëndetësore të 33 vendeve të ndryshme të botës mbi llojet e tumorëve që gjatë vitit 1961 kanë shkaktuar vdekje mbas konstatimit të mëparshëm se n'Amerikën e Veriut, n'Europë dhe n'Australi, neoplasmat maligne në 1961 zenë vendin e dytë të shkaqeve të vdekjeve (Rap. epid. démog. 1964, 17, Nr. 1-2). Prej këtyre informatave del se ndër meshkujt vendin e parë në mes të tumorëve që shkaktojnë vdekje më të shumta e zenë ato maligne të stomakut, pastaj ato të bronkeve, të trahesë, të pulmoneve jo të specifikueme si sekundare dhe vendin e tretë e zenë tumorët maligne të prostata-s, ndërsa ndërt fémrat vendin e parë e zenë tumorët maligne të gjirit.

Përsë i përket grup moshave të ndryshme, tumorët maligni i stomakut është vrejtë (si shkak vdekje) me të njëjtat përpjesëtime në mes të meshkujve dhe femrave të grup moshës 0-34 vjeç (0.35 dhe 0.3 përkatësisht për 100.000 banorë), me ndryshime disi më të theksuara në mes të dy sekuve të grup moshës 35-44 vjeç (7 dhe 4 përkatësisht për 100.000 banorë), dy herë më tepër tek meshkujt se sa tek femrat në grup moshë 45-54 vjeç (27 dhe 13 përkatësisht gjithënjë për 100.000 banorë) më tepër se dy herë tek meshkujt se sa tek femrat në grup moshat 55-64 vjeç (84 dhe 40 përkatësisht) gadi dy herë më i lartë tek meshkujt se sa tek femrat në grup moshë 65-74 vjeç (188 kundrejt 107 përkatësisht).

Të dhëna të tjera interesante përsa i përket lokalizimit dhe shpeshtësisë së tumorëve maligne që kanë shkaktuar vdekje gjatë vitit 1961 jepen në shumë tabelat ekoqilëse.

Sh. Basha

## MBI VLERËN PRAKTIKE TË DISA METODAVE TË EKZAMINIMIT NË DIAGNOSTIKËN MYKOTIKE

Dr. I. Shanlow, Dermatologische Wochenschrift viti 1964 volumi 149, Nr. 4, fq. 81-90

Autori përshkruan disa metoda laboratorike për diagnostikimin e myknavë të ndryshme, të cilat kanë një vlerë praktike. Ai mer në studim: 1. ngjyrosjen e preparave native me bojë Parker. 2. Ekzaminimet mikroskopike të kulturave mycetike në tub-xhami. 3. Luminoskopinë. 4. terrenet për të dallue trichophyton rubrum nga trichophyton metagrophytes. 5. vërtetimi i clamydosporeve tek candida albicans dhe 6. reaksionet fermentative të candida albicans për ngjyrosjen e preparateve, velomandohet boja Parker (Parkerink blue black super crom 51). Përzihet nji pjesë e bojës me 9 pjesë të KOH 5% si material shërbejnë më tepër skuatin dhe thonjtë e infektues. Materialit për ekzamenim, i hidhet 1-2 pika të përzjerjes të bojës «Parker» dhe shifet mbas disa orëvë ose të nesërinen. Ma tepër rekandomohet tek pityriasis versicolor dhe mykozel e kambëve. Për sa i përket egzamenimit mikroskopik të kulturave në tub të xhamit, autor i rekondon për diferençimin e shpejtë të dermoliteve të ndryshme, pa qenë nevoja me preqitit preparate nga kultura e zhvillueme mykotike.

Tue fol për përhapjen e jashtëzakonshëm të epidermofytisë në këto 30 vjetet e fundit, ihot se epidermophyton floccosum nuk është i vetmi shkaktar i kësaj sëmundjeje, ajo përhapet nga trichophyton rubrum dhe trichophyton mentagrophytes, të cilat me vështirësi mund të diferençohen. Kjo bëhet vetëm me anën e pigmentit që lormohet nga trichophyton rubrum. Për këtë qëllim ai përdor terrenet me agar dhe mijell misri dhe ujët peptonik simbas metodës së gürzit. Metodën me anën e ujti peptonik, D. Shaulow e quan të pa vlefshëm përfundimisht e dy trihofytoneve të nait përmenduna. Ky rekandon më tepër terene agari me 2% detroze dhe 4% mijell misri. Në tubë, zhvillohet nji pigment i kuq, kur komi të bëjmë me trichophyton rubrum. Për diagnostikimin e 7-8 llojeve të candida albicans që janë patogen përnjeriu, autor i përdor terrene agari me mijell misri dhe me mijell orizi. Chlamydosporet vihen re në terenet relativisht shpejt mbas 1-2 ditëve, por ka pasë rezultate më të mira në terenet e orizit. Në shumë raste të Candida albicans ndihmon përfundimin e tyne edhe aftësia me fermentue glykoze dhe maltoze deri në formimin e gazit. Autori tue u bazue në të dhanat e literaturës dhe në eksperientën e tij, thotë se edhe saharozet e kanë këtë cilësi.

## ZBULIMI DHE PËRHAPJA NË TOKË TË DERMATOFYTEVE NË BERLIN

Prej H. Böhme Dermatologische Wochenschrift 1964 volumi 149 Nr. 8 fq. 185-200

Në këtë artikull jetet koha e zhvillimit të dermatofyteve të ndryshme, vendet e maruna të provave dhe zbulimet e parazitëve për qdo vend në përqindje. Shpeshërisht e qdo lloji dermatofyti ndryshon simbas preardhjes së provave të tokës. Microsporum gypseum dhe microsporum cookej gjinden më shpesh në toka të parsunë, kurse trichophyton tereste në ato më të varfëra me lindë organike, dhe caramyces ajelloi nuk varet nga përbërja e tokës. Të dhënat e autorit krahasohen me ato të qyteteve të tjera Gjermane dhe diskutohen problemet e përhapjes së këtyre kërpudhave.

## MBI MJEKIMIN E VITILIGOS

Prej K. Balabanov dhe Iv. Dogramadiev Dermatologische Wochenschrift volum 149 Nr. 8 fq. 200-203

Autorët Bullgarë të klinikës së Dermato-venerologjisë së Sofjes, jepin rezultatet e tyne të mjekimit me amminimajus Line (Meladinine) dhe me Cu-Lyt që ka substancë kuprum. Për të dy medikamentet përdoren rezet e djellit dhe rezet artificiale ultra violet. Këta kanë konstatuar përmirësimë, por në përgjithësi nuk kanë mbeti të kënaqun. Më tepër shpresë simbas tyne napin banjat e djellit për 45-60 -75 ditë në plazh, ku të sëmurët gradualisht mund ta zgjasin radiacionin deri në 3 orë dhe të lahen edhe 4 herë në ditë. Ata kanë mjekue në këtë mënyrë në një periudhë prej 12 vjetësh, 10 fëmije, 9 gra dhe 6 burra. Nga këta 14 u shëruan mirë (të thuesh), 5 në të gjithë trupin, por patën në vitin tjetër recidiva që u repigmentuan shumë më

shpejt, 3 të sëmurrë që vazhdulen mjekimin për 3 vjet resht u shëruen definitivisht kurse një fëmijë për 2 vjet banja u shërua dhe recidivoj më vonë mbas 9 muajve. Autorët rekomoandojnë mjekimin me reze të djellit, si mjekimin më të mirë. Rezultatet e Cu-Lyt-it vijnë ma tepër nga banjat e djellit në plazhe, mbasi ky mjekim i kombinuam me UV, nuk nep as një rezultat. Edhe mjekimet me substancë fotosensibiluese (melanin) nuk e këshillojnë për komplikacionet dhe rezultatet e pakëta të tynë. Mjekimi i vitiligos i rekomanuem prej shokëve Bulgarë, nuk është gjë tjeter veç se një kthim në metodat klasicke të mjekimit të kësaj sëmundjeje.

#### **INFESIONI EKSPEKMENTAL I NJERIUT ME TRICHOPHYTON QUINSKEARUM DHE MJEKIMI ME GRIZEOFULVINE.**

Prej Jadwiga Schwann Dermatologische Wochenschrift, 1964, volumi 149, Nr. 12, fq. 302-308

Siq dihet trichophyton quinskearum ka prejardhje shtazore dhe prek lëkurën e lëmuat melanugo, rallë koltën ose bëhet shkak për tu qëqë sikeron Celsi. Shumë rrallë mer forma të infeksionit të përgjithshëm. Strehues i parazitit asht miu, por dhe qentë, macat, dhelprat, zogjtë etj. Infeksione artificiale ndër njëzit njihen me kohë. Mjekimi me pomadë antimykotike asht i lehtë. Autori i ven barrë vehtes me nxjer të dhana mjekimi me grizeofulvinë tek një rast i infektueve artifisialisht. Ky konstaton se gjatë mjekimit me grizeofulvinë, u çfaq një reaksion lokal alergjik dhe se intoleranca e grizeofulvinës (të vjellat, diare e dhimbje koke mungesë apetiti etj.) ishte intensive dhe e gjatë me gjithë sasinë e paktë të medikamentit të përdorur. Autori mendon se kjo lidhje me intolerancën individuale të sëmurrëve përkundrejtë edhe medikamenteve të tjera (sulfamida, auromicinë, chloromycetinë etj.).

#### **MUNDËSITË TERAPEUTIKE TË GRİSEOFULVINËS NË FUSHËN ANTI TUMORALE DHE ANTIVIRALE**

Prej S. D. Raudazzo me A. Giardina. Dermatologische Wochenschrift 1964, volumi 150 Nr. 27 fq. 3-6.

Autorët italjan, vejnë në dukje rezultatet e arrituna në mjekimin e reumatizmit dhe të Angina pectoris me anën e këtij medikamenti. Kjo i shtyri ata me provue në se ka edhe mundësi të tjera për të provue kët medikament edhe në sëmundje të tjera. Përdorimi i griseofulvinës në format e ndryshme të reumatizmit, spjegohet me efektin antiflogistik direkt në vatrën e inflamueme dhe në veprimin nervor të sympathetic. Po kështu mendohet edhe për anginën pektoral. Asht vërtetë se griseofulvina ka një veprim antimitotik dhe e shton potencën tokiske të Colchizinës. Ditet se vepreme antimitotike kanë edhe antibiotikët. Autorët, tue dhan disa njohuri të literaturës të përdorimit të antibiotikëve si mjete antivirale dhe vetit e griseofulvinës vejnë hypotezën se griseofulvina në një fardhëm duhet të veprojë edhe si antibiotik antiviral dhe antitumorali. Nga praktika e tynë, ata paraqesin një rast me Herpes Zoster të randë me temperaturë, dhimbje dhe lesione vesikulobulloze, që e kanë mjekue me doza të nalta të griseofulvinës, tue pas rezultate të kënaqësime (5 gr. griseofulvinë për 7 ditë rjesht).

#### **SYNDROMI CIANOTTI — CROSTI**

Prej H. Reich  
Der Hautarzt, volumi 14 Nr. 7 fq. 315-318.

Në vitin 1953 dermatologu i Milans F. Gianotti konstatoi një pasqyrë klinike të përcaktueme që e paraqiti si sëmundje sui generis në vitin 1955. Ma von u përshtkrue edhe në qytetet e tjera të Italisë dhe të vendeve të tjera (London, Paris, Lausanne, Bretagne dhe në Jugosllavi). Në vitin 1960 u përshtkrue nga Gianotti-Crosti në Gjermani edhe raste të tjera (Acrodermatitis papulosa infantilis ose eruptive papulose infantile acrodermatose) me rastin e një mbledhje të shoqatës së dermatologjëve gjermane në Hamburg. Autori përshtkruan 3 raste klinikisht dhe histologjisht për të parën herë në Gjermani dhe vjen në konkluzion se duhet theksue veçanërisht purpura hemoragjike e Gianotti-Crosti. Sëmundja prek zakonisht ekstre-

mititetet në formë simetrike në pjesët ekstensore, tue përfshi edhe shuplakat, shqojt mishrat e trasha, qafën dhe fytyrën në moshën fëminore prej 9 muejsë deri 9 vjet. Shenjat klinike fillojnë distal dhe hypin shpejt në pjesët e sipërme. Së fundit preket fytyra. Ajo paraqitet me papula edematose lithenoide, që më von fillojnë të deskuamohen ose kanë një pamje hemoragjike. Elksantema çduket brenda 4-6 javëve. Smadhimi i gjendrave në aksillat, qafë dhe inguinal konstatohet gjithmonë (P.S. U dha ky pëershkrim i shkurtër klinik simbas autorit, mbasi është një sëmundje e re që është konstatuar në poliklinikën e Tiranës dhe të Durësit nga dermatologët tanë për të parën herë).

### MJEKIMI ME VIT.D2 DHE REZIQET E MUNDËSHME

Prej H. Dürr, Dr. Hautarzt, 1963, volumi 14, Nr. 5, fq. 227-230

Autori pëershruan një rast me acne vulgaris, që u mjeckuc për 6 muaj me vit. D2 (600 tabl. nga 1 mg) me doza të nalta. Të sëmurit ju qiaq një lloj ekzeme dhe një keqçim i acnes në formë të një dermatose acne-thermatose me hypercalcemie dhe insufisience të funksionit të veshkave. Këtu pëershruen mjekimet me sukses të vit. D — terapije në patologji, pediatri dhe në dermatologi. Më tepër është përdorun terapije me vit.D2 në tuberkolozin e lëkurës, por dhe në ekzeman atakuje me shpërthencë, psoriasis etj. Gjatë këtij mjekim me doza të nalta janë vu re degozitime të calciumit në veshka, skicit etj. Në ekzeman janë dhënë 30-60 mg Vit.D2 në fillim, mandej për 6-7 ditë 15 mg.i.v. Të tjerë kanë përdor për tre ditë reshë nga 600.000 U. intermuskular për të pengue eksudatin. Kjo dozë konsiderohet e naltë pse janë observuar disa herë hypercalcemie, çregullime të veshkave dhe të metabolizmit gëllëror.

### PËRMBLEDHJE TË SIKURTËRA MBË DERMATOMYKOZËT MARRE NGA ZENTRAL — BLATT FUR HAUT — Ü GESCHLECHTSKRANKHEITEN

Volumi 114, Nr. 12, 4, 5 viti 1963

*Christina Schönborn* duke folur mbi trichophyton verucosum që prek njerëzit dhe shizatët, thotë se ky lloj paraziti është shkakëtar i qeres së viçave. Njerëzit infektohen ma tepër prej shtazëve dhe kërkon si shumë autorë të tjerë që të meren masa urgjente përmes mjezikës shtazëve megjithë se këta nuk dëmtohen dhe aq shumë. Së fundi përmend se shtazët ka mundësi të janë infektue nga toka ose nga materiet bimore si kashta dhe mjetet e tjera të ushqimit të shtazëve. (Heft-1).

*Paul Recepto* flet mbi përhapjen e dermatomykozave në regionin anogenital, të cilat si i pëershruan shkurtimi i (epidermophytonet moniliasis Erythrasma) thotë se më parë duhet ekskludue ndonji diabetes mellitus ose ndonji vatër infeksioni në këtë zonë dñe mandej të mjekekohet me 1-2%, të një solucioni gentianaviolet, 3% jodochlorhydroxyin ose amphotericin B-Locic (fungizone-Lotic). Ky rojekim ka dhënë vazhdimisht rezultate të kënaqëshme. Në rast se konstatohet një rezistencë e terapisë atëherë mund të përdoret peroral grizeofulvinë ose Nystatin simbas vërtetimit me anën e tereneve kulturale të parazitit. (Heft 1).

*P. Pinetti* dhe *A. Lostia* përshtruajnë mekanizmin e veprimit të grizeofulvinës në terapiën e dermatofytiozeve në lindhje me marjen e medikamentit në mënyrë të shkëputur. Autorët kanë marë në shqyrtime një grup të sëmuirësh që kanë patun 28 Tinea trichophytica, 6 Tinea favosa, 4 Tinea microsporica, 1 Sycosis trichophytica dñe një rast me trichophyti superficiale. Gjithsejt 45 të sëmuirë. Ndërsa këta u përdoren 4 skema mjejkimi të ndryshëm me grizeofulvinë. Përi grupin e parë u përdoren 29 mg/kg 2-3 herë në ditë. Në grupin e dytë u përdor po kjo dozë po duke e marun 3 herë në javë. Në grupin e tretë të sëmuirët morën 25-30 mg/kg. 2-3 herë në ditë — dy herë në javë dhe në grupin e fundit u përdor 30-35 mg/kg një herë në javë.

Rozultatet e shërimit u ngadalësuan në grupin e parë dhe në grupin e katërt por të gjithë grupet u shëruen deri në 97% në katërt grupet.

*Xavier Vilanova* dhe *J. Puig* bënë prova klinike duke përdorun një grizeofulvinë të re që ka vetëm 125 mg, me granula të imta në mjezikimin e llojeve të ndryshme të dermatomykozave dhe përfundojnë tue thanë se me këto tablete të reja mund të harihet shërimi si me tabletet prej 250 mg. grizeofulvinë por shtojnë se rezultatet më të mira ishin atëherë kur u përdoren dozat e plota të tableteve të vjetra. Autorë të tjerë kanë pas rezultate më të mira por kanë përdor preparat grizeofulvinë me granula shumë të imta.

*N. Hejtmánkova* Uhrova dhe *A. Hanelova* mbas mbi destruktivitët e dermatoftitëve në tokë. Si mbas të dhënave të shumë autorëve dihet se dermatofytet në tokë shkatërohen nga veprimi antagonist i mikroorganizmave. Autorët provuan veprimin e krimbit Diploccapter Coronata mbi trichophyton rubrum, trichophyton tereste dhe microsporum gypseum. Në provat e bamuna në terrenet e ushqimit me agar si dhe në terrenet sterile të tokës me flokë njeriu, treguan se krimbit i hajnë mycetë parazitarë dhe ushqehen prej tyre. Shporet mbeten dhe ishin në gjendje me u rinë agarin me glikozë.

*Jon D. Foley:* Autori thotë se një solucion procaine 2% ka veti antibakteriale, antifungale, por edhe i mbyst mykozat.

*A.R. Memmesheimer, E.G. M. Nall* dhe *T.H. Sternberg:* Autorët duke bamin 7 prova të ndryshme vinë në përfundim se serumi i gjakut të njeriut ka një veprimtari antifungostatike.

*A. Avram:* autori përshtakuat katër familje me infeksione mycetare nga trichophyton rubrum, që u kostatuan ndër kambe në 2-6 pjestarë të familjes së prekun. Kto pjestarë u infektuan nga i sëmuri brenda 6 muajve deri t'iti. Përhapja e infeksionit u ndërmjetësue siç duket nga përdorimi i përbashkët i papuceve, banjës, peshqirëve, çarçafëve dhe gërs'hëreve (Heft 2).

*I. Schatzow:* autori jep të dhanat e klinikës së dermatologisë së Plovdivit në Bullgari prej vitit 1954 deri 1961. Në këtë periudhë janë izolu dhe identifiku 310 lise parazitësh. 55.8% kishin trichophyton mentagrophytes, 39.7% trichophyton rubrum, 4.5% epidermophyton floccosum. Në mykozën e kambëve u gjetën ma tepër trichophyton metagrophytes kurse në mykozën e duarve trichophyton rubrum ishte 4 herë ma i shpeshtë se trichophyton metagrophytes. Në mykozën e thonjve u gjet trichophyton rubrum ma tepër si edhe në epidermophytin inguinale dhe në lëkurën e mbushun me fokë lanugo. Në tre raste u konstatuar edhe prekja e folikulit të fokusit nga epidermofytia. (Heft 2)

*A.M. Arieviç:* autor i ven disa pyetje reth klinikës, diagnostikës, mjekimit dhe profilaksisë së mykozave të kambëve dhe thotë se shumica e dermatologëve anojnë me i konsideru syndromet dysidrotike të durve dhe të kambëve si epidermofyt. Si mbas të dhënave të tij 1/3 e të sëmurëve kanë epidermofyt kurse pjesa ma e madhe vijnë nga dermatozet e ndryshme. Kur procesi lokalizohet në palat interdigital me maceratione të lëkurës, me erozione, ragade dhe të krumë atëhere kemi ma tepër të bajm me ekzemën dyhidrotike, me pyodermit ose me infeksione stafylokoksike banale. Në pranverë dhe në vjeshtë konstatohet ndër të rinxjë Dysidrosis lamellosa sicca. Në kto vitet e fundit konstatohen psoriasis me lokalizim në shuplakat e durve dhe në shojet e këmbëve që kanë një formë të thatë hyperkeratotike që të kujton rubrofytin ose ekzemën tylotike kurse forma eksudative (psoriasis pustuloza) i nganjë ekzemës dysidrotike. Kto gabime diagnostike, të shpien shpesh në insukses të terapisë. Tek ekzema, psoriasis dhe keratodermija asht tipike symetriciteti. Nji randësi të madhe ka lokalizacioni. Diagoza e epidermophytisë Kaufmann-Wolf vihet me anën e vezikulave, erozioneve dhe deskuamimeve që shifen në pjesën dorsale të kambës dhe të gishtrijave, në kandin e përparshcm të shollës dhe të thundrës në pikat aksilare dhe në regionin e axiles. Disa herë konstatohet epidermophytija dhe ekzema njikohësish në kambë. Randësi ka aplikimi i provës intra-dermale me epidermophytin. Për mjekim përdoren pasta dhe pomada me mjete fungicide dhe desensibilizimi në koncentracione të vogla. Kur kemi rubrofiti do të përdoren në mënyrë energike mjete keratolytike. Rubrofitija nuk është e pa shërushme së paku ashtu nevoja të përdoren tre kura dhe mbasi konstatohet se mjekjet fungicide zhvillojnë një rezistencë kundrejt parazitëve, këshillohet që kjo preparate ti ndryshojmë vazhdimisht. Autori këshillon që një preparat të mos përdoret ma lepër se 10-14 ditë. Disa herë asht nevoja që kjo preparati të jenë fungicide dhe baktericide. Mjaft i vështirë është mjekimi i onychiomyzozave. Rezultate të mira kemi kur përdoret grizeofulvinë një kohësish me mjete fungicide dhe keratolytike. Grizeofulvinë autor i jep për 6-8 javë nga 4 tablete në ditë prej 0.25 Gr. Së fundi jepen masa profilaktike përkundrejt infeksionit të mykozave dhe qëqat nevojën e domosdoshme të dizinfektimit të përditshëm të banjave dhe të dhomave.

*P. Rimbaud* dhe *J.A. Rioux:* Autorët përdorin përmjekimin lokal të pityriasis versicolor një pomadë me grizeofulvinë 5%<sup>a</sup> dhe 2.5%<sup>b</sup> solucion alkootik. Pjesa më e madhe u shërue por u vunë re edhe recidiva pa shkaktu komplikacione si acarime dhe reaksione alergjike. Autorët besojnë se ktu nuk kemi vetëm një veprim fungista-tik por duen të Juajn rol edhe mekanizma të tjera për shërimin e sëmundjes.

*C. Schirron:* Autori përmend se dermatomykozet vihen re si tek shtazëll ashtu edhe tek njerëzit dhe se infeksionet e shtazave janë të shpeshita. Këta shërbjenë shpesh si burim infeksioni për njerëzit. Infeksioni kryhet me ndërmjelësinë e shtazave shtëpijke sikur asht macia, qeni dhe shtazët e laboratorit. Kto të fundit shka-

këtojnë infeksione edhe në qoftë se skanë ndonjë shenjë të dukëshme klinike. Për të sigurue pastërtinë e terreneve kulturale Dr. C. Schirren rekomandon me i fut ktyne cycloheximid. Së fundi thotë se mjekimi i mykozave në shtazë me grizeofulvinë jep rezultate më të mira.

**D. Janke:** rekomandon terrenin e thatë me agar maltose të Saboraudit të firmës Merk përkultivimin e mykozave. Për vërtetimin e parazitave mikroskopikisht, autori vlerëson mjaft ngjyrasjen e preparateve native me solucionin e Amanit (acid carbol 20.0, acid lactic 20.0, glycerin 40.0 Baumwollblau 0.1, aqua des.ad 100.0) në vend të solucionit hydroxit të kaliumit. Me solucionin e Amannit ngjyrasen mirë dhe preparatet e pityriasis versicolor. Për injekimin e infeksioneve sekondare bakteriale të mykozave, këshillon që të përdoret një lloj peniciline e re në mënyrë orale (a-Phenoxy-n-propyl-penicillin-Kalium Bayer), mbasi nuk stimulon ritjen e para-ziteve.

**W. Meinhov:** Autori mbas tre vjet praktike thotë se injekimi me grizeofulvinë të Onykomkyozave, tue përfshi edhe ato të gishtrinje të këmbës, shërohen me kët medikament pa extracion të thonjve. Vatrat që nibeten eventualisht mund të priten pjesërisht ambulatorisht. Sasia e grizeofulvinës nuk mund të jepet në mënyrë ske-matike por do të veprohet në mënyrë individuale. Disa herë të sëmurët mund të shërohen me doza të vogla kurse në raste të tjera doza e grizeofulvinës do të rifet 1,5-2 gr. Rëndësi të madhe ka që para rji injekimi me grizeofulvinë, të bëhet diagno-juventibus.

**Hans-Kristian Krogh:** Autori ka injekku 5 të sëmurë me grizeofulvinë të zakon- shëm dhe me grizeofulvinë të imitë tue përdor në këtë rast gjysmën e dozës. Dihet se preparati i përdorur deri sot i grizeofulvinës ka një madhësi prej 10  $\mu$  dhe në rast se kjo madhësi zbret në 2.7  $\mu$  atëherë medikamenti ka mundësi të resorbohet shme. Mjekimi zgjati 6 javë. Rekomandohet pra që të përdoret grizeofulvina e imit me gjysmën e dozës për injekimin e dermatomykozave.

(Përmblehdhë nga doc. K. Kërciku)

# JETA SHKENCORE

## U MBROJTËN TRE DISERTACIONE

Krahas punës pedagogjiko-mësimore në fakultet një zhvillim të kënaqshëm ka marrë dhe puna shkencore. Një pjesë e temave shkencore u paraqit nga autorët si materjal për disertacion. Në vijim të kësaj pune të vëmendëshme nga ana e disa punonjësve të fakultetit kët vit u lejuan të mbroheshin tre disertacione.

Disertacioni i parë u mbrojt nga dermatovenerologu me eksperiencë Shuquri Basha me temën «Sifilizi në qarkun e Beratit». Autori në disertacion paraqet përfundimet e tij 10 vjeçare në studimin dhe luftën kundër sifilizit që në qarkun e Beratit ishte me një morbozitet të theksuar gjë para pakë vjetësh. Sh. Basha është përpjekur në studimin e tij të zbulojë rrugët e prejardhjes së sëmundjes nga pikpamja historike, përpjekjet e pamjaftuarshme për kurimin e të sëmurëve gjatë regjimeve antipopulllore dhe kujdesin e thellë gjë rreth e sëmundjes gjatë pushtetit popullore. Përsa i përket prejardhjes ai nuk arrin në përfundim lidhur me lashtësinë e sëmundjes por nga fakti se vendi ynë nuk ka qënë kurrë i izoluar duke filluar që nga periudhat më të lashta, kanë egzistuar mundësitë e përhapjes së sëmundjes. Format që autorri ka gjetur i ka ndarë në dy: Në qytet, si rjedhim i prostitucionit të toleruar në të kaluarën dhe nga mungesa e një mjekimi të pamjaftuarshëm, sëmundja paraqitej në forma primo-sekondare, kurse në fshat predominon format terciare destruktive si rjedhim i mungesës absolute të mjekimit. Shtatë kapitujt e tjerë të disertacionit Sh. Basha i a kushton punës së madhe për depistimin e sëmundjes dhe masave kundër saj në periudhën 1948-1957. Ai jep shifra e fakte për rezultatet e harjitura dhe përfundon duke theksuar se është zhdukur krejtësisht sifilizi genital dhe ai ekstragenital. Në disertacion bëhen një sërë rekomandime interesante për zbulimin dhe luftimin e rasteve latente e kongenitale që eventualisht mund të rezultojnë në persona pasardhës të sifilitikëve.

Patiologu Përparim Tepelena mbrojti disertacionin me temë: «Disa të dhëna mbi veprimin metabolik dhe përdorimin praktik të ujit mineral të Glinës». Nga kjo temë autorri studjon disa aspekte të veprimit metabolik të këtij uji mineral në mjekimin e urolitiazavc. Meqenëse faktorët kurortologjike (balnealogji) dhe ujërat minerale janë në vetvete një urë që lidh mjekësinë profilaktike me atë kurative, studjoi efektin e ujit mineral të Glinës dhe mundësitë praktike të përdorimit të tij. Nga përfundimi i materjalit të tij eksperimental disertanti vërtetoi se uji mineral i Glinës e shton diurezen në krahasim me ujin e zakonshëm të Selitës tek qëntë e lepujt e marrë në eksperiment. Nga përpunimi i të dhënave të sasive të klorurit të natriumit dhe azotit të eliminuar në urinë nga të sëmurët me urolitiazë që i janë nënshtuar mjekimit në Glinë, rezulton se ky i fundit jep një ngritje të vogël të sasisë së klorurit të natriumit të dhe azotit të eliminuar gjatë dy orëve të para pas marrjes së ujit.

Nga krahasimi i të dhënave me ujin e Peshkopisë afër Glinës dhe që përdoret si uj i zakonshëm del se diferenca e klorurit të natriumit dhe azotit vjen nga shtimi i diurezes me ujin e Glinës. Autori i disertacionit nënvizon se nga 125 të sëmurë me urolitiazë të observuar, 12 prej tyre kanë eliminuar gurë urinarë. Veç kësaj, në disertacion jepen edhe një numur të dhëna mbi përmirësimin objektiv të atyre të sëmurëve që kanë vazhduar kurat.

Në disertacionin e Josif Adhamit me temë: „Poliserozitet tuberkulare (etiopatogjenezen, klinikën dhe mjekimin si mbas të dhënave të spitalit klinik të Tiranës), ka marrë në studim 71 të sëmurë të cilët pasi kanë përfunduar kurat ka vazhduar t'i mbajë në observacion prë afro 1-5 vjetë. Pas përfundimit të studimit, autorë i ndërtuan skemën e tij të klasifikimit të peritoniteve, që ndryshon nga ato egzistuese. Ai konkludon se poliserozitet janë polietiologjike, por faktori kryesor etiologjik është tuberkulozi, këtu duhet të mos harohet roli i bacilit të tipit bovin i cili shkakton poliserozitë që janë më të zgjatur e recidivante. Docent J.E. Adhami nënvizon në disertacionin e tij se poliserozitet primare të ri ose kronike ku rolin kryesor e lot komponentja linfonodulare e kompleksit primar. Rruga kryesore e shpërndarjes është linfoematogjene, kurse drejtimi i përhapjes mund të jetë ashendent dhe transversal, koncentrik ose eksentrik. Barra dhe laktacioni, megjithse janë procese fiziologjike, ndikojnë shumë në zhvillimin e manifestimeve patologjike, prekja e organeve genitale të femrave është bashkëudhëtare e shpeshtë e peritonitit tuberkular. Autorë i disertacionit ka paraqitur rezultatet e mjekimit me preparate antibakteriale të kombinuar me kortizonike dhe tregon se eksudatet e serozave të ndryshme resorbohen shumë më shpejt se sa atëherë kur mjekoheshin vetëm me preparate antibakteriale. Kjo ka një rëndësi të dorës së parë për të evituar aderencat, veçanërisht në rastet me perikardit.

Në fund J.E. Adhami nxjerr një numur konkluzionesh shumë të rëndësishme e me vlerë të madhe praktike në luftën kundër kësaj sëmundjeje.

A. Rapo

### SESSION SHKENCOR PËR NDER TË XX VJETORIT TË ÇLIRIMIT

Këshilli shkencor i Fakultetit të Mjekësisë, për nder të XX vjetorit të çlirimt të Atdheut, organizoi një sesion shkencor të randësishëm. Në sesion muarnë pjesë veç punonjësve të Fakultetit, institucioneve shëndëtësore të Tiranës dhe të ftuar nga rrrethet e tjera të vendit. Sesiuni i zhvilloi punimet në 8 seksione të ndryshme ku u dëgjuan me vembendje 85 kumtesa në profilet e ndryshme mjeksore.

Ndërsa sesionet e organizuara në të kaluarën nuk kanë patur karakter problematik për vetë kushtet objektive të nevojave urgjente në preqatjen e kuadrit dhe eksperiencës së pakët, në këtë sesion u dëgjuan referate e kumtesa për probleme të parashikuara në planin e gjatë të punës shkencore të fakultetit. Të tilla kumtesa mund të përmendim mjaft si: Strumen në vendin tonë, cirozat hepatike, ekinokokoza, urolitiazat, tuberkulozi etj. Me një fjalë u paraqitën rezultatet e pjesëshme të punonjësve mësimorë-shkencorë efektivë dhe të jashtëm të fakultetit mbi probleme që preokupojnë organet tona të shëndetësisë përuajtjen dhe forcimin e shëndetit të popullit. Niveli i kumtesave të paraqitura në seksionet e ndryshme nuk tregoi vetëm karakterin problematik të planifikuar mbi të cilin punojnë shkencëtarët tanë të mjekësisë, por dhe përpjekjet e suksesëshme për analizë, përgjithësimë dhe sinteza interesante lidhur me studimet që kanë në dorë. Ky është një hap i madh përpara i punonjësve tanë mjekësorë të cilët nga etapa e parë e grumbullimit të materjalit eksperimental, klinik apo dhe statistikor dhe përshkrimi i tij, filluan të bëjnë analiza të thella dhe përgjithësimë teorike e praktike si faza të domosdoshme të një pune shkencore të fryshtësime.